

Univeristeti i Tiranës
Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë
Departamenti i Gjuhës Shqipe

Doktoratë

**Titulli: LEKSIKU VERIPERËNDIMOR I GJUHËS
SHQIPE PËRMES AUTORËVE BARDHI, GAZULLI E
DEMA.**

Udhëheqës shkencor:
Akad.as/prof.dr.Gjovalin Shkurtaj

Doktorante:
Ma.Anisa Kosteri

Tiranë, 2013

Doktoratë

Përgatitur nga: Anisa Kosteri

Për marrjen e gradës shkencore “Doktor”

Specialiteti: Gjuhësi (dialektologji)

**Titulli:LEKSIKU VERIPERËNDIMOR I GJUHËS SHQIPE
PËRMES AUTORËVE BARDHI, GAZULLI E DEMA.**

Udhëheqës shkencor: Akad. as/prof. dr. Gjovalin Shkurtaj

Mbrohet me, dt.____. ____ ._____ para jurisë:

1. _____(Kryetar)

2. _____(Anëtar)

3. _____(Anëtar)

4. _____(Anëtar)

5. _____(Anëtar)

Platforma

I. Hyrje	5
----------------	---

Kreu I

1. Vështrim historik e kulturor i krahinave veriperëndimore të shqipes dhe vatërzimi i qendrave të shkrimtarisë së vjetër shqipe (që nga Buzuku-Bardhi.. deri te B. Dema)	9
2. Roli i klerit zadrimer e më gjerë për pohimin dhe lëvrimin e gjuhës shqipe .	14
3. Përshkrim i fjalorëve dialektorë - krahinorë në përgjithësi dhe vendi i tre fjalorëve (Bardhi, Gazulli, Dema) në veçanti	18
4. Fjalori i Frang Bardhit dhe vlerat e tij si i pari ballafaqim i shqipes me një gjuhë të madhe, siç ishte latinishtja	21
5. Fjalori i Frang Bardhit dhe struktura e tij. Areali gjuhësor i Fjalorit të Bardhit.....	24
- Proverbat.....	29
6. Roli i Frang Bardhit si i pari leksikolog e leksikograf i gjuhës shqipe. Prurje gramatikore në Fjalorin e Bardhit.	30
7. “Fjalori i ri” i Nikollë Gazullit dhe përfaqësimi në të të folmeve veriperëndimore. Pasuria dhe gjerësia e tij, vlera njohëse dhe pohuese e pasurisë leksikore të shqipes veriperëndimore në atë fjalor.	35
8. Valenca leksikore në disa lema të Fjalorit të Gazullit	37
9. Malësia e Madhe dhe Gropa e Shkodrës si vatra kryesore e leksematikës së Gazullit. Kundrim tipologjik, tematik dhe strukturor.	49
10. Fjalori i Benedikt Demës.	55
11. Dema si figurë e dijetarit enciklopedik. Fjalori i B. Demës si maja e ajsbergut e punës vigane mbledhëse e studimore.	66

Kreu II

1. Veçori leksikore të Fjalorëve:	
1. a. Disa karakteristika leksikore të Fjalorëve	73
1.b. Shtresa e huaj e Fjalorëve	84

- Turqizmat	91
- Italianizmat	106
- Sllavizmat	110

Kreu III

1. Leksiku autorëve (Bardhi, Gazulli, Dema) që ka gjetur pasqyrim në fjalorët shpjegues të shqipes.	118
--	-----

1.1. Fjalori i Bardhit

- Fjalë që nuk janë përfshirë në Fjalorët 1954, 1980.	118
- Fjalë me kuptim shtesë, të shpjeguara në Fjalorët e viteve 1954, 1980.	122
- Fjalë që përfshihen vetëm tek Fjalori i 1954.	126
- Fjalë që përfshihen vetëm tek Fjalori i 1980.	128
- Fjalë që janë përfshirë në të dy Fjalorët ('54,'80).	129

1.2 Fjalori i Gazullit

- Fjalë që nuk janë përfshirë në Fjalorët 1954, 1980.	138
- Fjalë me kuptim të ndryshëm nga Gazulli.	145
- Fjalë me kuptim shtesë, të shpjeguara në Fjalorët e viteve 1954,1980.	147
- Fjalë që përfshihen vetëm tek Fjalori i 1954.	152
- Fjalë që përfshihen vetëm tek Fjalori i 1980.	156
- Fjalë që janë përfshirë në të dy Fjalorët ('54,'80).	160

1.3 Fjalori i Benedikt Demës

- Fjalë që nuk janë përfshirë në Fjalorët 1954, 1980.	168
- Fjalë me kuptim të ndryshëm.	173
- Fjalë me kuptim shtesë, të shpjeguara në Fjalorët e viteve 1954,1980.	174
- Fjalë që përfshihen vetëm tek Fjalori i 1954.	176
- Fjalë që përfshihen vetëm tek Fjalori i 1980.	177
- Fjalë që janë përfshirë në të dy Fjalorët ('54,'80).	179

2. Përfundimet	185
----------------------	-----

3. Bibliografia	195
-----------------------	-----

I. HYRJE

Si objekt të kësaj teze kemi vënë nxjerrjen në pah të leksikut veriperëndimor të shqipes përmes autorëve Frang Bardhi, Nikollë Gazulli e Benedikt Dema. Të tre këta autorë, leksikografë, fjalorët e të cilëve, në llojin e tyre të veçantë, kanë pasqyruar të folmen e gegërishtes veriperëndimore, leksikun e të folmes së Malësisë së Madhe dhe zonave përreth saj, duke përfshirë edhe qytetin e Shkodrës; më së pari, për arsye se të tre janë folës të lindur të kësaj të folmeje.

Të folmet veriperëndimore të shqipes shtrihen nga Plava e Gucia në Veri deri në Mat në jug, nga Tivari e Ulqini në perëndim deri në Nikaj –Mërtur e Pukë në lindje.

Në këtë grup të folmesh bëjnë pjesë të folmet e Malësisë së Madhe, Kelmendit, të Hotit, të Kastratit, të Shkrelit, të Buzës së Ujit, të Koplikut, të Grizhës, të Lohes, të Reçit, të Rrjollit, të Shalës, të Shoshit, të Pultit, të Postribës, të Shllakut, të Temalit, të Shkodrës, të Bregut të Bunës, të Bregut të Drinit dhe të Zadrimës.

Pjesa më e madhe e këtyre të folmeve janë tashmë të njohura e për të cilat ka studime monografike të botuara, si p.sh. për Shkrelin nga B.Beci,¹ për Kastratin,² Hotin,³ Kelmendin⁴ dhe Rranxat e Mbishkodrës⁵ ka shkruar monografi e artikuj problemore Gj.Shkurta; për Bregun e Bunës⁶ ka shkruar J.Gjinari, për Postripën⁷ ka botuar një studim monografik F.Luli, kurse për qytetin e Shkodrës⁸ kemi studimin për sistemin fonetik e fonologjik të saj nga B.Beci. Për të folmen e Shirokës⁹ ka shkruar T.Osmani. Prej të folmeve të Shalës kemi vetëm punimin për disa tipare të së folmes së Thethit¹⁰ nga J. Kastrati, si dhe të dhënat e anketimeve për “Atlasin Dialektologjik të gjuhës shqipe” në shumë pika.

Sa i takon veçorive gjuhësore të kësaj të folmeje, mund të përmendim:

- diftongjet e vjetra *ae* dhe *oe* përmes një krasis kanë kaluar në *æ* dhe *ø*: *thæ*, *vø*, *vøs*, *ngæ* etj.
- grupet e vjetra *kl*, *gl* kanë dhënë *ki* e *gi*: *kiumsht*, *giuni*, *i giat*, *kiaj* etj.
- grupi *fsh* është thjeshtuar në *sh*: *mnash*, *kiosha*, *shijse* etj.
- rrjedhorja e emrave femërorë njëjës të pashquar del me *-et*: *mish lopet*, *djal Shkodret* etj.
- përdorimi i grupit *nistor vo* : *voj*, *i vorfën*, *votër* etj.
- mungesa e rotacizmit si në mbarë toskërishten: *râna*, *ullîni*, *bâna* etj.
- ruajtjen e *a* hundore në vend të *ë*: *nâna*, *bâna*, *râna*, *të tâna* etj. Toskërishtja me kalimin e njohur në *ë*, përkatësisht, *nëna*, *bëra*, *rëra*, *të tëra*.

Këto veçori gjuhësore janë mirëfilli të pasqyruara relativisht gjërë edhe në Fjalorët e marrë në shqyrtim, lënda e të cilëve vjen pikërisht prej trevave të lartpërmendura.

¹ B.Beci, *E folmja e Shkrelit*, “Dialektologjia shqiptare” I, Tiranë 1971.

² Gj.Shkurta, *E folmja e Kastratit*. “Studime Filologjike”, 2, 3, Tiranë, 1967.

³ Gj. Shkurta, *E folmja e Hotit*, “Dialektologjia shqiptare” II, Tiranë, 1974.

⁴ Gj.Shkurta, *E folmja e Kelmendit*, “Dialektologjia shqiptare” III, Tiranë 1975.

⁵ Gj.Shkurta, *E folmja e Rranxave të Mbishkodrës*, “Dialektologjia shqiptare” IV, Tiranë 1982.

⁶ J.Gjinari, *Vëzhgime mbi të folmen e Bregut të Bunës*, “Dialektologjia shqiptare” I, Tiranë, 1971.

⁷ F.Luli, *E folmja e Postripës*, “Studime Filologjike”, 3, Tiranë, 1974.

⁸ B.Beci, “Të folmet veriperëndimore të shqipes dhe sistemi fonetik i së folmes së qytetit të Shkodrës”, Tiranë, 1995.

⁹ T.Osmani, *Shënime për fonetikën e së folmes së Shirokës* në “Buletin Shkencor i Institutit Pedagogjik 2-vjeçar të Shkodrës”, Shkodër, 1965.

¹⁰ J.Kastrati, *Mbi disa tipare të së folmes së Thethit*, në “Konferenca I e Studimeve Albanologjike”, Tiranë, 1965.

Leksikografia dialektore është një degë e re e gjuhësisë shqiptare. Intensiteti i botimeve në këtë fushë rritet ndjeshëm vetëm në vitet e fundit, të cilët shquhen për prurje të madhe e të larmishme fjalësh, kuptimesh e frazeologjish dhe për një ngritje të dukshme të nivelit të tyre shkencor, sidomos të atyre që kishin mbetur dorëshkrime dhe u botuan vitet e fundit, siç ishte edhe Fjalori i B.Demës. Në gjuhën shqipe kemi në përdorim shumë fjalorë dialektorë.

Ata mbartin lëndë leksikografike jo vetëm të pasur, por edhe interesante, mbi të cilën mund të ndërmerren studime nga disiplina të ndryshme gjuhësore dhe jogjuhësore.

Së pari, kemi **Fjalorin latinisht – shqip**, të Frang Bardhit, botuar në vitin 1635. Është vepra, e cila e bëri të zërë një vend themelor në leksikografinë shqiptare, ku do të shërbente si bazë për hartimin e fjalorëve të tjerë gjuhësorë.

Veç kësaj, kjo ka një vlerë të pallogaritshme gjuhësore, pasi është një pasqyrë e leksikut popullor të shek. XVI-XVII. Si bazë për Fjalorin e Bardhit, u mor gjuha kishtare latine, sepse ishte e nevojshme, që të gjithë njerëzit që i shërbenin kishës, të dinin latinisht.

Fjalori i Bardhit ka rëndësi të madhe historike në leksikografinë shqiptare me anët e veta pozitive dhe mangësitë e kohës, sepse në të mund të shihen mirëfilli ndryshimet që ka pësuar gjuha në rrjedhë të shekujve.

Sigurisht që vlerat pozitive janë ato që e karakterizojnë këtë vepër prej pionieri duke e vlerësuar Bardhin si leksikografi, i cili mori përsipër të pasqyronte pasurinë leksikore të gjuhës së vet. Nëse e vështrojmë sot Fjalorin e Bardhit, i botuar 400 vjet më parë, nga majat që ka arritur leksikografia shqiptare në hartimin e fjalorëve, do të na dukej një vepër me përmasa të rrudhura e me prurje të pakët gjuhësore, por duke marrë parasysh kohën dhe periudhën kur u krijua, mund të themi se fjalësi i Fjalorit të Bardhit përfshin bërthamën leksikore të gjuhës shqipe si dhe të parë me rëndësi të madhe potenciale edhe për bazat e një gramatike shqip. Kjo vlerësohet edhe nga Kostallari si e para përqsaje e pranëvënies e korpusit leksikor të një gjuhe të madhe të kohës,” latinishtes” me shqipen, ende në hullitë e para të lëvrimin të saj.

Nga Dom Nikollë Gazulli kemi “**Fjalorthi i ri**” (fjalë të rralla të përdorura në Veri të Shqipnisë), Qershor, 1941, i cili mund të thuhet se shënoi dhe lindjen e leksikografisë dialektore shqiptare.

Ishte viti 1941, një datë e mbarë për historinë e leksikografisë shqiptare, sepse po atë vit (1941) kemi edhe botimin e “ **Fjalorth i ri** “ i Pano Tases, i cili përmbante fjalë nga e folmja e Përmetit, si dhe disa shprehje, urime e mallkime të kësaj treve.

Dom Nikollë Gazulli (1891-1946), rreshtohet ndër dijetarët me emër të gjysmës së parë të këtij shekulli, më së shumti si gjuhëtar. I shkolluar dhe ai në Insbruk si i vëllai, Gjon Gazulli, i pajisur me kulturë gjermane, qe një shkencëtar me fizionomi të plotë në lëmë të gjuhësisë. Hartoi dy vepra origjinale leksikografike që i botoi në serinë e “Visareve të Kombit” dhe në revistën “Hylli i Dritës”, përkatësisht: “*Fjalori i fjalëve të rralla të malësive veriore*”¹¹ dhe “*Fjalori toponomastik.*”¹² Si leksikograf solli ndihmesë të shquar në gjuhësi sepse e pasuroi njohjen e sinonimisë krahinore të leksemave bazë të shqipes, gërmoi edhe në aspekte të hollësishme të tematikës së sferave jetësore parësore, si fjalë të bujqësisë, të blegtorisë, të zejtarisë popullore dhe aty-këtu dhe të frazeologjizmave përkatëse. Nikollë Gazulli ishte i dhënë edhe pas folklorit dhe historisë, fusha në të cilat boton shkrime, këngë të moçme etj. “Fjalorthi i ri” i Gazullit, së bashku me “Fjalorthin e ri, fjalë të rralla të përdoruna në Jug të

¹¹N. Gazulli, “Fjalori i Gazullit”, Tiranë 2005.

¹² N.Gazulli, “Fjalori toponomastik”, botuar pjesë – pjesë në revistën “Hylli i dritës” nga viti 1939 – 1943.

Shqipnis”, Tiranë, 1941, (“Visaret e Kombit”, vëllim XII) të Pano Tases, janë të parët fjalorë krahinorë në leksikografinë shqiptare.

Fjalori i gjuhës shqipe 1954 dhe ai i Benedikt Demës, i cili u botua për herë të parë në vitin 2005, u mbështetën bindshëm në Fjalorin e ri të Gazullit.

Së bashku me Fjalorin e tij Latinisht –shqip, botuar më 1635, të Bardhit është i pari libër shqip që dimë të ketë dalë nga shtypshkronja e Propaganda Fides dhe Fjalori i parë i njohur i gjuhës sonë, me rreth 2500 fjalë, të cilin Kolë Ashta e ribotoi me një renditje të re. Veç kësaj, kjo ka një vlerë të pallogaritshme gjuhësore, pasi është një pasqyrë e leksikut popullor të shek. XVI-XVII. Në të përfshihen fjalë nga leksiku veriperëndimor, kryesisht Zadrime e Malësia e Madhe.

Këtë Fjalor Bardhi e hartoi me qëllimin që të lëvrohej gjuha shqipe e të pasurohej larg bastardhimeve e prishjes së saj, si dhe për të lehtësuar punën e atyre që donin të shkruanin shqip me qëllimin e përhapjes së fesë së tyre.

“Fjalorthi i ri” i Gazullit, botuar më 1941, merr vlera duke qenë i pari fjalor krahinor i gegërishtes botuar deri më sot. Përfshin fjalë të rralla, disa nga ato edhe të padëgjua në veri të Shqipërisë, kryesisht pjesës veriperëndimore. Për hartimin e këtij Fjalori, mësohet se autori pati një letërkëmbim të ngushtë me Joklin dhe bashkëpunim të ndërsjellë të fjalorëve, sepse ndërkohë që Gazulli përfundonte “Fjalorthin” e tij, Jokli po përfundonte “Fjalorin etimologjik të Shqipes”. Gazulli ishte një erudit në kuptimin e plotë të fjalës, njohës i disa gjuhëve të huaja, të cilën e pasqyron qartë se shumë fjalëve në Fjalor u jep korresponduesen e tyre në latinisht, italisht, gjermanisht, greqisht dhe sllavisht. Vitet në të cilat u la në harresë emri i Nikollë Gazullit dhe Fjalori i tij, shënojnë një errësirë të vetë personalitetit të Gazullit, i cili doli në dritë vetëm pak vite më parë, vetëm kur pau dritën e botimit dhe vlerësimit të tij si figurë e madhe gjuhësore. Për shumë vite emri i Gazullit nuk u përmend, madje në shumë citime, si të gjuhëtarëve të mëdhenj: Xhuvani apo Çabej, shënohej vetëm “G”, “Fjalorth i ri”, ose “Shkodër 1941”.

Benedikt Dema, edhe ky një tjetër leksikograf i cili u mor gjerë me hulumtime në trevat veriperëndimore në lëmë të shqipes, u la në harresë bashkë me Fjalorin e tij, deri në vitin 2005 kur u botua nga shtëpia botuese “Toena”, na la një fjalor krahinor, që shërben padyshim si bazë e mirë për një punë studimore të pasur gjuhësisht. Duhet shënuar se kohët e fundit, shkrimtari francezkan At Zef Pllumi, në botimin e XV të veprës epike të Gj.Fishtës “Lahuta e Malcis”, ka përfshirë si shtojcë edhe një fjalor të fjalëve të rralla dhe me shumë kuptime, që gjenden brenda poemës së madhe, shpjeguar nga B.Dema. Ky fjalor ka 1361 fjalë nga të cilat pjesa më e madhe janë të brumit të shqipes, por nuk qëndrojnë pas edhe huazimet nga turqishtja, ndërsa fjalë të burimit sllav gjenden në numër më të vogël. Fjalori Benedikt Demës, për të cilin po shkruajmë, u përfundua në vitin 1966, me qëllim botimin, por nuk doli në dritë deri në ditët e sotme.

Siç thekson edhe vetë autori, ky Fjalor është një shtesë e fjalëve që i bëhet Fjalorit të gjuhës shqipe, 1954, duke përfshirë shumë lema që nuk përmenden, ose që kanë një kuptim të ndryshëm nga ai i pasqyruar në Fjalorin e ’54.

Për hartimin e këtij Fjalori, ai u mbështet tek “Fjalori i Bashkimit”, 1908, “Fjalorthi i Gazullit” 1941, tek disa vepra të Fishtës e Kanuni i Lekë Dukagjinit, duke mos lënë pa përmendur edhe punën e vyer studimore që ka mbledhur vetë autori prej gojës së popullit.

Fjalësi i këtij Fjalori pasqyron të folmen e gegërishtes veriperëndimore, zonën e Shkodrës e Malësisë së Madhe me rethinat e saj.

Vend me rëndësi në këtë Fjalor zënë edhe neologjizmat, fjalë të krijuara nga vetë autori, të cilat i japin kësaj vepre një veçanësi me vlerë të madhe, që meritojnë një

trajtim më vete. (Lidhur me termin “neologjizëm”, mbështetemi në shënimin që autori bën për fjalë të tilla, me një * majtas).

Siç vërehet, të tre këta autorë të shënuar të leksikografisë shqipe na lanë një trashëgimi të pasur leksikore, ku secili prej tyre është “i pari” në llojin e vet.

Fjalori i Bardhit përbën Fjalorin e parë të mirëfilltë dygjuhësh shqip – italisht, Gazulli na la Fjalorin e parë krahinor (të gegërishtes veriperëndimore), Dema, gjithashtu, i pari në llojin e vet, sepse me punën e tij hulumtuese, na pasqyroi një shtesë fjalësh që nuk ekzistonin në “Fjalorin e gjuhës shqipe” të vitit 1954, ose që kishin kuptime të ndryshme nga ato që gjenden tek ky Fjalor.

E përbashkëta e këtyre autorëve ishte, se të tre ishin priftërinj, kishin kryer shkolla të larta teologjike dhe të tre u morën me gjuhësi, thjesht, nga pasioni dhe dëshira për të dëshmuar pasurinë e thesarin e paçmuar të shqipes; nga ana tjetër, duhet thënë se të tre këta autorë kishin edhe përgatitje filologjike në atë shkallë, sa t’ia dilnin mbanë ndërmarjes së tyre. Bardhi e Dema, kishin një kulturë latine e neolatine, kurse, Gazulli, përveç përgatitjes klasike, mori edhe shumëçka nga gjuhësia e filologjia gjermanike. Këta autorë dhanë një ndihmesë të vyer në lëmë të leksikografisë, duke hyrë në historinë e leksikografisë shqiptare me një vend të besueshëm e që u shërben edhe sot hulumtimeve e kërkimeve rreth leksikografisë krahinore e më gjërë. Së fundi, ajo që pa dyshim, i bashkon autorët e mësipërm, është fakti që pasqyruan në veprat e tyre, me fjalësin e regjistruar, veçoritë e qenësishme të së folmes perëndimore të dialektit të gegërishtes veriore.

Më jepet rasti këtu të falenderoj gjithë pedagogët e mi që punuan për formimin tim shkencor, pedagogët e USh, të Universitetit të Tiranës për studimet “Master”, si dhe në mënyrë të veçantë udhëheqësin shkencor, Akademik i Asociuar, Gjovalin Shkurtaç për formulimin e tezës, platformën e saj, metodikën e zhvillimit dhe për ndihmën e pamungueshme që më ka ofruar për realizimin e kësaj teze. Falënderoj, gjithashtu, kolegët e mi të nderuar të Departamentit të Gjuhës shqipe të USH-së dhe të UT-së, që, janë treguar të gatshëm për çdo kërkesë timen, për literaturë ose këshillim.

Kreu I

1. Vështrim historik e kulturor i krahinave veriperëndimore të shqipes dhe vatërzimi i qendrave të shkrimtarisë së vjetër shqipe (që nga Buzuku-Bardhi...deri te B.Dema).

Të folmet veriperëndimore të shqipes shtrihen nga Plava e Gucia në Veri deri në Mat në jug, nga Tivari e Ulqini në perëndim deri në Nikaj –Mërtur e Pukë në lindje.

Në këtë grup të folmesh bëjnë pjesë të folmet e Kelmendit, të Hotit, të Kastratit, të Shkrelit, të Buzës së Ujit, të Koplikut, të Grizhës, të Lohes, të Reçit, të Rrjollit, të Shalës, të Shoshit, të Pultit, të Postribës, të Shllakut, të Temalit, të Shkodrës, të Bregut të Bunës, të Bregut të Drinit dhe të Zadrimës.

Pjesa më e madhe e këtyre të folmeve janë tashmë të njohura e për të cilat ka studime monografike të botuara, si p.sh. për Shkrelin nga B.Beci,¹³ për Kastratin,¹⁴ Hotin.¹⁵ Kelmendin¹⁶ dhe Rranxat e Mbishkodrës¹⁷ ka shkruar monografi e artikuj problemore Gj.Shkurtaj; për Bregun e Bunës¹⁸ ka shkruar J.Gjinari, për Postripën¹⁹ ka botuar një studim monografik F.luli, kurse për qytetin e Shkodrës²⁰ kemi studimin për sistemin fonetik e fonologjik të saj nga B.Beci. Për të folmen e Shirokës²¹ ka shkruar T.Osmani. Prej të folmeve të Shalës kemi vetëm punimin për disa tipare të së folmes së Thethit²² nga J. Kastrati, si dhe të dhënat e anketimeve për “Atlasin Dialektologjik të gjuhës shqipe” në shumë pika.

Trevat ku fliten të folmet veriperëndimore të shqipes, siç dëshmojnë zbulimet e bëra deri tani, kanë qenë të banuara shumë herët. Në këto vise ka jetuar fisi i madh i Ardianëve. Në shek. II para Krishtit, romakët e pushtuan Ilirinë. Në shek. XII shteti serb u drejtua drejt jugut në Kosovë dhe në Shqipërinë veriore. Përpjekjeve të pushtetit shtetëror e kishtar serb për sllavizimin e territoreve shqiptare në Kosovë, Maqedoni e Mal të Zi popullsia shqiptare u bëri ballë me sukses. Në trevat ku shtrihen të folmet veriperëndimore të shqipes, rreth mesit të shek. XIV u formua principata e Balshjave me kryeqendër qytetin e Shkodrës.

Më 1949 Shkodra, Lezha e Drishti i kaluan Turqisë, kurse Durrësi, Ulqini, Tivari e Butrinti mbetën nën sundimin e Republikës. U krijua më pas një sanxhak i ri me qendër Shkodrën, në kufijtë e të cilit u përfshinë viset e Shqipërisë Veriperëndimore.

¹³ B.Beci, *E folmja e Shkrelit*, “Dialektologjia shqiptare” I, Tiranë 1971.

¹⁴ Gj.Shkurtaj, *E folmja e Kastratit*. “Studime Filologjike”, 2, 3, Tiranë, 1967.

¹⁵ Gj. Shkurtaj, *E folmja e Hotit*, “Dialektologjia shqiptare” II, Tiranë, 1974.

¹⁶ Gj.Shkurtaj, *E folmja e Kelmendit*, “Dialektologjia shqiptare” III, Tiranë 1975.

¹⁷ Gj.Shkurtaj, *E folmja e Rranxave të Mbishkodrës*, “Dialektologjia shqiptare” IV, Tiranë 1982.

¹⁸ J.Gjinari, *Vëzhgime mbi të folmen e Bregut të Bunës*, “Dialektologjia shqiptare” I, Tiranë, 1971.

¹⁹ F.Luli, *E folmja e Postripës*, “Studime Filologjike”, 3, Tiranë, 1974.

²⁰ B.Beci, “Të folmet veriperëndimore të shqipes dhe sistemi fonetik i së folmes së qytetit të Shkodrës”, Tiranë, 1995.

²¹ T.Osmani, *Shënime për fonetikën e së folmes së Shirokës* në “Buletin Shkencor i Institutit Pedagogjik 2-vjeçar të Shkodrës”, Shkodër, 1965.

²² J.Kastrati, *Mbi disa tipare të së folmes së Thethit*, në “Konferenca I e Studimeve Albanologjike”, Tiranë, 1965.

Në periudhën midis viteve 1520-1566 nga sanxhaku i Shkodrës u shkëputën krahinat e Kosovës që formuan një sanxhak më vete, i cili u quajt sanxhaku i Dukagjinit.

Në fillim të shek XVIII sanxhaku i Shkodrës u nda në gjashtë kaza: në atë të Shkodrës, të Ulqinit, të Tivarit, Podgoricës, Plavës dhe Malit të Zi .

Më 1757 në krahinën e Shkodrës dhe në krahinat e tjera të Shqipërisë Veriore u vendos sundimi i Bushatllinjve, që vazhdoi deri më 1831. Me vdekjen e Kara-Mahmutit, humbi edhe autonomia e Pashallëkut të Shkodrës dhe me dorëzimin e Mustafa Pashë Bushatlliut, pashallëku i Shkodrës mori fund.

Turqit ndërmorën zbatimin e reformave kundër të cilave u ngritën masat popullore të fshatit dhe qytetit.

Pas shumë e shumë peripecish, shpallja e pavarësisë më 1912 do ta ndërlikonte edhe më tepër gjendjen politike. Më 22 mars 1913 Konferenca e Ambasadorëve vendosi përfundimisht edhe për kufijtë e Shqipërisë Veriperëndimore, duke shkëputur padrejtësisht nga trugu i saj, ndër të tjera, edhe territoret shqiptare të Plavës, Gucisë, Triepshit, Grudës, Trobainit, Hotit, Kojës, Fundnave, Tuzit, Krajës, Shestanit, Anës së Malit, Ulqinit. Në këtë mënyrë kjo pjesë e territoreve shqiptare iu aneksua Malit të Zi.

Duke kaluar konkretisht tek studimet e të folmeve të shqipes veriperëndimore, zanafillën e tyre e shohim në fillim të shekullit XX, ndonëse të dhënat e tyre nuk paraqisnin siguri shkencore.

Do përmendim këtu Maksimilian Lambercin,²³ rreth relacionit botuar më 1916 për disa veçori fonetike e morfologjike të së folmes së Grudës e Shoshit. Gjatë udhëtimit në Shqipëri vizitoi Grudën, Shkodrën, Lezhën, Krujën, Tiranën, Durrësin, luginën e Kirit, Shoshin, Shalën, luginat e Drinit dhe Valbonës dhe veçanërisht Mirditën.²⁴

Shënime për të folmet e qytetit të Shkodrës ka dhënë Justin Rrota. Gjithashtu, më 1951 Cimohevski botoi monografinë “Dialekti i Dushmanit,”²⁵ vepër e cila ka më tepër karakter përshkrues sinkronik. Kjo vepër përbën botimin më të plotë për sa u përket të folmeve të shqipes veriperëndimore. Me një fjalë, punimet dialektologjike të periudhës para Luftës së dytë Botërore janë të pakta dhe mbulojnë një pjesë të vogël të shqipes veriperëndimore.

Periudha e pasluftës pati disa gjurmime të mëtejshme të këtyre zonave. Këtu duhet përmendur hartimi i dy pyetësorëve nga Mahir Domi, Spiro Floqi, Eqrem Çabej, të cilët shërbyen si pikëmbështetje për këto të folme. U hartuan studime për të folmet e Thethit,²⁶ Shirokës,²⁷ Kastratit,²⁸ Shkrelit,²⁹ Kelmendit,³⁰ Bregut të Bunës,³¹ Postrribës,³² Hotit,³³ Rranxave të Mbishkodrës³⁴ etj.

²³ M.Lambretz, *Bericht uber meine linguistischen Studien von Mittel Mai, bis Ende August 1916*, në “Anzeiger der Akademie Wissenschaft in Wien”, hist. Klasse XX, 1916.

²⁴ A.Haxhi, T.Topalli, *Maximilian Lambertz*, “Leksikon - gjuhëtarë shqiptarë dhe albanologë”, Shkodër, 2012, f.609.

²⁵ W. Cimohevski, “Le dialecte de Dushmani”, 1951.

²⁶ J.Kastrati, *Mbi disa tipare të së folmes së Thethit*, Konferenca I e Studimeve Albanologjike”, Tiranë, 1965.

²⁷ T.Osmani, *Shënime për fonetikën e së folmes së Shirokës*, Buletin Shkencor i Institutit Pedagogjik 2-vjeçar të Shkodrës”, Shkodër, 1965.

²⁸ Gj.Shkurtaj, *E folmja e Kastratit*, “Studime filologjike”, 2,3,Tiranë, 1967.

²⁹ B.Beci, *E folmja e Shkrelit*, “Dialektologjia shqiptare” I, Tiranë, 1971.

³⁰ Gj.Shkurtaj, *E folmja e Kelmendit*, “Dialektologjia shqiptare” III, Tiranë 1975.

³¹ J.Gjinari, *Vëzhgime mbi të folmen e Bregut të Bunës*, “Dialektologjia Shqiptare” I, Tiranë, 1971.

³² F.Luli, *E folmja e Postrripës*, “Studime filologjike” 3, Tiranë, 1974.

³³ Gj.Shkurtaj, *E folmja e Hotit*, “Dialektologjia shqiptare” II, Tiranë, 1974.

³⁴ Gj.Shkurtaj, *E folmja e Rranxave të Mbishkodrës*, “Dialektologjia shqiptare” IV, Tiranë 1982.

Duke filluar nga viti 1978 në territorin e këtyre të folmeve ka filluar mbledhja dhe regjistrimi i materialeve me magnetofon sipas një pyetësori të veçantë për Atlasin Dialektologjik të Gjuhës Shqipe.

Lidhur me vatëzimin e qendrave të shkrimtarisë së vjetër shqipe, së pari u referohemi relacioneve të mbajtura nga prelatët rreth gjendjes së Shqipërisë veriore në shekujt XVI-XII e në vijim.

Kjo kohë për historinë e popullit e të vendit tonë, është periudha kur lufta më shumë se njëqindvjeçare kundër pushtimit turk kishte arritur kulmin.

Kryengritjet e shpeshta të shqiptarëve u kishin shkaktuar vështirësi të mëdha sundimtarëve, por këto kryengritje kishin sjellë një ringjallje në popull, duke mbajtur të gjallë dashurinë për vendin dhe për larminë e tij.

Gjysma e parë e shek. XVII shënon për Evropën shpërthimin e luftës, ku kemi rënien e papatit nga pozitat që kishte fituar në Mesjetë si fuqi botërore, Vatikani themeloi Kongregacionin e Propagandës së Fides (1622). Me këtë institucion Roma mori në dorë jo vetëm shtrirjen e ndikimit të saj në vendet e kolonizuara, por edhe luftën kundër islamizimit në vendet e pushtuara prej Perandorisë Osmane. Në relacionet e Marin Bicit më 1610 dhe ai i Bolicës më 1614, është paraqitur terreni ku do të zhvillohet veprimi misionar si dhe gjendja e saj ekonomike e politike mbi të cilën do të zhvillohet ai veprim. Krahas këtyre ekziston edhe relacioni i Gjec Bardhit mbi gjendjen kishtarë të Zadrimës më 1621, e cila na paraqet krahinën më kryesore mbi të cilën u themeluan më vonë misionet françeskane. Këto relacione janë dëshmitare se Vatikani merrej për luftën e shqiptarëve për çlirim kombëtar.

Më 1622 u themelua Kongregacioni i Propagandës, dhe që prej asaj kohe, veprimi i klerit katolik në vendet e misioneve merret në dorë nga ai.

Më 1634 u themeluan misionet françeskane në Shqipëri, shkak i cili mundësoi shkëmbimin e korrespondencave me Romën.

Relatori Pjetër Mazreku, kur flet për malësorët shqiptarë, shfaq kërkesën ndaj Vatikanit, që të hapeshin shkolla shqipe, në mënyrë që të forconin krishtërimin, i cili do t'i ndihmonte në lidhjet e tyre me Italinë dhe Evropën njëkohësisht.

Ndër të tjera, kemi një relacion të Frang Bardhit, dërguar Kongregacionit, i cili shprehet për gratë e krishtera që janë martuar me muslimanë, por megjithatë donin të merrnin sakramentet kishtarë:” ...po bij ndër kambë me përvujtëninë ma të madhe, së bashku me këto të krishtena të shkreta, gra të turqve, dhe po e lus lumëninë e tij (papën) të denjohet të zgjidhë e të lejojë që të munden me marrë sakramentet e shenjta, me qenë se kjo martesë deri tash asht bamë përdhuni e nga padija”(Vëll. II, Dokumen. Nr.24, fl.199).³⁵ Ndërsa relatori dalmatin Françesk Leonardis më 1638, shprehet për ipeshkvijnjtë se :” nxjerrin përfundime në praktikë, jo vetëm të gabueme e skandaloze, por disa herë edhe kundra besimit duke lejuar martesë të paligjshme”.

³⁶ Dhe relatori vazhdon duke numëruar aktet e paligjshme në shumë fusha .

Me pushtimin e vendit nga Turqia, kisha katolike u gjet pa një organ qendror brenda Perandorisë dhe dalëngadalë filloi shkatërrimi i saj. Për këtë arsye, kishat katolike dhe komunitetet pësuan në Shqipërinë e Veriut e të Mesme, presionet më të rënda nga ana e feudalëve turkë.

Në vitin 1641, Frang Bardhi shprehet për Zadrimën :” ...çdo vjet, ata që janë tue vdekë, shkojnë tue u lanë diçka kishëve: kush vneshta, kush ara, kush meshë, dhe grate sofrabeza e këmisha...”³⁷.

³⁵I. Zamputi, “Relacione mbi gjendjen e Shqypnis veriore e të mesme në shekullin XVII “, Vëllimi II, Tiranë, 1965, f.89.

³⁶Po ai, po aty, f. 185.

³⁷Po ai, po aty, f. 223.

Në Hot, më 1634, Gjergj Bardhi gjen se pronat e kishës ” i kishin shti në dorë disa bij të një fare prifti të vdekur që u kish lanë në trashëgim pasunitë e kishës. Tash asht e vështirë me ua heq duersh me që ata ka shumë kohë që i zotnojnë”.³⁸ Pra, shumë prona të kishave i kishin marrë vetë besimtarët, kur fshati kishte mbetur pa prift.

Më 1634 Gjergj Bardhi propozon të emërohet një ipeshkëv vendas me 3-4 meshtarë për të shërbyer në Malësinë e Mbishkodrës, dhe thotë:” për tri vjetë t’u jepet ndonjë rrogë derisa ata të krishtenë të fillojnë me u ndihmue” (Vëll. I, Dokum.Nr.39, fl. 66v).³⁹

Që nga 1637 dhe në vazhdim, Frang Bardhi dërgonte raporte në italisht dhe latinisht në Kongregacionin e Propagandës Fide në Romë, të cilat përmbanin një “minierë” të pasur informacioni rreth dioqezës së tij, zhvillimeve politike, rreth zakoneve shqiptare, strukturës dhe pozitës së Kishës Katolike në Shqipërinë e pushtuar nga Turqia Otomane.

Ata nuk i lënë ata të jenë të krishterë, ata i detyrojnë priftërinjtë e famullisë dhe peshkopët t’i binden besimit të tyre, gjë e cila është e ndaluar me ligj nga papa. Në kohën e Sulltan Sulejmanit, perandor i Turqisë, një feudal musliman i quajtur Pashai i Dukagjinit, që ishte lider i shumë provincave, kur ky kaloi përmes Zadrimës, u bashkua me të dhe shkoi pastaj në Kostandinopojë dhe i kërkoi perandorit t’i bënte atij një nder dhe t’i jepte Zadrimën si vakuf për hatër të shpirtit të tij me kusht që ai të ndërtonte tridhjetë ura gjatë lumenjve të Zadrimës, kështu që kur ai të vdiste, udhëtarët ti shërbenin shpirtit të tij. Perandori dha gjithashtu urdhër që njerëzit të mos iu nënshtroheshin spahijve, siç bëjnë gjithë kristianët e Maqedonisë dhe krahinave të tjera nën sundimin turk, por të ishin në vartësi direkte tek perandori përmes një mbledhësi të ardhurave, i cili do të emërohej çdo vit. Shumica e popullsisë së Zadrimës ranë dakord me këtë, sepse ata mund të paguanin shumë më pak se sa paguanin ndërkohë krahinat e tjera. Për të ruajtur këtë rregull Zadrima duhej të dërgonte shpesh një delegacion kryepleqsh në Kostandinopojë për të rinovuar këtë rregull tek perandorët. Kështu që, popullsia e Zadrimës nuk do të ishte më tani e tutje nën vartësinë e spahijve, dhe nuk do të tiranizohej nga sanxhak bejt, nga grumbulluesit e të ardhurave, kadijtë, vojvodët, etj. Popullsia e Zadrimës zotëronte pesëqind dokumentet që ruanin këtë zakon dhe kjo u pasua pas perandor Sulltan Sulejmanit dhe nga pasuesit e tjerë si nga Sulltan Selimi, Bajazidi, Murati III (që u vra në Poloni), Mustafaj, Murati IV, dhe perandori aktual Ibrahim. Kështu që, pas kësaj marrëveshje provinca e Zadrimës qeverisej si një republikë duke u drejtuar nga kryepleqtë e saj.

Një ndihmesë themelore në vatërzimin e shkrimtarisë së vjetër shqipe luajtën edhe leksikografët shqiptarë të trevës së Veriut Frang Bardhi, Nikollë Gazulli e Benedikt Dema, por nuk duhet lënë pa përmendur edhe ndihmesa e çmueshme e nisur nga Buzuku, Budi dhe Bogdani.

Për Nikollë Gazullin, biblioteka françeskane ishte qendra kryesore në Shkodër, sepse shërbente në famullinë e Rrjollit, por gjithashtu mbulonte famullinë e Shkrelit (pas 1940-ës).

Nga erudicioni i tij, Nikollë Gazulli, i dhënë veçanërisht pas folklorit dhe historisë, arrin në përfundimin se Shqipëria ka një histori fetare paralele me atë të Italisë, me martirë, me ipeshkvi e me Etën të vet, dhe thotë se "*ndë Shkodër t’anë kemi një*

38I. Zamputi, “Relacione mbi gjendjen e Shqypnis veriore e të mesme në shekullin XVII “, Vëllimi I, Tiranë, 1963, f.463.

39I. Zamputi, “Relacione mbi gjendjen e Shqypnis veriore e të mesme në shekullin XVII “, Vëllimi I, Tiranë, 1963, f.463.

Rromë të dytë në Ballkan. Këtu fillimi i Krishtnimit nis me kohna apostolike e vazhdon me një Seli I peshkvnore që ka një vijim të pakëputun deri në kohët e vona".⁴⁰ Kjo dije po materializohej aty në heshtinë e luginës së Prronit Thatë në Shkrel, ku Gazulli po hartonte një tjetër vepër madhore: "Fjalorin Toponomastik", të shkruar nën pseudonimin "Gelasius".⁴¹

Në vitin 1946, pas mbylljes së shkollave françeskane nga regjimi që u vendos, At Benedikt Dema jetën e kaloi brenda dyerve të "kuvendit të françeskajve", duke mos i ndarë asnjëherë shërbimet e priftërisë me pasionin për studime, derisa për një kohë mund të cilësohet "i ndrymë në studime".

Në qershorin e vitit 1967, Benedikt Dema, donte të botonte një fjalor. Ishte viti kur shteti shqiptar komunist mbylli të gjithë objektet fetare dhe ndaloi ndjekjen e riteve të tyre. Me sa duket, At Benedikt Dema, kishte zgjedhur momentin e papërshtatshëm për botimin e një Fjalori të tillë.

Në të gjithë punën studimore të At Benedikt Demës vendin themelor e zinte gjuha shqipe, pasuria leksikore dhe kuptimore e saj. Kjo e çoi vetvetiu tek hartimi i fjalorit.

⁴⁰Po ai, po aty.

⁴¹Po ai, po aty.

2. Roli i klerit zadrimer e më gjerë për pohimin dhe lëvrimin e gjuhës shqipe

Kërkesa për dije e arsimim ishte edhe synimi kryesor i klerit, për këtë arsye, u hapën shkolla në gjuhën shqipe krahas shtrirjes mirëfilli baritore e fetare dhe mësues në to u bënë priftërinjtë. Duhet të hynin idetë e Rilindjes për të emancipuar shoqërinë shqiptare të kohës, u botuan libra, u organizuan edhe kuvende të vogla në krahina e zona që idetë e kryengritjeve të shkonin deri te njeriu më i thjeshtë. Mund të themi se kjo lëvizje pati një organizim të përsosur e drejtim intelektualësh. Në vitet 1920-30-40, kjo lëvizje arriti nivele të larta zhvillimi nën drejtimin e patriotëve e intelektualëve të ngarkuar me detyrat e ipeshkëvinjve Pjetër Budi nga Guri i Bardhë i Matit dhe Frang Bardhi nga Nenshati i Zadrimës. Në këtë kohë Shqipëria ka krijuar lidhje të afërta me disa vende perëndimore antiturke. Megjithë trysinë edhe presionet turke, zhvillohet tregtia, shkëmbehen mallra dhe qarkullojnë njerëz kryesisht nëpërmjet ndihmës së klerit katolik.

Veprat në gjuhën shqipe gjatë shekujve të parë të pushtimit osman janë të pakta. Më e vjetra prej tyre që ka mbërritur deri më ditët sot, është "Meshari" i Gjon Buzukut(1555).

Me veprën e Buzukut kemi një vazhdimësi të kulturës shqiptare e të letrave shqipe edhe në kushtet e vështira të pushtimit osman, kulturë që në humanistët u përfaqësua me vepra kryesisht në gjuhën latine, që ishte gjuha e kulturës e kohës dhe që u pasurua më vonë me veprat e Budit, Bardhit, Bogdanit etj., në gjuhën shqipe.

Përmbajtja e veprës dëshmon për përdorimin e shqipes në shërbesat fetare. Kryesisht ka pjesë liturgjike, pjesë që lexohen e rilexohen vetëm prej klerikëve në shërbesat kishitare, përkthim i një libri latinisht i shkruar me alfabetin latin.

I ndikuar nga idetë e kësaj lëvizje, Buzuku bëri të pamundurën për t'u krijuar mundësi besimtarëve katolikë shqiptarë të merrnin drejtëpërdrejt në gjuhën amtare shkrimin e shenjtë.

Puna e tij nuk shërbente vetëm për dëgjimin e kuptimin e përmbajtjeve të disa ceremonive fetare, por edhe pikënisje për shkrimin e gjuhës. Me veprën e tij ai mundohet të pohonte individualitetin shqiptar. Vepra e Buzukut nuk ka vetëm meritë letrare, por është edhe një hap i guximshëm kulturor, që bën pjesë në luftën e popullit shqiptar për çlirim e përparim.

Mund të përmendim Frang Bardhin, i cili « duke kaluar nëpër Venedik dhe një qëndrimi të shkurtër, bëri që të shtypej një vepër, të cilën ia kushtoi Dogjes dhe Senatit Venedikas. Vepra i kushtohet Skënderbeut dhe që caktuar për me qitë poshtë botimin që kishte ba katër vjet ma pare Joannes Tomcus Marnavitius, ipeshkëv i Bosnjes, i cili kishte dashtë me e lidhe Gjergj Kastriotin me familjen Marnaviç dhe me Bosnjen ».⁴²

Për të mbrojtur shqiptarësinë e Skënderbeut autori niset nga argumente të sigurta dhe të shumta historike, pa nënçmuar gojëdhënat.

Duhet përmendur edhe relacionet e dërguara në Romë për dioqezin e Sapës, ku përmbaheshin njoftime të rëndësishme gjeografike e folkloristike.

Por, puna e tij kolosale i takon mbledhjes së fjalëve, kryesisht përkthimit shqip të fjalëve latine, sepse, sipas tij, theksonte nevojën për t'i ndihmuar gjuhës shqipe, e cila po humbiste e po bastardhohej.

⁴²B.Demiraj, "Dictionarium latino-epiroticum", Shkodër, 2008, f.25.

Pjetër Bogdani është figura më e shquar e letërsisë së vjetër shqiptare. Ai shquhet jo vetëm si klerik i lartë, por edhe si atdhetar, me dashuri të pakufishme për gjuhën shqipe e për popullin shqiptar, por edhe si dijetar e letrar, si luftëtar i paepur për çlirimin e vendit nga zgjedha osmane dhe për zhvillimin e përparimin e tij kulturor. Me veprimtarinë e tij politike 40-vjeçare, sidomos me rolin që luajti si udhëheqës i kryengritjes çlirimtare të vitit 1689 dhe me veprën e vet "Çeta e profetëve", Pjetër Bogdani me të drejtë është quajtur pararendës i hershëm i lëvizjes së Rilindjes sonë Kombëtare. U mor me lëvrimin e gjuhës sonë, hartoi në gjuhën shqipe edhe një gramatikë të latinishtes, madje kishte mbajtur në Kosovë edhe një shkollë ku mësohej gjuha shqipe, jo vetëm si klerik, por edhe si patriot. Me kulturën e tij të gjerë enciklopedike, me mendimet e tij përparimtare iluministe e atdhetare, me punën e gjatë këmbëngulëse më se tridhjetëvjeçare, Bogdani i dha letërsisë shqiptare dhe popullit shqiptar një vepër madhore, që kurorëzoi traditën e mëparshme letrare e kulturore dhe që paralajmëroi një periudhë të re të zgjimit gjithëkombëtar.

Katër B-të (Buzuku, Budi, Bardhi e Bogdani) u nisën nga dashuria për atdheun, ashtu siç shprehej edhe vetë Buzuku: "*En seh dasunit she botesse saneh..*"⁴³

Dom Gjon Buzuku mbase nuk ka përkthyer nga një libër i vetëm, por homelitë e mishërimin përgatitur e mbajtur shqip sipas të dielave, të kremteve dhe festave të shënuara të besimtarëve i mblodhi në atë që nga studiuesit është quajtur "Meshar".

Sa i takon gjuhës së përdorur R.Ismajli thekson: "*Sado që manifeston tendenca për njëfarë normëzimi, gjuha e Buzukut në thelb e paraqet shqipen popullore të zonave të Malësisë së Krajës*".

Kjo linjë e dashurisë për gjuhën shqipe dhe atdheun ka përkthyer si një fill i pakëputur, i përcjellë nga autori në autorë deri tek Bogdani, për të cilin gjuhëtari A.Kostallari ka shkruar: "*Njerëzit e mëdhenj punojnë jo vetëm për kohën e vet, por edhe për të ardhmen. Pikërisht këtu qëndron madhështia e jetësia e veprës së tyre. I tillë ka qenë dhe mbetet Pjetër Bogdani...*"⁴⁴

Kështu Bardhi, në kushtet e një studenti në Propagandën e Fides në Romë "*...ghiuhe tane ghi po bdarete e po baftarçohete faa maa pare te vé...*"⁴⁵ ia del të hartojë një Fjalor dygjuhësh (latinisht - shqip me rreth 2500 fjalë), duke përballuar për herë të parë shqipen me një nga gjuhët më të lëvruara të botës (për shekuj me radhë gjuhë e kulturës e shkencës dhe e letërsisë).

Ai bëri regjistrimin shkencor të mijërave lemave shqipe si fjalë aktive të kohës kur u hartua Fjalori. Kjo dashuri e çon atë që, brenda Fjalorit, të japë disa të dhëna gramatikore, fillestare për shqipen si dhe të pasqyrojë një pjesë të thesarit folklorik shqiptar – me 113 proverba, mbase të gjitha pronë e visarit tonë popullor.

Më tej, autori më prodhimtar me tre vepra religjioze: "Doktrina e Kërshtenë", 1618, "Ritualit roman", 1621, "Pasëqyra e t'rfyemit", 1621 të përkthyer nga italishtja dhe latinishtja, duke përballur edhe ky gjuhën shqipe me gjuhë të lëvruara perëndimore. Shqipërimet e Budit dëshmuar mundësitë shprehëse të gjuhës sonë, siç thoshte ai "*... e tue paam ashtu ende se këta diesitë e letërorët hollë, qi u vjen ndore ashtu gjaakafshë me ndimuom, e lanë shkret e gjaa maa s'po ndimonjënë; maa s'keshë*

⁴³ T.Topalli, A.Haxhi, *Shqipja e shkruar në shekullin e XVI-XVII*, "Histori e gjuhës së shkruar shqipe", Ushtrime, Shkodër, 2007, f.18.

⁴⁴ A.Kostallari, *Pjetër Bogdani dhe gjuha letrare shqipe*, "Pjetër Bogdani dhe vepra e tij", Tiranë, 1991, f.17.

⁴⁵ B.Demiraj, "Dictionarium Latino-Epiroticum", Shkodër, 2008, f.75.

*tjetër qish me baam, veçese hina mbarë e prapë, sido munda, shkrova mbë gjuhu tanë maa parë...*⁴⁶.

Përveç kësaj, tek ky autor letërsia shqipe do të gjejë fillimet e veta në krijimtarinë poetike, me qindra vargje me tematikë jo vetëm fetare, por edhe atdhetare.

Shkrimtari i fundit i kësaj radhe mjeshtrash të gjuhës shqipe, është Bogdani, i cili zë fill me veprën e parë origjinale “Cuneus Prophetarum”⁴⁷ 1685. Ky shkrimtar nuk përballi shqipen me gjuhë të huaja, por fakti dhe dëshmoi se gjuha jonë ka mundësi e shprehësi për fusha të ndryshme të dijës, si: teologji, pedagogji, filozofi, e drejta morale.

Të katër këta autorë (studiuar në fushë të leksikut nga gjuhëtari K.Ashta)⁴⁸ pasqyrojnë me mjaft vërtetësi qëndresën e shqipes ndaj gjuhëve përreth si dhe depërtimin e orientalizmeve, të cilat vijnë e rriten nga Buzuku tek Bogdani.

*“Shqipja e autorëve shqiptarë të shekullit 17 – Pjetër Budit, Frang Bardhit, Pjetër Bogdanit, është letrare par excellence. Ajo shpesh paraqet veçori mbidialektore në shkallën që filologët e kanë të vështirë të identifikojnë të gjitha elementet specifike të idiomave të tyre natyrore. Ata madje jo rrallë kanë folur për procese të mirëfillta koineizimi brenda gegërishtes lidhur me gjuhën e Bogdanit...”*⁴⁹

Një emër tjetër është edhe Gjon Nikollë Kazazi. Vetë fakti se ai ishte doktor në teologji dhe filozofi dëshmon për njërin nga njerëzit më të ditur të botës shqiptare në shek.XVIII. Në arqipeshkvinë e Shkupit qëndroi plot dhjetë vite, duke zhvilluar një veprimtari të gjatë apostullike, kulturore - letrare e gjuhësore, gjithnjë duke iu kundërvënë, me fjalë e vepra konkrete, në mënyrë këmbëngulëse politikës asimiluese të pushtuesit osman. I vetëdijshëm se me kalimin e shqiptarëve në besimin islam, gjuha shqipe kishte mbetur "gjuhë shtëpie dhe tregu", Gjon Nikollë Kazazi, duke ndjekur traditën e ndritur të shkrimit shqip të paraardhësve të tij, kishte përkthyer dhe botuar katekizmin Doktrina e krishterë (Romë 1743).

Për At Donat Kurtin, Simon Pepa, shkruan: *"Dhe tani, në 55- vjetorin e botimit të "Iliadës" shqiptare të gjithë ata që e mblodhën dhe e botuan nuk janë më. Edhe Kuvendi Françeskan ku punuan, është këthyer në gërmadhë."*⁵⁰

Ai edhe pse ishte në burg vazhdoi punën shkencore, nga e cila e ndau vetëm vdekja. Atje ai njihej me të burgosur të krahinave të ndryshme të Shqipërisë, dhe mblidhte fraza gjuhësore që përdornin ndër ato krahina. I shkruante ndër fletore dhe përgatiste "Fjalorin Frazologjik të Gjuhës Shqipe". Ky fjalor kishte 45000 fraza. Ka qenë i shkruar në dy kopje me dorë, një për Universitetin, dhe një do ta merrte me vete kur të lirohej.

I nderuar prej të varfërve e të përlurëve të mbarë Shqipërisë, të cilëve, në këtë jetë të mjeruar, u la trashëgim një thesar shumë të çmueshëm nga mendja e tij e ndritur: "VISARET E KOMBIT".

Një tjetër figurë e ndritur në kulturën shqiptare, një intelektual dhe klerik i madh, ishte edhe At Gjergj Fishta, gjithashtu i lindur dhe i rritur në Zadrimë dhe që, për fatin e madh të Shqipërisë e të shqiptarisë, ai do të punonte gjithë jetën në Shkodër e në

46 T.Topalli, A.Haxhi, *Shqipja e shkruar në shekullin XVI-XVII*, “Histori e gjuhës së shkruar shqipe”, Shkodër 2007, f.28.

47 Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Insituti i gjuhësisë dhe i letërsisë, Pjetër Bogdani, “Cuneus prophetarum”, botim kritik përgatitur nga Anila Omari, Tiranë, 2005. (Mësonjëtorja).

48 K.Ashta, “Leksiku historik i gjuhës shqipe”, 1-6, 2000-2012, botim i ISA, Shkodër.

49R. Ismajli, “Gjuhë standarde dhe histori identitetesh”, Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Tiranë, 2005, f. 32.

50 S. Pepa, “Martirizimi i kishës katolike shqiptare” 1994-1990, f.30.

Malësinë e Madhe, duke i shtuar urtësisë e butësisë zadrimore, edhe qytetarinë ndejtare të Shkodrës e burrinë e bujarinë proverbiale të malësorëve. Kështu, në fakt, nëpërmjet veprave të Fishtës do të na shpalosej gjerë krejt leksemantika e frazeologjia e mbarë gegërishtes veriperëndimore, si të thuash do të na jepej *bukë e gatuar* me miellin e shumë arave, që nga Fishta e Zadrimes në lindje deri në bjeshkët e Mbishkodrës ku jetoi e punoi shumë vjet si meshtar në Rapshën e Hotit⁵¹.

Duke qenë i veshur me zgunin e sandalet e zbathura të shën Françeskut të Asizit ishte famullitar në famullinë e Lezhës, mësimdhënës e meshtar në Kolegjin e Troshanit dhe për 12 muaj gjendet në Gomsiqe të Pukës. Në bashkëpunim me abatin e Mirditës, imzot Prengë Doçi, krijon Shoqërisë Letrare dhe Kulturore "Bashkimi", boton artikuj të rëndësishëm e të mprehtë, duke përhapur të vërtetën në një numër sa më të madh njerëzish. Ishte i pari që hapi klasat qytetare, duke futur gjuhën shqipe në mësim, në kohën që ishte emëruar drejtor i shkollës fillore françeskane. Më pas ishte kryetar i Komisionit të Alfabetit të Gjuhës Shqipe në Manastir (1908), si dhe themelon dhe drejton revistën e njohur kulturore-shkencore "Hylli i Dritës" (Shkodër, 1913). Ai, hapi Shtypshkronjën Françeskane, nga ku nisën të dalin rregullisht periodikë të shtypit katolik dhe kulturorë në qytetin e Shkodrës. Krijoi lidhje dhe ura bashkëpunimi me të gjithë albanologët e njohur evropianë asokohe, duke i pasur si bashkëpunëtorë dhe bashkëtrajtues të shumë temave interesante mbi Shqipërinë, gjuhën, visaret e kombit, traditën, letërsinë dhe krishtërimin e hershëm ndër shqiptarë, përruron hapjen e gjimnazit të njohur "Illyricum" në Shkodër, që pas vdekjes do të marrë emrin e tij.

Mund ta themi me plot gojën se pa Fishtën historia e kultura shqipe do të ishte e mangët.

Simon Pepa shprehej “ *Klerikët katolikë, vendës dhe të huaj, dhanë shumë edhe në fushën e leksikografisë. Ata qenë nismëtarë në shumë degë të kësaj disipline: dhanë të parin Fjalorth etimologjik (P. Mazrreku, 1633), të parin Fjalor të gjuhës shqipe (Frang Bardhi, 1635), të parët Fjalorë italisht-shqip e anasjelltas (Rossi, 1866; Jungu, 1895; "Bashkimi", 1908), vunë gurin e parë të themelit në leksikografinë krahinore (Gazulli, 1941, së bashku me studiuesin nga Jugu, Pano Tase), në leksikografinë onomastike (Gazulli, 1939-1943) pra një punë mjaft e lavdëruar kjo*”.⁵²

⁵¹Gj.Shkurtaj, *Tri ndihmesat për gjuhën e Fishtës*, “Pesha e e fjalës shqipe”, Tiranë, 2009, f.79-104.
⁵²S.Pepa, *Kontributi i klerit katolik në leksikografinë shqiptare*, “Krishtërimi ndër Shqiptarë” - Simpozium Ndërkombëtar - Tiranë, 16-19 Nëntor 1999, f. 444-445.

3. Përshkrim i fjalorëve dialektorë - krahinorë në përgjithësi dhe vendi i tre fjalorëve (Bardhi, Gazulli, Dema) në veçanti.

Leksikografia dialektore është një degë e re e gjuhësisë sonë. Intensiteti i botimeve në këtë fushë rritet ndjeshëm vetëm shekullin e fundit, të cilët shquhen për një prurje të madhe e të larmishme fjalorësh dhe për një ngritje të dukshme të nivelit të tyre shkencor. Në gjuhën shqipe kemi në përdorim shumë fjalorë dialektorë.

Ata sjellin lëndë leksikografike jo vetëm të pasur, por edhe interesante, mbi të cilën mund të ndërmerren studime nga disiplina të ndryshme gjuhësore dhe jogjuhësore.

Leksiku dialektor e krahinor gjendet përballë dy dukurive, ku shkaku kryesor është zhvillimi i fuqishëm i shoqërisë shqiptare dhe sfidat e globalizmit.

Së pari, kemi **Fjalorin latinisht – shqip**, botuar në vitin 1635 nga Frang Bardhi. Është vepra, e cila e bëri të zërë një vend themelor në leksikografinë shqiptare, ku do të shërbente si bazë për hartimin e fjalorëve të tjerë gjuhësorë.

Veç kësaj, kjo ka një vlerë të pallogaritshme gjuhësore, pasi është një pasqyrë e leksikut popullor të shek. XVI-XVII. Si bazë për Fjalorin e Bardhit, u mor gjuha kishtare latine, sepse ishte e nevojshme, që të gjithë njerëzit që i shërbenin kishës, të dinin latinisht.

Në 1710 një Anonim nga Shqipëria, boton **Dizionario italiano et albanese peralfabeto**. Në f.1- 17 është **Fjalori italisht – shqip**. Në parathënie përmendet qyteti i Beratit dhe një fshat me emrin Dobrovnik. Meqë dorëshkrimi është në dialektin e Veriut, duhet menduar se kemi të bëjmë me ndonjë misionar që ka jetuar edhe në Jug dhe që mund të jetë edhe autori.

Më tej në 1763, përmendim **Nicolo Chetta**, me një **Fjalor italisht – shqip**, i hartuar kur ai nuk ishte më shumë se 21 vjeç.

Mbahet ky shënim : “ *Ki leksiko kle shkruarë ka zoti Ketta të horë e Kuntisësë vit linsu Hristonit 1763 e e dhuroi z. Sul të horësë Pallacit Adhriano* “.⁵³

Shënimi është me shkronja greke, ndërsa Fjalori me alfabetin latin të Veriut. Pra, shënimi duhet të jetë i mëvonshëm, atëherë kur Keta filloi të lëkundet për çështje të alfabetit.

Shemimi Shkodra, më 1835, na lë një **Fjalor shqip – turqisht** në vjersha. Autori thekson se e hartoi për t’iu ardhur në ndihmë ushtarëve turq që vinin në Shqipëri dhe të shqiptarëve që nuk dinin turqishten. Ka përdorur alfabetin arab. Baza e tij është e folmja e Shkodrës, por ka edhe fjalë nga Berati, gjë që dëshmon se ka jetuar edhe në Berat. Ka rreth 1000 fjalë dhe pak frazeologji.

Në vitin 1904 kemi botimin e **Fjalorit të Kristoforidhit**, i cili ka më tepër se 40.000 fjalë. Shërbeu si një gur themeltar për formimin e fjalorëve të mëvonshëm. Ishte fjalori më i mirë i kësaj periudhe, që konsiderohet si hapi i parë për hartimin e një fjalori shpjegues të gjuhës shqipe, sepse pasurinë leksikore e frazeologjike të mbledhur nga goja e popullit e përfshiu në fjalor jo si pasuri dialektore, por si pasuri e përbashkët e shqipes.

“**Fjalori i ri**”i Shoqërisë Bashkimi 1908. Fjalor i shtypur me shkronja latine. Është konsideruar si Fjalor më i pasur se ai i Kristoforidhit, për nga sasia e fjalësit si dhe alfabeti i përdorur. Përmban rreth 13000 fjalë. Ndonëse është fjalor dygjuhësh, shqip-italisht, lënda leksikore e tij i përket gegërishtes veriperëndimore.

⁵³DH.S.Shuteriqi, “Shkrimet shqipe në vitet 1332 – 1850,” Tiranë, 1976, f.120.

Nga **Dom Nikollë Gazulli** kemi “**Fjalorthi i ri**” (fjalë të rralla të përdorura në Veri të Shqipërisë), Qershor, 1941, i cili shënoi dhe lindjen e leksikografisë dialektore. Paralelisht, më 1941 kemi “**Fjalorthi i ri**” i Pano Tases, i cili përmbante fjalë nga e folmja e Përmetit, si dhe disa shprehje, urime e mallkime të kësaj treve.

Gjithashtu, në vitet '40 të shek XX, Karlo Taliavini bëri objekt studimi të folmet e Kosovës e Maqedonisë veriperëndimore.

Për të folmet brenda kufijve të Republikës së Shqipërisë përmendim monografinë e V. **Cimokovskit** mbi të folmen e Dushmanit (Dukagjin).

Pas Çlirimit, në vitin 1954, botohet **Fjalori i gjuhës shqipe**,⁵⁴ i hartuar nga Kostaq Cipo (kryetar), Eqrem Çabej, Mahir Domi, Anton Krajni, Osman Myderrizi, botim i Institutit të Shkencave, i pari fjalor shpjegues i mirëfilltë i shqipes dhe arritja më e madhe e kësaj faze të leksikografisë shqipe. Ai është i tipit të vogël, sepse pasqyron shtresën aktive të leksikut të shqipes dhe një pjesë të kufizuar të shtresës pasive, që është krejt e domosdoshme për të kuptuar gjuhën e sotme shqipe. Megjithëse fjalori u hartua i mbështetur në toskërishten letrare, ai përfshiu fjalë nga të gjitha anët e Shqipërisë.

Nga fjalët krahinore janë pasqyruar ato që kishin një përhapje më të gjerë, si edhe ato që ishin të vlefshme për leksikun e përgjithshëm.

Studimi i leksikut dialektor e krahinor në gjuhësinë shqiptare është bërë nëpërmjet studimeve jo të drejtpërdrejta, por në gji të studimeve që janë kryer për gjuhën standarde shqipe, për dialektet dhe të folmet e veçanta të saj.

Aleksandër Xhuvani dhe Eqrem Çabej janë marrë drejtpërdrejt me leksikun dialektor.

Në veprën “**Studime gjuhësore**” E.Çabej vë në dukje rëndësinë e leksikut dialektor e krahinor për dy çështje themelore të gjuhësisë shqiptare: për historinë e shqipes dhe të shqiptarëve dhe për historinë e shqipes standarde.

Në vitin 2001 kemi nga J. Thomai, monografinë dialektore “*Leksiku dialektor e krahinor në shqipen e sotme*” si një punim më i plotë dhe më i arrirë për këtë fushë, në të cilin jepen qartë kuptimet e fjalëve dialektizëm e krahinorizëm dhe pasqyrohen mirëfilli marrëdhëniet e leksikut dialektor dhe krahinor me leksikun e shqipes standarde.

J.Thomai si tregues të parë të dialektizmave dhe krahinorizmave, merr mospërputhjen e tyre me normën letrare ose mospërdorimin e gjerë në gjuhën letrare.

Në vitin 2005 u botua “**Fjalor fjalësh të rralla të gjuhës shqipe**” nga Benedikt Dema, të cilën e njohim si dorëshkrim që më 1966, po që nuk pau dritën e botimit, ndërsa në vitin 2006 Mehmet Elezi nxjerr veprën “**Fjalor i gjuhës shqipe**”.

Po kështu për të folmet arbëreshe përmendim “**Fjalor i arbëreshëve të Italisë**” i Emanuelo Xhordanos.

Por, lind pyetja se, cili është vendi që zënë Bardhi, Gazulli e Dema në leksikografinë shqiptare?

Bardhi, së bashku me Fjalorin e tij Latinisht –shqip, botuar më 1635, është i pari libër shqip që dimë të ketë dalë nga shtypshkronja e Propaganda Fides dhe Fjalori i parë i njohur i gjuhës sonë, me rreth 2500 fjalë, të cilin Kolë Ashta e ribotoi me një renditje të re. Veç kësaj, kjo ka një vlerë të pallogaritshme gjuhësore, pasi është një pasqyrë e leksikut popullor të shek. XVI-XVII. Në të përfshihen fjalë nga leksiku veriperëndimor, kryesisht Zadrime e Malësia e Madhe.

⁵⁴K.Cipo,E. Çabej, M.Domi, A.Krajni, O.Myderrizi, “Fjalor i gjuhës shqipe”, Tiranë, 1954.

Këtë Fjalor Bardhi e hartoi me qëllimin që të lëvrohej gjuha shqipe e të pasurohej larg bastardhimeve e prishjes së saj, si dhe për të lehtësuar punën e atyre që donin të shkruanin shqip me qëllimin e përhapjes së fesë së tyre.

“**Fjalorthi i ri**” i Gazullit, botuar më 1941, merr vlera duke qenë i pari fjalor krahinor i gegërishtes botuar deri më sot. Përfshin fjalë të rralla, disa nga ato edhe të padëgjua në veri të Shqipërisë, kryesisht pjesës veriperëndimore. Për hartimin e këtij Fjalori, mësohet se pati një letërkëmbim të ngushtë me Joklin dhe bashkëpunim të ndërsjellë të fjalorëve, sepse ndërkohë që Gazulli përfundonte Fjalorthin e tij, Jokli po përfundonte Fjalorin etimologjik të Shqipësisë. Gazulli ishte një erudit në kuptimin e plotë të fjalës, njohës i disa gjuhëve të huaja, të cilën e pasqyron qartë se shumë fjalëve në Fjalor u jep korresponduesen e tyre në latinisht, italisht, gjermanisht, greqisht dhe sllavisht. Vitet në të cilat u la në harresë emri dhe Fjalori i tij, shënojnë një errësirë të vetë personalitetit të Gazullit, i cili doli në dritë vetëm pak vite më parë, vetëm kur pa dritën e botimit dhe vlerësimit të tij si figurë me rëndësi edhe në studimet gjuhësore.

Benedikt Dema, edhe ky një tjetër leksikograf në lëmë të të shqipes, i cili edhe ky u la në harresë bashkë me Fjalorin e tij, deri në vitin 2005 kur u botua nga shtëpia botuese Toena, na la një fjalor krahinor dhe një punë studimore të pasur gjuhësisht.

Ky Fjalor u përfundua në vitin 1966, me qëllimin për të dalë në shtyp, por nuk doli asnjëherë.

Siç thekson edhe vetë autori, ky Fjalor është një shtesë e fjalëve që i bëhet Fjalorit të gjuhës shqipe, 1954, duke përfshirë shumë fjalë që nuk përmenden, ose që kanë një kuptim të ndryshëm nga ai i pasqyruar në Fjalorin e '54.

Për hartimin e këtij Fjalori, ai u mbështet tek “Fjalori i Bashkimit”, 1908, “Fjalorthi i Gazullit” 1941, tek disa vepra të Fishtës e të Kanunit të Lekë Dukagjinit, duke mos lënë pa përmendur edhe punën e vyer studimore që ka mbledhur autori prej gojës së popullit.

Fjalësi i këtij Fjalori pasqyron të folmen e gegërishtes veriperëndimore, zonën e Shkodrës e Malësisë së madhe me rethinat e saj.

Vend me rëndësi në këtë Fjalor zënë edhe neologjizmat, fjalë të krijuara nga vetë autori, të cilat i japin kësaj vepre një veçanësi më vete.

Siç vërehet të tre këta “të mëdhenj” të leksikografisë shqipe na lanë një trashëgimi të pasur gjuhësore, ku secili prej tyre është “i pari” në llojin e vet.

Fjalori i Bardhit përbën Fjalorin e parë të mirëfilltë dygjuhësh shqip – italisht, Gazulli na la Fjalorin e parë krahinor (të gegërishtes veriperëndimore), Dema, gjithashtu, i pari në llojin e vet, ku me punën e tij hulumtuese, na pasqyroj një shtesë fjalësh që nuk ekzistonin në Fjalorin e gjuhës shqipe të '54, ose që kishin një kuptim të ndryshëm nga ky Fjalor.

E përbashkëta e këtyre autorëve ishte, se të tre ishin priftërinj, të tre dhanë një kontribut të vyer në lëmë të leksikografisë, duke na lënë tre fjalorë të mëdhenj, dhe më e rëndësishmja, vërejmë se në këta fjalorë, pasqyrohet e folmja geqe, përkatësisht zona e Zadrimës, Shkodrës e Malësisë së Madhe.

4. Fjalori i Frang Bardhit dhe vlerat e tij si i pari ballafaqim i shqipes me një gjuhë të madhe, siç ishte latinishtja.

Frang Bardhi lindi në Sapë të Zadrimës, nga familja e Bardhajve. Pinjoj të kësaj dere të shquar në librat e kulturën shqiptare zihen në gojë ndër dokumentet kishtare dhe ndër ato të jetës politike të vendit tonë në shekullin e XVI e XVII.

Në 1628 hyn në Kolegjin Ilirian të Loretos, ku studion ndër të tjera edhe latinisht, italisht, sllavisht dhe pak turqisht.

Qe mbështetësi i misioneve françeskane të varura nga Kongregacioni i Propagandës Fide në Shqipëri qysh më 1631. Harton një projekt për të çuar në këmbë Shqipërinë kundër turqve me ndihmën e Venedikut.

Fjalori latinisht – shqip, botuar në vitin 1635 është vepra, e cila e bëri të zërë një vend themelor në leksikografinë shqiptare, ku do të shërbente si bazë për hartimin e fjalorëve të tjerë gjuhësorë.

Por, ai u shfrytëzua prej leksikografëve të mëvonshëm pa ia përmendur emrin dhe u desh një kohë e gjatë derisa u vu në dukje puna e tij, si njohës i mirë i gjuhës shqipe.

Vepra tjetër e Frang Bardhit, e cila zuri një vend të rëndësishëm në historinë e Shqipërisë, është "*Apologjia e Skënderbeut*"⁵⁵, botuar latinisht në Venedik më 1636.

Vepra në të vërtetë është një apologji (mbrojtje) që i bën autori Skënderbeut, si bir dhe hero i popullit shqiptar, prandaj edhe është quajtur Apologjia e Skënderbeut. Këtë vepër autori mendohet se e ka shkruar për 15 ditë, kur po kthehej në Shqipëri për të hedhur poshtë mendimet pa baza të një peshkopi boshnjak, që i mohonte Skënderbeut prejardhjen shqiptare.

Duke iu kthyer *Fjalorit* dygjuhësh latinisht- shqip, duhet theksuar se, vepra ka rëndësi të madhe për kulturën kombëtare sepse shënon të parin fjalor të shqipes të hartuar nga një shqiptar e jo një i huaj (një meritë të tillë mjaft vende nuk e kanë). Shumë fjalë ose kuptime fjalësh do të ishin harruar e zhdukur, po të mos ishte ky Fjalor. Këtu gjejmë pasqyrim mjaft fjalë të brumit vendës.⁵⁶

Fjalori i Frang Bardhit, nuk është një fjalor i latinishtes klasike, sepse qëllimi i tij nuk ishte që të bënte një fjalor për leximin e veprave klasike. Si bazë, u mor gjuha kishtare latine, sepse ishte e nevojshme, që të gjithë njerëzit që i shërbenin kishës, të dinin latinisht. Vetëm me gjuhët klasike mund të fitohej një kulturë e lartë.

*“Ai e dinte mirë gjendjen e ulët kulturore të klerit shqiptar, që lexonte për ditë librin e meshës dhe lutjet e ndryshme, por... për t’u ardhur në ndihmë këtyre hartoi të parin fjalor latin – shqip dhe për ta bërë më të lehtë e më të sigurtë përdorimin e tij nuk i ngarkoi fjalë me kuptime të ndryshme, por u mjaftua me kuptimin e tekstit të vjelë.”*⁵⁷

Për hartimin e *Fjalorit* autori zgjodhi rrugën më të vështirë dhe më shkencore, duke lexuar një sasi veprash fetare dhe regjistroi fjalët që do të përfshiheshin duke i marrë nganjëherë bashkë me kontekstet.

Gjithashtu ai nuk e ndjen veten të plotësuar krejtësisht me këtë vepër, sepse duke qenë në dhe të huaj për shtatë vjet, nuk arrinte të kujtonte shumë prej fjalëve shqipe, dhe se nuk kishte me kë të këshillohej për këtë vepër.

Këtë Fjalor Bardhi e punoi me qëllimin që të lëvrohej gjuha shqipe e të pasurohej larg bastardhimeve e prishjes së saj.

⁵⁵ F. Bardhi, *Skënderbeu “Apologji”* (përkthyer nga latinishtja, S. Prifti), Tiranë, 1957.

⁵⁶ Konferenca Ipeshkvnore e Shqipërisë “Krishtërimi ndër shqiptarë” (Simposium Ndërkombëtar, Tiranë, 16-19 Nëntor 1999), S.Pepa, *Kontributi i klerit katolik në leksikografinë shqiptare*, “Krishtërimi ndër shqiptarë”, Shkodër, 2000, f.445-446.

⁵⁷ P.Geci, *Frang Bardhi dhe “Fjalori i tij latinisht – shqip”*, “Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe” II, Tiranë, 1972, f.300.

Fjalori u shtyp me shkronja romake dhe italike. Italikja në përgjithësi është ruajtur për shqipen, por jo në mënyrë përjashtuese.

Mark Skura, i cili u mor me shqyrtimin e Fjalorit të Bardhit, thekson, se ishte i vetmi Fjalor në shqip, i cili u bë burim për leksikografinë shqipe, si për Kristoforidhin, dhe “Bashkimin”. Ky fjalor latinisht –shqip është i pari i llojit dygjuhësh. Fjalët latine, pranë të cilave u vunë ato të shqipes, e bëjnë këtë Fjalor që të jetë i një lloji të veçantë ashtu siç e çmon edhe vetë autori:

*“maa mbe tieteret ane cuitoua e me ndy maa mire me ncheçyem giaacaffsce fe asgiaa, perffe, ndemos nghegnehem, me ndiete fe nder terretit e pache drite veien e cufcton fcume”.*⁵⁸

Me këto fjalë e hap Frang Bardhi fjalorin e tij Latinisht – shqip të vitit 1635, vepra e parë e mirëfilltë gjuhësore.

Në botimin e tij për Frang Bardhin, gjuhëtari Mustafa Kruja nënvizon:” *Në këtë vepër të përvutë shqiptare, kënduesi s’ka për të gjetun vetëm një listë alfabetike të thatë të fjalëvet shqipe të Frangut të Bardhë (kund nja 2500), por diçka edhe më tepër, qi kam shpresë se mund t’i sjellë një dobi praktike studimit të gjuhës s’onë përgjithësisht.*”⁵⁹

Gjithashtu, ky studiues, është i mendimit se, pothuajse nga të gjitha fjalët e parashtruara në Fjalor, nuk ka ndonjë të mos përdoret në shqipen e sotme.

Gjysma e fjalëve të përdorura janë shqipe, rreth 1300, por sipas K.Ashtës , Bardhi ka rreth 2544 fjalë shqipe.

Sa i takon pasurisë së shqipes, studiuesi dhe përkthyesi Pashko Geci, ka vënë në dukje : “ *Për një gjuhë të pasur, sikurse ishte latinishtja, ky numër ishte tepër i vogël, duke pasur parasysh se fjalët janë vënë vetëm në një kuptim, në kuptimin e tekstit. Kështu Fjalori pasqyron vetëm një pjesë të leksikut të latinishtes, kjo sasi fjalësh mund të mjaftonte vetëm për fjalë të rralla të latinishtes.*”⁶⁰

Sipas studiuesit Pashko Geci, leksiku i shqipes pasqyrohet i varfër. Kjo, sepse fjalët sinonime të latinishtes janë përkthyer në shqipen me të njëjtën fjalë dhe në disa raste fjalori dygjuhësh bën shërbimin e fjalorit shpjegues, por edhe se shumë fjalë të latinishtes me kuptime të ndryshme, ose mjaft të largëta, për mungesë fjalësh, janë dhënë në shqipen me një fjalë të vetme. Kjo vepër leksikografike ka vlerë të madhe gjuhësore, jo vetëm për paraqitjen e fondit leksikor të gjuhës sonë, por edhe për formimin e disa neologjizmave të krijuara sipas bazave gramatikore të gjuhës shqipe. Bardhi kishte si qëllim që të bënte një fjalor praktik që t’u shërbente edhe atyre që nuk kishin njohuri gjuhësore.

Përveç Fjalorit, ai përfshin edhe 113 proverba shqipe dhe të përkthyer nga latinishtja, italishtja e turqishtja. Mund të thuhet se është interesimi i parë për mbledhjen e botimin e këtyre elementeve folklorike. Bardhi thekson, se i ka vendosur këto proverba, sepse libri iu duk i pakët dhe i vogël, e në mënyrë për ta përmbushur pakëz, ai vendos edhe disa proverba të shqipes.

Autori i veprës monumentale “Leksiku historik i gjuhës shqipe”, Kolë Ashta nënvizon: *Këto proverba i shkruan në gjuhë të ndryshme: në dy gjuhë : herë shqip – latinisht, herë shqip – italisht, herë shqip – turqisht; në tri gjuhë : herë shqip – turqisht – latinisht, herë shqip – latinisht – turqisht, herë shqip – italisht – turqisht.*⁶¹

Kjo vepër leksikografike e vitit 1635 është e para që dimë të ketë dalë nga shtypshkronja e Propaganda Fides dhe Fjalori i parë i njohur i gjuhës sonë, me rreth

⁵⁸B. Demiraj, *F. Blanchus*, “Dictionarium latino-epiroticum”, Shkodër, 2008, f.85.

⁵⁹ M.Kruja, “Nji studim analitik Gjuha e Frang Bardhit dhe shqipja moderne”, Tiranë, 2007, f.13-14.

⁶⁰ P.Geci, *Frang Bardhi dhe “Fjalori” i tij latinisht – shqip*, ”Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe” II, Tiranë, 1972, f.299.

⁶¹ K.Ashta, ”Leksiku historik i gjuhës shqipe”, III, Shkodër, 2000, f.69.

2500 fjalë, të cilin Kolë Ashta e ka vjelë fjalësin e tij në veprën “Leksiku historik i gjuhës shqipe III”.

Puna leksikografike e këtij autori do vlerësohet, se është i pari ballafaqim i shqipes me një gjuhë të lëvruar, siç ishte latinishtja; nga njëra anë për vështirësitë si fjalor dygjuhësh, dhe, nga ana tjetër, autori nuk pati me kë të konsultojë, sepse kishte shtatë vjet që kishte shkuar në Itali.

Sfera e lemave të përfshira është e përdorimit të përgjithshëm ligjërimit, gjithashtu janë sjellë edhe elemente të latinishtes kishtare, një fushë përdorimi praktike për shërbesat fetare.

Element tjetër me rëndësi është edhe fakti se, ky Fjalor, në disa raste mund të quhet edhe Fjalor shumëgjuhësh, sepse pranë fjalëve në gjuhën latine autori vë edhe ato të gjuhës italiane e turke, psh.: *lat. huc – it. qui – turq. bunda – shq.këtu*.

Për këtë Bardhi, në historinë albanologjike, lavdërohet për njohjen e shumë gjuhëve. Këtu ka edhe disa fjalë të huaja, si italianizmat: *guerra* për luftë, *fosse* për gropë (f.27), *soldat* për ushtar (f.58) etj., greqizma (më pak), si: *putir, zahare* (f.138); turqizma: *ibrig* (f.4), *kasap* (f.9), *haraç* (f.176); sllavizma: *zakon* (f.20), *grazhd* (f.107), *bashtinë* (f.3) etj., të shënuara si etimologji nga vetë autori. Pavarësisht nga këto, ky Fjalor është i një rëndësie të veçantë.

“Që kemi të bëjmë me një vepër të rëndësishme, - shkruan K.Ashta, - e vërteton fakti se nga veprat e fazës së vjetër të shkrimit shqip më tepër u pat njohur, përdorur e studiuar Fjalori i Bardhit për kërkime albanologjike në shek. XX, sepse duke qenë fjalor në dy gjuhë, latin e shqip, që edhe për ndihmë të atyre gjuhëtarëve të huaj, që shqipen s’e dinin.”⁶²

Por, duhet theksuar edhe fakti se, siç thoshte Mario Roque ” ...*dictionary kurr nuk që rishtypë prej Propagandës, me gjithë mungesën e një fjalori tjetër shqip të shtypun deri në shekullin e XIX, kurse Doctrina e Budit ka qenë rishtypë tri herë*”.⁶³

Fjalori i Bardhit ka rëndësi të madhe historike në leksikografinë shqiptare me anët e veta pozitive dhe mangësitë e kohës, sepse në të mund të shihen mirëfilli ndryshimet që ka pësuar gjuha në rrjedhë të shekujve.

Sigurisht që vlerat pozitive janë ato që e karakterizojnë këtë vepër gjuhësore duke e vlerësuar Bardhin si leksikografi, i cili mori përsipër të pasqyronte pasurinë leksikore të gjuhës së vet.

“Tek Frang Bardhi zbulohet një shenjë e traditës etnografike dhe etnologjike shqiptare, në mos ajo ndërtohet në frymën dhe gjedhën e traditës europiane të kohës. Konstatimi i tezës së fundit do të dëshmonte edhe një vlerë të karakterit dhe frymës europiane, të cilën e solli Frangu i Bardhë në traditën shqiptare”⁶⁴- vëren studiuesi i historisë së shqipes, Begzad Baliu.

⁶²K.Ashta, ”Leksiku historik i gjuhës shqipe III”, Shkodër, 2000, f.86.

⁶³ M.Roque, *Frang Bardhi dhe Fjalori i tij*, “Dijetarët francezë për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare”, Shkodër, 2005, f.153, marrë nga “Buletin Shkencor”, Shkodër, nr.4, 1966, përktheu nga frëngjishtja Willy Kamsi.

⁶⁴B.Baliu, *Frang Bardhi dhe albanologjia*, ”Kërkime albanologjike”, Prishtinë 2010, f. 31.

5. Fjalori i Frang Bardhit dhe struktura e tij. Areali gjuhësor i Fjalorit të Bardhit.

Padyshim që vepra e parë e mirëfilltë gjuhësore në leksikografinë shqiptare është Dictionarium-i i Frang Bardhit, botuar në Romë më 1635, “Fjalor latinisht shqip” me titullin në origjinal “Dictionarium Latino-Epiroticum”, Romë, 1635.

Vlerësohet se është i pari fjalor i gjuhës shqipe, me të cilin fillon leksikologjia shqiptare. Autori e hartoi, siç e shpreh qartë në parathënie, i shtyrë nga qëllimi atdhetar për të ndihmuar që gjuha shqipe të mos prishej e të mos humbiste në kushtet e pushtimit të huaj dhe për t’u shërbyer klerikëve katolikë shqiptarë që nuk e dinin latinishten. Në këtë fjalor për herë të parë gjuha shqipe u ballafaqua me një gjuhë të huaj si latinishtja, që ishte gjuha më e përpunuar ndërkombëtare e asaj kohe. Fjalori përfshin rreth 4500 fjalë latine, të cilave u përgjigjen rreth 2500 fjalë shqipe. Krahas fjalëve jepen edhe togfjalësha që tregojnë përdorimin e tyre. Pjesa e shqipes mbështetet kryesisht në gjuhën popullore dhe ndërthen edhe mjaft fjali e kuptime të lashta. Krahas tyre ka edhe fjalë të ndërtuara prej vetë autorit nga brumi i shqipes si barasvlerëse të atyre latine. Nganjëherë pranë fjalës latine vihet edhe përkthimi në italisht; gjithashtu herë pas here pranë fjalës shqipe jepet edhe ndonjë huazim nga turqishtja. Bien në sy mjaft fjalë të ndërtuara me prapashtesa, të cilat janë bërë shumë prodhimtare nga Rilindja e këtej. Fjalori përfshin edhe lista të disa pjesëve të ligjëratës, emra qytetesh e kështjellash të Shqipërisë dhe përsëritje në gjuhën shqipe. Aty gjejmë për herë të parë një listë prej 113 proverbash e thëniesh të urta. Kjo vepër e F.Bardhit ka shërbyer e shërben si burim i rëndësishëm për studimin e historisë së gjuhës shqipe e të kulturës shqiptare. Fjalori i ribotua me një hyrje studimore nga albanologu M.Roque dhe është rishtypur më pas në Prishtinë dhe në vitin 2006 në Tiranë. Fjalët shqipe të këtij Fjalori u botuan me një hyrje studimore nga K.Ashta.⁶⁵

Ai që e ribotoi veprën e Bardhit, ishte albanologu francez Mario Roques me titullin “Le dictionnaire albanais de 1635”, duke mos lënë pa vendosur edhe titullin origjinal dhe emrin e autorit. Studiuesi Roques ka përfshirë edhe një parathënie me 44 faqe në lidhje me Fjalorin e Bardhit.

Ky Fjalor u shkrua me alfabetin latin, ku duket përpjekja e autorit për t’ia përshtatur këtë alfabet fonetikës së shqipes, ngaqë deri në atë kohë as që bëhej fjalë për njësim të alfabetit, sepse, siç shprehet studiuesi Mustafa Kruja, ata (Buzuku, Budi, Bardhi, Bogdani) e kanë ndjerë nevojën të shkruajnë shqip, dhe për këtë arsye kanë përdorur një shqipe vetjake.

Alfabeti i përdorur, është ai latin, i plotësuar me tri shenja përkatëse : ε – z, γ - ü (sot y e shqipes), ξ - th, dh.

Në këtë fjalor, për herë të parë, gjuha shqipe ballafaqohet me një gjuhë të përpunuar, siç ishte gjuha latine në atë kohë. Përkthimi në shqip mbështetet kryesisht në gjuhën popullore, në fondin kryesor të gjuhës sonë, por shpeshherë Bardhi sjell në përdorim edhe shumë arkaizma. Me këtë vepër zë fill leksikologjia shqiptare, ndaj me të drejtë Bardhi quhet edhe leksikologu i parë në historinë e gjuhës shqipe.

Në zërin për Frang Bardhin tek FESH, 2008, lexojmë: Frang Bardhi,⁶⁶ leksikografi i parë shqiptar, historian, folklorist dhe etnograf, klerik i lartë katolik. Një nga autorët e letërsisë së vjetër shqiptare. Hartoi dhe botoi më 1635 “Fjalorin latinisht-shqip” për të ndihmuar lëvrimin e shqipes dhe për të qenë mbështetje a nxitje që të botoheshin më

⁶⁵ Shih: A.Kostallari *Fjalori Latinisht-Shqip i F.Bardhit*, në FESH, vëllimi I, Tiranë, 2008, f.694.

⁶⁶Fjalor Enciklopedik Shqiptar, Tiranë, 2008, vëllimi I, f.180.

shumë libra në gjuhën amtare. Me proverbat e botuara aty F.Bardhi ka bërë edhe përpjekjen e parë që njihet për mbledhjen e folklorit shqiptar. Më 1636 botoi në Venedik veprën "Georgius Catriotes Epiensis, vulgo Scanderbeg, Epirotarum Princeps fortissimus ac invincitimus ("Gjergj Kastriot i Epirit, i quajtur përgjithësisht Skënderbeg, princ shumë trim e i pathyeshëm i Shqiptarëve"), të cilën e shkroi si polemikë për të hedhur poshtë mëtimet e pathemelta të një peshkopi boshnjak bashkëkohës që kishte dashur të nxirte Skënderbeun nga familja e tij nga vendet e Bosnjës.

Argumentet e përdorura nga F.Bardhi janë mbështetur në burime historiografike, arkivore e kronikale që njiheshin në atë kohë, duke mbajtur ndaj tyre edhe qëndrim kritik. Në relacionet e tij të shumta krenaria për traditat shqiptare dhe shprehet dëshira e shqiptarëve për liri.

Që në fillim të parathënies së veprës, Bardhi shfaq qëllimin e tij në lidhje me Fjalorin, duke u shprehur për shqipen si një gjuhë që po humbiste e bastardhohej ditë për ditë. Dhe kjo, ishte më se e vërtetë, se nën ndikimin e italishtes e turqishtes, gjuha shqipe po e humbte pastërtinë e vet.

Dhe qëllimi kryesor i tij ishte që priftërinjtë shqiptarë të dinin t'i thonin urdhëresat kishtare në gjuhën shqipe në padijeni të saktë të latinishtes.

Duke u përqendruar tek Fjalori, duhet theksuar se fjalët latine nuk i përkasin latinishtes klasike, por asaj moderne,⁶⁷ veçse kjo nuk do të thotë që priftërinjtë shqiptarë të gjenin në të, atë që me të vërtetë e kërkonin.

Ajo që bie në sy, është se Bardhi nuk e përmend fare Pjetër Budin, i cili kishte shkruar tashmë dy vepra.

Për këtë është shprehur Mario Roque, se është e çuditshme, që Bardhi të mos e përmendë fare emrin e Pjetër Budit, i cili tashmë kishte dy vepra të përkthyer shqip, të cilat priftërinjtë shqiptarë i kuptonin shumë mirë⁶⁸. Kjo dukuri të lë të mendosh, se, ose nuk i ka njohur këto vepra, ose nuk i ka kushtuar rëndësi mësimi fetar aq shumë, por riteve e ceremonive në veçanti.

Historiani i gramatologjisë shqiptare Jup Kastrati nënvizon: " *Bardhi e përpiloi Fjalorin e vet ndër disa rrethana historike të caktuara, kur nuk kishte dalë në dritë pasuria leksikore e shqipes ndër shkrime të autorëve paraardhës, për të cilët Bardhi s'dinte gjë ose pak mund të dinte vetëm për Budin*".⁶⁹

Ndërsa gjuhëtari Selman Riza është i mendimit se, Bardhi duhet t'i ketë përvetësuar nga Budi veçoritë fonetike dhe grafike të shqipes.

Bardhyl Demiraj, theksonse ka një shpërpjesëtim të qartë mes pjesës së fillimit dhe asaj të mbarimit, ku numri i fjalëve që nisin me A-E është tepër i zvogëluar, për shkronjat F-I përpjesëtimi është normal, ndërsa për L-V shfaqet një tepri.

Bardhi, siç e kemi theksuar më lart, disa fjalëve u ka dhënë barsvlerëset e tyre në italisht e turqisht, por edhe kjo dukuri ka ndodhur në përpjestim të zhdrejtë.

Autori, nga fakti se Fjalori do të dilte me pak faqe (80, siç e kishte parashikuar vetë ai), e ka fryrë duke marrë për bazë një Fjalor latinisht çfarëdo. Nga kjo rrjedhin listat e gjata me fjalë në *in-*, *per-*, *pro-*, *re-*, në kundërshtim me numrin e vogël të fjalëve me

⁶⁷B. Demiraj, "Dictionarium latino-epiroticum" 1635, Shkodër, 2008.f.38.

⁶⁸M. Roque, *Frang Bardhi dhe Fjalori i tij*, "Dijetarët francezë për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare", Shkodër, 2005.f.153, marrë nga "Buletin Shkencor", Shkodër, nr.4, 1966, përktheu nga frëngjishtja Willy Kamsi.

⁶⁹J. Kastrati, "Histori e albanologjisë" I, Tiranë, 2000. f.79-101.

de-, ex-.⁷⁰Përkatësisht, me *in-* kemi 173 fjalë, me *per-* 219, me *pro-* 141, *re-* 250, ndërsa me *de-* 49 dhe *ex-*22 fjalë. Si shembuj të tillë kemi: *deluere – meulaam; decorticare – me riepune; exulceratio – varra, oð plaga; expes – paa fpreffe; interdiu – ditene; interea, tratanto – saa; perturbatus – turbuluem; peruenire – me mberym heret; proceffus – fruit; procliuis – te prugnune; reolare – me fluuruem mbrapa; retendere – me eliruem etj.*

Një fakt tjetër, për të cilin mendohet se Bardhi ka ndërruar metodë, është se fjalëve latine u ka dhënë një korresponduese në italisht dhe glosave shqipe, korrespondueset në turqisht, gjë që të lë të kuptosh, se mos ka dashur të na pasqyrojë një Fjalor katërgjuhësh. Por, prania e turqishtes, mund të shpjegohet qartë se priftërinjtë shqiptarë kanë qëndruar nën presionin turk gjatë, psh., *hodie –sod, turcicè, bugiun* (B. f.31), *huc- cheha, turcicè, buraija*, (B. F. 32), *illicitum – malecuem, turcicè, haram* (B.f. 33) etj, etj., por dhënia e tyre në italisht, është më pak e qartë, duke menduar se shumë fjalë italiane janë të prejdardhura nga ato latine, si psh *damnú , danno – dam* (B. f.17), *efurio, efurire – cham uu* (B. F.23), *fabula, favola – perrala* (B. f.24), *frumentú, frumento- grune* (B.f.28) etj, etj.

Por, sipas studiuesit Mario Roque, përgjegjëset e tyre në italisht kanë një dobi të veçantë, sepse shpjegojnë një fjalë të çuditshme latine, para se të jepet përkthimi në shqip⁷¹, psh., *forceps,tanaglie – daena* (B. f.27), *frixorium, padella- furtereia* (B. f.28), *fur, ladro - cuffaar* (B. f.28), *hepar, fegato –mufchenij* (B. f.31) etj, etj.

Një tjetër studiues i Bardhit, Mustafa Kruja, shprehet se: “ *ndër 2300 fjalët e Bardhit rrallë e tek gjindet ndonji qi mos t’a ketë gjuha e jonë në përgjithsi edhe sod mbas treqind e sa vjetsh...*”⁷²

Pra, Bardhi ka me të vërtetë një pasuri leksikore gjuhësore, ku fjalët e Fjalorit janë koherente edhe në ditët e sotme.

Sipas Selman Rizës, rëndësia e Fjalorit qëndron në ruajtjen e shqiptarizmave të vjetra, ku shohim se është treguar tepër fanatik.

Bardhi ndoqi traditën shkrimore të paraardhësve të tij, kryesisht arealin kulturor-fetar të Shqipërisë së Veriut, katolike, duke marrë parasysh normën drejtshkrimore të italishtes, shprehet Demiraj.

Për Bardhin, tjetër është gjuha, tjetër alfabeti, pavarësisht se si shqipja, ashtu edhe latinishtja, shkruhen me të njëjtin alfabet.

Ai ka përdorim të ndryshëm të shkronjave latine ndërmjet tingujve të shqipes.

Bardhi nuk bën dallimin e zanores *e* me *ë*, por për të dyja ai përdor zanoren *e*. psh.: *nafus –hunde* (B. f.63), *pacator – paitueff* (B. f.81), *pinguis – i maime* (B. f.98), *sacer – scecruem* (B. f.138) etj.

E njëjta gjë ndodh me bashkëtingëlloret *c* e *ç*, ku për *c* ai përdor *z*, psh.: *devenire – me fdripune vendit zenalte* (B. f.19), *felis, gatto – miza* (B. f.25), *feftinare – me ezune cpeit* (B. f.25) , ndërsa *c* e përdor për *k, ç, q* psh.: *fimbria – scundilli* (B. f.26), *fons,fontana – crue oó gurre* (B. f.26), *illicitum – malecuem* (B. f.33), *locufta-canderri* (B. f.50), *lupus, lupo – huc* (B. f.51) etj.

⁷⁰M. Roque, *Frang Bardhi dhe Fjalori i tij*, ”Dijetarët francezë për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare”, Shkodër, 2005.f.153, marrë nga “Buletin Shkencor”, Shkodër, nr.4, 1966, përktheu nga frëngjishtja Willy Kamsi.

⁷¹M. Roque, *Frang Bardhi dhe Fjalori i tij*, ”Dijetarët francezë për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare”, Shkodër, 2005.f.153, marrë nga “Buletin Shkencor”, Shkodër, nr.4, 1966, përktheu nga frëngjishtja Willy Kamsi.

⁷²M.Kruja, ”Nji studim analitik Gjuha e Frang Bardhit dhe shqipja moderne ”, Tiranë, 2007,f.45.

Përsa u takon zanoreve hundore, autori nuk e bën dallimin, ndërsa zanoret e gjata shënohen me dyfishimin e tyre. P.sh: *fatius – maa mire* (B.f.142); *saxulum – guurç* (B.f.143); *fed – maa* (B.f.147); *feparare – me daam* (B.f.149), etj.

Përveç këtyre, gjejmë edhe dyfishimin e bashkëtingëlloreve, të cilat i përdor për të dalluar të shurdhëtat nga të zëshmet, por ka disa parregullsi në këto përdorime. P.sh: *poculum – cuppe* (B.f.100); *plerique – ma emaççëia pieffe* (B.f.100) etj.

Vetë autori është i vetëdijshëm për mungesat e librit të vet, dhe për këtë është munduar ta plotësojë a zgjerojë me disa shtojca me karakter gramatikor.

Në faqen e fundit të shënuar me *errata* të jep idenë e sasisë së gabimeve të përdorura, gjë që na lë të kuptojmë, se pjesës së fundit i është kushtuar më shumë kujdes se sa fillimit.

Pas Fjalorit vihen re disa shtesa si: numërorë, emra farefisnie, toponime, ndajfolje, pasthirma, proverba e tri biseda popullore. Këto, mbase Bardhit iu duk Fjalori i pakët e i vogël e për këtë arsye u mundua ta bënte sa më të plotë.

Në fund të parathënies, ai shprehet: ” *s mujta mā mirë me e nkëthyem me e mbushunë e me e ndërequnë*”.⁷³ Në këtë mënyrë i kërkon ndjesë lexuesit nëse Fjalori nuk ka dalë aq i plotë dhe i goditur, duke i treguar edhe arsyen e mospërballjes tepër me gjuhën shqipe, duke theksuar faktin se shumë fjalë të shqipes nuk i mbante mend, sepse nuk kishte me kë të bisedonte gjuhën mëmë.

Relatori Mark Skura shprehej, se ky Fjalor u shërbente jo vetëm shqiptarëve, por edhe për studiuesit e huaj ishte i nevojshëm. Kolë Ashta e vlerëson dhe e vërteton këtë fakt, duke u shprehur, se Fjalori i Bardhit u pat njohur, përdorur e studiuar më shumë për kërkime albanologjike në shek. XIX, sepse si Fjalor dygjuhësh, latin – shqip, që më i lehtë në përdorim edhe për ata gjuhëtarë të huaj, që shqipen s’e dinin.⁷⁴

Fjalori i Bardhit u bë më vonë burim për leksikografinë shqipe, si për Kristoforidhin, Bashkimin, madje, sikundër shprehet Kolë Ashta, ky Fjalor mund të ketë ndihmuar për një tjetër “ Fjaluer latin – shqip” botuar nga etërit jezuitë në Shkodër, më 1925.⁷⁵

Përsa i takon sasisë së fjalëve shqipe dhe atyre të latinishtes, vërejmë se kemi 2500 fjalë shqipe dhe 5000 ato latine. Kjo dukuri ka ndodhur për faktin se autori shumë fjalëve latine u ka dhënë kuptime të njëjta në gjuhën shqipe, psh.:

lepide – *pelchye fcim* (B.f.47)

ridicule – *pelchye fcim* (B. f.135)

salse - *pelchye fcim* (B. f.140)

enim – *praftu* (B. f.22)

ideo – *praftu* (B. f.33)

nam – *praftu* (B. f.63)

quia – *praftu* (B. f.119). etj, etj.

Gjithsesi, kjo vepër është për t’u vlerësuar, sepse, kryekreje, është Fjalori i parë i shqipes dhe me një pasuri leksikore të fondit shqip prej 2492 fjalësh.

Në fund të fjalorit, në një shtojcë, autori ka përfshirë edhe material gjuhësor, si: numërorë, emra mashkullorë e femërorë, emra farefisnie, emrat e qyteteve dhe të kështjellave kryesore të Shqipërisë, parafjalë, pasthirma, disa mënyra të përhëndeturi si dhe një dialog të shkurtër. Ajo gjithashtu i hapi rrugë dhe një dege tjetër të dijes shqiptare, folkloristikës sonë, sepse në të janë përfshirë edhe 113 proverba, shumica origjinale por mund të ketë edhe të përkthyer.

⁷³F. Bardhi “Dictionarium latino-epiroticum” 1635.f.121.

⁷⁴K.Ashta, “Leksiku historik i gjuhës shqipe” III, Shkodër, 2000.f.63.

⁷⁵K.Ashta, “Leksiku historik i gjuhës shqipe” III, Shkodër, 2000.f.63.

Kreu I përfshin **Tegnefunate Latinisct, talianisct, arbenisct e turgisct**, pra numërorët latinisht, italisht, shqip e turqisht.

Kreu II përfshin **Emenate e prindet mafchie e femene: latinisct, talianisct, arbenisct e turgisct**, pra emrat e farefisnisë të gjinisë mashkullore e femërore latinisht, italisht, shqip e turqisht, psh.:

filius, figlio – *biir; turgift oglan* (B. f.194)

confobrinus, cugino – *cufcerij; amuga* (B. f.194)

auunculus, zio – *vnghie* (B. f.195)

amita, zia – *emte* (B. f.195)

sponfa, fpofa- *nuffeia; gelin* (B. f.195) etj.

Kreu III përfshin **Emenate e qyteteuet e te chefctielet Arbenit: latinisct, talianisct, arbenisct e turgisct**, pra emrat e qyteteve e të kështjellës së Arbërit, latinisht, italisht, shqip e turqisht, psh.:

Dyrachium – *olim Romanorum Colonia nunc A. Durrazo – Durrez* (B. f.197).

Petralba, Pietra bianca- *Guri i Barççe* (B. f.198).

Scutari - *Scodra* (B. f.198).

Kreu IV përfshin disa ndajfolje dhe shprehje ndajfoljore, *De Aduerbijs, quæ traduntur apud Epiroticos, ficut etiam apud Latinos*, psh.:

in loco – *chetu, hic, qui turcicè bunda* (B. f.199)

periafta- *intus, permbrenda, foris* (B. f.199)

ndene tá – *inferius, ngiat – prope* (B. f.199)

perpara – *antè, pernbrappa – retro* (B. f.200)

cus di- *quis fcit?* (B. f.202) etj.

Kreu V përmban parafjalë dhe shprehje ndajfoljore, **De præpofitionibus Epiroticis, ferè omnes præpofitiones antè ponuntur nominibus, funt vero eiufinodi**, psh.:

mb æemere – *adcor, mb ghiuhe – ad linguā* (B. f.204)

per bucche – *propane: per vene, pro vino* (B. f.205)

mbas moortiet fime – *poft mortem meam* (B. f.205) etj.

Kreu VI përmban disa pashirra, **De Interiectionibus**, psh.:

dolentis: *hai, hai, hei* (B. f. 206)

ridentis: *ha ha, he he* (B. f. 206)

irridentis: *pa fuco, pa fuco fi ban, fi çote* (B. f.206)

Kreu VII përfshin proverbat, *Prouerbia, & fententæ*, në të cilat numërohen rreth 113. Po i paraqesim disa prej tyre, psh.:

cus gnef vetehene gnef Teneæone – *quit nofcit feipfum, agnofcit noftrum Deum* (B. f.207)

dita e mire gnifette ndenattenet – *il bel giorno fi cognofce dalla mattina* (B. f. 210)

duhete me strijm cambete faa chee te mbuluemite – *bifogna diftenderfi fecondo la coperta* (B. f.211)

deeti,eiarmi, grueia, trij te chechia te meçaa – *mare, ignis, mulier, tria mala magna* (B.f.212) etj.

Më tej Bardhi ka vijuar me disa përshendetje të tipit:

mire fe te giaagn sot – *salve domine* (B. f. 217)
mire fe te sijellechaa e diaçeta e Tineot (B. f. 217)

ose ndeshim edhe disa dialogje:

Cu ve vellaa hoi? Oó qu ve ó i arbebefce? – *quo vadis frater mi? Vel quo tendis ó Epirota* (B. f. 218).

Prei ftamboli nde pelchiefte Tineot ghi afcte mbe ghielt- *Verfus Cofantinopolim fi placet noftro Deo qui eft in Caelis* (B. f.218).

Në fund të Fjalorit Bardhi ka paraqitur një *Admonitio de erroribus*, duke përfshirë disa gabime ortografike , që, sipas autorit, janë shtypur gabim nga shtypshkronja duke mos ditur mirë gjuhën shqipe.

Studiuesi Mustafa Kruja shprehet: “*Sikur t’u shkruente sod një vepër gjuhe si fjalor’i Frangut të Bardhë nuk do të vjyente as shpenzimet e shtypit. I shkruem e i botuem në 1635 ásht një thesar, si të gjitha dokumentet e vjetra të gjuhës s’onë prej qindvjetit XVI...*”⁷⁶

Fjalori latinisht-shqip mbetet me të vërtetë një thesar i gjuhës shqipe, të cilin shumë gjuhëtarë e sidomos leksikografë e morën si pikë referimi për hartimin e fjalorëve të mëvonshëm në gjuhën shqipe.

- Proverbat si pjesë përbërëse e tij.

Gjurmimi i fjalës e i shprehjes popullore në të gjitha trojet e shqipes, jo vetëm ka marrë në kohën tonë përmasa shumë të gjera, por është bërë i gjithanshëm, shumë më sistemor e i thelluar se në të kaluarën dhe u nënshtrohet kërkesave shkencore më të larta.

Lënda e mbledhur në gjirin e popullit ka ushqyer e ushqen jo vetëm fjalorët e shqipes, por edhe të gjitha studimet gjuhësore shqiptare.

Njësitë frazeologjike mbushin zbrazëtitë e sistemit leksikor e të atij semantik aty ku nuk ka emërtime njëfjalëshe ose përdoren për pastrimin e leksikut nga fjalët e huaja.⁷⁷

Gjuha e gjallë e popullit, gjuha e krijimtarisë gojore popullore, me një pasuri të madhe frazeologjike me vlera të pazëvendësueshme, përbën burimin për shumë njësi frazeologjike.

⁷⁶M. Kruja, “Nji studim analitik Gjuha e Frang Bardhit dhe shqipja moderne”, Tiranë, 2007, f.73.

⁷⁷J. Thomai, “Norma e gjuhës letrare dhe frazeologjia e gjuhës shqipe”, Studime mbi leksikon dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe III, Tiranë, 1989, f.191.

Njësitë frazeologjike, si lëndë e sistemit të gjuhës, u nënshtrohen ndryshimeve të kohëpaskohshme e në drejtime të ndryshme. Ajo që bie në sy tek ndryshimi i tyre, është më tepër brendia sesa forma.

Fjalët e urta, si pjesë e formave të shkurtra të krijimtarisë gojore, kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë të pranishme në të gjitha etapat e zhvillimit kulturor të njerëzimit.

Në fjalorin e Frang Bardhit kemi 113 proverba, të cilat pasqyrojnë më së miri psikologjinë e popullit shqiptar, traditën e zakonet e tyre.

Jemi munduar t'i bëjmë një klasifikim duke u përqendruar tek motivimi i tyre në sajë të prejardhjes dialektore.

Shtresën e parë e përbëjnë frazeologjizmat a proverbat që kanë qenë e janë pronë e mbarë gjuhës, për të cilat historikisht nuk mund të vërtetohet burimi krahinor, kurse në gjendjen e sotme, nuk kanë asnjë tregues krahinor.

Si të tillë mund të përmendim:

mbaffi te chies zane, ani mbfso e cila është sinonime me frazeologjizmin *pësimet bëhen mësim ose i pësuar, i mësuari* (Fgjs, 2006, f.810).

me mijtë ha e pi e treg mos ban, e ndeshim sot pothuajse me të njëjtin variant, *me tëndin ha e pi, e treg mos ban* (Fgjs, 1954, f.572).

gnana dore laan tietrene e te dyyja laagnene fachiene, të cilën e kemi me të njëjtën trajtë *njëra dorë lan tjetrën, të dyja lajnë fytyrën* (Fgjs, 2006, f. 207).

anemicu plach, f te bahete curre mich e, nde t u mbafe, s bahete i dereite, e ndeshim tek Fjalori i Mehmet Elezit në të njëjtën trajtë, *Anëniku plak s'bahetë kurrëmik, e ndë t'u baftë, s'bahetë i dërejtë* (F.M.E, 2006, f.918).

ma mire me hestune, fe fcume me fole , e gjejmë si fjalë të urtë edhe tek Fjalori i Mehmet Elezit, *ndër punë qi s'i dijme asht ma mirë me heshtue se me folë* (F.M.E, 2006, f. 579).

gna nierij ghi kaa fcume fiale gna i fcurçene e mund, e takojme edhe tek Fjalori i Mehmet Elezit, pothuajse me të njëjtën trajtë, *ni shurdhan e mund ni njeri si ka shumë fjalë* (F.M.E, 2006, f.1438).

pefcu maa pare chielbette nde cryet. Nuk e kemi takuar në Fjalorët e shqipes, ndonëse në ligjëimin bisedor gjen përdorim.

dita e mire gnifette ndenattenet, e ndeshim si fjalë të urtë edhe tek Fjalori, 2006, *dita e mirë duket që në mëngjes* (Fgjs, 2006, f.198).

molla nuçe rezohete largh mmollet, sot e takojmë me sinonimin e saj *dardha nën dardhë bie* (Fgjs, 2006, f.170).

duhete me strijm cambete faa chee te mbuluemite, ndërsa sot e gjejmë me këtë trajtë, *shtriji këmbët sa ke jorganin* (Fgjs, 2006, f.452).

cu giaa f afte, giaa fgindete, është sinonime me fjalën e urtë, *ku ka zë, s'është pa gjë* (Fgjs, 2006, f.355).

ri ftremene e flet dereit, e ndeshim edhe sot me të njëjtin kuptim, *të rrimë shtrembër e të flasim drejt* (Fgjs, 2006, f. 931).

si me fce, aftu me fcruet, e njëjtë me shprehjen *shih e shkruaj*, (Fgjs, 2006, f.1030).

chiet fcegiettene e mbfcefen archne, është sinonime me shprehjen e sotme *hedh gurin e fsheh dorën* (Fgjs, 2006, f.337).

nde gnantet vefc me hije e per tieterit me del, e njëjtë nga ana formale e kuptimore, *nga njëvesh i hyn e nga tjetri i del* (Fgjs, 2006, f.1169).

cus kaa denare ame e ate ble, e ndeshim tek Fjalori i Mehmet Elezit pothuajse me një kuptim të ndryshëm, *me pare gjân gjithçka, veç babë e nanë jo* (F.M.E, 2006, f.1059).

vcu ghimene nderrō, ma veffne f e harron, e njëjtë me *ujku qimen e ndërron*, por *zakonin s'e harron* (Fgjs, 2006, f.1139).

digete bari i gnome, ndeper te ççaatet, e kemi dhe tek Fjalori i Mehmet Elezit, *digjetë bari i njomë ndëpër të thatët* (F.M.E, 2006, f.180).

cu turchu ve cambene aty f del baar. E dëgjojmë si proverb në ligjërimin bisedor, por nuk e gjejmë të shpjeguar në Fjalorët e shqipes.

si te bais, aftu chie me gietune, është sinonime me shprehjen *ç'të mbjellësh, do të korrësh* (Fgjs, 2006, f. 606).

Shtresën e dytë e përbëjnë frazeologjizmat a fjalët e urta me burim dialektor a krahinor, por, që tashmë janë përgjithësuar e që gjuha shqipe i ka bërë pronë të saj.

kis ha giucuem s kaa me menguem, si fjalë të urtë me këtë trajtë nuk e gjejmë të përdorur, por mund të kemi sinonimen e saj nga ana e domethënies, *po vune pemë, ke me ua hanger kokrrat* (F.M.E, 2006, f.52).

nieriu i urte giççe caffcene tendon, mund të jetë sinonime me *njeriu i mençur çdo gjë e mund* (popullore).

te kekimate mbfognene, e ndeshim tek Fgjs, 2006 me një trajtë të ngjashme, *mësoj nga gabimet* (Fgjs, 2006, f.625).

fialethe iane graa, maa te bamette burra, e kemi tek Fjalori i Mehmet Elezit në tjetër formë, por përmbajtja është e njëjtë, *fjala e djalit si Zana e malit, fjala e resë si kokrra e rrfesë* (F.M.E. f.435).

ma mire me decune gna here, fe me u reëcuen giççehere, e kemi me një kuptim të ngjashëm, *më mirë të vdesësh në këmbë, sesa të rrosh i gjuhëzuar* (Fgjs, 2006, f. 1159).

cus ue nde mullij, doemos do permiellette, e ndeshim me po të njëjtë trajtë e po të njëjtin kuptim tek Fjalori i Mehmet Elezit, *kush ve ndë mulli, doemos do përmielletë* (F.M.E. f.949).

giççe cafcene me mot, përdoret tepër në ligjërimin popullore, *çdo gjë me mot(kohë)* (popullore).

duhete me pritune rend, të njëjtë si shprehje nuk e ndeshim të shpjeguar, por mund të kemi sinonimen e saj, *mos u ngut, mullini â me rend* (F.M.E. f.890).

cufc ue kaa dale, ve fcendos, e ndeshim në ligjërimin popullore, *kush vete ngadalë vete shëndosh* (popullore).

s bet beffe nde chetta feculle, e kemi tek Mehmet Elezi në një trajtë të ngjashme, *duel shkresa, hupi besa* (F.M.E. f.195).

ma mire me paffune anemichne e ftruem, fe michne e mbuluem e ngjashme me proverbin, *o zot ruejmë prej mikut se prej anmikut ruhem vetë* (F.M.E. f. 918).

si te ndeergnes afctu chee me chiene ndeerune, e ngjashme me shprehjen popullore, *si të më mbulosh, do të të mbuloj* (popullore).

kaali afte i atij ghi e galcon, mund të jetë sinonime me shprehjen, *vetëm i zoti e nxjerr gomarin nga balta* (popullore).

gna guur s ban muur, e ndeshim tek Fgjs, 2006, *me një gur s'bëhet mur* (Fgjs, 2006, f.337).

cus ban foffene fcioghit vete bie ndene tá, është sinonime me shprehjen, *kush i bën gropën tjetrit, bie vetë brenda* (Fgjs, 2006, f.329), ose *kush mundohet t'i bëjë varrin tjetrit, bie vetë brenda* (Fgjs, 2006, f.651).

aio caffsce ghi afte ma e bucure, aio afte maa festijr me e paffune, përdoret shpesh në ligjërimin popullore, *gjënë e bukur është vështirë ta kesh* (popullore).

lufta paa te decune f aste, ky proverb gjen përdorim edhe në ligjërimin e përditshëm, *pa të vdekur, nuk ka luftë* (popullore).

te dafunite prei fe paamit vien, e ndeshim tek Fjalori i Mehmet Elezit me të njëjtën trajtë e të njëjtin kuptim, *të dashunitë prej së pamit vjen* (F.M.E. f. 338).

cus gna cias ep, dyy here ep, sot ndeshim një proverb të ngjashëm me të, *njëra dorë ta japë e tjetra të mos e shohë* (F.M.E. f. 367).

giççe caffa per denare, përdoret edhe sot në ligjërimin e përditshëm, *çdo gjë bëhet për para*, (popullore).

s duhete me eane beffe as vijt, as turchut, kemi disa proverba të ngjashme, ku mund të veçojmë njërin, *ruejmë Zot prej Valisë, zjarmit e ujtë* (F.M.E. f. 1533).

giççe çe kaa sakonete e vet, përdoret edhe sot, *çdo vend ka zakonet e veta* (popullore).

mos te mundofte i munduemi, shpesh e përdorim në ligjërimin bisedor, kryesisht gegërishtja veriperëndimore, *mos të mundoftë i munduari* (popullore).

s afte mbarre me mos ditune, ma me mos dafune me zane, e ndeshim edhe sot në ligjërimin popullore, *nuk është turp të mos dish, turp është të mos duash të mësosh* (popullore).

vuaai affo ftepie cu chendon pulla e gielli heften, janë të shumta fjalët e urta me këtë kuptim. Përmendim, *ku kndon pula e sundon grueja, mos hi; kur të kndojnë pulat në shpi, mbarojnë burrat e mbesin gratë*, ose në formë mallkimi, *të këndoftë pula e të sundoftë gruaja* (F.M.E, 2006, f.1189-1190).

Shtresën e tretë e përbëjnë ato frazeologjizma a fjalë të urta dialektore a krahinore. Tek këto lloj proverbash, shumica nga ato nuk i ndeshim në gjuhën letrare, por janë dialektore e krahinore, të cilat përdoren vetëm në disa krahina të Shqipërisë, kryesisht gegërishtes perëndimore, nga ishte dhe vetë autori.

*cus gnef vetehene gnef Teneone
nierij mbeleçç e eotyne perderçç
vece etyne afte i paampcat
ata te mire ghi te bai fc fgignef fe, Tineeot ia ban
scoghi kaa fume arefye
kis te bai ff bane vrtfcim e fucó fi kaa me te dale
giçç cafsce me te percuerm
gindene fcume duer niereeis
suome ftane, ani te baamete
e dog langu bufterre
cus nuche afte mbfuem fdi me vrççenuem
tuch i diegh plachef fe aty perchet
maimuni nuchete eihete mb lach
anemichne mose kieel çuune
cuur dró fe te del maa cheich, mos e ban
schiferi f gittete mba mieaácit
tue fole fialete e fediga rittene
mos iep arefyye t paaditunit, çote Salamoni
giççecus duhete te mbae paie Miestrij ff uet
atto cafsce ghi f te kaane hie e s te perkaf fene, s duhete me i defceruem
grueia e bucure e vena e amble iane helm
atto cafsce ghi biene te çimtune f duhete me i cuituem*

kif do εoghela oó bilbili, ia bie prendeveera
 cuur dró fe te del maa cheich, mos e ban
 defceroime gižžehere atto cafsce ghi f chemi
 gižžecus fcucon te mirene e uet
 ani i keich nuče žehete
 buftra ghi nguttete me pielle, ban chelyfte e verbene
 cus leen chembyem, chembyem des
 te fofunite prit
 gif fe iemi te bijte e Mortffe
 morne f duhete me e haruem, perffe fod mue nef fere tyy
 i belbeti mer uef maa mire te belbetit
 deeti, eijarmi, grueia, trij te chechia te mežaa
 cuf chaa fcume bibeer, ftie ende nder lacanat
 gne ghind te cuituem f pagugnene gne te pagueme
 grueia e bucure e vena e amble iane helm
 te vobegune cu ta εane nata aty afte Pelaf fiitij
 žeu i eij ban buchene e baržže
 mialtete fcume here ban me lepyym ghiftate
 cus ue nde mulij maa pare, ai maa pare bló
 cus dro eiarre, n timit ichen
 mer peene nde do me gietune lamfcine
 cuur te fcofsce vefte vetij, athere chie me e paam
 nder te verbenit ti ende mberfcil fyte
 i uerbeni hiec te verbenine e te dy nde fof fet rezohene
 cus chaa huu f chezen
 kaalit mire f duhen fpore
 mos me mer, c mos me chie žane
 ende dellefcit fe gnefunas há vcu
 i chembyemi gižže here ban darfme
 hu εot e ti εot e baar kaalit cus iep?
 hu fi fnich e ti fi fnich e cafte caait cuf i ftie?
 scegeta e stijme f chežžen
 s afte i urte ai ghi mberfcel derene e oborrit mbaff i uožne kaane oó žijte
 maa mire me žyem cryete, ye me vum εakon te rij oó lif te ree
 sduhete me lueitune me gurre perplete
 ma veien gna želpene e giale, se gna luua i zoffete

Veprat e autorëve të vjetër përmbajnë një pasuri të madhe leksikore, ku pjesën më të madhe e përbëjnë fjalët e gjuhës popullore, të cilat vazhdojmë t'i përdorim edhe sot. Por, nuk duhet mënjanuar fakti se ato kanë krijuar mjaft fjalë të reja, qoftë sipas modeleve të vendit, qoftë sipas modeleve të huaja me brumin e shqipes. I marrë në terësi Fjalori i Bardhit dëshmon qëllimin e mirë për të nxjerrë në pah pasurinë leksikore të shqipes dhe punën e kujdesshme për të ruajtur pastërtinë e gjuhës dhe për ta mbrojtur atë nga huazimet e tepërta.

Deri tani meritë e parë për mbledhjen e proverbave i takon Frang Bardhit, jo vetëm për botimin, por edhe për pasqyrimin e mendësisë shqipare të asaj periudhe kohore.

6. Roli i Frang Bardhit si i pari leksikolog e leksikograf i gjuhës shqipe. Prurje gramatikore në Fjalorin e Bardhit.

Për historinë e kulturës shqiptare dhe për leksikografinë shqipe, vepra e zadrimit Frang Bardhi, gjithashtu përbën një ndihmesë të vyer, që la gjurmë në gjuhësinë shqiptare, e cila edhe sot pas katër shekujsh ngjall interes studimi dhe analize të Fjalorit të tij. Kjo vepër, siç do të shprehej Shefkije Islamaj, i siguroi Frangut të Bardhë pavdekësinë.⁷⁸

Ndonëse Frang Bardhi mbeti si i pari leksikolog e leksikograf në gjuhën shqipe, i cili hartoi të parin fjalor dygjuhësh latinisht – shqip, fjalor që shërbeu si gur themeli dhe bazë e shëndoshë për hartimin e fjalorëve të mëtejshëm në gjuhën shqipe, ai la gjurmë edhe si gramatikan, për të cilin themi se gjejmë edhe gjurmët e para për një gramatikë të shqipes.

Bardhi në këtë rast jep disa elemente të gramatikës së shqipes, kryesisht për pjesët e pandryshueshme të ligjëratës.

Jani Thomai nxjerr në pah se, Frang Bardhi e ka ndier nevojën që ta vërë shqipen në vend të parë. Kështu vepron me ndajfoljet, të cilat i jep shqip - latinisht, ose ndonjë shqip – italisht, me pasthirmat që i jep vetëm në shqip, me shembujt për parafjalët, të cilët i jep shqip – latinisht⁷⁹, do të thotë se, Frang Bardhi nuk ka pasur si qëllim kryesor motivin fetar e biblik, por më tepër dëshirën për t'i shërbyer gjuhës shqipe.

Përsa i takon gramatikës, ekzistojnë të dhëna sikur edhe Pjetër Budi të ketë folur për disa elemente të gramatikës së shqipes, ose edhe Ndre Bogdani në kujtimet e tij flet për një gramatikë shqip, e cila kishte humbur në peripecitë e luftës me osmanët. Por, bazat e sakta e të konstatuara i ndeshim në veprën e Frang Bardhit.

Ai i ndan sipas kapitujve në këtë mënyrë:

Kreu i parë, Numërorët ose siç i quan ai Tegnefunate Latinisct, Talianisct, Arbenisct, e Turgisct, Hoc est Nomina numeralia Latinè, Italicè, Epiroticè, & Turcicè. Në këtë kapitull, siç thekson studiuesi Ragip Mulaku, ai ka përdorur termin shqip *te njefunate*, sepse *numëror* vjen nga latinishtja *numerus*.⁸⁰ Bardhi numërorët i ka ndarë në themelorë dhe rreshtorë. Tek numërorët themelorë ka përcaktuar numrat nga një deri në katërqind mijë. Është për t'u theksuar, se Bardhi për numërorin një, përdor të dyja variantet nja (*njambëdhjetë, njazet*) dhe një (*njëqind, një mijë*).

Tek numërorët rreshtorë vërejmë një trajtë të veçantë të formimit të tyre, psh.: *i dyytimbëdhjetë, i tretimbëdhjetë, i katërtimbëdhjetë* etj.

Kreu i dytë, Emenatee Prinnet Mafchie, e Femene Latinisct, Talianisct, Arbenisct, e Turgisct.

Hoc est Nomina mafculorum, & foeminarum Parentum, Latinè, Italicè, Epiroticè, & Turcicè. Pra, kemi emra të gjinisë mashkullore, si biir, tatë, tatagjysh, kushërii, dhandërri, si dhe emra të gjinisë femërore, psh.: *gjyshja, skatragjyshja, motra, kusherina* etj. Bie në sy përdorimi i emrave me nyje përpara, ose siç quhet ndryshe nyje me vlerë pronori, që u paravendoset emrave të farefisnisë si, *i nipi, e motra, e shoqeja* etj.

⁷⁸ Sh. Islamaj, *Fjalori latinisht – shqip i Frang Bardhit, Fjalor i madh apo i vogël*, “400 – vjetori i Frang Bardhit”, Prishtinë, 2007, f.15.

⁷⁹ J. Thomai, *Frang Bardhi leksikograf*, “400 – vjetori i Frang Bardhit”, Prishtinë, 2007, f.59.

⁸⁰ R. Mulaku, *Elemente të një gramatike në Fjalorin e Bardhit*, “400 – vjetori i Frang Bardhit”, Prishtinë, 2007, f.71.

Kreu i tretë, Emenatee Gyteteuet, ete Chefetielet Arbenit Latinisct, Talianisct, Arbenisct, e Turgisct.

Hoc est propria nomina Vrbiū nonnullarum, atque Castellorum, ad eam partem Macedoniæ spectantium, quæ Epirus, fiuè Albania dicitur; proponuntur fecundum ordinem alphabeti, Latinè, Italicè, & Epiroticè digesta, vbi primun occurrit. Këtu përfshihen disa emra qytetesh dhe këtjellash, si Antivari, Tivari, Dukagjina, Valona, Vulona (Vlora), Guri i Bardhë, Përsëren (Prizren), Dolçinjo, Ulçinji (Ulqin) etj.

Kreu i katërt, De Aduerbijs, quæ traduntur apud Epiroticos, ficut etiam apud Latinos.

Ndajfoljet i ka ndarë në :

1. aduerbia loci (ndajfolje vendi): *chetu, periafta, ndene te, ngiat* etj.
2. aduerbia Qualitatis (ndajfoljet e mënyrës dhe të sasisë), si: *mire oo bucure, trimenift* etj.
3. aduerbia temporis (ndajfolje të kohës) : *sod, die, vone, tas* etj.
4. aduerbia numeri (ndajfolje të sasisë), si: *gna here, dy here, tri here* etj.
5. aduerbia negandi (ndajfolje të mohimit), psh.: *io, s afte* etj.
6. aduerbia affirmandi (ndajfolje të pohimit), psh.: *aftu afte, vertet afte* etj.

Kreu i pestë, De præpositionibus Epiroticis, ferè omnes præpositiones antè ponuntur nominibus, funt vero eiu finodi. Këtu përfshihen parafjalët në gjuhën shqipe:

perpara: *perpara iaueffe, perpara fepijffe*

cundre: *cundre anemichiet*

per: *per Teneone, per cryet tem*

mbas: *mbas meeie*

te: *te deetine, te peruene*

n: *n tatet, n eotit, n eiarmit*

pā: *pā duer, pā denare*

me: *me Pepene*

ngiat: *ngiat vijt* etj.

Kreu i gjashtë, De Interiectionibus. Bardhi ka përfshirë pasthirrmat e fjalë që shfaqin ndjenja, si:

dolentis (dhembje): *hai, heu, hei*

ridentis (gëzim): *ha ha, he he*

irridentis (tallje, qesëndi a përqeshje): *pa fuco, pa fuco fi ban*

faftidientis (përbuzje, urrejtje) : *sco, sco tutiè*

approbantis (pëlqim a miratim) : *bucure, aferim*

admirantis (habi): *allaha, allaha, pa chechyre pa chechyre*

Nëse e vështrojmë sot Fjalorin e Bardhit, i botuar 400 vjet më parë, nga majat që ka arritur leksikografia shqiptare në hartimin e fjalorëve, do të na dukej një vepër e pakët gjuhësore, por duke marrë parasysh kohën dhe periudhën si i u krijua, mund të themi se fjalësi i Bardhit përfshin bërthamën leksikore të gjuhës shqipe si dhe themelet e para të një gramatike shqip.

7. “Fjalori i ri” i Nikollë Gazullit dhe përfaqësimi në të i të folmeve veriperëndimore.

- *Pasuria dhe gjerësia e tij, vlera njohëse dhe pohuese e pasurisë leksikore të shqipes veriperëndimore në atë fjalor.*

Dom Nikollë Gazulli (1891-1946), gjuhëtar, klerik, rreshtohet ndër dijetarët me emër të gjysmës së parë të këtij shekulli, më së shumti si gjuhëtar. Lindi në Dajç të Zadrimës. Kreu seminarin Papnor të Shkodrës dhe studimet e larta teologjike në Istbruk (Austri). Mori pjesë krahas të vëllait, Gjon Gazullit (deputet i opozitës, i ekzekutuar me varje në vitin 1927), në lëvizjet kryengritëse të malësorëve të Veriut e të Mirditës kundër qeverisë së A. Zogut dhe u burgos 4 vjet në Gjirokastrë. Shërben për shumë vite në zonën e Malësisë së Madhe (në famullinë e Shkrelit) ku gjurmoi dhe mblodhi lëndë të pasur leksikore, frazeologjike, onomastike, etnografike etj. Botoi dy vepra gjuhësore: “Fjalorth i ri” (fjalë të rralla të mblëdhuna në Veri të Shqipnisë) ” me mbi 5000 fjalë, që doli si vëllim XI i serisë “Visaret e Kombit” (Tiranë, 1941), dhe “Fjalori onomastik”, botuar pjesë – pjesë në “Hylli i Dritës” me 22 numra (1939-1943) nën pseudonimin Gelasius. U pushkatua pa u gjykuar në vitin 1946.⁸¹

Si leksikograf solli ndihmesë të shquar në gjuhësi. Nikollë Gazulli ishte i dhënë edhe pas folklorit dhe historisë, fusha në të cilat boton shkrime, këngë të moçme etj. “Fjalorthi i ri” i Gazullit, së bashku me “Fjalorthin e ri, fjalë të rralla të përdoruna në Jug të Shqipnisë”, Tiranë, 1941, (“Visaret e Kombit”, vëllim XII) të Pano Tases, janë të parët fjalorë krahinorë në leksikografinë shqiptare.

Fjalori i gjuhës shqipe 1954 dhe ai i Benedikt Demës, i cili u botua për herë të parë në vitin 2005, u mbështetën bindshëm në Fjalorin e ri të Gazullit. Për shumë vite emri i Gazullit nuk u përmend, madje në shumë citime, si të gjuhëtarëve të mëdhenj: Xhuvani apo Çabej, shënohej vetëm “G”, “Fjalorth i ri”, ose “Shkodër 1941”.

Ajo që dallon këto dy vepra, shumë të vlefshme për kulturën kombëtare, është niveli i lartë shkencor, ku duket dora e një dijetari të mirfilltë si filolog i kompletuar, metodologjia e hartimit, objektiviteti i lëndës gjuhësore, dhe sidomos shpjegimi analitik i lëndës, vë në dukje Simon Pepa.

Fjalësi i këtij “Fjalorthi” paraqet më së miri një hapësirë të së folmes së gegërishtes veriperëndimore, përkatësisht trevës së Malësisë së Madhe (Bajzë, Bogë, Egçi i Bregut, Gruda e Madhe, Gruda e Vogël, Gruemira, Kastrati, Kelmendi, Hoti, Reçi, Rrjollli, Shkreli,(nga i cili përfshihen një shumicë fjalësh ⁸²), Shkodra, Dukagjini, Lezha, por kemi edhe fjalë nga gegërishtja verilindore, si zonat e Pukës e gegërishtja qendrore, ku përfshihet Mirdita me zonat përkatëse.

“ *U bane hulumtime të gjata ndër fjalorë të huej për t’u gjetun kuptimi i vërtetë i fjalëve - nënvizon autori në parathënien e “Fjalorit”-, por shumë herë as s’kam mujtë as s’kam dashtë me i rreshtue të gjitha vështrimet, për arsye se fjalori i vogël u paraqitet të dijshëmvet shqiptarë e të huej për studim, e don me kjenë një pasqyrë, si do të studjohen djalektat e ndryshëm, për me i a mbërri një fjalori të madh të përbashkët*”⁸³.

⁸¹Shih: S.Pepa, FESH, vëllimi II, f.757-758.

⁸² B.Beci, *E folmja e Shkrelit*, “Dialektologjia shqiptare” I, Tiranë, 1971.

⁸³N. Gazulli, *Fjalori i Gazullit*, Parathanje, Tiranë, 2005, f.5.

Fjalësi i “Fjalorit” përmban 5000 lema. Simon Pepa numëron 4819 fjalë të rralla⁸⁴. Sipas studiueses Ledi Shamku,⁸⁵ kriteri sasior nuk ngre peshë, sepse ky është një fjalor i tipit shpjegues dhe përshkrues dhe e rëndësishme është metodologjia e hartimit, gjë që Gazulli e ka pasqyruar në mënyrën më të përsosur.

Për Gazullin gjuha e folur e popullit, është ajo që duhet t’i japë shkrintarit fondin themelor të mjeteve të shprehjes dhe se lëvruesi i gjuhës letrare duhet të depërtojë në shtresa të thella të saj, në leksikon dialektor e krahinor përkatës.

Fjalësi i tij përfshin mjaft aspekte të jetës shqiptare, historisë, gjeografisë, kulturës (kryesisht zonave të gegërishtes veriperëndimore) duke na dhënë një pasuri leksiko-frazeologjike të shqipes, duke i dhënë lemave përkatëse ngarkesa e ngjyime kuptimore të reja e duke zgjeruar valencat e tyre në bashkëvajtje me kategori të tjera morfologjike.

Si njohës i mirë i gjuhëve të huaja dhe me një përgatitje të lartë filologjike klasike e moderne, në shumicën prej fjalëve, ai jep edhe përgjegjëset e tyre në gjuhë të tjera, si italisht e latinisht, ose edhe gjermanisht e frëngjisht, kjo ndoshta për të treguar edhe etimologjinë e asaj fjale, psh. :

currel-i – (Rr. M.M) – *të gërryeme qi bâjnë në shkambij ujnât ; germ. Karrenfelder, it. scanalature* (F.G. f.88).

qepore-ja (dhë.PI) – *enët e dheut i lyejnë me qepore për mos me kjasue; qepue; it. smalto, frang.emaille* (F.G.f.91).

Gazulli i kushton rëndësi polisemisë, sinonimisë dhe homonimisë së fjalëve të përdorura. Po i ilustron me shembuj si më poshtë:

kafjall-i (PK, MR) – 1. *gotë –a. 2. një hae bukë e lehtë, razog, zâmër, lat. Haustrus, germ. imbiss* (F.G.f.187).

kóre-ja (M.M) – 1. *kjënë i sendërgjuem me tutë fëmijit: Korja e Lidhcavet; 2. surrat – i, it. maschera, germ. maske. 3. (M.M, SP) mbarre, me pasë kore, jemi ba një kore: jemi bâ periqëni i botës, prralla e jetës* (F.G.f. 211).

sabitë (Krz.MR) – *âsht sabitë drûja, tkurë (PK), kuritë (SP), përfiskë, përfikë, fiktue* (F.G.f. 365).

brâjë-a (MR) – 1. *mullâ i kuq a i irun qi del ndershej gishtash; it. panericcio: më kanë dalë do brâja ndër gishta; germ. Fingerentzündung, Umlauf. 2. sh. Bashk. fq. 49 shëji si mullâ qi lën të ziemit në landë te preme, e n’asht të thyem qi njëten* (F.G. f.67).

Tjetër element me vlerë, që nuk duhet lënë pa u përmendur, është se autori i ka kushtuar rëndësi faktit të përdorimit të një gjuhe të mesme, në mënyrë që të kuptohet nga të gjithë shqiptarët e të gjitha trevave.

“...sa për gjuhë të mjesme mârri lëjën me shkruet një oroe qi më duket me vend.Fjalën: gjuhë e mjesme: ka pasë asi Shqiptarësh qi e kanë mârri në vështrim të dheshkrojës, shka po diftoj qi asht një hutim (gabim)...”⁸⁶

⁸⁴ S.Pepa, *D.Nikollë Gazulli- themelues i leksikografisë krahinore dhe i asaj onomastike*, “Gjurmime kulturore”, Shkodër 2000, f.44.

⁸⁵ A.Haxhi – T.Topalli, *Nikollë Gazulli, (Ledi Shamku-Shkreli, Parathënie e botimit anastatik të Fjalorit të Gazullit, Tiranë, nëntor, 2005, f.5-16)*, “Leksikon, gjuhëtarë shqiptarë dhe albanologë”, Shkodër, 2012, f.42.

⁸⁶ N.Gazulli, “Fjalori i Gazullit”, Parathanje, Tiranë, 2005, f.8.

Po e ilustruam me shembuj: fjala *pykë* ka variante të ndryshme përdorimi sipas krahinave të ndryshme. Në Çamëri ajo del *pylkë*, në Hot e Grudë (M.M) thuhet *pyjkë*. Sipas Gazullit, fjala *pykë* nuk mund të jetë e gjuhës së mesme, sepse i takon *një zhvillimi gjuhësor në shkallën zero*⁸⁷. Trajta *pylkë* gjithashtu nuk i përket gjuhës së mesme, sepse janë *âma*⁸⁸ e trajtavet tjera, keshtu që si e mesme, i takon të jetë trajta *pyjkë*, që i përket së folmes së Malësisë së Madhe, përkatësisht nëndialektit të gegërishtes veriperëndimore.

Tjetër rast, kemi fjalën *qeshë*, ku në Pukë jep variantin *keshë*, si trajtë të mesme jep përdorimin e Bardhit *me kjeshun* ose në Malësinë e Madhe jep variantet *kelbë*, *kjelbë*, *qjelbë*, por edhe *qelbë* si përdorim në M.M e Pult të Dukagjinit, në krh. me *qelbë*, standard.

Të tillë e quajti Gazulli gegërishten, si gjuhë e mesme, që të kuptohet nga të gjithë shqiptarët e çdo treve. I këtij mendimi është edhe studiuesja L. Shamku, e cila shprehet : “ ...*shtrohet me ngut nevoja e normimit të gegërishtes. Ky normim do kryer duke u nisur nga stadi i sotëm i përdorimit të gegërishtes, i cili sikundër rezulton, ka brenda edhe standardin, por mbetet i pandryshueshëm pikërisht në ato tipare ku kjo idiomë dallon genësisht prej standardit.*”⁸⁹

Një vend të rëndësishëm në Fjalor zënë njësitë frazeologjike me shpjegime nga më të rëndësishmet.

Larmia frazeologjike del tepër e pasur dhe interesante, e cila pasqyron më së miri mendësinë dhe psikologjinë e zonave malësore të gegërishtes veriperëndimore.

Këto frazeologjizma i kemi klasifikuar sipas strukturës gjuhësore përkatëse, duke i ndarë në frazeologjizma me strukturë togfjalëshi, me strukturë fjalie, me vlerë mbiemërore, foljore, ndajfoljore.

Frazeologjizmat me vlerë emërore dhe foljore përbëjnë edhe pjesën më të madhe të tyre. Disa nga këto i kemi përqsasur me Fjalorin e frazeologjizmave të J.Thomait (1999), sepse i kemi ndeshur pothuajse me të njëjtën trajtë gramatikore e me të njëjtin kuptim, ndërsa pjesa më e madhe nuk ekzistojnë të pasqyruara si frazeologjizma në **Fjalorin** e J.Thomait.

Frazeologjizma me strukturë togfjalëshi:

Folje + emër

ec me beh – *vemende* (F.G. f.58). Me të njëjtin kuptim, por me një trajtë tjetër e takojmë këtë frazeologjizëm tek J.Thomait, **e bëj beh** (për diçka) – *i vë mendjen (diçkaje)*, *2.pandeh, kujtoj ; më shkon (më vete)mendja* (FFGJSH. f.110).

me ra buzvet – *me thye qafen prej ndonji shkambi* (F.G.f.77). Tek FFGJSH kemi në këtë formë, **i ra pas buze** – *e pësoi vetë, e gjeti e keqja* (FFGJSH, f. 149).

me qite buzvet – *krh.karmue, it. precipitare; nënkuptohen përherë/ buzët a zgripit i shkambit, shkrepit* (F.G.f.77) .

me cbihi andrra – *m’u realizue* (F.G. f. 81).

m’u falë me këndin – *m’u përshëndetë* (F.G.f. 126)

me hjekë si Lekë Dukagjini – *me hjekë mundime të mdhaja* (F.G. f. 176).

hutova burra – *ka hy tash vonë ndër malsina, gabue* (F.G.f. 179).

me kjë me fjalë - *m’u gjet havale* (F.G.f. 198).

⁸⁷N.Gazulli, “Fjalori i Gazullit”, Parathanje, Tiranë, 2005, f.8.

⁸⁸N.Gazulli, “Fjalori i Gazullit”, Parathanje, Tiranë, 2005, f.8.

⁸⁹L.Shamku- Shkreli, *Fjalori i Gazullit dhe gegërishtja e papërmbushur*, “Shtatë vjet prolog”, Tiranë, 2005, f.134.

ma muer syni – *me përshi me të kqyrun* (F.G. f.250). Tek Fjalori Frazologjik (1999), e kemi, **ma ha (ma merr) syri** – *besoj se e bëj, mendoj se ia dal në krye, kujtoj se e përballoj* (FFGJSH, f.894).

Folje + ndajfolje

e bana bêft – *e bana n'asgja* (F.G. f. 58).

me mbetë cangull – *ngri trupi* (F.G. f. 80).

me marre mësysh – *me mbetë i shituem, ngrafisun* (F.G. f. 250).

b) njësi frazeologjike me strukturë fjalie

u çue e iku rrozga më bjezga – *shpejt e shpejt* (F.G.f. 64).

vonoi m'u pjekë sa një bobë – *s'ryset kurrë me mend* (F.G.f.65).

s'bërtet bretkoca pa ujë – *nuk gëzon kush pa gjâ në bark* (F.G.f. 68).

m'u ba camrruk prej së ftofti – *m'u ngrrucë së ftofti* (F.G. f. 80).

me lidhë këndin cambruk – *me i a përmbledhë shtatin, me e bâ të pa kjênun* (F.G. f. 80).

me mbetë si (peshku) mbë cërrat – *me ra gjall' e ngusht* (F.G. f. 81).

me i ra në qokë fjalës – *me i ra mbë të* (F.G. f. 94). E ndeshim tek J.Thomai (1999), **i ra në qokë** (diçkaje) – *i ra në të një pune a një çështjeje, e gjeti tamam* (FFGJSH. f. 831).

me kë në fati së bardhë – *me kë në nafakë* (F.G. f. 127).

me i dhanë kuj fëtyrë – *me marrë me të mirë* (F.G. f.130). E ndeshim me të njëjtin kuptim edhe tek FFGJSH (1999), **i jep fytyrë** (dikujt) – 1. *tregohet shumë i afërt e i përzemërt me dikë, e merr me të mirë. 2. e përkëdhel shumë dikë sa e prish, e llaston tepër* (FFGJSH, f.325).

vjetë t'u ka pasë fiatë kali – *i mbaruet* (F.G.f.130).

kanë dalë firo 6 okë raki – *me firue* (F.G.f. 132).

me bâ vendin flâmë – *m'e dli rë vendin krejt* (F.G. f. 134). Pothuajse me të njëjtën trajtë dhe kuptim e ndeshim tek J.Thomai (1999), **i ra flama** (diçkaje) – **shih i ra flaka** – 1. *nuk gjendet gjëkund, është mbaruar, 2. është zhdukur, është shkatërruar krejt, ka mbaruar* (FFGJSH, f.304).

me i vû kuj futën e zezë - *me i bâm gjakun* (F.G.f. 141).

me i dalë kuj hirit – *qi e ka bjerrë uzdajën e dikuj* (F.G. f.176). Një formë ndryshe e ndeshim tek J.Thomai (1999), **më doli nga hiri** – *nuk e dua më, nuk më pëlqen; mëka humbur besimi te dikush* (FGJSH. f.437).

bosht e muej e kecë e vjetë – *grue e kadalëshme në punë, qi bân një muejme mbushë një bosht me pë të tjerrun e një vjetë me mbushë një kecë(shtjellcë)* (F.G.f. 196).

të ndiesha kumtin (e zi) – *të ndiesha lajmin e dekës, të mâr r t e mordja* (F.G. f. 224).

me i a hapë kuj kumtin – *me i tretë (bojën) farën* (F.G. f. 224).

më vinte rreth me të prekuna mangulaqe - *kush âsht për t'u dashtë* (F.G. f. 249).

m'e marrë një send me sy - *me përshi me të kqyrun* (F.G.f. 250). Tek Fjalori i frazeologjizmave(1999) e ndeshim me një tjetër kutim, **e mora në sy**(diçka) – *ia hyra*

diçkaje pa u trembur për ndonjë pasojë të keqe që mund të vijë, nuk u tremba nga një qëndrim a veprim i caktuar (FGJSH. f. 901).

m'erdh te dera mish në mashk – *pa gjâ në shtat* (F.G.f. 251).

dikuj i han mini pallën – dikuj i punon daci orën – *kush orëçuet e kush orëprëm* (F.G.f.298).

Një tjetër klasifikim i frazeologjizmave në Fjalorin e Gazullit mund të jetë ai sipas vlerës leksiko – gramatikore.

Njësi frazeologjike me vlerë mbiemërore, të cilat kanë kuptimin kategorial të mbiemrit.

burgu të bân si vedin - *të zi e të mjerë* (F.G.f. 76).

shko more burg – *i dekun* (F.G. f. 76).

burrë si qingje – *femën, burrë i pa burrni* (F.G. f. 93).

këtu kënkën gurët e namis - *pafarë, qi s'kanë të mbaruem* (F. G. f.276).

Njësi frazeologjike me vlerë foljore, të cilat i klasifikojmë në këto nëngrupe:

- **Folje + emër**

me ra buzvet – *me thye qafën prej ndonji shkambi* (F.G.f. 77)

më cbihi ândrra – *m'u realizue* (F.G.f.81).

me endë ngatrra – *me sajue* (F.G.f.123).

hutova burra – *gabova* (F.G.f. 179).

i këcyen kaçubët – *qi s'zên vend , qi idhnohet shpejt* (F.G.f. 185).

ma muer syni - *me përshi me të kqyrun* (F.G.f.250).

m'e grumbullue menden – *m'u kokrrue* (F.G.f.259).

- **Folje + folje**

me qitë me mbetë – *me punue për mbetë, qi të qindrojë, të jesë* (F.G.f.256).

në kjoftë me m'u kenë – *me dalë, m'u realizue* (F.G.f.198).

m'epet me dhânë – *m'u dha, i u dha me folë, me kqyrë* (F.G. f. 119).

me dalë me tretë – *shkoi në mërgim* (F.G.f.430).

- **Folje + ndajfolje**

me marrë mbësytsh – *me mbetë i shituem* (F.G.f.250).

me mbetë cangull – *ngrî trupi* (F.G.f.80).

Në këtë fjalor ka frazeologjizma, shpjegimi i të cilave jepet në shqip, por pjesa më e madhe e tyre shpjegohen drejtpërdrejtë me italishten, kjo sepse italishtja asokohe njihej mjaft mirë në nivelet intelektuale (sidomos midis klerit katolik), fakt që tregon se ishte më e thjeshtë të jepej një shpjegim krahasues në gjuhë të huaj sesa në shqip.

Një tjetër element me vlerë që ndeshim tek Fjalori i Gazullit, është se ai ka përfshirë edhe elemente etnolinguistike, të cilat pasqyrojnë, mendësinë, psikologjinë, karakterin

dhe kulturën shpirtërore dhe materiale të popullit shqiptar, sidomos atij në zonat më të skajshme veriore.

Po japim disa shembuj si më poshtë:

gjâmue – *me i bâ gjâmën të vdekunit me sjellje të caktueme: bashkohen burrnimi t'a mârrmën lajmin e dekës, granija shkojnëme 'ta; një grue do të mbajë zânin tue vajtue (vajore, vajtojcë). Burrat kundruell shpisë rreshtohen gna dy e bërtasin dy herë: mjeri ûn për ty, miku, vllau i im! Etr.- mjeri ûn-oo, mjeri un-ê-ê!*

N'oborr të hpis thrrasin kështu katër herë në kambë. Britma do tëpërsëritetprej gjashtëherënë dymbëdhetë herë a njizet' e katër herë, por përherë parë: të hymën te i vdekuni thrrasin prap dý herë, rrahin parzmat prej dhimbe e dahren njëni prej tjetrit tue rrethue vigun;mandej thrrasin prap e dý herë vetmas nëkambë; mandej bijnë në gjûj. Në Pukë ndëjnë krahun me shplakë të dorës të apme përmbî të vdekunin e sa herë lohet vigu i ndaluem i rrugës. Në Dukagjin thrrasin: kraj'i im: rrahen e gërvishten (përgjaken) në shêj dhimbe, e shum herë shkon gjaku rrëkajë tânzave të faqevet; kapin hundën me dorë tue lëshue një zâ me shungullue toka.Grueja vetëm vajtohet, por gjinija (gjaku i saj) e vllaznija i bân edhe gjâmën tue thirrë përherë: vëllau i im!(f.35).

bjerrun- (i,e) (M.M)adj.bjerrë (m'u) : *me hî në jaz, m'u veshë në të zi. Jam i bjerrun; N.N âsht i bjerrun; germ. (im Trauer sein a traurig sein.) Në Malësi të Madhe nana vên në krye rubë të bardhë për djalë qi i ka dekë, e tjerët të zezë. (f.64).*

razog-u – (në Kanû të Lekës) –*1. dukagjinsit kur pajtohen prej zotnije për punë i thonë: të due kulaçin e xèt me djeth, në nade tri rrojët e ditës, as zogun nuk nuk t'a fal, as nuk t'a shes! Hakun t'a due grumbull! Zogu ishte pushimi me dy orë ditë, prandej kur zotnija e harronte thirrshin: ra zogu, flutëroi zogu! 1. Pushim, sa pushon zogu. 2. haeja e kësaj kohe: zâmër – a (Kurbini): frz. Po e bâjmë një zog (pushim të shkurtën, sa pushon një zog). Me hângër zogun; me hangër n'e mbasdite; shms. Razogjt ish in koniqet qi i kishte detyrë i Mirditsi Derës Gjomarkejvet, kur ndonji kësi princash dilte me këqyrë gjendjen e popullit (f. 344).*

buzm-i – *1. carâni i votrës, përboçë-a, urëz-a, 2. nata e Buzmit, e kremja e të këthyemit të diellit prej vere a pranvere, lutet nër male të Veriut të Shqipnis me sjella të posaçme natën e Këshndellavet, në të cillën digjet Buzmi, qi shembëllen vjetën e shkueme, tue bâ urime për vjetë t'ardhëshme, 3. ishte si buzëm, çumrak i vogël e i keq, i pa-ândshëm, trup i pa-latuem(f.78).*

Në lëmin gramatikor vërejmë mjaft struktura interesante, formime fjalësh me mënyra e tipa fjalëformimi të shumta, të cilat bëjnë që kjo vepër të jetë e organizuar dhe e vlerësuar nga ana gjuhësore. Po të nisemi nga disa mënyra fjalëformimi, vërejmë se Fjalori i Gazullit paraqet larmishmëri në përdorimin e tyre. I rendisim me radhë, si më poshtë:

1. Prejardhja:

Fjalë të formuara me parashtesim: Këtu një vend themelor kanë zënë foljet me parashtesën *për-* me kuptim përforcues e intensiv. Vërejmë 35 raste me këtë lloj formanti.

Po i rendisim me radhë: *përbâ* (f.304), *përbî* (f. 304), *përborë* (f. 304), *përbû* (f.304), *përqadhë* (f.305), *përçá* (f.305), *përdahë* (f.305), *përfëlitë* (f.307), *përfikë* (f.307), *përfiskë* (f.307), *përftue* (f.307), *përfolë*(f.308), *përhjekë* (f.309), *përhoshë* (f.309), *përkoqë* (f.310), *përkrahë* (f.310), *përkujtue* (f.311), *përkurë* (f.311), *përloshë* (f.311), *përngî* (f.313), *përsýnue* (f.314), *përsleshë* (f.314), *përschkardhë* (f.314), *përskhye* (f.314), *përtafë* (f.314), *përtretë* (f.314), *përtrue* (f.315), *përtharë* (f.315), *përthye* (f.315), *përvarë* (f.315), *përvjedhë* (f.316), *përvue* (f.316), *përvû* (f.316), *përzburgë* (f.317).

Fjalë të formuara me prapashtesim: Ndeshim emra prejfoljorë me prapashtesat *-im/-ime*, si dhe emra abstraktë e përmbledhës me prapashtesat *-i*, *-ri*, *-ni*.

- **Emrat prejfoljorë me prapashtesat *-im/-ime*** zënë një vend të konsiderueshëm në Fjalorin e Gazullit, gjë që tregon se ky tip fjalëformimi ka qenë prodhues në formimin e fjalëve të reja nga tema foljore. Kemi gjithsej 85 raste përdorimi. Ajo që bie në sy është se të gjithë këto emra prejfoljorë abstraktë i takojnë sferës së jetës së përditshme, mënyrës së të jetuarit e të konceptuarit. Po i vërejmë me radhë:

bigëzim-i (f.62), *bijim-i* (f.62), *burrzim-i* (f.77), *qiqillim-i* (f.93), *darallim-i* (f.104), *dasim-i* (f.105), *dashtënim-i* (f.106), *drrasim-i* (f.110), *foshkim-i* (f.137), *giasim-i* (f.150), *grasim-i* (f.155), *gjakim-i* (f.162), *harbim-i* (f.171), *harmatim-i* (f.172), *hulumtim-i* (f.178), *hutim-i* (f.179), *krahazim-i* (f.213), *lëshim-i* (f.234), *lodhënim-i* (f.237), *mballim-i* (f.252), *mbarashtim-i* (253), *mbëshenjtim-i* (f.255), *mbushullim-i* (f.257), *merandim-i* (f.260), *mjaftim-i* (f.265), *mujshim-i* (f.272), *mundshtim-i* (f.273), *naklim-i* (f.276), *ngashnjim-i* (f.288), *ngulim-i*(f.290), *pasim-i* (f.300), *përdhunim-i* (f.306), *përftim-i* (f.307), *përgim-i* (f.308), *përlim-i* (f.311), *përmallim-i* (f.312), *përvim-i* (f.316), *peshim-i* (f.318), *picëlim-i* (f.320), *piskim-i* (f.324), *pllenim-i* (f.330), *pravullim-i* (f.334), *rrebnim-i* (f.351), *rrëshim-i* (f.354), *rrëxim-i* (f.356), *sajim-i* (f.365), *sakicim-i* (f.365), *sâmtim-i* (f.366), *sufirim-i* (f.380), *syzim-i* (f.384), *shêmbtim-i* (f.390), *shmërim-i* (f.390), *shbilim-i* (f.391), *shtërpënim-i* (f.412), *shtërzim-i* (f.412), *shtjellim-i* (f.414), *trunjëzim-i* (f.432), *thyezim-i* (f.441), *udhakim-i* (f.442), *uratim-i* (f.445), *ushtim-i* (f.446), *vërglim-i* (f.452), *vetllim-i* (f.455), *zbunim-i* (f.465), *zburim-i* (f.465).

- **Tek emrat abstraktë me prapashtesat *-i*, *-ri/ni***, si sferë më e përdorur është ajo e sëmundjeve të ndryshme, por zënë vend edhe sfera të tjera të jetës së përditshme. Janë ndeshur rreth **37 emra**. Vend më të madh zënë ato të formuara me prapashtesën *-i*, pastaj ato me prapashtesën *-ni*, ndërsa me *-ri* nuk kemi ndeshur. Psh:

bishtni-ja (f.63), *dasì -ja* (f.105), *forulli-ja* (f.137), *giashi-ja* (f.150), *guzhmì-ja* (f.162), *hakrri-ja* (f.169), *harmi-ja* (f.172), *imti-ja* (f.180), *kallni-ja* (f.189), *lahuri-ja* (f.227), *lugati-ja* (f.240), *mbëkatni-ja* (f.253), *mbrapshiti-ja* (f.256), *meshni-ja* (f.261), *motsi-ja* (f.269), *ndezulli-ja* (f.285), *mujçi-ja* (f.271), *mujshi-ja* (f. 272), *nami-ja* (f.276), *ndezulli-ja* (f.285), *pahì-ja* (f.296), *pajni-ja* (f.296), *përfati-ja* (f.306), *randi-ja* (f.343), *rysnì-ja* (f.348), *rrebulli-ja* (f.351),

stërpi-ja (f.378), *shejni-ja* (f.389), *shkarkì-ja* (f.395), *shkarthì-ja* (f.396), *shkyeni-ja* (401), *shkyesi-ja* (401), *shplakì-ja* (f.408), *turrahì-ja* (f.434), *veshti-ja* (f.454), *vudhèni-ja* (f. 463), *zali-ja* (f.463).

- **Tek emrat përmbledhës** kemi një numër të vogël të pranisë së tyre. Vërejmë 19 emra të tillë, kryesisht të formuara me prapashtesën **-i**, pastaj kemi prapashtesën **-ni**, ndërkohë që gjenden raste edhe me prapashtesat **-rri, -ri, -si**.

Duke u bërë një klasifikim, kemi:

- **emra që tregojnë marrëdhënie familjare, miqësore etj.:** *dhândrri-ja* (f.119), *vëllazni-ja* (f.452), *rregulli-ja* (f.352), *zojnit-ja* (f.471).
- **emra që tregojnë një shumësi njerëzish që zënë të njëjtin vend në shoqëri:** *bashkari-ja* (f.57), *bjeshki-ja* (f.64), *frymsi-ja* (f.138), *lypësi-ja* (f.243), *mbledhì-ja* (f.254), *moçëmi-ja* (f.266), *motni-ja* (f.269) *përgiasi-ja*(f.308).
- **emra që tregojnë një terësi banorësh, një shumicë njerëzish të pacaktuar:** *rrokulli-ja* (f.360), *rrugni-ja* (f.362).
- **emra abstraktë që tregojnë dukuri të ndryshme të jetës së përditshme:** *prefati-ja* (f.334), *terì-ja* (f. 424), *vegulli-ja* (f.450), *vrastì-ja* (f.461), *vraçì-ja* (f.461).
- **Kemi mbiemra dhe emra vepruesish me prapashtesën -ës/ ëc** nga tema foljore e emërore. Kjo dukuri e formimit të emrave e mbiemrave me anë të prapashtesës **ës/ëc** ka qenë e pranishme tek Fjalori i Gazullit, duke bërë të mundur të numërojmë 43 raste të tilla, të cilat i kemi klasifikuar si më poshtë:
- **Mbiemra me prapashtesën -ës nga tema emërore:** *lulës-i,-e,-ja* (f.241), *rojëc-e* (f.346), *thepëc-e* (f.438), *ujëc-i,-ë,-a* (f.442), *ûnëc-i,-e,-ja* (f.444),
- **mbiemra me prapashtesën -ës nga tema foljore:** *dhimbëc-e* (f.120), *grîs-e* (grirës) (f.158), *lânës-i,-e,-ja* (f.228), *prekëc-i,-a* (f.335), *rrodhëc-i,-e,-ja* (f.359), *shtojëc-ë* (f.414), *zgllobëc-ë* (f.467).
- **emra me prapashtesën -ës nga tema emërore:** *dritës-a* (f.114), *ferrëc* (f.129), *frymëc-i,-e,-ja* (f.138), *kambëc-a* (f. 189), *krypëc-a* (f. 220), *miellëc-a* (f.263), *prâjës-i* (f.333), *rrahëc-i* (f.349), *shpînëc-a* (f.408), *shtalbës-a* (f.410).
- **emra me prapashtesën -ës nga tema foljore:** *qitës-a* (f.94), *dasë-a* (ndarës) (f.105), *dredhëc-i* (f.113), *ëndëc-i* (f.123), *kapëc-a* (f.191), *larës-i* (f.229), *lâsë-a* (larës-e), (f.230), *mêkës-i* (f.258), *rrepëc-i* (f.353), *shtjellëc-i* (f.413), *xânës-i* (f.477).
- **mbiemra dhe emra me prapashtesat -or/-tor, sor, -ar/ -tar.** Kjo mënyrë fjalëformimi ka qenë tepër prodhimtare në Fjalorin e Gazullit. Kemi ndeshur formime emrash e mbiemrash me anë të prapashtesave **-or/-tor/-uer**(si variant dialektor), me prapashtesën **-sor** nuk e kemi parë, por kemi ndeshur variantin dialektor **-cuer**, i cili është parë vetëm në dy raste, si emër dhe mbiemër. Ndërkohë formimet me prapashtesat **-ar/-tar** ka qenë vepruese kryesisht tek mbiemrat.
Kemi ndeshur gjithsej 20 mbiemra me prapashtesat **-or/ -tor/ -uer**, 1 me prapashtesën **-cuer** dhe 34 me prapashtesat **-ar/-tar**. Tek emrat kemi takuar 32 raste me prapashtesat **-or/-tor/-uer**, 1 emër me prapashtesën **-cuer**, dhe 27 raste me prapashtesat **-ar/-tar**. Po i vërejmë si më poshtë:
- **mbiemra me prapashtesat -or/tor:** *bukatuer* (f.74), *cîngiluer-ore* (f.84), *qelbësuer-ore* (f.90), *qepore-ja* (f.91), *qestistuer-ore* (f.92), *damtuer-ore* (f.104), *detuer-ore* (f.110), *fêmnore emashkullore* (f.127), *javatore-ja* (f.182), *javuer-ore* (f.182), *kallumshuer-*

ore(f.189), *kungullore-ja* (f.225), *lavruer-ori* (f.232), *lefjuer-ore* (f.233), *maluer-ore* (f. 248), *mashkulluer-ori* (f.250), *meshnuer-ore* (f.262), *mixuer-ori-ore-ja* (f.264), *rrângçuer-ore* (f.350), *shëplakuer-ore* (f.391), *vjeshtuer-ore* (f.459).

- **mbiemra të formuar me prapashtesën - sor:** *krekcuer-ore* (f.216).
- **mbiemra të formuar me prapashtesat –ar/-tar:**
akulltar-e (f.44), *caktar-e* (f.79), *qellimtar-e* (f.90), *qestar-e* (f.92), *qokatar-e* (f.94), *diestare-ja* (f.110), *falëtar-e* (f.125), *fjalatar-e* (f.132), *flugtar-e* (f.135), *guciliar-e* (f.159), *gurënar-e* (f.161), *gurnar-e* (f.161), *gjuestar-e* (f.168), *hastar-e* (f.173), *hollimtar-e* (f.177), *kelcar-e* (f.196), *krahatar-i,-e,-ja* (f.213), *krekar-e* (f.216), *lejetar-e* (f.233), *mendar-e* (f.259), *motar-e* (f.268), *motmotar-e* (f.269), *mujshar-e* (f.271), *natare-ja* (f.277), *prekatar-e* (f.335), *prekëcar-e*(f.335), *skofijar-e* (f.372), *skofnar-e* (f.372), *shkërdhimtar-e* (f.397), *shtrydhëtar-e* (f.415), *treskëtar-e* (f.430), *vishkullar-e* (f.458), *vitular-e* (f.458), *zhurmatar-e* (f.476).
- **emra të formuar me prapashtesat –or/-tor:** *balluer-ori* (f.54), *bishtore-ja* (f.63), *qepuer-uri,-ori* (f.99), *dhambtuer-ori* (f.118), *dhândrrorë-t* (f.119), *fajkore-ja* (f.125), *fillore-ja* (f.131), *gjinatore* (f.167), *maltuer-ori* (f.248), *margjënuer-ori* (f.249), *mazatuer-ore* (f.251), *mëzuer-ore* (f.263), *moknore* (f.267), *nanshore-ja* (f.272), *pasuer-ore* (f.295), *patanuer-ori* (f.301), *petanuer-ore* (f.318), *rrokënjuer-ori* (f.349), *skâjulluer-ori* (f.370), *sukore-ja* (f.381), *sumbullore-ja* (f.381), *shapkore-ja* (f.386), *shatuer-ori* (f.387), *shelqner-ori* (f.389), *shiluer-ori* (f.393), *shînuer-ori* (f.393), *shisnuer-ori* (f.393), *shkipëtore-ja* (f.398), *tharbtore-ja* (f.436), *ushtuer-ori* (f.446), *vektuer-ori* (f.451), *zânore-ja* (f.464).
- **emra të formuar me prapashtesën –sor:** *kambëcuer-ori* (f.190).
- **emra të formuar me prapashtesat –ar/-tar:**
- *andatar-e*(f.46), *bollar-i* (f.66), *bracancar-i* (f.67), *gjâmatâr-i* (f.163), *gjeshatare-ja* (f.166), *kaçullar-i* (f.186), *kalkare-t* (f.188), *kotar-i* (f.212), *kungar-i* (f.224), *lavrar-i* (f.232), *lavërtar-i* (f. 232), *lugare-ja* (f.240), *luzhar-i* (f.242), *llapar-i* (f.244), *mbledhëtar-e* (f.254), *mjekatar-e* (f.265), *mullar-i* (f.272), *ndeshëtar-e* (f.284), *prijatar-e* (f.337), *pshtymëtar-i* (f.340), *rrebullar-i* (f.351), *sullar-i* (f.381), *sumbullar-i* (f.381), *shkardhëtar-e* (f.395), *trevestar-e* (f.430), *urtar-i* (f.445), *vetllar-i* (f.455).
- **mbiemra dhe emra me prapashtesa zvogëluese-përkëdhelëse:** Ky formim fjalësh ka qënë veprues vetëm tek emrat, kryesisht me prapashtesat –**zë**, –**ëz**, –**th**, –**ëx** dhe janë ndeshur 88 raste të tilla. Tek mbiemrat kemi vetëm dy raste të tilla me prapashtesën –**th**. Po i vërejmë më poshtë:
- **mbiemra:** *bakalimth-e* (f.52), *marmîth-e* (f.249).
- **emra:** *bërshëllizë-a* (f.60), *cikth-i* (f.83), *crângth-i* (f.85), *çapëz-a* (f.98), *çazë-a* (f.98), *dhâmbëz-it* (f.119), *ëndëz-a* (f.123), *erëx-a* (f.124), *fâjth-i* (f.125), *falzë-a* (f.125), *fëmëz-a* (f.127), *fërflizë-a* (f.128), *fërllazë* (f.128), *fëshehëz-a* (f.129), *filizë-a* (f.131), *gëveshëz-a* (f.149), *gurth-i* (f.161), *gjarkëz-it* (f.164), *gjymth-i* (f.169), *halth-i* (f.170), *hejzë-a* (f.173), *helmzë-a* (f.174), *indth-i* (f.181), *iriqëz-a* (f.181), *kabûth-i* (f.184), *kapëz-a* (f.191), *katrâmëz-i* (f.195), *këlyshith-i* (f.197), *këlyzë-it* (f.197), *kërkûth-i* (f.200), *kërsânëz-a* (f.201), *kerrmëz-a* (f.201), *koshëz-a* (f.212), *krapëz-a* (f.214), *krenëz-it* (f.217), *kripth-i* (f.218), *kromëz-a* (f.218), *kryqëz-a* (f.219), *kûjth-i* (f.222), *kullëx-a* (f.223), *lejthizë-a* (f.233), *lëqêth-i* (f.233), *lerth-i* (f.234), *lujzë-it* (f.241), *lyeth-i* (f.243), *lyeth-i* (f.243), *mbirëz-a* (f.256), *mullzë-a* (f.272), *murajzë-a* (f.274),

ndërgishtëz-a (f.282), *njerith-i* (f.292), *orokth-i* (f.293), *parmëz-a* (f.300), *pëshjtjerzë-a* (f.319), *prizë-a* (f.338), *pulëz e egër* (f.340), *pulith-i* (f.341), *rrokëz-a* (f.360), *rrollëz-a* (f.361), *rrotëz-a* (f.361), *rrunëz-a* (f.363), *spith-i* (f.376), *stupëz-a* (f.380), *surrzë-a* (f.382), *sharrëz-a* (f.387), *shkimëz-a* (f.398), *shndrizë-a* (f.403), *shojzë-a* (f.403), *shokëz-a* (f.403), *shpatëz-a* (f.405), *shpëndëx-a* (f.405), *tëmballëx-a* (f.423), *tokëz-a* (f.428), *thëllanëx-a* (f.438), *thikëz-a* (f.439), *thûnzë-a* (f.441), *ulizë-a* (f.443), *ujth-i* (f.443), *unth-i* (f.445), *urëz-a* (f.445), *urrxë-a* (f.446), *ûth-i* (f.447), *vigjëz-e* (f.457), *vilazë* (f.457), *vrujekth-i* (f.463), *vûth-i* (f.463), *zjarth-i* (f.470).

Fjalë të formuara me parashteso-prapashtesim:

- **emra me prapashtesën –ës/-ëc nga tema foljore:**
shqitësë-a (f.388), *shpërnjoftës-e* (f.407), *shpërlakëc-a* (f.407).
- **mbiemra me prapashtesën –ës/-ëc nga tema emërore:** *përkrahës-i,-e,-ja* (f.310), *shpërralëc-e* (f.407).
- **mbiemra me prapashtesën –ës/-ëc nga tema foljore:** *përdredhëc-e* (f.306), *përpËs-i,-e,-ja* (përpËrës), (f.313), *shpërlás-e* (shpërlarës-e), (f.407).

Fjalë të formuara me nyjëzim:

- **emra asnjanes që vijnë nga emërzimi i pjesores,** janë të paktë në numër. Ndeshim gjithsej 7 raste të tilla, gjë që tregon se zënë një vend të vogël në Fjalor, duke e bërë këtë tip fjalëformimi joprodhimtar. Psh:
dhânun-t, të (f.120), *ndërmblysun-it, të* (f.284), *ngredhun-it, të* (f.289), *njethun-t, të* (f.292), *ranë-t, të* (f.343), *shtirun-it, të* (f.413), *thekun-t, të* (f.438).
- **emra asnjanes të formuar nga emërzimi i mbiemrave të nyjshëm.** Edhe këtu takojmë pak raste të përdorimit të emrave abstraktë asnjanes. Vërejmë 3 emra të tillë: *lashtë-it, të* (f.230), *rrâ-t, të* (f.350), *vetëm-it, të* (f.455) .
- **mbiemra të prejardhur:**
- **Prejpjesorë:** ndeshim 12 fjalë të tilla. Po i vërejmë me radhë:
bjerrun (i,e), (f.64), *cekatun (i,e)*, (f.81), *dêjun (i,e, të)*, (f.106), *derdËmë-i, -e, -ja (i,e)*, (f.108), *knarun-i,-ë,-a (i,e)*, (f.206), *llâm-i,-e,-ja* (f.243), *prâm-i,-e,-ja (i,e)*, (f.333), *prekun-i-ë-a(i,e)*, (f.335), *rrihun-i-ë-a(i,e)*, (f.356), *shapuem-i,-e,-ja (i,e)* (f.386), *shkapërcyem-i-e, -ja (i,e)*, (f.394), *ushtuem-i,-e,-ja (i,e)*, (f.446), *vajatun-i,-ë,-a (i,e)*, (f.447) .

Fjalë të formuara me nyjëzim dhe parashtesim:

- **mbiemra prejpjesorë.** Kemi 4 raste të tilla: *mbëshênjuem-i,-e,-ja (,e)*, (f.255), *përkyem-i,-e, -ja (i,e)* (f.311), *përthËm-i,-e,-ja (i,e)*, (f.315), *shkapërcyem-i,-e,-ja (i,e)*, (f.394).
- **mbiemra foljorë me –të/-t.** Kemi gjithsej 19 mbiemra të tillë. I kemi të gjithë të formuar nga tema foljore:
crogët (i,e), (f.85), *crrolët (i,e)*, (f.85), *gêmtë (i)*, (f.145), *lpâtë-i,-ë,-a* (f.239), *mbërdostë (i,e)*, (f.254), *mbërdhezhtë (i,e)*, (f.254), *mbërdhezët-a,-a (i,e)*, (f.254), *mbërdhuzët –i (i,e)*, (f.255), *merdhostë-i,-an (i,e)*, (f.260), **ndêtë-io,-a(i,e)**, (f.285), *ndrydhët-i,-a (i,e)*, (f.287), *ndujtë-i,-a (i,e)*, (f.287), *ndêtë-i,-a(i,e)*, (f.285), *ndujtë-i,-a(i,e)*, (f.287), *përdostë,i,e* (f.306), *pËtë-i,(i,e)*, (f.325), *shpâtë-i,-a (i,e)*, (f.405), *tertë (i,e)*, (f.424), *thâmtë-i,-a (i,e)* (f.436) .

Mbiemra me –shëm me temë foljore dhe emërore dhe ndajfoljore që shënojnë një tipar cilësor. Vërejmë se ky tip fjalëformues ka qenë prodhimtar tek Gazulli, kjo për vetë faktin, se mbiemrat me **-shëm** i takojnë variantit dialektor të gegërishtes, duke mos lënë papërmendur, se disa nga ato gjejnë përdorim edhe në standard. *Parë në një vështrim të përgjithshëm*, - nënvizon Shezai Rrokaj, - *mbiemrat dhe ndajfoljet me –shëm u përkasin të dyja koineve letrare (gege e toske). Por përsa u përket mjeteve formuese dhe, ç'është më e rëndësishmja, dinamikës prodhuese, gegërishtja shfaq një epërsi të dukshme.*⁹⁰ Ndeshim gjithsej 39 raste të formimit të mbiemrave. Më poshtë kemi bërë një klasifikim të tyre, duke marrë për bazë temën fjalëformuese.

- **me temë foljore:** *ardhshëm (i,e), (f.48), avitshëm (i,e), (f.50), bylmyeshëm (i,e), (f.79), druejshëm (i,e), (f.115), drûnueshëm (i,e), (f.115), grîshëm (i,e), (f.158), hangërshëm (i,e), (f.171), hjekëshëm (i,e), (f.176), mârrshëm (i,e), (f.250), mbetshëm-i,-e,-ja (i,e), (f.255), ndêjshëm-i,-e,-ja (i,e) (f.281), ngufshëm –i,-e,-ja (i,e), (f.289), ngulshëm-i,-e,-ja (i,e), (f.289), pështueshëm (i,e), (f.319), piejshëm (i,e), (f. 320), rritshëm-i,-e,-ja (i,e) (f.357), tretshëm-i,-e,-ja (i,e), (f.430), thekshëm-i,-e,-ja (i) (f.437), vrashëm-i,-e,-ja (i,e), (f.461).*
- **me temë emërore:** *andshëm (i,e), (f.46), ânshëm (i,e), (f.47), bylmetshëm-e (i,e), (f.78), dielshëm (i,e), (f.110), gjâshëm (i,e), (f.164), hershëm (i,e), (f.174), mujshëm –i,-e,-ja (f.271), mundshëm-i,-e,-ja (i,e), (f.273), nkastëshëm-i,-e,-ja (i,e), (f.279), prâjshëm-i,-e,-ja (i,e), (f.333), pritëshëm (i,e), (f.338), shëndetshëm-i,-e,-ja (i,e), (f.390).*
- **me temë ndajfoljore:** *mbâllishëm-i,-e,-ja (i,e), (f.252), ndëntazhëm-i,-e,-ja (f.282), ngiatshëm-i,-e,-ja (i,e), (f.289), tashëm-i,-e,-ja (i,e), (f.421),*
- **me temë mbiemërore:** *gjallshëm (i,e), (f.163).*

Fjalë të formuara me nyjëzim, parashtesim dhe prapashtesim

- **mbiemra foljorë me –të/-t të formuar nga tema foljore.** Janë ndeshur vetëm 5 raste të tilla: *përbûjtë-i,-a (i,e), (f.305), përbuzët-i,-a (i,e), (f.305), përdostë (i,e), (f.306), përmbysët-i,-a (i,e), (f.312), shpërdhitë (i,e), (f.406).*
- **mbiemra me –shëm me temë foljore:** *pa-përgiashëm-i,-e,-ja (i,e), (f.298), përgiashëm-i,-e,-ja (i,e), (f.308), përrshënueshëm-i,-e,-ja (i,e), (f.314).*
- **me temë emërore:** *pa-ândëshëm-i,-e,-ja (i,e), (f.295), përmbarrëshëm-i,-e,-ja (f.312), zditëshëm-e,-ja (i,e) (f.465).*
- **me temë ndajfoljore:** *përmbîshëm-i,-e,-ja (i,e), (f.312).*

Gjithashtu janë ndeshur edhe **mbiemra me prapashtesën -shëm** që formohen nga tema me kompozita: *punërryeshëm-i,-e,-ja (f.341), fjalëmujshtëm-i,-e,-ja (f.133), fjalërryeshëm-i,-e,-ja (f.133).*

Formimi i fjalëve me kompozim.

Kjo mënyrë fjalëformimi ka qenë prodhuese, kryesisht në formimin e emrave dhe mbiemrave, ndërsa tek pjesët e tjera të ligjëratës, nuk e kemi takuar, përjashtoj rastin e një ndajfoljeje. Kemi gjetur gjithsej 77 raste të përdorimit të fjalëve me këtë mënyrë fjalëformimi. Po i paraqesim me radhë:

⁹⁰Sh.Rrokaj, *Fjalësi me prapashtesën –shëm në disa vepra të I.Kadaresë*, “Çështje të gjuhës shqipe”, Tiranë, 2007, f.21.

- **emra:**ballafaçkë-a (f.53), ballbreshtëz-a (f.54), bishtalug-u (f.63),bishtfultere-ja (f.63), bishtkuq-i (f.63), bishtpelëz-a (f.63), boçëborë-a (f.65), bollapjeshkë-a (f.66), dyllvesh-i (f.117), dhambësutë-a (f.118), erëkuqe-ja (f.124), fierëkuqe-ja (f.130), fik-hindi (f.130), gacëngjigjë-a (f.141), gardhpulëç-i (f.143), grykakuq-i (f.159), grykë-furrë (f.159), grykëhollë-a (f.159), gurapesh-i (f.160), gurëgrîhëç-i (f.160), gjeth-thue-pulë (f.167), kambëpulë-a (f.190), kambëshm-i (f.190), kambëzezë-a (f.190), kashtëfryzë-a (f.194), kashtëkuqe-ja (f.194), kashtërrojë-a (f.194), kokërrduçe-ja (f.208), kryekuq-i (f.219), kryelanë-a (f.219), kryeshtrêmbët (f.219), kryezi-u (f.219), krymb-bore (f.219), krypësorrë-a (f.220)lulbardhë-a (f.241), lulkuq-i (241), lulshpërvjeltë-a (f.241), lulshterpë-a (f.241), mëlli-ujce (f.259), mollakuq-i (f.267), pulëbardhë-a (f.340), rrogazezë (f.359), rrogazi-u (f.359), skjeplugë-a (f.371), skjepgjatë-a (f.371), sorrëshkinë-a (f.374), spirëgjake-ja (f.376), spirilang-e (f.376), shikakuq-i (f.392), shkozëbardhë-a (f.399), shprishalesh-i(f.408),ûnëzezë-a (f.444), vërzakuq-i (f.453).
- **mbiemra:** babarrun-e (f.51), buzvjerrë-a (f.78), çartabukas-e (f.98), dy-velçe (f.118), dhambëhekurt (f.118), dhâmbzezë-a (f.119), fjalë-lashtë-i,-a (f.133), fjalëmujshtëm-i,-e,ja (f.133), fjalërrëxuem-i,-e,-ja (f.133), fjalërryeshëm-i,-e,ja (f.133),hjekakeq-e (f.175), hijelehtë-i-a (f.176), hundëvarun-i-ë,-a (f.178), kryekeq-e (f.219), motmotak-e (f.269), motmotar-e (f.269), motkeqe-ja (f.269), mundzi-zezë (f.273), ndeshëzi-zezë (f.284), ndjellëzi-zezë (f.286), pikalarëm (i,e), (f.321), punë-madh-e (f.341), punërryeshëm-i,-e,-ja (f.341).
- **ndajfolje:**thuepulë (f.440).

Siç e vërejmë pasuria e këtij Fjalori është e larmishme, në të cilat ndërthuren mjaft elemente gjuhësore, që mirëfilli pasqyrojnë edhe vlerat universale të këtij Fjalori.

Ledi Shamku shkruan “ *Nxjerrja e gëgnishtës nga hiesina dhe reshtja e ftohtësisë ndaj saj kërkojnë dritë; dritë që ende nuk është ndezur, porse mund të ndizet në çdo rast. Fjalori i Gazullit është një pjesë rëndësishme e kësaj drite*”.⁹¹

Fjalori i Gazullit ka shërbyer dhe shërben si pikë mbështetje e konkretizimi për mjaft dijetarë që merren me shqipen e historinë e saj.

⁹¹L.Shamku-Shkreli, *Parathënie e botimit anastatik,*” Fjalori i Gazullit”, Tiranë, 2005, f.16.

8. Valenca leksikore në disa lema të Fjalorit të Gazullit

Megjithëse është një fjalor krahinor, në Fjalorin e Gazullit, fjalët e përfshira kanë valencë leksikore njëlloj si fjalët e një Fjalori tjetër normativ të gjuhës shqipe, ashtu siç kemi bërë në një përjasje me «Fjalorët e gjuhës shqipe», 1954, 2006. Bashkëlidhja leksikore e fjalëve përcaktohet nga faktorë të jashtëm gjuhësorë, ku sendi dhe objekti duhet të kenë lidhje logjike mes tyre, psh., mund të thuhet ka *sy të shkruar*, por nuk thuhet ka *buzë të shkruara*, ose *flokë të verdhë*, por jo *sy të verdhë* etj. Kjo ka të bëjë me atë që quhet edhe ligji i valencës⁹², gjë që për një leksikograf nuk duhet lënë në harresë. Për t'u krijuar bashkëlidhja e fjalëve, i rëndësishëm është konteksti, sepse jashtë tij, na jepet një kuptim i papërcaktuar i fjalës. Në Fjalorin e Gazullit kemi vënë re se të gjitha fjalët semantizohen në një kontekst a situatë të caktuar. Fjalëve përkatëse dialektore, Gazulli iu jep valencë leksikore duke i shoqëruar me fjalë përcaktore të ndryshme .

Duke filluar me *valencën e emrit*, kemi raste si :

Emër + emër :

zhym-i (Miliskau.PK) – *pluhuni, hîni qi lën duhani i djegun* : **zhym pilave, zhym cigare** (G. f.476).

zhokël-a (SP)- *lëvorja qi mbulon kokrrën e goshës në bështâjë*: **zhokël groshe, zhokël kollomboqi, zhokël lejthije** (G. f.475).

bind-i (S.P) - . 1. *çudi, mrekulli*. 2. *send i çuditëshëm, i mrekullueshëm*: *Bindi i Zotit: mirabile Dei (lat.) bindi i tokës: një mrekulli, për bind: mrekullisht*. (G.f.62). (**Bindi i Zotit, bindi i tokës**).

cërrlek-u (M.M.) *cërlek-u*, - 1. *çurril, çurrel uji, shka qet kroni*: **cërrleku i kronit**. 2. (**cërrlek gjaku**). (G. f.82).

gjâ-ja - 1. fraz. *gjâja e keqe: teshë i keq; i mârri gjâ jé ti!* 2. *filozofikisht: lat.substantia: substantia panis, arsyeja për të cilën âsht bukë*. 3. *gjâna, t: mallna, t*. 4. *element-i; lypën shum gjâna për me bâ ketë punë*. . (**gjâja e bukës**) (G.f.162).

hjekë-a (M.M) - 1. *të hjekun-t, lat. ablation-nis, me hjekë me vra: atentat-i, m'u hjekë në vrasë*. 2. *voltët e dekës (Nënshati SP)agoní –ja: kjo s'âsht jetë me hjekë; fraz. me hjekë si lekë Dukagjini: me hjekë mundime të mdhaja*.**hjekë e vrasës** (G. f.176).

lashdë-a (SP). –a t: 1. *lazhdë- a, copë, procjon, ; e han lazhdën e bukës sa...*2. *lazhdë qiri: një copë qiri, një lazhdë buke* (G. f. 230).(**lazhdë qiri, një lazhdë buke**).

murrfice-ja (Klm. M.M) - 1. *mbrapshti-ja (DK) osojnë-a (slav) vend kû dimnit bjen pak a aspak dielli*. 2. *dheu i muurfices, krahi i murrfices: vende me akuj të papëmë e me diell të pakët a pa të krejt*. (G.f.274). (**dheui murrfices, krahi i murrfices**).

mys-i (KP, SP) - 1. *koje, lkostrë, lkojë buke*.2. *lkostra e hollë qi vên toka e pûnueme, ka vû toka mys; fraz. hiqja mysin asaj pune! Hiqe shpresën so!* (G.f. 275).(**mys buke, mys i dheut, mys i tokës**).

⁹² A.Kostallari, “Kompozitat dëshirore dhe urdhërore të shqipes“, Studime filologjike 4, Tiranë, 1968.

Emër + mbiemër

rrëshyell-elli(Malsinat)- *rrëshejë,t: rrëshuell-olli, rrshojët(SHK)*,(G.f.354).(**rrëshyell i helmatuem, rrëshyell i egër**).

Folje + emër :

prës-i (M .M) – *gajle, kujdes, kasavet: (mos m’e bâ pres, me vû pres, mos kij pres)* (G.f. 336).

ngazë-a (SP)- *të qepun t’imë:(m’e qepë ngazë, m’e bâ ngazë)* (G.f 288).

Valenca e foljeve, kemi raste si :

Folje + emër

prue (SP)- *me plaçkitë, prëtue:(m’a proi shpin, m’a prove gjân)* (G. f.339).

rrëshqitë – *pëshqitë, shkitë (PK) rrëshitë (SP), rrëshqas, pëshqas, shkas, rrëshas...* (G.f.354).(**më rrëshqiti kamba, më rrëshqiti puna**).

cungue (S.P).- v. akt. 1.*me cungue lisiin, me i pré degët e trupin tue i lânë pjesën mâtë trashën. 2. m’e cungue njeriun: me i këputë kryet, kambë e krahët, tue mbetë veçcungu i njeriut (it.torso)*, (G. f.87). (**me cungue lisiin, m’e cungue njeriun**).

darallosë (Rr. M.M.)v. akt. - 1. *me darallosë kendin; m’e bâ me luejtë mendësh, m’e çue peshë, m’e harlisë. 2. m’u harlisë mendësh sikurse i smundi, m’u turbullue ndër mende. I smundi ishte darallosë mendësh.* (G.f.105). (**darallosë mendësh**).

ëndë (M.M.) - 1. *me endë voëtë: pula i ëndë voët në gjiri të voevet. 2. me ëndë murin: m’e sajue, me fillue m’e bâ murin. 3. me ëndë rrushi, me ëndë pëmët, lulet. 4. me ëndë pelhurë. Fraz. me ëndë ngatërresa, me ëndë vekë, N.N. ka nisë me i ëndë do vekë, fraz. Pá u ëndë fëmija e vajtuen (M.M.): antequam conciperetur puerulus eum planxerunt.* (G.f.123).(**me endë voëtë, me ëndë murin, me ëndë rrushi, me ëndë pëmët, lulet, me ëndë pelhurë, me ëndë ngatërresa, me ëndë vekë**).

gërmue (M.M) - 1. *me ngushtue: më gërmoi me shkue, më gërmoi gazi, po mue shka më gërmoi me i a hÿ kësaj pune: 2. pas. me hÿ ndër ngushtica; fraz. u gërmova me fjalë në mal; mos u gërmo tepri, i u gërmuen dhit, i u gërmue ushtriya e i sharruen. ,* (G.f.147). (**më gërmoi gazi, i u gërmuen dhit , i u gërmue ushtriya**).

matosë (M.M) -. 1. *me marrë mbë njënën ânë: ka matosë mullari i sânes, i ká matosë mendja: i ka marrë dallësh (tyrq). 2. m’u turrë: n’ardhtë dita, po të ma matosna; me matosë mbas dikuj: m’u dhânë, me shgrehë mbas ndokuj. 3. me dhânë krah, rrugë; s’dij se kah po na matosin.* (G.f. 251).(**i ká matosë mendja**).

ngufacë (SHK) -1. *me ngufacë sytë, me i hapë sytë në lakmim të njëj sendi, 2. intr. me ngufacë: rri e ngufac! Rri e digju prej lakmimit të njëj sendi (gufë, krh. v. mërdhacë).* (G.f.289). (**me ngufacë sytë**).

shpufë (M.M) - 1. *me shpufë duhan: me pim duhan. 2. me plasë pa zhurmë, shpufi kështëja në zjarm, i shpufi dija, trimnija; i mbaroi.* (G. f.409). (**me shpufë duhan: me pim duhan, shpufi kështëja,i shpufi dija, trimnija**).

thekë (M.M) - 1. *me thekë kambët: m’u grahë kâmbvet, me shpejtue. 2. me thekë zânin: m’e shty përjashta me fuqi, 3. Klm. M.M: me thekë borë: me qipzue, spihë.* (G.f.437). (**me thekë kambët,me thekë zânin,me thekë borë**).

urtue(M.M) - 1. rrin tue urtue gjith ditën e lume në vend se me punue. 2. akt. me urtue këndin:m'e prû në fije, me urtue fëmijt: me i vûm në mende. 3. pajtue, me ato fjalë e urtova. urtë-a (Budi) urtí-ja. (G. f 445). **(me urtue fëmijt)**.

Folje + folje

gërmue (M.M) - 1. me ngushtue: më gërmoi me shkue, më gërmoi gazi, po mue shka më gërmoi me i a hÿ kësaj pune. 2. pas. me hÿ ndër ngushtica; fraz. u gërmova me fjalë në mal; mos u gërmo tepri, i u gërmuen dhit, i u gërmue ushtriya e i sharruen.(G. f.147). **(më gërmoi me shkue)**.

hjekë-a (M.M) -1. të hjekun-t, lat. ablation-nis, hjeke e vrasës, me hjekë me vra: atentat-i, m'u hjekë në vrasë. 2. voltët e dekës (Nënshati SP)agoní –ja: kjo s'është jetë me hjekë; fraz. me hjekë si lekë Dukagjini: me hjekë mundime të mdhaja. (G. f.176). **(me hjekë me vra)**

Folje + ndajfolje

gërmue (M.M) - 1. me ngushtue: më gërmoi me shkue, më gërmoi gazi, po mue shka më gërmoi me i a hÿ kësaj pune: 2. pas. me hÿ ndër ngushtica; fraz. u gërmova me fjalë në mal; mos u gërmo tepri, i u gërmuen dhit, i u gërmue ushtriya e i sharruen. (G. f.147). **(mos u gërmo tepri)**.

Valenca e mbiemrit :

emër+ mbiemër

ndezç-i(M.M) - qi ndezet, qi merr zjarm: (G.f 285). **(gur ndezç, uj ndezç)**.

ardhshëm (M.M) i, e adj - njeri i ardhshëm: qii vjen punës, arsyes: i ndigjueshëm, i shoqnueshëm; punë e ardhshme, qii vjen për doresh, njeri i ardhshëm me kuvend: qii vjen arsyes.(G. f.48).**(njeri i ardhshëm, punë e ardhshme)**.

hangërshëm-i, -e –ja (M.M.) adj – 1. qi hahet, bukë e hangërshme.2.qi është i hangërm, i ngim prej haeje: më duhet me këne i hangërshëm për me mujt me pi venë. (G. f.171).**(bukë e hangërshme)**.

kelcár-e (krh. MR) adj.- 1. gjâ kalbësiqe, gjâ e ligësht sikurse një kësollë qi është tue rá mbrendë: e kam një shtëpi kelcáre. 2. thejç-ë, drû kelcare, drû qi thehet shpejt p.sh. e krekës; shtyllë kelcare: shtyllë e brishtë, lat. fragilis, germ. Zerbrechlich, it. fragile, frang. Fragile, frêle, cassant.(G. f.197). **(shtëpi kelcáre, drû kelcare, shtyllë kelcare)**.

Siç vërejmë, pjesët e ligjëratës që më së tepërmi formojnë valencë leksikore janë emrat, mbiemrat e foljet, dhe tek-tuk ndonjë ndajfolje.Po t'i bëjmë një përqasje me Fjalorët e gjuhës shqipe të vitit 1954, 2006, shohim se ka nga ato fjalë që i ndeshim me një kuptim të ndryshëm nga ai që na pasqyrohet tek Gazulli. Psh.: kemi raste të tilla si:

ardhshëm - tek Gazulli ka kuptimin për njeri i ardhshëm, i ndigjueshëm, ishoqnueshëm, qi i vjen arsyes, ndërsa tek Fjalori i '54 dhe ai i 2006, ka kuptimin e diçkaje që pritet të vijë, që do të jetë a do të bëhet në të ardhmen, psh. : mjek i

ardhshëm, javën e ardhshme etj. Pra, vërejmë se kuptimi dialektor i kësaj fjale është ndryshëm nga ai i përgjithshmi.

bjerrun- tek Gazulli e kemi *me hî në jaz, m'u veshë në të zi*. Jam i bjerrun; N.N. është i bjerrun; germ. Në Fjalorin e '54 **bjerr** – *humbas*, ndërsa në Fjalorin e 2006 kemi **bjerrë-** (fol.) *i shkoi fjala bjerrë*. Tek Fjalorët e '54, 2006 kuptimi është pothuajse i njëjtë edhe me nuanca të ndryshme ligjërimore, ndërsa Gazulli jep kuptimin dialektor me një kuptim krejt të ndryshëm.

présë-a : Gazulli e jep me tre kuptime : 1. *tradhëti-ja; me pre kendin*. 2. *hollí qi i çilen tokës me parmendë, për me projtë zagnat prej ujnash*. 3. *preset e fluskës (Ulqini) it. i speroni della nave: prés-i*. (G.f.336).

Në Fjalorin '54 ka shumë kuptime, ku në asnjërin prej tyre nuk gjejmë përjasje me ato të Gazullit, madje edhe vetë ndërtimi i fjalës është krejt i ndryshëm: 1. **pres ft.** (*preva, pre, prerë*)-1.*heq një pjesë nga një e tërë: prej drutë*.2. *ther: preu një qengj; grij i preu lia pulat; të preftë murtaja; më pru barku; fig. e preu në besë*; 3. *ndaloj, pezulloj; i preu udhën, i preu hovin; i preu fjalën; ia preva shkurt, i prenë punimet; i preu gjakun; i preu rrogën*. 4. *lë, s'vazhdoj më: kam prerë duhanin, rakinë; i preva shpresat*.5. *caktoj (çmimin, dënimin) preja pazarin; ja prenë dy vjet, u dënua për me dy vjet burg; fig. i u pre të ngrënë, s'ka oreks, s'ha më; i u pre qumështi, i shteroi lehonës; u prenë miqt, s'vijne më....*(F.54, f. 429).

gërmue – Gazulli: 1. *me ngushtue: më gërmoi me shkue, më gërmoi gazi, po mue shka më gërmoi me i a hÿ kësaj pune*: 2. *pas. me hÿ ndër ngushtica; fraz. u gërmoja me fjalë në mal; mos u gërmo tepri, i u gërmuen dhit, i u gërmue ushtria e i sharruen*. (G.f.147).

Në Fjalorin e 2006, **gërmoj** - 1. *mih dheun për të hapur një gropë ose për të zbuluar diçka; rrëmoj: gërmoj me kazmë*. 2. *edhe jokal. gërmoj nëpër shtëpi*.3. *edhe jokal. fig. bëj kërkime të hollësishme, hulumtoj: gërmoj nëpër arkiva*. (F.2006, f.314).

Në Fjalorin e'54: **gërmoj** - *hap dhenë me një almise; bëj një vrimë a një gropë në dhe; fig. mos e gërmo më këtë punë, lëre me kaq, mos e nga më*. (F.f.139).

Vërejmë qartë se Gazulli e jep me një kuptim të ndryshëm nga dy Fjalorët, të cilët përkojnë me njëri – tjetrin.

Ose, kemi mjaft fjalë, të cilat kanë të njëjtin kuptim me atë që na jepet tek Fjalori i Gazullit, psh. :

bind- i- tek Gazulli del me kuptimin e *çudi, mrekulli* (G.f.62), po ashtu edhe tek Fjalori i gjuhës shqipe 1954, ndërsa Fjalori i 2006 nuk ekziston si fjalë.

cërrlek-u – Gazulli e jep: 1.*çurril, çurrel uji, shka qet kroni: cërrleku i kronit*. 2. *cërrlek gjaku, i shkoi gjaku prej varre cërrlek* (G.f.82). Në Fjalorin e 2006 e kemi **cërrlí/k** - *curril uji*. Ndërsa në Fjalorin e 1954 nuk ekziston si fjalë.

cungue –tek Gazulli e kemi : *me cungue lisiin, me i pré degët e trupin tue i lânë pjesën mâ të trashën*. 2. *m'e cungue njeriun: me i këputë kryet, kambë e krahët, tue mbetë veç cungu i njeriut (it. torso)*. (G. f. 87).

Në Fjalorin e 2006 kemi edhe përdorimin figurativ - *i heq një pjesë dhe e lë mangët, gjymtoj: ia cunguan artikullin*. (F.2006, f.141).

ëndë (M.M.) – Gazulli : 1. *me endë voëtë: pula i endë voët në gjiri të voëvet*. 2. *me endë murin: m'e sajue, me fillue m'e bâ murin*. 3. *me endë rrushi, me endë pëmët, lulet*. 4. *me endë pelhurë. fraz. me endë ngatërresa, me endë vekë, N.N. ka nisë me i endë do vekë, fraz. pá u endë fëmija e vajtuen (M.M.):antequam conciperetur puerulus eum planxerunt*. (G.f. 123).

Në Fjalorin e '54 kemi formën foljore: **end** - *bëj pëlhurë; endem: endet pëlhura; fig. sillem poshtë e lart*. (F.54. f.107).

Në Fjalorin 2006 kemi përdorimet: **end¹** kal., -a, -ur 1. *end qilimin*. 2. *fig. krijoj, thur: end vjersha (keq.) trillon; endin komplete*.

Por kemi edhe disa kuptime të tjera të kësaj fjale që nuk ndeshen tek Gazulli:

end² kal., -a, -ur 1. *bëj dikë që të vijë e të shkojë disa herë, e sjell rrotull*. 2. *hedh (shikimin etj.) pa ndërprerje në një drejtim: endi shikimin në sallë; hëna end dritën mbi male. éndem vetv. shkoj e vij disa herë diku; sorollatem: endet rrugëve; endeshin nga një qytet në një tjetër*.

end³ jokal. v. III, -i, -ur *çel lule, lulëzon: endi molla; / lidh kokërr: endi gruri*.

end⁴ kal. V. III, -i, -ur *pështyn (për mizat): e ka endur miza mishin*. (F.2006, f.246).

hjekë-a – Gazulli: 1. *të hjekun-t, lat. ablation-nis, hjekë e vrasës, me hjekë me vra: atentat-i, m'u hjekë në vrasë*. 2. *voltët e dekës (Nënshati SP) agoní –ja: kjo s'ásht jetë me hjekë; fraz. me hjekë si lekë Dukagjini: me hjekë mundime të mdhaja*. (G. f. 176). *hjekë si lekë Dukagjini: me hjekë mundime të mdhaja*. (G. f.176).

Në Fjalorin e '54 kemi trajtën emrore **hjekës-i** - *informatori që i lehtëson punën e kusarit dhe gjakësit për të kryer veprën e tyre*. (F.54, f.172). Vërejmë se për këtë trajtë emërore kuptimi leksikor, është pothuajse i njëjtë.

Por, duhet theksuar, se Fjalori i Gazullit mbart në vetvete një pasuri të pashtershme letrashqipe, të cilat përdoren në trevat veriperëndimore të shqipërisë dhe që nuk i ndeshim në Fjalorët e sotëm të gjuhës shqipe.

Mund të përmendim fjalë të tilla, si: *darallosë, figullue, balahû, bedatë, kelcar, lashdë, maknore, matosë, murrfice, shpufë, treskë, triqë* etj.

Një tjetër element me rëndësi, i cili ngjall interes në Fjalorthin e Gazullit, është se përmes valencës së fjalëve ai ka krijuar edhe *bashkëlidhje metaforike*⁹³ të tyre, duke i ilustruar kuptimet e fjalëve me shembuj të ndryshëm, çka bën që ky Fjalor të jetë si i pasur, ashtu edhe i arrirë nga ana gjuhësore.

Sipas kësaj rregullsie kemi këto skema bashkëlidhjesh metaforike:

- **në vend të një emri frymor të një grupi tematik zë vend një emër frymor i një grupi tjetër tematik:**

zemër qofe / njeri qofe (G.f. 94).

drang mice / drang lugati (G. f.113).

njeri garcel / kal garcel (G. f.154).

grue katanë / mushkë katanë(G. f.195) etj.

- **në vend të një emri jofrymor të një grupi tematik zë vend një emër jofrymor i një grupi tjetër tematik:**

anët e barrës / ana e pëlhurës (G. f.46).

angrra e mushknivet / angrra e dheut (G.f. 47).

bengu i trimit / bengu i shoqnis (G. f.59).

boçë pishe / boçë kollomboqi (G. f.65).

qyeja e vis / qyeja e malit (G .f.96).

m'u dushkue mali / m'u dushkue landa (G.f.117).

nji bangë duhan/ nji bangë tesha (G. f.55).

me flakurue shpija / u flakurue buka (G. f.134).

⁹³H. Shehu, *Çështje të sintagmatikës në fjalorë të shqipërisë*, "Leksikografia shqipe, Trashëgimi dhe perspektivë", Tiranë, 2005, f.159-160.

- në vend të një emri frymor zë vend një emër jofrymor :

njeri i ardhshëm / punë e ardhshme (G. f. 48).

njeri i avitshëm / mendime të avitshme (G.f.50).

me brufullue krymbat / me brufullue bari (G. f.71).

njeri krekëc / dru krekëc (G. f.216)

- në vend të një emri jofrymor zë vend një emër frymor:

vend bëzdyç / njeri bëzdyç (G. f. 61).

me kreckue lisiin / me kreckue krena (G. f.216) etj, etj.

“Fjalorthi i ri”, ashtu siç jemi mësuar ta dëgjojmë për vite me radhë, pa ia dëgjuar e jo më tepër vlerësuar emrin e tij deri në vitin 2005, kur u ribotua nga shtëpia botuese Çabej, ka një vlerë të vyer gjuhësore, nëpërmjet të cilit pasqyrohet qartazi se sa e pasur është shqipja, duke na dhënë një sërë lemash gjuhësore me shumkuptimësinë e tyre, duke na pasqyruar një leksik të panjohur të gegërishtes veriperëndimore, i cili e vlerëson Gazullin një ndër leksikografët e parë të dialektit të gegërishtes, si dhe të vetmit deri në ditët e sotme.

10. Malësia e Madhe dhe Gropa e Shkodrës si vatra kryesore e leksematikës së Gazullit. Kundrim tipologjik, tematik dhe strukturor.

Malësia e Madhe shtrihet midis luginës së Vuthajve dhe luginës së Rrjollit, ndërsa në anën perëndimore mbërrin deri tek fusha e Shkodrës, me kufi ndarës lumin e Vrakës.⁹⁴

Ndonëse Nikollë Gazulli shërbesat e tij fetare i kryente në Shkrel dhe Rrjoll të Malësisë së Madhe, ndalesa e tij kryesore ishte Biblioteka Françeskane në Shkodër, dhe ai, ndonëse bashkëpunonte me Mjedën a Fishtë, gjendej kryesisht në shoqërinë e At Benedikt Demës.

Porsi bleta mbledh nektarin e luleve, ai mblodhi prej popullit të maleve tona mijëra fjalë të rralla, shprehje frazologjike, onomastikë e toponomastikë, materiale etnologjike e deri harta të vjetra mbi të cilat bëri analiza shkencore.

Dom Nikollë Gazulli me zellin e tij të paepur, mblodhi fjalë e shprehje popullore nga zona e Malësisë së Madhe. Gjeografikisht dhe nga ana dialektologjike, Malësia e Madhe dhe Shkodra janë shumë afër njëra tjetrës, kështu që duhet theksuar se Gazulli pasqyroi më së miri të folmen e gegërishtes veriperëndimore.

Fjalësi i Fjalorit përmban rreth pesë mijë lema. Kjo shifër nuk do të thotë se Fjalori nuk përmbush parametrat kryesorë, përkundrazi, sasia është ajo që nuk duhet të vërehet, e rëndësishme është cilësia e këtij Fjalori.

Duke marrë parasysh shtrirjen dialektore të fjalësit të Fjalorit, vërejmë se, përveç zonave të Malësisë së Madhe, janë përfshirë fjalë edhe nga Puka, Dukagjini, Mirdita, Ulqini, Malësia e Lezhës, Bregu i Bunës, por ka lëndë edhe nga Tirana etj., (ku Gazulli ka përfshirë fjalë në rrethe).

Fjalësi i Pukës përfshin zonat e Berishës, Blinishtit, Behotit, Buzhalës, Qelzës, Çerretit të Poshtëm, Dardhës, Kabashit, Këçirës, Komanit, Midhës, Milskaut, Ukthit. Jemi munduar të bëjmë një përjasje me leksikon e trevave veriperëndimore të nxjerrë nga Gj.Shkurtaj, B.Beci, Xhabir Topalli, Jorgji Gjinari dhe të paraqesim sa është i pranishëm Fjalori i Gazullit me lemat përkatëse, duke shënuar vetëm ato raste që i gjejmë të pasqyruara.

Pukë

aejkë- a – *undyrë leshi: lanulinë* (G. f.43).

agullue – *më janë agullue sÿt: terratisë* (G. f. 44).

arç-i – *argësh –i, argësht – i; trinë thuprash e mbajtun mbi uj me rrëshiqja të frÿm e e shtÿme prej notarësh për me kalue ujnât* (G. f.48). Gj.Shkurtaj jep dy kuptime të tjera të kësaj fjale, **arrç-i**- *dosëz, klysh dheu, dhe arrç-i* – *arrëza e qafës*.⁹⁵

arkësh- i – 1. *pendë kurthe*. 2. *sustë-a (ital)* (G. f.48).

balç-i – 1. *lyesë, (thohet për bare varrësh)*. 2. *jod-i (krh. balçëm-i.)* (G. f.53).

balishë-a – *ballushë-a, flokët e lanun të gjatë në ball*. (G. f.53). Tek Xh. Topalli e kemi, **balash-i** – *kalë me baloshë në ballë*.⁹⁶ Kemi ndërrimin fonetik nga *i:a*.

⁹⁴ Gj. Shkurtaj, *E folmja e Hotit*, "Dialektologjia shqiptare" II, Tiranë, 1974, f. 344.

⁹⁵ Gj. Shkurtaj, *E folmja e Kelmendit*, "Dialektologjia shqiptare" III, Tiranë 1975, f.94.

⁹⁶ Xh. Topalli, *Disa vërejtje për të folmen e krahinës së Pukës*, "Dialektologjia Shqiptare" II, Tiranë, 1974, f.325.

bardhë-a– potkë –a - 1. *thupër e Ivorueme qi ngulin ditën e Shën - Jozefit për shëj të xânmes së kullösës.* 2. *bardha-t (Luma) të lashtat, bimët e mbjellme herët, grûni, elbi, tershana, etj.* (G. f. 56).

bështrik-u – *bushtrik, bushtriq-i: kollomboq q'i s'lidhë kalli* (G. f.60).

bimue – *me prodhue, me qitë në dritë: dikur Drini s'ishte por e bimoi Zotynë.* 2. *me krijue. përbâ; bimim, bimesë, bimues* (G. f. 62).

boça e fytit – 1. *arrçi i fytit; ashti në gërgilâc të fytit: a a njëti thojt në boçë të fytit; molla e Adamit.* 2. *boçë pishe: kabllësh, pepërlleshkë: kokrra qi bân pisha.* 3. *boçë kollomboqi të fshâm* (G. f.65). Xh. Topalli e ka, **boç-a** – *koçani i misrit mbasi i hiqen kokrrat (Ib) bokla; në Qelez: katue.*⁹⁷ Të njëjtin kuptim jep edhe B.Beci për Shkrelin, **bo:ç-a** -*koçan.*⁹⁸ Gjithashtu edhe tek e folmja e Mirditës kemi, **boç-a** – *koçan misri.*⁹⁹

brushtull-i – *bimë* (G. f.72).

bufnjak-e - 1. *dhe e ezezë e e lehtë në të punuem me që: tokë bufnjake.* 2. *bor' e butë e mjellajë, në të cillën hupë kamba me shkelë* (G. f.73).

bukuritue – *me i dhanë një sendit bukuri, zbukurue* (G. f.74). B.Beci pë të folmen e Mirditës e përdor, **bukuru (me)** – *zbukuroj.*¹⁰⁰

burrzue – *me nisë djali m'u pjekë, m'u qymë, m'u rudithë mustakësh, n'u ndjersë musteqesh* (G. f. 77).

burrzim-i – *koha qi mbërrin djali i ri me mârrë hije burri; për varza: m'u gruenue*(G. f.77). Malësia e Madhe e ka **burrhoet**.

bushtër-a – 1. *shakë-a.* 2. *kulshedër-a.* (G. f.77). Gj.Shkurtaç jep trajtën, **bushtërr-a** – *femra e qenit, del edhe në vështrimin: grua e keqe, idhnake.*¹⁰¹ B.Beci na jep trajtën, **bushtër-a** – *femëra e qenit.*¹⁰²

buzvjerrë-a – *buzvarun-a; mbet buzëvjerrë, i vuer buzët, u topit; krh. hundvjerrët, me varë hundë* (G. f. 78).

buzhel-i – *kjenës i sendërgjuem me trembë fëmij, krh. gogol-i, bubazhel-i* (G. f.78). Edhe në Shkodër gjen përdorim, **bubazhel-i**.

crogë-a – *vend pa lisni: (krh. rogë)* (G. f.85).

crogë – 1. *me bâ, a m'u bâ crogë vendi.* 2. *me ra lesht e kres* (G. f.85).

cubak-e – *cub-e, bishtshkurtën: orë cubake; kishem me pasë le me orë cubake: me orë tëpreme, me fat të lig* (G.f.86). B.Beci në të folmen e Mirditës e ka, **cub-dele me bisht të shkurtër.**¹⁰³

cukël-a – 1. *pakicë: mbetën do cukla.* 2. *pakicë teshash* (G. f.86). Malësia e Madhe e ka **cokël-a**.

cukëm-a – *tepricë, kusur; më ka mbetë edhe një cukëm paresh pa t'i marrë* (G. f.86).

cûmër-a – 1. *nënkrejçë, cënuq, jestek.* 2. *kambalec-i: m'u ka thye një cûmër shtrati, kambcë-a* (G. f.86). Malësia e madhe përdor trajtën **cumrrak-e** – *i/e vogël me trup.*

cûngël-a – *cung i vogël* (G. f.87).

curakzue – *curakë (me)* (G. f.87). Tek e folmja e Rranxave të Mbishkodrës e gjejmë, **curakis** – *pres, shkurtoj degët e një peme ose flokët e një fëmije* etj.¹⁰⁴

⁹⁷ Xh.Topalli, *Disa vërejtje për të folmen e krahinës së Pukës,* "Dialektologjia Shqiptare" II, Tiranë, 1974, f.325.

⁹⁸ B.Beci, *E folmja e Shkrelit,* "Dialektologjia shqiptare" I, Tiranë 1971, f.310.

⁹⁹ B.Beci, *E folmja e Mirditës,* "Dialektologjia Shqiptare" IV, Tiranë 1982, f.95.

¹⁰⁰ B.Beci, *E folmja e Mirditës,* "Dialektologjia Shqiptare" IV, Tiranë 1982, f.96.

¹⁰¹ Gj.Shkurtaç, *E folmja e Kelmendit,* "Dialektologjia Shqiptare", III, Tiranë 1975, f.91.

¹⁰² B.Beci, *E folmja e Mirditës,* "Dialektologjia Shqiptare" IV, Tiranë 1982, f.96.

¹⁰³ B.Beci, *E folmja e Mirditës,* "Dialektologjia Shqiptare" IV, Tiranë 1982, f.97.

¹⁰⁴ Gj.Shkurtaç, *E folmja e Rranxave të Mbishkodrës,* "Dialektologjia shqiptare" IV, Tiranë 1982, f.237.

curan-e - *njeri a shtâzë veshcure* (G. f.87). Tek e folmja e Kelmendit e kemi, **cur-a** – *dhi që i ka veshët shumë të vegjël*.¹⁰⁵ Tek B.Beci e gjejmë, **curre-ja** – *dele me veshët të shkurtër, quhet delja pa veshë*.¹⁰⁶

curran-e – *njeri i fortë si curri* (G. f.88). Xh. Topalli e ka, **curr-i** – *shkëmb i thepisur*.¹⁰⁷ Gazulli e ka përdorur si mbiemër në mënyrë figurative. Edhe tek B.Beci kemi, **curr-i** – *shkëmb*.¹⁰⁸

qellimtar-e - *njeri qi punon qellimas, aventurjer-e* (G.f.90).

quktisë - *me i ra mbë të shëjit; na quktisi me gurë* (G. f.95).

qyne – *âsht bâ qyne: plakë e stërplakë* (G. f. 97).

çamë-a – *çamër buke: grimcë, dromcë buke* (G. f. 98).

çuhâ-ni - 1. *bucak-u*. 2. *jebrik me çep*. 3. *fëmij të vogjë të curakët: hiqnju cuhâj* (G. f.102).

danik-u – *odë e veçue me për ndonji qëllim* (G f.105). Në Mirditë, B.Beci na jep trajtën, **daneik, danek** – *e veçuar, e veçantë*.¹⁰⁹

danisë - *me danue, me e da menden, me vendue, me këputë: kam danisë me shkue, e kemi danisë këtë gjâ* (G. f.104). Në Mirditë kemi trajtën, **daneit (me)** – *ndaj*.¹¹⁰

dega-ja – 1. *dava, davi*. 2. *shamatë* (G.f.106).

degatë – *m'u degatë për punë tëkota* (G. f.106).

dejprapët – 1. *dejprapë, mbë shpinë, mbë kokërr të shpinës, ra dejprapët*. 2. *i dejprapët: mbë shpinë: vënë gotën dejprapët e jo grahuq = vënë me grykë përprjetë e jo me grykë teposhtë* (G. f.107).

delmerja – *në toponym, curri i delmeres: çobaneshë, blegë-a* (*Shestani, ndër kangë*) edhe, *bleg-u* (?) (G. f.107).

dënue, dinue – *m'u pakue; u dënue vëna në vozgë, dënoe pak ata lang mos të derdhet* (G. f.108). Gj,Shkurtaç jep trajtën, **dnoj,-ova,-ua** – *pakësoj, mbaroj diçka*.¹¹¹

drrasue – *me shtrive, me veshë me drrasa* (G. f.110).

drrasim-i – 1. *shtrojë, e veshme drrasash*. 2. *vend i nalcuem me drrasa; kishte hypë mbë një drrasim e po kuvendëte të madhe* (G. f.110).

detuer-ore – 1. *qi vjen prej deti, borë detore, poç detuer: kungull-pijës*. 2. *qi rritet në det a afër deti: peshk detuer* (G. f.110).

përllim-i – *detyrë, me zbatue përllimin: me la borxhin* (G. f.311).

Berishë

me bukëzue – (Ber. PK) *me hangër një grimë bukë* (G. f.74).

bungvogli – (Ber. PK) *nji farë bunge* (G. f.75).

fërshllje – *fëshëllye, shëllye*(G. f.128).

karsh-i – *vend karsh, a kërh; gerdhaitë, mbushë me gurë e shkambij* (G. f.193).

knarë – *m'u gëmushë, gërmucë: me i u knarë kuj: knarrë* (G. f.205).

¹⁰⁵Gj.Shkurtaç, *E folmja e Kelmendit*, "Dialektologjia Shqiptare", III, Tiranë 1975, f.71.

¹⁰⁶ B.Beci, *E folmja e Mirditës*, "Dialektologjia Shqiptare" IV, Tiranë 1982, f.97.

¹⁰⁷ Xh.Topalli, *Disa vërejtje për të folmen e krahinës së Pukës*, "Dialektologjia Shqiptare" II, Tiranë, 1974, f.325.

¹⁰⁸ B.Beci, *E folmja e Mirditës*, "Dialektologjia Shqiptare" IV, Tiranë 1982, f.97.

¹⁰⁹ B.Beci, *E folmja e Mirditës*, "Dialektologjia Shqiptare IV", Tiranë 1982, f.99.

¹¹⁰ B.Beci, *E folmja e Mirditës*, "Dialektologjia Shqiptare" IV, Tiranë 1982, f.99.

¹¹¹ Gj.Shkurtaç, *E folmja e Rranxave të Mbishkodrës*, "Dialektologjia shqiptare" IV, Tiranë 1982, f. 238.

pândë-a – *panda e shpisë: ngreha me gjithëshka ka: fryni një erë natën me tërbim e i a hodh pândën e shpisë në breg të Drinit (G. f.298).*

përmjetue – *me plotsue dishka djerë në mjet (mjedis); e përmjetova gotën së mbushëmi (G. f.313).*

rrem-i – *mend-i, e mora mbë një vrem, ças-i (G. f.462).*

Blinisht

ashemb-i – *mallkim-i, e ke me ashemb m'e bâ këtë punë (G. f.50).*

torrec-i – *pergjel-i, kompas-i (G. f.428).*

vraçue – *me vrâ mizorisht e me shumicë, me ba kërdi (G. f.461).*

Behot

sarushtë-a – *bimë, Scrofularia (G. f.366).*

shajkë-a – *âsht quejtë (gabimisht) sheka e mullinit, si ni bucjelë qerri me fletëtë ngulme vrangull, me të ndeshun në rrymë t'ujit sillet e bân me luejtë tëgjitha veglat e mullinit. Këjo vegël parake kje zbatue edhe ndër sendërgjime të reja.(G. f.385).*

thuk-u – *shterë-a, havan-i, kupë guri, drûni, metali për me shtypë mbrendë shka do: je shëndoshë e bâ si thuk (G. f.440).*

Qelëza

baltik-e – *vend, tokë baltike: tokë me lagështinë (G. f.53).*

bërbâ-ni – *mashkulli i bletës (G. f.59).*

biterr – 1. ? 2. *mârrë mendsh: jam bâbiterr e s'dij kah i a mbaj (G. f.63).*

brrokë – a – 1. *kërroqe, kaçie bâ me lëvore blini. 2. rreth i gjânë lëvoresh, qi u a vëjnë dhijvet në qafë mos me thithë vedin (G. f.72).*

buhnajë-a – 1. *pluhnajë-a: u çue buhnajë prej ere e na i muer sytë; pluhun i madh; krh. djalekt. ital. shqipëtar. buhnë-a: puhun-i (de Rada): çtiei te kjelkji kë buhna: shtije ndë kelq këtë pluhun! dhe molinë, tokë molinë (G. f.74).*

cetinë-a – *cegëm-i; mot acar, acari e madhe; âsht cetinë e madhe (G.f. 82).*

currî-ni – *çurril, çurrel, çurg-u; fraz. me mbajtë menden currî në Zoti: drejtë, fill, fillak (G. f.88). Në Mirditë kemi curril-i – rrjedha e ujit të çezmes.¹¹²*

currîtë – *i drejtë, fill, fillak; mende e currîtë, mende e drejtueme fill mbas njij sendi (G. f.88).*

qokë-a – 1. *birë, vrimë në drû a gur, rrumbullake a e gjatë; vi, ku hyn shtërngueshëm një copë tjetër e përputhme; germ. Nut, fjalë landëtarësh, edhe: fëmën – a. sh. këthîc-i. Fraz. Me kënë në qokë, me i pasë mend mbëtë, tëpërmbledhme. Me ira në qokë fjalës, kuvendit, pûnës, me i ra mbë të, m'e diktue; krh. djalekt. friulan divenire cioc: m'u dejë, m'u bâ në qëf (G. f.94).*

quherdhe-ja – *çerdhe-ja (G. f.95). Xh.Topalli, çuherdhe-ja – çerdhe, fole.¹¹³*

derdhoshë – *me rrahue, me shtrûe për tokë: i ka derdhoshë bora degët e mandavet(G. f.108).*

¹¹² B.Beci, *E folmja e Mirditës*, "Dialektologjia Shqiptare" IV, Tiranë 1982, f.97.

¹¹³ Xh. Topalli, *Disa vërejtje për të folmen e krahinës së Pukës*, "Dialektologjia Shqiptare" II, Tiranë, 1974, f.326.

drang-u – 1. *shul i trashë qi i vehet derës për tërthuer m'e shtërngue*. 2. *hû i math e i gjatë me shtý barkën* (G. f.113).

dulltak-u – *granit-i, gur vulkanik me kokrriza të gastarta të krypësorrës, të gurgacit e mikës* (G.f.116). etj.

Çerreti i Poshtër

frymue – frymnue 1. *me mbushë me frymë, me idhnue*. 2. *jam frymue në N.N: jam mbushë me frymë, idhnue* (G. f.138).

Dardha

ndërlisë – *ndërkue (ndërlíkue: me qitënë një lik tjetër; kush din se ku jemi ndërkli së e s'mund u ndeshëm)* (G. f.283).

teshue – *hakrrue, janë teshue dosat: mbarsë* (G. f.425).

Kabashi

bashkari-ja - *merá, hali: motit edhë frati-ja* (G. f.57).

hijenue – *me ndejë nën hije, me kalie nën hije zhegun e ditës: ç'po ban këtu? Po hijenoj* (G. f.176).

ndrijue – *m'u mbledhë në vedi, thuhet sidomos për misa të trupit qi ndrijohen, ngrihen tue u mbledhë, shtangohen* (G.f. 287).

përftue – 1. *këjo lopë ka përftue njet viç*. 2. *përtri* (G.f.308).

stihë – *me ngucë, stihue, idhnue: njaj më stihon* (G. f.379).

Këçira

drobe-ja – *shpend liqejsh e ujnash; fraz. s'mund lozë vendit me sa një drobe, trobe, trope* (G. f.114).

fetak-e – *njeri fetar tek s've, fanatik-e* (G. f.129).

shtâng –u – 1. *maje heshte, shgjeta?* 2. *çmim i kputun: i kanë vû shtangun okës së kollomboqit* (G. f.411).

Komani

allçëniku – *nji farë guri njeje së rubinit qi në katund të Komanit gjindet edhe mbi dhe, në zjarm digjet; përdoret me shkrymbë varrët* (G. f.45).

bibrak-e – *lakur (i-e), blec-e, curak-e* (G. f.61).

bonjake (tokë) – *tokë e trashë e me ujcinë, vruinë* (G. f.66).

qallë-a – 1. *varra qi bâjnë veglat prese tue u mbëshue me tej (jo me maje)*. 2. *varrë, vizë qi u bâhen në kambë disavet, pse ecin zbathun, a prej ndonji lëgate: mëjanë bâ kambët qalla-qalla* (G.f.89).

flâmër-i – *flâmra, t. 1. flamur-i, flamujt, t: me luejtë flamrash; natën e shën Gjinit lidhin me kurpna vandakë byku e i djegin tue i sjellë rrokull me duer*. 2. *bajrak-u* (G. f.134).

foskë-a – gropë e vogël, fosë-a: fos-i, gropçel-i; ishte ba vendi foska-foska (G.f.137).
B.Beci na jep trajtën **fos** – kanal që bëhet në shpate malesh për të pritë rrëketë qëformohen mbasi bie shi.¹¹⁴

Midha

bângëc-i – *nji bangëc bore: top bore* (G. f.55).

bokërr-a – *mî fushe në njeje të ndryshkut, rrenon bimët e biron bagtin, sidomos n'eshke e në të leth* (G. f. 66).

carde-ja – *ngarkicë, ngarkesë e vogël. 1. sh. Bashk. fq.477, pjesë, grup-i* (G. f.80).

cijue – 1. *me tingllue veshët. 2. me kjenë prekë a gjetë prej ndonji rreziku: në mos të ndigjoftë, ka me i cijue në vesht!* (G. f.82).

çup-i – 1. *mos më ndigjoftë, po e hjedh në çup tëarmit: në truell, votër të zjarmit. 2. burr me flokë të shkurtën; çupë-a, fëmën flokëshkurtë, prandej: çupë-a, vajzë-a pse s'i ka flokët e gjatë si të martuemet* (G.f.103).

gërmë-i – *gjâ e vogël e pa fuqi, p.sh. dritë e gërmë* (G.f.147).

Miliskau

zhÿm-i – *pluhuni, hîni qi len duhani i djegun: zhÿm pilave: zhÿm cigare* (G. f.476).

Ukthi

andaq-e – *andaq pune, mësimi* (G. f.45).

bakalimth-e – *i vocërr me vjetë: fëmi bakalimth* (G. f.52).

pjerzë-a – *bimë, Cenopium bonusenricus* (G. f.32).

Fjalësi i Dukagjinit përfshin zonat e Dushmanit, Pultit, Shllakut.

Dukagjini

krahol-i – *jelek-u (tyrq)* (G. f. 214).

krrokullë-a – *mbërrokullë-a, gjymtyrë qi bashkon ashtin e kofshës (koçallakun me kopaç* (G.f. 221).

lasë-a – *të lamë: shala prin në lasë të duerëvet(në kanû të lekës kurse bahen çabulle),* (G.f. 230).

llokatiq-i – *tambël i tundun qi asht hjekë tlyeni* (G. f.245).

mârrtas – *difton mungesën e dishkahit, p.sh.: mârrtas dielli kûênka çue! (prej rêsh qi e mbulojnë, i mârrun drite)* (G.f. 250).

mbëzuckë-a – *tureçkë-a, turini (krh. floçkë, prej flokëç, mbëzuckëç = buzë),*(G.f.256).

mtue – *krratë, s'të mton kush për gjâ, mtoi me mârrë diç* (G. f. 271).

ndërshejçë-a – *pikëzore, drrasë tjegulle kalore* (G.f.284). Tek B.Beci kemi foljen

nërshej – *në mes: “ vin e u hin nërshej Shkrelit e Lohes”, “u prishen nërshe vedit”.*¹¹⁵

pit – *dola pit në maje: përpjetë në maje: pjet' e në mâje* (G. f.325).

rupë-a – *përpjetëz, bjeshke, faqe mali me pak shkrepë e me kullosë* (G. f.347).

¹¹⁴ B.Beci, *E folmja e Mirditës*, ”Dialektologjia shqiptare” IV, Tiranë 1982, f.101.

¹¹⁵ B.Beci, *E folmja e Shkrelit*, ”Dialektologjia shqiptare” I, Tiranë 1971, f.317.

Dushmani

ryzue- *m'u dalë përjet petkavet, m'u vjetruet petkat; si eryzove kështu brezin!*(G.f.348).

Pulti

lodhënim – *djergënim* (G. f.237).B. Beci jep trajtën, **lollonim-i** – *llahusë, lëhonë*.¹¹⁶
logue – *rrafshue* (G.f.238).

lpâ – *me bâ në të prirun, në të lam; me lpâ gurin: m'e latue në të lam* (G.f.239).

lpatë – *nëprrike, me prrike: ngrehe gurin lpatë e jo thik* (G.f.239).

lugë llaçi – *mistri-ja, vegël këthistarësh, me marrë llaçin me i a vum gurit* (G. f.240).

llakë – a – *llakë bore: skllotëre, flok (flug) bore qi shkrihet sa të bie në tokë*(G.f. 244).

maranaje-t – *rrëshajët, pse ndër të kreme të Rrëshajvet dilej në mâje të Malit të Maranajit, ku duket kje ndonji kishë në zâ* (G.f.249).

megue – *me megue drita: me ague* (G. f.258).

përmjet – **i** – *qëndra, mjedisi: këtu është përmjeti i katundit* (G. f.313).

spajni-a – *dukë, të dukun, vegim* (G. f.384).

tângë-a – *dâm, paragjykim; me i a lâë, me i mbetë kuj tângë, një fjalë, një punë* (G.f. 420).

Shllaku

orrlë-a – 1. *urrlë-a, velgjë i pa rrëshinë*. 2. *molikë-a*. (krh. fj. urrë-a). 3. *sbardhulinë-a një rreth i ri prej së bardhi qi i shtohet për gjithëjetë lisit* (G.f.294).

vendçuer-ore – 1.*banuer i ngulun, toprakli (turq.)*. 2. *tokë vendçore: me një pozicion të mirë* (G. F.452).

Fjalësi i Mirditës përfshin zonat e Fandit, Këthellës, Kryeziut, Oroshit.

Mirditë

krtratë – *me kqyrë kendin për një send, me mtue. Nuk u ba pleqnija me të drejtëpse pleqt krratshin me hangër pare* (G. f.220).

krrokë – *thohet për brimë qi lëshojnë korbat, bretkocat; korbi, krrokë, u ndie një korb tue krrokë* (G. f.221).

kuq-i – *vegsh i math, i pa vegë, zen shumë okë: vorba asht ma e vogël se vegshi, por me vegë, cinga ma e vogël se vorba, herë me vegë e herë pa të. Kur kush mbas buke epet në kuvend, thonë se: është ngishëm tash me mish prej kuqi e me raki prej kotrove* (G. f.222). Gjithashtu edhe tek B.Beci për të folmen e Mirditës kemi, **kuq-i** – *enë dheu si vorbë po pa veriga, përdoret për të zier mish*.¹¹⁷

kylë – *me mbushë: ç'i paska kylë Zoti zgjojt me mjaltë* (G. f.226).

lapë-i-ë-a – *i venduem përfundi, i pëfundë, i poshtë; përk. i popë, i venduem për sipri, i epërm. ? krh. top. në bjeshkë të Mundellës: livadhi i lapë, e liv. i popë* (G.f. 228).

latrac-i – *planc, bark bagëtije me zgrof e zorrë* (G.f. 231).

mështekën-a – *mushtekën-a* (G.f.262).

¹¹⁶ B.Beci, *E folmja e Shkrelit*, "Dialektologjia shqiptare" I, Tiranë 1971, f.316.

¹¹⁷ B.Beci, *E folmja e Mirditës*, "Dialektologjia shqiptare" IV, Tiranë, 1982, f.109.

nrâte-ja – *nade-ja: u zgjova nrâte heret(ne nrâte heret) dje në nrâte; ndrâte-ja* (G.f. 280). B.Beci e paraqet **nate-ja** – *nade, mëngjes: “ tash nate nuk ke pse m’pret”*.¹¹⁸

ofshë – *thirrje dhimbe: ofshë për mue: medet (turq), kej neshtrasha! kej!* (G.f.293). Gjithashtu tek e folmja e Mirditës kemi, **nrôte-ja** – mëngjes.¹¹⁹

përgjegjë – *përgjakë, lëvyrë, gjaknue: jam përgjegjë, luftë e përgjegjëme; më duelën thijat e përgjegjëme* (G.f.309).

taritik-u- *djal i burrëzuem, tarabak, taraman* (G.f.421).

Fandi

lezmue – *me ikë; lezmo, lezmuen të gjith* (G.f.235).

milcue – *me i hjekë drrasës, para se m’e vû në sdrug, lyerthat (mullajt) qi ka, me ûntue* (G. f.264).

popec-i – *popel (Bashk. 358), papëhok-u, kokërdhak guri* (G.f.331).

Këthellë

parrî –ni – *shpirt i keq, i lig, damtuer* (G.f.300).

satullue- *jam satullue së ftofti: jam ngrucë, ngrucë, mbëledhë trupit prej së ftofti* (G. f.382).

shtâjkë-a – *të therun, dhimbë e fortë, më ka kapënji shtajkë e fortë ndër brî, qëndër-a* (G.f.410).

Kryezi

krrâe-ja – 1. *e drejtë a arsye qi mund të et a qi kujtohet se asht mbi një send, a me veprue a me ndejë dorëjashtë a mos me e ba një punë; mtesë-a: m’erdh te dera me shum krrâme, s’qitet me krrâme të tija!* 2. *shbajtë: ligështina, lëngatë të vijueme në trup; halle: si po je, me krrâme shum!* (G.f. 220).

kusuferr-e – 1. *njeri qi tinëz mundohet me shti keq.* 2. *njeri qi punon tinëz (mbas ferrash?)* (G.f.226).

lauricë-a – *grue e pambarre, kalore-ja* (G.f.232).

mestitë – *me majë bagëtin, p.sh. thitë* (G.f.261).

mjerthi - *mjerthin, dernathi* (G.f.265).

preq-i – *bigëz-a, drû e bigzueme qi ngulet në majë të mullarit të sanës (kashtës) për mos me marrë era kapliqin, pâmën, duokun* (G.f.334).

Fjalësi i Ulqinit

majere- ja – *vesha e drûjtë e fluskës (përjashta)*(G. f.247).

vërzën-a – *verzën-a, e veshëmja e përmbrendëhme e fëluskës,përk.Majere* (G.f.453).

zym-i – *hekur qi nën uj lidhë presin e fëluskës me ballpresin* (G.f.472).

âni i dorës – **nëni i dorës** (G.f.47).

fagû-ni – *zjarmishta, gjelltorja n’ani, sh. fogû* (G.f.125).

Bregu i Buenës

mângël-a – *makinë-a: manglat e vaporrit* (G.f.248).

plêngë-a- *bahe, bëkë* (G. f.328).

¹¹⁸ B.Beci, *E folmja e Shkrelit,*” Dialektologjia shqiptare” I, Tiranë 1971, f.317.

¹¹⁹ B.Beci, *E folmja e Mirditës,*” Dialektologjia shqiptare ”IV, Tiranë 1982, f.113.

Siç vërehet mirëfilli, ky fjalor është një thesar më shumë në leksikografinë shqipe, i cili pasqyron se sa e gjerë është gjuha, sa e thellë dhe me zona të panjohura na del ajo. Gazulli jep pasqyrën e të folmes së gegërishtes veriperëndimore me larminë e leksikut të pasur, ku vendin kryesor e zë Malësia e Madhe e gropa e Shkodrës, duke vijuar më tej, sipas sasisë së fjalëve me Pukën dhe zonat e saj, Dukagjinin, Mirditën e më pak me Ulqinin, Bregun e Bunës.

Një tjetër çështje me interes për t'u trajtuar në Fjalorin e Gazullit, është se shumë fjalëve u jep sinonimen përkatëse në gjuhën letrare/ dialektore, por ka nga ato, të cilave ai u jep vetëm një shpjegim me fjali. Kjo na lë të kuptojmë se Gazulli nuk gjente përgjegjëset e lemave krahinore në gjuhën standarde ose edhe në dialekt, për këtë arsye, ai jepte kuptimin e fjalës duke e shoqëruar me fjali.

Po i vërejmë duke i radhitur si më poshtë:

Fjalë krahinore që i ka vënë sinonimin në gjuhën letrare / dialektore:

abulli-i – *avull-i*(G.f.43).

acar-e – *grue acare= e dliirët, veshëacare; mot acar = i ftofët* (G. f.43).

aft-i – *afti i borës bjen të ftofët; ajri, tafti* (G. f.43).

aktund-i – *rend, kurá (tyrq.): kur i erdh aktundi me shkue ushtar* (G.f.44).

âmë-a – *ka âmë vojquri, buka paska âmë të randë: âmë e mirë: shije, a* (G.f.45).

andshëm- *i kandshëm(âhtëm:ândë, âtë)* (G.f.46).

âng-u – *ângth, ânkth* (G.f.47).

anvishë-a – *amvizë = zojë shpije, zojnore* (G.f.48).

babarrun-e – *i fortë, trimaloç-e: i fuqishëm shtatit* (G.f.51).

balc-i – *ushkur-uri* (G.f.53).

ballahû – *kundruell, ndër sy: s'mund i thom ballahû: s'mund i a përplasi ndër sy, s'mund i thâm kokërdhak. M'a bâni njetë punë ballahû, më foli, i ndëja (ballahû-kokërr)* (G.f.54).

buhnajë-a – 1. *pluhnajë-a: u çue buhnajë prej ere a na i muer sýtë: pluhun i math;krh. djalekt. ital. shqipëtar. buhnë-a: pluhun-i (de Rada): çtiei te kjelkji ktëbhna: shtije ndë kelq ktë pluhun!* 2. *dhë molinë, tokë molinë* (G.f.74).

cahë – *me pague: nuk të lëshoj pa m'i cahë paret e mija* (G.f.79).

qas! – *largo! Kështu u thërrasin bagëtivet pëlleja, kur i mjelin; qase kambën: largoe!* (G.f.89).

qasue – *me sajue, me bâ sajimin e shtëpis: me qasue shpin* (G.f.89).

qëmër-a – 1. *gjarpnim-i, të sjellunat qi bâ gjarpni tue u hjekë rrëshqânë. 2. shtrëmbënim-i, shtrëmbë-a - ; e ka ba murin qëmra qëmra: leqe leqe* (G.f.90).

çafodhe-ja – 1. *krahnoshe, krahnorcë. 2. çantë lëkure a tjetër sehit, valigje* (G.f.97).

çakraman – *e – shakllaban- e(tyrq); vagabond (it.)* (G.f. 97).

çamër-a – *çamër buke: grimcë, dromcë buke* (G. f.98).

çeftuz-e – *çehresuz, me fytyrë të keqe; s'ka mâ burr çeftuz se ishte* (G. f.99).

dak-u – 1. *dash-i. 2. êmën kombtar* (G. f.104).

danik-u – *odë e veçueme për ndonji qëllim* (G. f.104).

dritës-a – *kandil-i* (G.f.114)

ëndë-a – *të luluem, t; koha qi êndin lulet, qi nisin me çilë. 2. e diellja e êndës(PK): e diellja e Larit* (G.f.122).

fajkore-ja – *take-ja, lundër e madhe* (G.f.125).

gjakim-i – *dëshir i flakët, i ndezun; lakmi* (G.f.162)

pi – *mbi shpi, mbi rrugë, sipri, sipër* (G.f.319).

rrime-ja – *rrême, karrême, rrajzë-a për bubës-it, fraz. ishte si rrime* (G.f.357).

Fjalë krahinore që i ka shpjeguar me fjali:

afërmendësh – *mos fol afërmendësh: mos fol nëpër të, dishka atypari, jo gjâ të njimendët- kjo punë âsht afërmendësh* (G.f. 43).

akulltar-e – *njeri qi e ka menden akull, qi i peshon fjalët* (G.f.44).

ardhshëm- *njeri i ardhshëm: qi i vjen punës, arsyes: i ndigjueshëm, i shoqnueshëm; punë e ardhshme, qi vjen për doresh, njeri i ardhshëm me kuvend: qi i vjen arsyes* (G.f.48).

balishan-e – *kush lê balishën* (G. f.53).

baltimë,t – *me hangër sa me hjekë baltimën e gojës: të keqt qi merr goja prej së pa ngrânmi; të baltimët* (G.f. 53).

ballafaçkë – *të ramë të fyeshëm, e bjerrme me zhurmë; e muer e fitoi një ballafaçkë* (G.f.53).

bastarr-i – *kacafit-i, kësoll' e vogël sa me xânë një a dy vetë, ngrehër me ruejtë bastanin, berret, etj.* (G.f.56).

bucak-u – *ênë uji prej drûni, me çep a lëfyt si jebriku* (G.f.73).

cacë – *ka nisë fëmija me cacë* (G.f.79).

capë-a – *dhe a shtrat dheu i forcuem prej motesh si çemento, i gurzuem, peqinë (slav), harasan (tyrq)* (G. f.80).

qepue – *m'u shkri e m'u baâ një; guri i shkrim qepohet për gur të shkrîm* (G.f.92).

qeradhyke-ja – *copë drûje qi s'âsht bâ thingjill (qymyr) qerradhyk, qerradhyke-ja* (G.f.92).

qesllue – *me i dhânë frymës jashtë tue u kullë lehtë; sh. qellëxue* (G.f.92).

çallapinë-a – 1. *grue e shkatrrueme ndër rângë, e lânun faret.* 2. *shpi e vjetrueme* (G. f.98).

çapell-i – *dy fiq të thatë të hapun dysh a të çam e të lidhun bashkë, të përputhun; përkundra: fik njëjsë; fik i vetëm, i that e i vûm nëpê varg me tjerë* (G.f.98).

çojë-a – 1. *të çuemit, kur dyndën prej fushe në bjeshkë, e prej bjeshke në fushë; kohë e çojës, kur të vijë çoja.* 2. *në poezi kishte me kjenë: arsis (çojë zâni)* (G.f.101).

dêjun – 1. *tokë e dêjun, ku âsht shkri a ulë bora, tokë e vûtë, e plantë.* 2. *horizontale: m'e vû një send në tëdêjun* (G.f.106).

dendë – *me mbushë barkun e m'u dendë = tendë* (G.f.108).

derdÿ – *me ngurrue tue mbetë ndërdyzash, me kjenë ndërzyzash; njaj njeri derdÿhet m'e ngrehë një shpi* (G.f.108).

derdhë– *me derdhë kollin, lin etr. thohet për kangë a lëngatë qi s'kthejnë mâ, mbassi të shndoshemi një herë* (G. f.108).

êgjue - *më janë êgjue do delme, më kanë mbetë êgja do delme; êgjë,êjë, i thonë delmes a dhis pse u mbahet një kingj a edh i huej në të mjelun, kurse u ka cofë i veti.* (G.f.121).

êmnesë – *ngjarje në shêj, qi s'harrohet; frz. u bâ një emnesë e motit, një e ngjame m'u pëmendë për mot e mot* (G. f.121).

esull-i – *agjinesë e shtërngushëme, kur s'shtihet gja në gojë, me kënë nd'esull(a t'esull) me ndëjë nd'esull, krh. n'ujë, e t'ujë* (G.f.125).

gjelbëzue – *m'e shijue haen me dishka: gjelbëzo me djathë se t'a smilon haen !* (G.f. 165).

petanuer-ore – 1. *tokë a mal si pet shkalle.* 2. *i bâm në trajtë të shkallës: tokë petanore.* 3. *qetë e naltë a shkambij ndër brigje t'ujit me patalok përsipri a strehë përfundi* (G.f. 318).

Këto fjalë të rralla që i vërejmë në këtë fjalor, janë fjalë që përdoren në ligjërimin popullor në zona të ndryshme të Veriut të Shqipërisë, të cilat dëshmojnë për një gurrë të çmuar leksikore të fondit shqip dhe na japin larminë e shumëkuptimësinë e përdorimit të fjalës shqipe me ngjyime e përftesa që vetëm një filolog si Nikollë Gazulli ka ditur t'i mbledhë e të na i pasqyrojë në këtë Fjalorth, siç e quan ai.

11. Fjalori i Benedikt Demës.

Klerikët katolikë, vendës dhe të huaj, dhanë shumë edhe në fushën e leksikografisë. Ata qenë nismëtarë në shumë degë të kësaj disipline: dhanë të parin Fjalorth etimologjik (P. Mazrreku, 1633), të parin Fjalor të gjuhës shqipe (Frang Bardhi, 1635), të parët Fjalorë italisht-shqip e anasjelltas (Rossi, 1866; Jungu, 1895; "Bashkimi", 1908), vunë gurin e parë të themelit në leksikografinë krahinore (Gazulli, 1941, së bashku me studiuesin nga Jugu, Pano Tase), në leksikografinë onomastike (Gazulli, 1939-1943), pra një punë mjaft e lavdëruar kjo.

Në këtë kontekst, historia e popullit shqiptar është e lidhur ngushtë me kishën dhe klerin katolik, të cilët kanë qenë kurdoherë inspirues në luftë për fe dhe atdhe, duke mos lënë pa përmendur edhe rolin kryesor që kanë pasur në lëmë të gjuhësisë.

Dihet mirëfilli se gjuha dhe kultura shqiptare e karakterit evropian, doli nga kleri katolik shqiptar me "Formulën e pagëzimit", të arqipeshkvit të Durrësit, Imzot Pal Engjëllit, më 1462.

Por, është për të ardhur keq se, me përjashtim të Bardhit e pak të "Bashkimit", për asnjë nga këta klerikë dijetarë, nuk u fol për sa vjet asnjë fjalë, ndonëse puna e tyre ishte e ditur. Dhe, çka është më keq, mjaft nga ata u masakruan egërsisht. Kështu, *D. Nikollë Gazulli, D. Ndrë Zadeja, Atë Bernardin Palaj, D. Aleksandër Sirdani, P. Gjon Karma, Atë Donat Kurti, D. Ndoc Sahatçia, D. Ndue Suma, D. Kolec Prendushi*, etj., u kthyen në martirë.

Eliminimi i figurave kryesore nuk e tërhoqi kishën nga pozicioni antikomunist. Kjo u shfaq hapur në kundërshtimet ndaj reformave të para ekonomike e sociale.

Në qershorin i vitit 1967, një prift, ndër morri të botonte një fjalor. Ishte viti kur shteti shqiptar komunist mbylli të gjithë objektet fetare dhe ndaloi ndjekjen e riteve të tyre. Vepra madhore ishte puna e tij e palodhur, ditë e natë, që prej vitit 1949. Vetë kjo vepër është origjinale në llojin e vet, duke bashkuar qëllimin për një enciklopedi shqiptare.

At Benedikt Dema qe fëmijë i Pjetër Demës dhe nënës Roza. Lindi në Boriç të Shkodrës më 28 prill 1904. Mësimet fillestare i mori në shkollën fillore françeskane pesëvjeçare në Shkodër. Pasi përfundoi ciklin e ulët të shkollimit, kishte shprehur dëshirën dhe ishte regjistruar kandidat për t'u bërë rregulltar i Shën Françeskut. Pas përfundimit të kandidaturës, veshi petkun françeskan në shtator 1920.

Kur u diplomua, për të thelluar dijenitë teologjike, nga eprorët e tij qe dërguar për studime universitare në Fakultetin Filozofiko-Teologjik në Antoniano në Romë, së bashku me At Anton Fishtën, At Donat Kurtin dhe At Konstandin Konajn.

Kjo ndodhi më 28 prill 1925. Në përfundimin e studimeve pesëvjeçare, filozofike dhe teologjike u shugurua meshtar më 7 prill 1928, në Romë, duke marrë atributin At (pater).

Edhe pse nuk u prek drejtpërsëdrejti prej përndjekjes që shteti u bëri klerikëve, sidomos klerit katolik, At Benedikt Dema e vuajti shpirtërisht goditjen që iu dha kultit në përgjithësi dhe kishës katolike në veçanti. Vitet e fundit i kaloi në Shkodër, duke u strehuar tek e motra.

Në "Hyllin e Dritës" ai ka botuar më tepër se 50 artikuj e studime shkencore dhe publicistike, duke përdorur si nënshkrime dhe pseudonimet: "Ben-dea" dhe "P.B.D". "Fjalori i shqipes", krahas me "Fjalorin enciklopedik", janë dy prej veprave më të rëndësishme filologjike të At Benedikt Demës.

Emri i At Benedikt Demës është një emër relativisht i njohur nga gjithë shqiptarët. At Benediktin e njeh zona e Shkodrës, e Malësisë së Madhe, si prift i devotshëm e i përkushtuar, si njeri i shkolluar dhe me prirje filologjike e gjuhësore.

Vepra e tij “Fjalor fjalësh të rralla të gjuhës shqipe”, një punë mbledhëse 18 -vjeçare, është një thesar më tepër në leksikologjinë e leksikografinë shqiptare, e cila mbërrin në duart tona, vetëm kur gjen dritën e botimit nga shtëpia botuese Toena, në 2005. Por, kërkimtarin e palodhur të fjalëve të gjuhës shqipe, gegërishtes veriperëndimore, nuk ka studiues që merret me gjuhësi e të mos e njohë. Kur shikon me vëmendje të veçantë Fjalorin, vëren, se sa mund të është dashur autorit të mbledhë andej e këndej gjithë atë mori fjalësh dhe sa e çmueshme është puna e tij, sepse ai mbledhi fjalë nga gurra popullore, të cilat përdorshin në atë periudhë nëpër malësira dhe sidomos që kishin një kuptim të ndryshëm, ose nuk gjindeshin fare në Fjalorin e gjuhës shqipe 1954. Këto fjalë sot e pasurojnë dhe e zgjerojnë gjuhën tonë nëse vihen në përdorim.

Nikë Ukgjini dhe Shaban Sinani vënë në dukje në pasthënien e Fjalorit se Dema shpreh njohuri klasike gjuhësore, kujdes të jashtëzakonshëm edhe në renditjen e fjalësit, renditje që është menduar gjatë dhe që bashkon traditën e hartimit të fjalorëve, standarde ndërkombëtare të leksikografisë dhe disa zgjedhje vetjake të tij.

Autori vetë për hartimin e këtij fjalori, u mbështet tek Fjalori i Bashkimit 1908, Fjalorthi i Gazullit, prej fjalëve të rralla të Fishtës e Kanunit të Lekë Dukagjinit.

At Benedikt Dema shprehet: “*Fjalët, qi i kam gjykue si të vjetrueme e sot kalue në mospërdorim, fjalët sinonime të tepërta e shprehjet krejt krahinore e mjaft të kufizueme përkah përdorimi, sikurse ka ba Instituti në Fjalorin e vet, i kam lanë edhe unë jashtë*”¹²⁰.

Ky Fjalor përmban fjalë e shprehje të papërmendura, ose që kanë një kuptim të ndryshëm nga Fjalori i gjuhës shqipe 1954. Në parathënien e librit autori shprehet: “*Përmban fjalë e fraza të paçekuna ase me një vështrim të ndryshëm a të shtuem në Fjalorin e Gjuhës shqipe t’Institutit të Shkencave të botuem në Tiranë, 1954.*”¹²¹

Po japim shembuj duke i krahasur me Fjalorin e sotëm të gjuhës shqipe, 2006, për të pasqyruar se sa këto fjalë mund të integrohen në fjalësin e shqipes së sotme me shprehësi të veçantë:

acar,i- të ftoftë i thatë, fraq (B.D, f. 11). Fjalori i ’54 e jep me dy kuptime: **acar-i** – 1. *i ashpër, i vrazhdë* 2. *i kthjelltë, i pastër, ashpër, pisk ngushtë, e kam punën acar* (F. ’54, f.1), ndërsa Fjalori i 2006 jep një shpjegim më të zgjeruar kësaj fjale: **acar-i** – 1. *të ftohtë i madh, i thatë e me ngrica*. 2. *fig. ashpërsi, vrazhdësi, zemërim; acari*. 3. *fig. shumë i kthjelltë: ujë acar.....acar-* 1. *ashpër, vrazhdë*. 2. *shumë pastër*. 3. *ngushtë, pisk, e ka punën acar* (F. 2006, f.26).

çkallavitë – *me u lëshue, me lëshue vetin* (B.D. f.41). Fjalori i ’54 nuk e ka këtë fjalë, po ashtu edhe ai i 2006.

danik-u -1. *si Fj.,(1954)* 2. *barkushe, secila nder dy gollet poshtrake të zemres nder frymorë* (B.D. f.43). Siç vërehet, përveç kuptimit të parë që është njëlloj me atë të Fjalorit 1954, autori na jep edhe një kuptim të dytë shtesë. Në Fjalorin e 2006, mungon.

dheçkë – *i ndytë* (B.D. f.52). Fjalori i ’54 dhe ai i 2006 nuk e kanë këtë fjalë.

haprrue – *udhtue me shpejti* (B.D.f 83). Fjalori i ’54 dhe ai i 2006 nuk e kanë këtë fjalë.

¹²⁰B. Dema, ”Fjalor fjalësh të rralla të gjuhës shqipe”, Tiranë, 2005, f. 7.

¹²¹B. Dema, ”Fjalor fjalësh të rralla të gjuhës shqipe”, Tiranë, 2005, f.7, (botuar nën kujdesin e Dom Nikë Ukgjinit dhe redaktimin shkencor të Akademikut Kolec Topalli dhe Prof.dr. Tefë Topalli).

kojni – *kursim* (B.D. f.105). Gjithashtu, Fjalori i '54 nuk e shpjegon një fjalë të tillë. Të njëjtën gjë vërejmë edhe tek Fjalori i 2006.

Autori shpjegon qartë, se ku është mbështetur për të krijuar këtë Fjalor:

së pari, në Fjalorin e Bashkimit, 1908

së dyti, në Fjalorthin e dom Nikollë Gazullit, 1942

së treti, prej fjalëve të rralla të veprave të At Gjergj Fishtës e të “Kanunit të Lekë Dukagjinit”

së fundmi, prej disa dorëshkrimeve të vetë autorit, të cilat përmbajnë fjalë që i ka mbledhur vetë autori nga goja e popullit.

Në fund të Fjalorit përfshihet një shtesë fjalësh, të cilën autori e quan “Shtesë e fjalorit të gjuhës shqipe”. Në të përmbliohen fjalë të huazuara nga turqishtja, greqishtja etj, e që sot nuk janë më të nevojshme, ose fjalë të përdorura në krahina të kufizuara të Shqipërisë, të vjetruara, të cilat kanë një përdorim të rrallë.

“Fjalët janë të nxjerruna prej shenjimeve të bame ndër fjalorët e “Bashkimit”, e të D.N.Gazullit, prej fjalortheve të renduem në fund të botimeve të mbrame të Folklorit kombtar”¹²², - citon vetë autori.

Benedikt Dema na la një fjalor krahinor dhe një punë studimore të pasur gjuhësisht, ku vend të rëndësishëm zënë edhe neologjizmat, fjalë të krijuara nga vetë autori, të cilat, sipas tij, janë të rëndësishme për terminologjinë shkencore.

Modestia e tij del qartas në fjalë të tilla:” *Pranimi ose mospranimi i tyne në Fjalorin e gjuhës sonë mvaret edhe këtu prej gjykimit të përbashkët të shkrimtarve shkencatarë*”¹²³.

Përfshihen rreth 284 neologjizma të krijuara nga vetë autori (sipas tij).

Nga ana kuptimore, këto neologjizma i ndajmë në:

fjalë që i pëkasin sferës së bimëve ,psh.:

badrore – *fam.bimësh nifletendse (farëpështjellake) të dame në shenj për lule të mëdha e të hijshme*(D.f.17).

banamore- *fam. bimësh nifletendse(farëpështjellake) deri 9 m e gjatë, qi rriten nder vende subtropikale* (D.f.19).

bargjanore – *rend bimësh i klasës së fletëbimoreve me gema të thjeshtë a të degzuem*(D.f. 20).

bathrore- *fam.bimësh nifletendse, qi pershinë sidomos bimë stolie me lule të mëdha gjithnduer njejeesh e të merme, si bathra e butë e egër luleselikali etj.* (D. f.22).

bazhurore – *fam.bimësh dyfletendse (fletëperçame), zakonisht bimë barore me lang tambluer e t’athët* (D.f. 22).

belkonore- *fam.bimësh dyfletendse (fletëperçame),baroja të gjalla, ujtake* (D. f. 22).

berthamorët – *nëndamje e kërpudhave calikore* (D.f. 23).

bimë shkyese – *klasë bimësh pundilore (talofite) nifytore shum të vogla, këpurdha në veshtrim të hapët* (D.f. 24).

çajore – *fam. bimësh dyfletendese (fletëperçame)* (D.f.38).

çapzore – *fam.bimësh dyfletense (pafletore), baroja e shkurre* (D. f. 39).

djgësore – *fam. bimësh dyfletendse* (D.f.47).

drandofillore – *fam. bimësh dyfletendse, shumica e pemve frytore* (D.f.48). etj.

¹²²B.Dema, ”Fjalor fjalësh të rralla të gjuhësh shqipe”, Tiranë, 2005, f. 245.

¹²³B.Dema, ” Fjalor fjalësh të rralla të gjuhësh shqipe”, Tiranë, 2005, f.8.

Fjalë që i përkasin sferës së frymorëve, psh.:

- brenatytë** – *fam. gjitarësh thundrakorë tëgjinisë së Pertypsave* (D. f.27).
breshkuer – *rend frymorësh i klasës së shterpijve* (D. f.27).
bretkuer – *rend frymorësh i klasës së Dheujtakve a t'amfibve* (D. f.28).
brijuer – *klasë frymorësh detarë e tipit të Bimefrymorve në trajtë të shukthit a të jetullës* (D. f.28).
brucar – *rend frymorësh detarë i tipit të Kordhezarve, të mveshun prej një bruce a manteli likuruer a kercluer-kallnik me dy çilje* (D. f.28).
diellfrymorza – *rend frymorësh i klasës së Kambërrajorve* (D.f.46).
dorëflatruer – *rend frymorësh i klasës së gjitarve* (D. f.47).
dostuer – *rend frymorësh i klasës së Gaforrarve* (D. f.48).
dythundrak – *frymorë gjitarë, qi kanë thundër pllojce, si pertypsatetj.* (D. f.50).
dhjetëkambueri – *fam. frymorësh dyvezhilorë* (D. f.53).
frushkulluer - *rend frymorësh mikroskopikë i klasës së Dikimtarve* (D. f.63).

Fjalë që i përkasin fushës së mjekësisë, sëmundjet etj., psh.:

- fryshani** – *zhvillim i teperm fizik pa perpjestim me moshë (makrosomi)* (D. f.63).
gjaktërheqje – *terheqja e një sasi gjaku, tue pre a therë një dell (flebotopi), ase neper mjet t'ushujzave, te çarkut etj.* (D.f.77).
kundërgulsë – *mjekë kundra gultit (spazmit) a ndrijimit të muskujve* (D. f.112).
kundërpajë – *veprim kundra prajës a infektimit prej mikrobeve etj.* (D. f.112).
kundërpajësë - *mjeti a mjekë qi lufton prajen a infektimin* (D. f.112).
kundërvepruesi – *substancë qi ka veti të pengojë a të neutralizojë efektet e një helmi* (D. f.112).
mojendalesë – *shejní anormale mbas fillimit të mojeve nder emna* (D. f.136).
mosmbamende – *ligshtimi a bjerrja e mbamendjes* (D. f.137).
padhimbje – *ndalimi i ndiejimit të dhimbave* (D. f.151).
pafolje – *mungesa e zanit për shkak të gandimit të fytrecit* (D. f.152).
pagjaksi – *gjendje e lingatueme e cilsueme prej pakimit pak a shum të fortë të rruezave të gjakut* (D. f.152).
paralenyjre – *smundje e afert me lenjyren (tiffin) e barkut, me koleren e me katarrin e zorrve* (D. f.157).

Fjalë që përfshijnë pjesët e trupit psh.:

- brenore** – *likurzë e hollë e synit* (D. f.27).
dykrençi – *dymajç, muskul, qi ka skajime të dame në dy krena te krahi* (D. f.50).
dymbdhetshë - *e para pjesë e zorrve të holla, fillë nen zgrof* (D. f.50).
kundërkikzë – *brokzë e vogël në pjesën e jashtme të veshit, kundruell kikzes* (D. f.112).
kundërvringull – *kodrinë gjatsore në pjesën e jashtme të veshit kundruell vringullit* (D. f.112).
nenshkebozë – *e dyta shtresë e hollë e likurës* (D. f.143).
paratmadhë – *dhambët e mëdhaj mjes dhambve e tmadhve* (D. f.157).
pejzim – *permbledhja e të gjithë pejzave a muskujve* (D. f.161).
plajmthek – *organa thakore mashkullore nder lule të imve plleçilta, qi peftojn plajmthin per riprodhimin e tyne* (D. f.172).
plajmthuer – *pjesa e zgjanueme në krye të plajmthekut* (D. f.172).

qymore – *degzimet ma të hollat, si qyme, të dejve* (D. f.181).
rretore – *pervesha ma e mbrendshme e kokerdhokut të synit* (D. f.188).
rruezak – *apofizat ferrce qi trajtojn kreshten e korrizit të shpinës* (D. f.191).

Fjalë që përfshijnë shpendë të ndryshëm psh.:

çapore – *gjini shpendësh e rendit të Kënetarve* (D. f.39).
glytruer – *flutura të mëdha nate, qi endin një pellhurë të rrastë me fije të mëndashta* (D. f.71).
kambëlikurzuer – *gjini shpendësh e rendit të notarve* (D. f.96).
skjepbutë – *gjini shpendësh e rendit të piskatorve* (D. f.196).
skjepdhambuer – *gjini shpendësh e rendit të trumcave* (D. f.196).
skjepfemuer – *gjini shpendësh e rendit të trumcave* (D. f.196).
skjepkujuer – *gjini shpendësh e rendit të trumcave* (D. f.196).
skjepngulun – *gjini shpendësh e rendit të trumcave* (D. f.196).
pendlagjatë – *gjini shpendësh e rendit të notarve* (D. f.161).

Fjalë që përfshijnë lloje peshqish të ndryshëm psh.:

bajthuer – *fam. peshqish e gjinisë s' Anakantinve* (D. f.18).
bimëfrymueri – *frymorë t'ultë parruzorë, zgorça deti* (D. f.24).
fytreuer – *fam. peshqish e gjinisë s' Anakantinve të rendit të Halorve* (D. f.65).
gishtaflatur – *fam. peshqish e gjinisë s' Akantopterave* (D. f.70).
hanzuer – *fam. peshqish e gjinisë s' Akantopterave* (D. f.83).
korbazuer – *fam. peshqish e gjinisë s' Akantopterave* (D. f.106).
shikëfrymuer – *rend frymorësh i klasës së peshqve* (D. f.205).
levreuer – *fam. peshqish e gjinisë s' Akantopterave* (D. f.118).
pakambuer – *fam. peshqish e gjinisë s' Anakantinve* (D. f.153).

Fjalë të përgjithshme, psh.:

anithyemje – *shgatrimi i anisë me udhtarë mbrendë në mjedis të detit* (D. F.13).
aqanshëm – *akuilateral, i barabartë nder të dyja anët* (D. f.14).
aqfuqishëm – *me fuqi të barabartë, ekuipotent* (D. f.14).
aqvlershëm – *me vlerë të barabartë, ekuivalent* (D. f.14).
aqvlerësi – *vlersim i barabartë, ekuivalencë* (D. f.14).
çanzim – *percaktim, perkufizim, definicion* (D. f.38).
çanzue – *percaktue, dhane definicionin* (D. f.38).
dikim – *derdhje, shprazje* (D. f.46).
ditore – *gjini flutrash qi siellen ditën* (D. f.46).
dhambsi – *rendi i dhambve* (D. f.52).
gjigtarzi – *lendz dymyzer i tejpashem e lastikuer, një nder mjete base të synit* (D. f.79).
jashtafrymsi – *te xjerrunit e frymës jashta mushkënive* (D. f.91).
lapzuer – *golovegjë gjataruqe me dy lapza perane, si të vidhi etj* (D. f.116).
peravullim – *veprimi me të cilin duem të kalojmë mbrenda udhëve të frymsisë një substancë në trajtë të avullit a të gazit* (D. f.162).
pergjinim – *te dhanunit e tamblit amnuer foshnjës qyshë prej lindjes për disa muajt* (D. f.163).

preme – e dame, caktim, gjyq (D. f.175).

qanderiksë – (fuqi) qi matet me i ike qandres së tërhjekjes së vet (D. f.178).

rrëfenim – veprimi i rrëfesë qi i bjen njerit (D. f.188).

strelak –kush asht në gjendje të permirsimit në shëndet mbas një smundje (D. f.199).

strokore – mullaj të butë qi i dalin kalit rreth gilcave të gjunit (D. f.200).

shikendsë – glyteruer (D. f.20).

shikzues – substancë mjekore, qi, e vume mbi likurë, perfton harmatim, tue çue perpjete pjesen e siperme të saj të mbushun me njerk (shikzë) (D. f.205).

shtrivendim – vendimi, me të cilin shtrihet një çdo njeri në shtroje (D. f.213).

Siç vërehet, pjesa më e madhe e këtyre fjalëve, janë të terminologjisë shkencore, të cilat për vetë autorin ishin të një rëndësie të veçantë.

Po t'i bëjmë një klasifikim nga ana strukturore e fjalëformuese, vërejmë një larmi përdorimesh:

Fjalë të formuara me parashtesim:

kunderpraje, kundërvringull, nënshkebozë, paralenjyre, paramajmun, paratmadhe perbase, jashtafrymsi, kundergulse, kunderprajse, kundervepruesi, padhimbje, pafletore, pafolje, pagjaksi, pakambuer, pakrenuer, paramajmun etj.

Fjalë të formuara me prapashtesim:

bazhurore, bërthamorë, bardhore, birzorët, blinore, bordullakoret, brejtar, brenore, breshkuer, brijuer, brucar, brugore, çajore, çanzim, çapzore, ditore, djegsore, dostuer, drandofillore, dhambsi, frymorzi, gaforrar, pështymsi, qetsues, ujtimi, zhardhokore etj.

Fjalë të formuara me parashteso – prapashtesim:

jashtafrymsi, kundërprajse, kundervepruesi, padhambuer, padhimbje, pafletore, pafolje, pagjaksi, pakambuer, pakrenuer, parabimore, parreshtuer, parruezuer, peravullim, perdjersim, perdredhse, pergypzim, pergjinim etj.

Fjalë të formuara me kompozim + prapashtesim:

bimëfrymueri, diellfrymorza, dorëflatruer, flatërkambuer, fletëbashkueme, fletëbimore, fletëpërçame, frytngranse, gishtaflatruer, gojërrotulluer, gurthyesja, gjaktërheqje, gjethtrashore, kambëbarkuer, kambëlikurzuer, kambërrajuer, kanderngranse, lulefrymuer, lulegjuhore, mykoreshkyese, mykorengranse, ujeffrymuer etj.

Fjalë të formuara me përngjitje:

aqanshëm, aqfuqishëm, aqvlershëm, aqvlerësi, dykrençi, dymdhetshe, mosmbamende etj.

Vihet re se, shumica e neologjizmave të krijuara nga Benedikt Dema janë fjalë të formuara me prejardhje (parashtesore, prapashtesore dhe parashteso-prapashtesore) dhe kompozim, ndërsa përngjitja zë një vend relativisht të vogël.

Fjalori krahinor i Benedikt Demës, është një pasuri më tepër në disiplinën e dialektologjisë shqipe, është një pasqyrë e të folmes veriperëndimore të Shkodrës e Malësisë së Madhe, por mbi të gjitha është një gur themeli në leksikografinë e leksikologjinë shqipe.

12. Dema si figurë e dijetarit enciklopedik.

- *Fjalori i B. Demës si maja e ajsbergut e punës vigane mbledhëse e studimore.*

Dema, duke qenë figurë erudite dhe njohësi gjuhëve të huaja, fjalëve shqipe u ka dhënë korresponduesen e tyre në gjermanisht, frëngjisht, italisht e turqisht.

I konkretizojmë me shembujt më poshtë:

abe,-ja – hije. *je ba si abe* (fr. *nuance, degradation de couleurs*; gj. *Schattierung*). (D. f.11)

adhemzë,-a – veme, vemizë, vemsë kandrrash (koleoptere), krymb i vogël (it. *bruchus*). (D. f.11).

agmi, -a – shkelqim, bardhni (it. *candore, candidezza*) (D. f.11).

amball,-i – jamball (turq.), zakarezë (D. f.12). Këtu kemi ndryshimin fonetik të rënies së bashkëtingëllores *j* në fillim të fjalës.

ange,-ja – unt, ijë, të hollë (pjesa e butë e trupit të frymorve mjes koshës e brive (fr. *flancs*, it. *fianchi*, gj. *Weiche*) (D. f.13).

feleke, -ja – gja e mraztë, jallane (it. *vanità*) (D. f.57).

perftaje,-a – flamë, grip, rrufë (it. *influenza, grippe*) (D. f.163).

Gjithashtu Benedikt Dema në Fjalorin e tij iu referua Fjalorit të Bashkimit (1908), nga i cili kemi shumë fjalë, të cilat i ka shënuar me B dhe Bs (për shtojcën e fjalorit të Bashkimit). Po i vërejmë si më poshtë:

aferditë,-a – planeti Venus (D. f.11). Malësia e Madhe përdor “*ylli i drits*”.

agor,-i – prani. – *n’agor të tij: para tij, në prani të tij; pamje* (D. f.11).

ajar,-i – kreshnik, fatos (D. f.11).

ajli – ah! Mjerim (D. f.12).

bajm,-i – bagem, krizam (D. f.17).

ballsue – perballue (D. f.19).

bashkaz – zbashkut, bashkarisht (D. f.21).

dandalle,-ja – vishtirsi, ngatrrësë (D. f.43).

gjinjim,-i – kristalizim (D. f.79).

krandçë,-a – shkurre e vogël (it. *suffrutice*), (D.f.107).

krenzë,-a – nyeth, kryet e shtyllës femnore në lule (it. *stimma*), (D.f.108).

kryemjek-u – kryetari, i pari i mjekve (it. *profisico*), (D.f.109).

lavrak – kular (si ngjarpni), me lakime, valë- valë (it. *ondulato*), (D.f.117).

pelëqorre,-ja – nijfarë loje (it. *gatta cicca*), (D.f.161).

Përveç Fjalorit të Bashkimit, Dema i është referuar edhe Fjalorit krahinor të Gazullit, duke i shënuar simbolikisht me G dhe Gs (shtesa e Fjalorit të Gazullit), psh:

abe,-ja – hije. *Je ba si abe* (D. f.11).

afermeç – neper te, jo gja e sigurte (D. f.11).

afermendësh – afermeç (D. f.11).

ankojë,-a – njeri që s’pushon tue u ankue (mori dhelphen, moj ankojë, shumë anmiq xune me gojë!) (D. f.13).

anshem (i) – 1. FJ. 2. *i skajshëm* (D. f.13).
arsye – *pru në fije* (D. f.15).

Për nga sasia fjalësi i Bashkimit në Fjalorin e Demës është rreth 89 fjalë ndërsa fjalë nga Gazulli kemi 67.

Në lidhje me Fjalorin e gjuhës shqipe 1954, autori është shprehur, se është mbështetur aty, por duke u dhënë fjalëve një kuptim të ndryshëm, ose e njëjta fjalë, por në trajtë të ndryshme.

Po i shohim me radhë disa prej tyre:

adhrim,-i – FJ. *adhurim* (D. f.11). Kemi dukurinë e sinkopës, rënien e *u-së*.
ajrosë – Fj. *ajrue, qitë n'ajr, ba qi të hijë ajri* (D. f.12). Në Malësi të Madhe përdoret “*ajrisë*”
aksh – *dikush, filani; Fj. akësh* (D. f.12).
anshem (i) – 1. Fj.; 2) *i skajshëm* (D. f.13)
aver,-vra – 1. *tokë e çueme përpjetë, tokë e papunueme: asht çue toka aver = asht çue(bymue) toka*. 2. *si Fj.*; 3. *aver pëlhure: vel* (D. f.16).
bigonitë – *folë keq, shprallue (Fj. shpifë)* (D. f.24).
bijtë – *mbijtë (Fj.)* (D. f.24). Këtu kemi asimilimin e togut *mb:b*, dukuri e gegërishtes veriperëndimore, kryesisht së folmes së Malësisë së Madhe.
breshtë – 1. *me u kristalizue*. 2. *si Fj.* (D. f.28).
fashuell,-olli – 1. *si Fj.*; 2. *dala e gjasë së butë, mulla ndezulluer* (D. f.57).
gerhatë – 1. *si Fj. 2. shprishë (janë gerhatë berret ndër shkurre)* (D. f.68).
gojzë,-a – 1 -3. *si Fj. 4. pirat e indzave shkebozore te gjethve nder bimë. 5. dulbze (dergjë berresh), qi u bjen kah turini* (D. f.71). Në Malësi të Madhe kemi, “**gojzë-a** – *nyje, mëgojzë*”.
hutue – 1. *si Fj. 2. venue* (D. f.87).
këmishë,-a – 1. *si Fj. 2. magë etj.*

Siç e shohim autori ka bërë një punë të vyer mbledhëse e studimore në paraqitjen e këtij Fjalori, duke sjellë mbi të gjitha origjinalitetin e tij. Ai nuk ka sjellë fjalë që janë në Fjalorin e 54, por është munduar t'i sjellë një trajtë tjetër dhe me kuptime të tjera, ashtu siç i shohim në shembujt e mësipërm, por edhe siç na paraqiten në Fjalor me plot shembuj të tjerë.

Autori ka përfshirë në Fjalor edhe fjalë nga Gjergj Fishta, por të cilat për nga sasia nuk janë shumë. Psh.:

çekë – 1. *permendë, çitue, xanë në gojë*. 2. *me u ndeshë, shkrepë* (F) (D. f.40).
dalldi,-a – *entuziazëm, kreni, gëzim i madh* (F) (D. f.42).
dallitë – *dá, dallue* (F) (D. f.43).
dijjë – *i dijshtëm, parafolsë* (F), (D. f.46).
fejzë,- a – *gyp i hollë, dell* (F), *shtonë* (D. f.57).
ferfillue – 1. *si Fj. 2. ba një punë shpejt e dosido*. 3. *vezullue, shndritë* (F) (D. f.57).
karrapucakue – *me u mbledhë dyfish, germuq* (F), (D. f.99). Malësia e Madhe e përdor edhe si ndajfolje, “**karrapue** – *mbliidhen kruspull*”.
kimezi – *qymezi* (F), (D. f.103). Këtu kemi ndryshime fonetike, si **k:q** (dukuri e gegërishtes verilindore) dhe **y:i** (dukuri e gegërishtes qendrore, por edhe e toskërishtes jugore).
ktheterkuks – *me kthetra krrute, të lakueme* (F), (D. f.110).
kurne - *me u çue tallaz* (F), (D. f.113).

pershî,-ja – *hapsi, shtuell* (F), (D.f.166).

pîtë - *pitás, ngathtas* (F), (D.f.171). Vërejmë kalimin e grupit të bashkëtingëlloreve **mp:p** (mpitë : pîtë).

prujtun,-it – *poshtnim* (F), (D. f.176).

rëmaj – *vend i çilun për vorreza; vorr* (F), (D. f.184).

rradhe,-ja – *ushtri* (F), (D. f.186).

shtjellë – 1. *si Fj. 2. ngrehë, naltue; value, valavitë* (F), (D. f.213).

zatuer – *i kumueshëm* (F), (D. f.239).

Siç e vërejmë, gjenden 17 fjalë nga leksiku i Fishtës në Fjalorin e Demës.

Tjetër element i rëndësishëm, që nuk duhet lënë pa përmendur, është se autori në fund të fjalorit, ka si kapitull më vete, një tubë fjalësh, siç shprehet ai, “*Shtesë e Fjalorit të gjuhës shqipe*”.

Këto fjalë sipas Demës, janë huazime nga turqishtja, greqishtja, të cilat sot nuk janë të nevojshme, ose janë fjalë të përdorura në krahina të kufizuara të Shqipërisë, ose fjalë të vjetruara, që nuk përdoren më. Këto fjalë, autori i ka vendosur më vete, në mënyrë që të mos ngatërrohen me leksikon e përgjithshëm të gjuhës shqipe.

Fjalët janë të nxjerra nga Fjalori i Bashkimit, i Gazullit, si dhe prej fjalorthëve të *renduem*¹²⁴ të Folklorit kombëtar. Afërsisht numërohen rreth 2436 fjalë, ku pjesa më e madhe prej tyre janë fjalë të huazuara nga turqishtja, një pjesë fare e vogël janë nga greqishtja, të cilat i ka shënuar me gr., dhe nga mbledhja e Folklorit kombëtar.

Siç e theksuam pjesa më e madhe janë nga turqishtja. Po i marrim në shqyrtim duke përmendur disa prej tyre dhe duke i bërë një ballafaqim edhe me Fjalorin e orientalizmave të Tahir Dizdarit.

akllek,-u – *të nryem fëtyre* (D. f.247). Tek Dizdari e kemi me të njëjtin kuptim, **akllek-u** – *Shkodër e rrethe: mjet kozmetik, krem bardhë i ndrequn me voj ullini, gëlqere e zhivë, ose me tëlyen të pashkrimë, zhivë e bjakë, me të cilin para 20-30 vjetëve – edhe deri tashti vonë nëpër fshatra të rretheve të Shkodrës e të Shqipnisë së Mesme ngjyeshin fytyrën nusët myslimane të qytetit dhe tëkatundeve; të bardhët, sqafidh; dërti* (F.O. f.14).

akshi,-a – *kuzhinjer, pjektúr* (D. f.247). E ndeshim me të njëjtën trajtë tek Fjalori i Orientalizmave, 2005, **akshi-u** – *Veri; ahçi, akçi Jugë; ai që ushtron zejen e gatuemjes së gjellënave pranë një konaku ose dërkoreje; gjellëbamës, gatonjës* (F.O. f.16).

allaxhakli,-a – *kreditor* (D. f.247). Po kështu e kemi tek F.O., 2005, **allaxhakli – u** – *Shkodër; uhadhanës, kreditor* (F.O. f.24).

babagjan, i - *burrë bujar, i fuqishëm* (D. f.249). E ndeshim me të njëjtin kuptim, **babaxhan-i** – *burrë i pa të keq e i dashtun; trim, i zoti* (F.O. f.52).

badem, -i – *karamel, sheqer* (D. f.249). Tek Dizdari e kemi me të njëjtin kuptim, por në trajtën e shumësit, **badêma-t-** *Shkodër para 35 vjetësh: sheqerlleke, kufeta* (F.O. f. 53).

bajagi – *mjaft, shum* (D. f.249). E gjejmë me të njëjtën trajtë e kuptim **bajagi** – *fjalë e të folmes së Shkodrës për “mjaft, gadi shumë, bukur mirë”* (F.O. f.57).

bazyret,-i – *dukë, fëtyrë* (D. f.250). Dizdari e përdor në një trajtë tjetër, por me të njëjtin kuptim, **basyret-i** - *Shkodër – ana muslimane; basret Shqipëri e Mesme;*

¹²⁴B.Dema, “Fjalor fjalësh të rralla të gjuhës shqipe”, Tiranë, 2005, f. 245.

bazret Mat, Kurbin, bazaret në fjalorin etim. të Meyerit 30. Fytyrë; dukë; çehre; faqe (F.O. f.71).

bellí – *kjartas, ballafaqe*. Tek Dizdari e kemi me këtë formë, **belí** – *haptas, faqeza; me të saktë* (F.O. f.93).

bezdarah (me dalë) – *me zmadhue* (D. f.251). Tek Dizdari e kemi të shpjeguar me fjali dhe me në formë tjetër, **beshdarah** – “*mos t’hapet edhe ma fort neper popull me dale tepri beshdarash* (F.O. f.98).

çapraz,-i – *stringel* (D. f.253). Në Fjalorin e Orientalizmave e kemi në numrin shumë, **çapraze- t** – *gjithçka që veht e mberthehet për së kithi, shkarthi, tërthuer. Jelek ose anteri dy kapakësh që mbërthehen për së kithi. Rryp fyshekësh, pallaska, armë etj. që ngjeshen e barten tërthorisht. Stolisje me qostekë sermit e vargje me monedha metalike, të varuna në mënyrë rë tërthortë...// toka, pare të vjetra që varin për stoli katundaret tona të viseve të Jugut; stringëla* (F.O. f.150).

çehresuz – *çeftuz, mrrodh* (D.f.253). Tek Dizdari e ndeshim **çehresëz-e** – *në Shkodër çehresyz: fytyrëvrantë, tureçkan, buzëpaqeshur, i ngrysur, turivarë, i mvrejtur, i zymtë, i mrrolun, i murdhizun, çeftuz, merdostë (Gazulli), vramuz (Bashkimi), qeremus (Cordignano)* (F.O. f.159).

çyryk – *pingil, me gand, i prishun* (D. f.254). Në Fjalorin e orientalizmave të Tahir Dizdarit e kemi **çyryk-e** – *kudo në Veri pjesërisht edhe me këthim të y:u çuruk: gja e prishun, e gandueme, e gjymtueme, ngelun me cen, që i ka hy ixhrami, me të metë* (F.O. f.183).

derexhë,-ja - *shkallë, gradë* (D. f.255). Me të njëjtën formë dhe kuptim e kemi tek Dizdari **derexhe-ja** – *Jugë, Shqipni e Mesme por në Veri me theks të çvendosun derexhe: gradë, shkallë, qokë* (F.O. f.205).

dynjallek – *praktikë, përvojë* (D. f.256). Tek Dizdari e kemi pothuajse me të njëjtin kuptim, **dynjallek-u** – *Jugë: gjendje, situatë ekonomike; gjind, hallk; të vaditun, botkuptim* (F.O. f.239).

exhel,-i – *egjel, dekë e paracaktueme, ka exhel: me nxitim* (D. f.258). Tek Fjalori i Orientalizmave e kemi, **exhel-i** – *kudo: në Shqipni të Mesme me epentezë të një nazali dental enxhel, dhe në anën katolike të Shkodrës, si ç’e ka zakon për fjalët e burimit turk me zbutje të afrikatës egjel: çasi i vdekjes, që në vështrim të besuemit musliman, asht i fiksuem prej Providencës çë prej lindjes* (F.O. f.260).

ezhderhá,-ja – *kutsheder, trim i madh, drangue* (D. f.258). Me të njëjtin kuptim e kemi edhe tek Dizdari, **ezhdërha-ja** – *figurë e besimit popullor që përfytyrohet si kulshedër*, Fgjsh 111, (F.O. f.262).

gerbet,-i – *mergim, largim* (D. f.260). Dizdari e jep me të njëjtin kuptim **gërbet-i** – *në tosk. me kalimin e velarit nistor g:k kurbet: largim nga vendlindja, shtegti në dhe të huej, mërgim* (F.O. f.294).

galip (me ardhe) – *me pushtue* (D. f.260). E gjejmë me të njëjtën trajtë tek Dizdari, **galip** – *Shkodër e ngjeti: me ardhë galip: me mujtë kënd, me ia dalë kujt, me i marrë shinë* (F.O. f.290).

gjehenem,-i – *ferri* (D. f.261). Tek Fjalori i Orientalizmave e ndeshim me **xh, xhehenem-i** – *Jugë; në Veri me sikopë xhehnem; diku tjetër dhe xhenem: 1. skëterrë, ferr, pisë (Weig.), hadhë (Bus), kolas (çekrezi), gërrom (Leotti), ferr-fika (Prezë)*, (F.O. f.1104).

gjymryk,-u – *doganë* (D. f.261). E ndeshim në të njëjtin kuptim edhe tek Dizdari, **gjymryk-u** – *tagër që paguhet për mallin që importohet nga një shtet në tjetër// zyra fiskale e ngarkueme për të nxjerrë dhe për të arkëtue këtë taksë; doganë* (F.O. f.316).

gjytrym – *koçiram, garravaç, galamsh* (D. f.261). Tek Dema e kemi me sinkopë ndërse në Fjalorin e Orientalizmave e kemi: **gjytrym-e** – *Shkodër, (ana muslimane)*,

gjytrym (ana katolike): i mbledhun gjymtyrësh, i ngelun lëmuç, garumull (Dibër), shuk (Tiranë), truç, garravaç (Shkodër), ulok, kruspull, galamash (F.O.f.319).

halabak – *kallabak (D. f.262). Dizdari e shpjegon nëkëtë mënyrë, halabak-u – Shkodër, Shqip. e Mesme: kabahe i ultë në sjellje; zhgatarraq që s'din të veshet e tëruej rrobat e shtatit; tra i palatuem, latura që siellet poshtë e përpjetë (F.O. f.336).*

hamam,-i – *banjë (D. f.262). E ndeshim me të njëjtin kuptim edhe tek Fjalori i orientalizmave hamam-i – kudo: në Berat me errësimin e a-së tonike hamëm: banjë allaturka; ngrehinë banjosh të nxehta (F.O. f.345).*

insanijet, -i – *njerzi (D. f.265). Tek Dizdari e kemi në këtë formë, insan-i- njeri, mb. i njerëzishëm, i arsyeshëm, i formuem si lypset me sjellje të mira e karakter (F. O. f. 420).*

ilmxhi – *dijekeq, dinak, sherr (D. f.265). E ndeshim tek Dizdari me disa kuptime, dhe nga forma e kemi pa prapashtesën –xhi, ilëm-i – dituni, shkencë. Me këtë kuptim në krejt truëllin shqiptar nëpër qytete sidomos deri para 35 vjetësh..... ilm-i – “dinakëri, kopili”; ilaxhi, ilmtar “dijekeq, dinak, kopil”, ylmexhi “ i shtimë, me dy faqe, rrencak, qi ka dhambët e bardhë e shpirtin e zi (F.O. f.415).*

isharet, -i – *shenj (D. f.265). Me të njëjtin kuptim e kemi edhe tek Fjalori i Orientalizmave, isharet-i – shenj, gjest që bahet me sy, me dorë, me buzë, me krye, për të dhane me kuptue o me tregue diçka; nojmë të cekun; gjasë; shejni; njeftshë; gjasë, ramje, simptomë; sinjal (F.O.f.428).*

itibar, -i – *çmim, nderim (D. f.265). Tek Dizdari e ndeshim në këtë formë dhe me me shumë kuptime itibar-i – ma të shumtën diku dhe me epentezë të guturaleve velarë – h- apo –k- ihtibar, iktibar: nder, randë që ka një njeri në marrëdhanye me botën, në vertyt të cilsive të tija morale a të zotsisë mendore; stimë, përfillje, besim, konsideratë, çquarsi, reputacion, sajdi (F.O. f.429).*

itat,-i – *bindni, nderim (D. f.265). Tek Fjalori i Orientalizmave e ndeshim me dyfishimin e zanores a, itaat-i – bindje, nënshtrim, ndigjesë, përvujtëni (F.O. f.429).*

jací,- a – *muzg (D. f.267). Tek Dizdari kemi një shpjegim më të hollësishtëm të kësaj fjale, jaci-ja – të falunit e mrâmë që ushtrojnë besimtarët muslimanë dy orë mbas përdimit të diellit; darkë-herë (F. O. f.434).*

jarebí – *zot! Vah! (D. f.267). Në Fjalorin e Orientalizmave kemi një shpjegim të tillë, jarabi!,jarebi!- o Zot, Perëndija ime; vall a thue”. Shprehet në urime, në bêt, në përgjërimë, në namatime etj. (F.O. f.443). Malësia e Madhe përdor trajtën “jarebil”.*

juzbash,-i - *jyzbash, kryetar mbi 100 vet, zyrtaz (D. f.268). Tek Dizdari e ndeshim në trajtën, jyzbash-i – kryeqindës, kapiten, komandant kompanije në ushtri (F.O. f.461).*

kallaus,-i – *prisë (D. f.269). Dizdari na jep një shpjegim më të detajuar të kësaj fjale, kallauz-i – ai që u difton udhen të tjerëve, sidomos ai që kët punë e ban me qëllim të keq; prisë, hjekës në hajni etj., kapucar (F.O. f.483).*

kaftan,-i – *zhybe e qindisun qi përdorshin dikur funksionarët turq (D. f.269). Në Fjalorin e Orientalizmave e kemi, kaftan-i – rrobë e gjatë prej kumashi të kuq dhe me gëzof përbrenda; e vishnin burrat në të kremte të mëdha dhe në ditë të shënuara (F.O. f. 472).*

maraz,-i – *mllef (D. f.274). Tek Dizdari e kemi në disa kuptime, maraz-i – 1. inat, mllef, duf, smirë, nezë, mëni, iri, urretje, tângë, brengë, pek, të brejtun. 2. ke Miklosich dhe Meyer, sëmundje, të ligështuem. 3. me kuptimin e sëmundjes “coccolino, catarro d'infreddatura”, Rossi VIE 108; “të kuqt e madh” në Lurë sipas Q. Haxhihasanit BUSHT. 4. marazue (me, me u-)”me u spërtkeqë...(F.O. f. 617).*

matrapaz,-i – *çikrrimtar (D. f.274). Fjalori i Orientalizmave e shpjegon matrapaz-i – me shurdhim të okluzivit dental dhe të atij bilabjal në silabë të parë e të tretë: shitblemës pa cak, kambësuer, endacak, që blenë e shet aty për aty, pazarak (Berat),*

fig. njeri joleal, krajtari, që përpiqet të fitojë lekun në mënyrë jo të ndershme, por në shpinë të tjetrit e të shoqnisë (F.O. f.625).

mixhidë,-a – *pare argjendi si frang* (D. f.275). Tahir Dizdari na e jep me **e**, **mexhidi-ja** – *Kosovë, ambigjene pse në Shkodër mexhid-i (ana muslimane), mixhid (ana katolike); në Shqipni të Mesme mexhide-ja, në Jugë mexhite, meçite, (tashma e vjetruem): monedhë sermit e madhe në kohën e sundimit osman me vleftë 23 grosh të vjetër, 20 grosh të ri, baras me fr. 4.21 (një e pesta e lirës), që ka qenë shtypë nen mbretin e Sulltan Abd'el Mexhidit* (F.O. f.652).

nafakë, -a – fat, orë (D. f.277). Tek Fjalori i Orientalizmave e kemi me të njëjtat kuptime, **nafaka-ja** – 1. *shumë mujore e caktueme nga gjykata e Sheriatit për jetesën e grues së ndame ose të jetimave nen tytori, prej totalitetit të gjasë qi trashigojnë ose prej ndo i fondit bamirë. 2. (me kët vështrim të dytë s'e kanë asnjana nga gjuhët uhazuese) Veri: rrisk, baft, mirësi, mbarësi...*(F.O.f.695).

Në gegërishten veriperëndimore gjenden edhe formimet me kompozita, si *nafakmadhe, nafakzi/zezë, nafakbardhë*.

nahie,-a – *krahinë, vis* (D. f.277). Edhe në Fjalorin e Orientalizmave e ndeshim me të njëjtën trajtë dhe kuptim **nahi-ja** – *kudo në trajtë të apokopueme: krahinë, qark, vis treve, pejë, ngastër, zonë* (F.O.f. 697).

nizam,-i – *urdhen, mbarshtim* (D. f.277). E ndeshim në disa kuptime, **nizam-i** – 1. *rend, rregull. 2. ushtar i rregullt në kohën e sundimit osman. 3. nizamçe, petka, rrobe nizamçe (petka “ të zeza” si çu thuhej asokohe), rrobe civile, setre pantoll, jo veshë kombëtare. 4. nizameshë, Shkodër në kohën e sundimit osman, në gropë të Shkodrës e vilejetit që ishte, thireshin kështu gratë tyrke të funksionarëve, të oficerave e nëpunsave tjerë, që përbaishin një shumicë në vetvete, të cilat përposë gjuhës, dalloheshin nga vendaset shqiptare si në veshmbathje, në tualet, në sjellje delikate. 5. nizamisht, para 50 vjetësh ka qenë përdorë sallde për veshjen e grave në Shkodër. 6. shumë familje (po në Shkodër) që kishin ndonji pjestar nëpunës shteti ose në rangë të oficerave, dhe ashtu të veshun me petka të zeza nizamçe...* (F.O.f. 719).

oxhakzade – *fisniki, bujari* (D. f.279). Në Fjalorin e Orientalizmave e kemi me të njëjtin kuptim **oxhakzade** - *fisnik e bir fisniku* (F.O. f.737).

paçariz,-i – *pështjellim* (D. f.280). Tahir Dizdari na e jep në këtë formë **paçariz-i** – *përzimje, gjurulldi, rrëmujë, tollovi, konfuzion; të përpushun* (F.O. f.738).

qylah,-i – *plis, kësulë* (D. f.282). Tahir Dizdari jep një shpjegim më të hollësishëm të kësaj fjale **qylah-i** - *Veri; në Jugë e Shqip të Mesme dhe me labjalizim të h-së fundore qylaf; në Dibër qilaf: 1. kësulë e bardhë, e naltë, me një bisht të vogël pësipër, që importohet së jashtmi. Kjo kësulë me cipë të lëmuet bante pjes në kostumin kombëtar të qytetit të Shkodrës (ana muslimane), të krahinave të Anës së Malit, të Krajës së Kastratit e deri diku nder shtëpija të para edhe në Hot, Grudë, Shkrel.* (F.O. f.818). Në Malësi të Madhe ndeshim trajtën “qylaf” (ndryshimi fonetik i **h:f**).

qylym,-i – *plaf, paste* (D. f.282). Tahir Dizdari jep dy variantet **qilim, qylym** – *Jugë; Dibër, dhe tue labializue të dy i-të qylym në Veri e Shqipni të Mesme; në Mat qulim 1. shtroje, ma së forti e leshtë, e punueme në vegjë të posaçme ose në avlliment, me madhësi e ngjyra të ndryshme që shtrohet në dysheme të këthinave dhe nëpër minderë, pef, belce, shag. 2. në krahasim të halisë (sharqoje, një copet, ose disa polash), qylym në Shkodër konsiderohet i dorë së dytë e jo me itibar, dhe ashtu deripak parandej ka pas ba pjesë në pajen e nuseve shtëpijash dorëholla* (F.O. f.808).

redif,-i – *ushtar rezervë* (D. f.284). Të njëjtin kuptim kemi edhe tek Fjalori i Orientalizmave **redif-i** – *ushtar rezervet, rezervist* (F.O. f.835).

saber,-bri – durim (D. f.286). Tahir Dizdari e shpjegon në këtë mënyrë, **saber-i** – *vetia e atij që heq një vuajtje a të keqe pa u qa e pa e lëshue vehten; vetia e atij që pret me qetësi një gjë që vonohet. Durim, zemërgjerësi, tolerancë* (F.O. f.853).

safi – *thjeshtë, vetëm* (D.f.286). Me të njëjtin kuptim e ndeshim edhe në Fjalorin e Orientalizmave **safi** – *i papërzier me gjë tjetër, thjesht, neto puro, firuet* (F.O.f. 856).

sefer,-i – luftë (D. f.287). Autori e jep me “*te tana vështrimet që ka në turqisht*”¹²⁵, **sefer-i** – 1. *udhëtim, shtegëtim, lundrim nëpër det*. 2. *luftë, spedicion për luftë*. 3. *herë, radhë*. 4. *sefereja, në katune të Shqipnisë së Mesme: pjatë bakri e rrafshët, me thepa anash që përdoret për të shprazëgjellë*. 5. *seferisht, Shkodër, udhetarisht, gerbetçisht*. 6. *se-ferje fshat në rreth të Kavajës* (F.O. f.888).

sheher,-hri – *qytet* (D. f.289). E kemi me të njëjtin kuptim edhe tek Tahir Dizari, **shehër** – *qytet i madh, ma i hapte e i populluem se kasabaja; qendër qeveritare, tregtije e trafiku* (F.O.f.958).

shigajet,-i – *ankim* (D. f.289). Tek Dizadri e kemi në një trajtë tjetër, por kuptimi i njëjtë, **shiqajet** – *ankim, vaj, qamje* (F.O. f.971).

tamah,-i – lakmi, dishir (D. f.291). Në Fjalorin e Orientalizmave e gjejmë me të njëjtën trajtë, **tamah-i** – *Veri, Jugë; në Shqipni të Mesme me ramje të spirantit fundorë, tue analizue a-në theksore dhe në gjininë fem. tamâ-ja ka edhe tamaf: lakmi, sy-untës, dorështërnguetësi* (F.O. f.992).

veqil,-i – *zavendsë, prokurator* (D. f.296). E kemi të sqaruar më qartë tek Fjalori i Orientalizmave, **veqil-i** – 1. *ai që zen vendin e titullarit të një zyre, kur largohet e shpërngulet ky, derisa të vijë titullari efektiv, ose të emnohet një tjetër; zavendës, përfaqësues, mëkambës, i deleguem* (F.O. f.1085).

xhymlet,-i – *grumbull* (D. f.297). Me të njëjtin kuptim e ndeshim edhe tek Fjalori i Orientalizmave **xhymle** – *krejt, krejt si jemi, grumbull, varg, të tanë bashkë* (F.O. f. 1128).

Gjithashtu ka dhe një numër fjalësh, më të pakta, nga greqishtja. Po i rendisim me radhë:

dheksë – *pranue* (D. f.257)

dhiataí,-a – *urdhen, dekret* (D. f.257)

dhiavatë – *lexue* (D. f.257)

dhiori,-a – *afat* (D. f.257)

dhioritë – *caktue, urdhnue* (D. f.257)

eftis – *menjiherë* (D. f.258).

fimeridhë,-a – *gazetë* (D. f.259).

evjenjë,-a – *fisniki, bujari* (D. f.258).

ipurgo – *ministër* ((D. f.265).

therjo,-u – *bishë, egësi* (D. f.294).

thisavro – *vizar, thesar* (D. f. 94).

¹²⁵T.Dizdari, ”Fjalori i Orientalizmave në gjuhën shqipe”, Tiranë, 2005, f.887.

Kjo tregon se At Benedikt Dema paraqitet si zotërues i mirë i gjuhëve klasike si greqishtja e latinishtja, por edhe i gjuhëve të qytetërimeve të reja si italishtja, frëngjishtja dhe gjermanishtja.¹²⁶

Nuk duhet lënë pa përmendur edhe “*Fjalori i fjalvet të rralla shqipe e i fjalvet të hueja të përdoruna në veprën e At. Gjergj Fishtës*”¹²⁷ nga At Benedikt Dema, pasqyruar në “Lahutën e Malcis”, botimi i XV nga At Zef Pllumi. Ky fjalor përmban 1631 fjalë nga të cilat pjesa më e madhe janë turqizma dhe një numër të vogël e përbëjnë fjalë të burimit sllav e grek.

Vend me rëndësi në Fjalorin e Demës zënë edhe frazeologjizmat, të cilat e pasurojnë edhe më tepër gjuhësisht veprën e tij, por edhe japin një pasqyrë më të thelluar të dialektit veriperëndimor, përmes varianteve dialektore të përdorura. Dema nuk është se ka përdorur ndonjë shenjë përkatëse në ilustrimin e tyre, por i kemi gjetur në sajë të shpjegimeve që u ka bërë autori leksemave të veçanta. Vërehen mirëfilli se shumica prej tyre janë variante dialektore ose edhe frazeologjizma krahinore, të cilat zënë vend përdorimi vetëm në disa krahina të caktuara dhe vështirë t’i ndeshim të shpjeguar në Fjalorët e shqipes e sidomos në atë të Frazeologjizmave.

Po i vërejmë disa nga ato duke bërë një përjasje me Fjalorët e gjuhës shqipe 1954, 1980, 2006, si dhe Fjalorin e Frazeologjizmave të Jani Thomait.

ader-dra – *llafe, fjalë kote, pallavra, dokrra, shaka: Me qite (thye) adra: me ba llafe koti (kote), (D. f.11)*. Tek Fjalori Frazeologjik nuk e gjejmë me të njëjtën trajtë si tek Dema, por kemi sinonimen e saj, **çan dokrra** (dikush) – *çan dërrasa* (dikush), ose mund të kemi edhe një tjetër frazeologjizëm sinonim me këtë, (thotë) **dokrra në hi** – *flet kot, as vetë nuk e di se ç’thotë, flet gjepura* (FFGjSh, f.80).

me i marre kuj anen – *me u largue prej kuj, me e shikjue jo me dashtni* (D. f.13). Me të njëjtin kuptim që ka dhënë Dema nuk e ndeshim tek Fjalori i Frazeologjizmave (2006). Gjithashtu nuk e ndeshim as në Fjalorin e gjuhës shqipe, 1980.

me qite kend manesh – *me e da prej tjerve (per me folë veçmas etj) (D. f.13)*. Ndajfolja **manesh** nënkupton më anash, krahinorizëm që përdoret në gegërishten veriperëndimore, zona e Malësisë së Madhe – 1. *anash, mane, mënjanë, njananë. 2. veças të tjerëve, damas. 3. mbanë. 4. mënjanë; larg syve të dikujt* (FGjSh, Mehmet Elezi, f.873). Në Fjalorin Frazeologjik të Jani Thomait nuk e ndeshim si të tillë, me të njëjtin kuptim, por takojmë në këtë formë, **e nxjerr në anë** – 1. *dikë a diçka. E shpëtoj nga një e keqe, e ndihmoj të kapërcejë vështirësitë. 2. diçka. E përfundoj, e çoj deri në fund, e kryej me sukses* (FFGjSh, f. 5).

me ra manesh – *me ra perbri* (D. f.13). Këtë frazeologjizëm nuk e ndeshim të shpjeguar në këto Fjalorë. Gjithashtu edhe Fjalori i gjuhës shqipe 1980, nuk e ka si fjalë, sepse kemi të bëjmë me një krahinorizëm të mirëfilltë të zonës veriperëndimore.

me i dale manesh – *me i dale në krye, me e krye* (G.), (D. f.13). E ndeshim thuajse me të njëjtin kuptim tek Jani Thomai, **dal në anë** - *shpëtoj nga një gjendje e keqe; kapërcej një vështirësi; ia dal në krye (diçkaje)* (FFGjSh, f. 4).

me u çmekë së ngranuni, jam çmekë gazi – *me ba një veprim në tepri* (D. f.41). E ndeshim tek Mehmet Elezi, **çmek/em** – *me u çmekë (prej ç + mekem), lodhem së ngrëni, më merret fryma. “ m’u çmekë së ngranëmi”* (Gazulli), (FGjSh, Mehmet Elezi, f.314). Sipas Elezit, Dema e ka të huazuar nga Gazulli këtë frazeologjizëm.

¹²⁶ N.Ukgjini, Sh. Sinanaj, ”At Benedikt (Mark) Dema, Fjalor fjalësh të rralla të gjuhës shqipe”, Tiranë, 2005, f.307.

¹²⁷ B.Dema, “Fjalori i fjalvet të rralla shqipe e i fjalvet të hueja të përdoruna në veprën e At Gjergj Fishtës, Lahuta e Malcis”, Botimi XV, Botime Françeskane, Shkodër, 2006.

gjujzue – me iu ulë kuj nder gjuj (D. f.80). Ndonëse si frazeologjizëm është tepër i përdorur në ligjërimin e përditshëm, nuk e gjejmë të përdorur në Fjalorët e përmendur. E ndeshim në Fjalorin e Gjuhës Shqipe, 1980 në dy kuptime, **gjunjëzohem**- 1. *bie ose ulem në gjunjë para dikujt a diçkaje, përgjunjem* (FGjSh, 1980). 2. *përulëm para forcës së dikujt, e pranoj veten të mposhtur, bie në gjunjë; kërkuj mëshirë; përgjunjem* (FGjSh, 1980).

me hjekë mirë/keq – *me jetue mire / keq* (D. f.86). Me të njëjtën formë nuk e ndeshim, por kemi sinonimen e saj tek J. Thomai, **bëj jetë** - *jetoj në kushte të mira, rroj mirë* (FFGjSh, f.212). Në Malësi të Madhe gjejmë kompozitën” **hjekakeq-e**”.

me e hjekë me krye (gjindë) - *me e pague një faj me jetë të vet a të gjindve të shpisë* (D. f.86). Kemi sinonimin e saj te Fjalori Frazeologjik, **i iku (shkoi) kryet** – *i iku (shkoi) koka dikujt* (FFGjSh, f.262).

kacanelë – marrë hov (D. f.93). E kemi si të tillë, **merr hov** – *nis të zhvillohet a të veprojë me vrull, ngrihet e përparon më me forcë* (FFGjSh, f.202).

kushatisë – çue dam krejt (D. f.114). Të njëjtin frazeologjizëm e kemi edhe tek J. Thomai, **e bën (e çon, e hedh) dëm** – 1. *e prish kot, nuk ia shfrytëzon vlerat, e harxhon kot, nuk e vë në punë, nuk e shfrytëzon*. 2. *e vret* (FFGjSh, f.72). Vërejmë se Fjalori Frazeologjik jep një kuptim të dytë të këtij frazeologjizmi, që nuk e ndeshim tek Dema.

lbyrë – me u mbledhë vra, marrë syshë, me rru dhë sytë (prej drite), me vu perde sytë (D. f.118). Me kuptimin e Demës e ndeshim tek Fjalori Frazeologjik si, **më merren sytë** – 1. *më turbullohet vështrimi, nuk shoh mirë; më vishen sytë*. 2. *gënjehem pas dikujt a pas diçkaje, më duket i bukur e mashtrohem, nuk e vërej mirë, nuk e shoh siç është në të vërtetë* (FFGjSh, f.449). Vërejmë se vetëm kuptimi i parë përkon me atë të Demës.

maraz – me u çue toka maraz (D. f.129). Këtë frazeologjizëm nuk e ndeshim në këto Fjalorë. Në Fjalorin e Gjuhës Shqipe, 1980, e takojmë si fjalë të ligjërimin bisedor, por si frazeologjizëm nuk ekziston dhe kuptimi nuk na përkon me atë të Demës, **maraz-i** – 1. *ndjenjë munduese që lind nga dëshira e madhe për të pasur diçka që e ka dikush tjetër ose për t’ia kaluar dikujt, smirë, inat*. 2. *hidhërim, brengë* (FGjSh, f.1058).

me i ra mohit – me mohue (D. f.136). Me të njëjtin kuptim e ndeshim tek Mehmet Elezi, **me ra moh** – *me mohue* (FGjSh, Mehmet Elezi, f.932).

qellue – me i ra shenjtit (D. f.179). E ndeshim tek Fjalori Frazeologjik me të njëjtin kuptim, **i ra në shenjë** – *gjeti pikërisht atë që kërkohet, preku thelbin e çështjes; e pa a e kuptoi atë që duhej; qëlloi (goditi) në shenjë; i ra në të; i ra pikës; i ra në fije; i ra në teste; i ra në qokë* (FFGjSh, f.459).

qepue – me u shkri e me u ba një (D. f.179). E kemi tek Fjalori Frazeologjik, **është bërë një** (me dikë) – *është lidhur shumë ngushtë me dikë dhe bashkëpunon me të; është njësoj si ai* (FFGjSh, f.349). Pra, kuptimi është i njëjtë, ndonëse jo me të njëjtën trajtë, siç e ka përdorur Dema.

rrillue - marrë mendësh kendin (D. f.189). Jani Thomai, ashtu si Dema jep të njëjtin kuptim për këtë frazeologjizëm, **ia mori mendtë** (dikujt) – *e bëri për vete me lajka e lëvdata; e magjepsi* (FFGjSh, f.314).

rripue – me u ba rryp (D. f.189). Një frazeologjizëm të tillë nuk e ndeshim as te Jani Thomai, e as te Fjalori i Mehmet Elezit. Mund të themi se ka mbetur në kuadrin e një frazeologjizmi krahinor. Malësia e Madhe përdor formën “**rrypohet**”, me ndërrim fonetik të **i:y**.

sfitë – me qitë mund (D. f.194). Këtë frazeologjizëm nuk e ndeshim tek Fjalorët e sipërpërmendur.

skorrjatë – fikë uje (D. f.196). Këtë frazeologjizëm nuk e ndeshim tek Fjalorët e sipërpërmendur, ndonëse në ligjërimin bisedor gjen mjaft vend përdorimi.

me mbetë shah – *me mbetë ngri, me u çuditë, marrë mendësh* (D. f.202). Këtë frazeologjizëm nuk e ndeshim tek Fjalorët e sipërpërmendur. Gjejmë një shpjegim të detajuar të kësaj fjale tek Fjalori i 1980, **shah** – 1. *duke qëndruar vetëm mbi këmbët e prapme, arithi, qirithi (për kafshët si kali, ariu); drejt përpjetë për sendet; shahthi. 2. shtang. mbeti shah. 3. fig. vetëm, pa njeri, shkretë* (FGjSh, 1980).

shkondendue – me ia prishë qejfin, zemrën (D. f.207). E kemi me të njëjtën trajtë e kuptim tek Fjalori i Frazeologjizmave, **ma prishi qejfin** (dikush) - *nuk ma plotësoi dëshirën; më mërzi; më zhgënjeu; ma prishi zemrën; ma theu zemrën* (FFGjSh, f. 402).

shkrehtue – folë kot, pa u matë (D. f.207). Jani Thomai e përdor si të tillë, **(flet) kot më kot** (dikush) – *flet kuturu, nuk i peshon fjalët* (FFGjSh, f.256).

me shkrepë synin – me e luejt bishtin e synit për me i ba shenj kuj, mbyllë sytë (D. f.207).

me ba shenj me sy – *me çilë e mbyllë synin shpesh* (D. f.208). E ndeshim në një formë tjetër, por kuptimi i njëjtë, **ma bën me sy** (dikush) – 1. *më jep shenjë me anë të syve për diçka; më shkel (më luan) syrin. 2. (diçka) shaka, më tërheq shumë për ta marrë a për ta blerë; më pëlqen shumë, më josh* (FFGjSh, f.441). Vërejmë, se ndryshe nga Dema, Jani Thomai na e pasqyron me dy kuptime këtë frazeologjizëm.

shtozue – prendue, me u dhane mbas ndokuj (D. f.213). Si frazeologjizëm nuk e ndeshim të shpjeguar, ndonëse në ligjërimin e përditshëm përdoret mjaft, kryesisht në gegërishten veriperëndimore, me kuptimin, *bëj shumë për dikë a diçka*.

shvendue – me luejtë vendit (D. f.215). Tek Jani Thomai e kemi, **luaj vendit!** – *përdoret për të shprehur një habi të madhe për ato që na tregon a na thotë dikush, ose në rastet kur një njeri ka paragjykimin se ajo që thotë dikush, mund të sjellë ndonjë të keqe* (FFGjSh, f.539). Siç e shohim, Fjalori Frazeologjik jep një kuptim të figurshëm të këtij frazeologjizmi, ndërsa Dema pak a shumë na jep një kuptim më të drejtëpërdrejtë.

me u çue tangla – *me u çue peshë* (D. f.217). Këtë frazeologjizëm e ndeshim me të njëjtën trajtë dhe kuptim tek Fjalori i Mehmet Elezit, **tangla** - (*krh. tang, dang, tak etj., me shllimin e veprimeve të hovshme*); *me u çue tangla, me u çue peshë* (FGjSh, Mehmet Elezi, f.1448).

tumbarë – me u vu per udhë (D. f.222). Si të tillë, nuk e ndeshim të shpjeguar tek Fjalori Frazeologjik (2006). Në Malësi të Madhe kemi shprehjen frazeologjike “*mir e tumi:r*”.

mos me ba ver me gojë – mos me folë asnji fjalë (D. f.231). E ndeshim tek Mehmet Elezi me të njëjtin kuptim, **ver** – nuk ban ver me gojë, nuk e hap gojën (FGjSh, M.E. f.1559).

vercakue – *mos me xane vend* (D. f.231). Në Fjalorin e Frazeologjizmave e kemi me të njëjtën trajtë, **nuk më nxë vendi** – *jam shumë i shqetësuar, nuk më pritet për diçka, nuk kam durim; lëviz sa andej këtej, nuk rri dot në një vend nga shqetësimi a nga padurimi* (FFGjSh, f.540). Malësia e Madhe ka formën “*vercikas-at*”.

vukuell (me u ba) - me u ba razi (D. f.235). Fjalori Frazeologjik i gjuhës shqipe nuk e ka, ndërsa në Fjalorin e Mehmet Elezit e ndeshim si të tillë, **razi,a** - 1. *pëlqim, miratim, me u ba razi ose me ra razi për diçka, me pranue, me u pajtue. 2. mirëkuptim, harmoni e dyanshme ose e të gjithëve; e shkueme mirë* (FGjSh, M.E. f.1237).

zbardullue – *hapë sytë gapërr* (D. f.239). E ndeshim me të njëjtin kuptim tek Jani Thomai, **i hapi (i çeli) sytë gapërr** – *zgurdulloi (shqeu sytë)* (FFGjSh, f.140). Në Malësi të Madhe gjejmë trajtën “**zgargulloj sÿ:t**”.

zbardullye – *me i mekë sytë* (D. f.239). Një frazeologjizëm të tillë nuk e ndeshim në Fjalorët e sipërpërmendur.

Me plot gojë mund të themi se emri i At Benedikt Demës përfaqëson viganin e punës mbledhëse e studimore, të fjalës së gjallë krahinore të marrë nga goja e popullit, për ta sjellë në mënyrë të përsosur para lexuesit shqiptar.

Kreu II

1. Veçori leksikore të Fjalorëve:

1.a. Disa karakteristika leksikore të Fjalorëve

Po të nisemi me Fjalorin e Frang Bardhit, ose Dictionariumin e tij, vetë titulli në latinisht të lë të kuptosh se kemi të bëjmë me një fjalor latin, por po të hyjmë më në brendësi dhe sidomos të kemi parasysh qëllimin e autorit për hartimin e këtij Fjalori, kemi të bëjmë me një Fjalor dygjuhësh latinisht- shqip, i krijuar me shumë funksione, ku së pari kemi pasqyrimin e leksikut të gjuhës shqipe dhe pasurinë e saj, si dhe idenë për t'u shërbyer klerikëve katolikë në mësimin e gjuhës latine, por edhe klerikëve të huaj që nuk kishin njohuri për gjuhën shqipe .

*“Me këtë shpjegohet, përse autori një pjesë të lëndës së shtojcave e ka dhënë duke u nisur nga latinishtja dhe duke e përkthyer në shqip, po ashtu një pjesë duke u nisur nga shqipja dhe përkthyer latinisht”*¹²⁸, thekson Xhevat Lloshi.

Vetë ai është i mendimit se Fjalori i Bardhit është me thënie nga fillimi deri në fund për qëllime mësimore, aq sa vjen deri te faqet e një libri bisedimesh. Pra, Bardhi e ka nisur si një fjalor dhe e ka përfunduar si libër mësimor, në të cilin pjesët përbërëse janë të ndërlidhura.¹²⁹ Si një libër mësimor për mësimin e gjuhës shqipe nga të gjithë. Duhet theksuar edhe fakti se Bardhi zgjodhi ato fjalë latine, të cilave do t'u gjente përgjegjëset në gjuhën shqipe.

Sipas Demirajt, Bardhi ka raste që fjalëve nuk u jep një përkthim, por vetëm spjegim. Kjo, sipas tij, se Bardhi nuk është përpjekur të gjejë ekuivalentet shqipe ose t'i krijojë vetë ato.¹³⁰

Fjalësi shqip i Bardhit arrin rreth 2500 lema, prej të cilave 1300 janë autoktone.

Fjalori nuk ka karakter shpjegues. Shpeshherë krahas leksemave jepen edhe përdorimi i tyre me togfjalësha ose edhe lokucione foljore me vlerën e një fjale të vetme. Psh.:

coaceruare – *me mbeleçe bafche* (B. f.12).

cæptare - *me eane fijl* (B. f.13).

conciliare – *me baam paich* (B. f.14).

eicere – *me nziere iaste* (B. f.22).

feftinare – *me ezune cpeit* (B. f.25).

infpicat dentes – *mprefen eambete* (B. f.38).

intercludere – *me mberfcele tefcuemite* (B. f.39).

internectere, ligar in fieme – *meliçune bafche* (B. f.39).

interfcindere- *me e preem pergymffe* (B. f.40).

inumbrare, far ombra – *me baam hie* (B. f.41).

itinerari – *me baam vçe* (B. f.42).

iugare – *me i baamb asfche* (B. f.43).

¹²⁸Xh. Lloshi, *Fjalori i Frang Bardhit dhe fjalësi shqip i Theodor Kavaliotit*, ”400 – vjetori i Frang Bardhit”, Prishtinë 2007, f.34.

¹²⁹Xh. Lloshi, *Fjalori i Frang Bardhit dhe fjalësi shqip i Theodor Kavaliotit*, ”400 – vjetori i Frang Bardhit”, Prishtinë 2007, f.33.

¹³⁰B. Demiraj, ”Dictionarium latino – epiroticum”, Shkodër, 2008, f.41.

iurare – *me baam mbee* (B. f.43).

Të njëjtën dukuri kemi vënë re edhe tek Gazulli e Dema. Mund të themi se autorët, përmes kësaj dukurie gjuhësore, janë munduar të japin një larmi të madhe leksemash e formime togjesh o togfjalëshash, për të nxjerrë më në pah thellësinë e gjuhës shqipe, pasurinë dhe variantet e ndryshme gjuhësore që na paraqet dialekti i gegërishtes, përkatësisht gegërishtja veriperëndimore. Po japim disa nga shembujt më të spikatur:

brufullue – 1. *me brufullue krymbat*. 2. *brufulloi bari* (G.f.71).

bukue – 1. *me hangër bukë*. 2. *mos me përkue* (G. f.74).

bukuritue – *me i dhânë një sendit bukuri, zbukurue* (G. f.74).

cërkue – *me mjelë kah pak* (G. f.81).

cërrlekue – *me pikë cërrlek* (G. f.82).

erue – 1. *me lëshue erë, me i dhânë erë, të kandshëme e të pa-kandshëme*. 2. *m'u ndie era* (G.f.124).

fatue – *me urue kuj fat* (G. f.127).

fëmnue – *me bâ femna* (G. f.127).

fijue – *me shtë, me la me fî* (G. f.130).

gërdhâmue – *m'u përzie me gërdhâm* (G. f.146).

Nga Benedikt Dema:

dërrasue – *shtrue, veshë me dërrasa* (D. f.46).

dorëzanue – *me hi dorëzanë dhanë në dorë, dorëzue* (D. f.48).

dhelpnue – *me u ba dhelpen, sherr* (D. f.53).

erue – *marrë erë (me hundë)*; *me u afrue* (D. f.55).

fajisë – *me i vu kuj fajin, perbuzë* (D. f.56).

gargullue – *me ba si gargulli, gargullite* (D. f.67).

gazitë – *bindë (dhenë), vu në gaz* (D. f.68).

gjelmue – *kerkue gjellen, gjelbzue* (D. f.78).

jashtue – 1. *qitë jashtë*; 2. *hapë* (D. f. 91).

kuqrrisë – *me u lkuqë, me u ba i kuqlemtë* (D. f.113).

Gjatë nxjerrjes në pah të këtyre lemave është vënë re se tek Fjalori **Latinisht – shqip** i Frang Bardhit, bie më tepër në sy dukuria e shpjegimit të fjalëve përmes lokucioneve ose togfjalëshave të ndryshëm, ndërsa Gazulli e Dema janë munduar të tregohen më të rezervuar në këtë pikë dhe kanë dhënë shpjegimin e tyre përmes fjalëve përkatëse. Kjo tek Bardhi mund të ketë ndodhur për dy arsye. Në radhë të parë, mund të jetë fakti se Bardhi nuk është përpjekur të gjejë ekuivalentet shqipe, ose është munduar t'i krijojë vetë ato, ndërsa arsyeja tjetër mund të jetë, se në atë kohë kur ku krijua Fjalori, 1635, nuk kishte as një alfabet të njësuar, as drejtshkrim e tejet larg për t'u folur për një gjuhë të konsoliduar, gjë që është e vështirë jo vetëm për Frang Bardhin, por edhe për çdo leksikograf tjetër që do merrej me hartimin e një Fjalori në kushte të atilla. Ndërsa, ndryshe qëndron puna për dy Fjalorët e tjerë, që u hartuan pothuaj tre shekuj më pas, të cilët vijnë pas një sërë përpjekjesh nga gjuhëtarë e studiues të ndryshëm për konsolidimin e gjuhës shqipe. Do veçonim këtu punën e vyer të Kongresit të Manastirit (1908) dhe Komisionit Letrare (1916), të cilat na dhanë edhe vendimin, se cilin alfabet do përdorte gjuha shqipe, gjithashtu hodhën edhe kërkesën për unifikimin e gjuhës letrare.

Për këtë arsye Gazulli e Dema janë treguar më të saktë në shpjegimin e fjalëve dialektore e krahinore.

Gjithashtu në fjalësin e Bardhit, Gazullit e Demës zë vend edhe shpjegimi me sinonimi, dukuri e cila e pasuron dhe u jep më tepër vlerë këtyre fjalorëve. Gjuha shqipe ka mundësi të mëdha për të përdorur shumë fjalë me kuptim të përafërt, por me një ngjyrim të fortë emocional, të cilat i gjejmë të pasqyruara në këto fjalorë. Këto lloj sinonimesh që do të pasqyrohen u përkasin sinonimeve stilistikore, të cilat mund t'i quajmë fjalë me ngjyrim emocional, ose sinonime dialektore. Po i vërejmë me radhë:

materfamilias – *ama eftepyffe oó eogna estepyffe* (B. f.56).

miles, foldato – *luftetaar, foldat* (B. f.58).

nuncius – *scues, legaat* (B. f.69).

nundinæ – *pæaar oó treghetij, oó tregh* (B. f.69).

obelifcus, aguglia – *guur i giate, i ungene* (B. f.71).

obferuare - me e chechyrune me i vum γyt (B. f.74).

pannus – *scegun, oó Zohe* (B. f.82).

patibulum – *stanghe, oo Crych* (B. f.84).

peruigil, vigilante - *pergiues, fraenich* (B. f.96).

piger – *vonues, pritues* (B. f.98).

populari – *me pruem, me vieçune* (B. f.102).

prænubilus – *vranete oó errete* (B. f.106).

præfidere – *me culundrifune oó me guuernuem* (B. f.107).

prauus – *i keich, i paa fcyfcim* (B. f.108).

prudens – *i ditune, i urte* (B. f.115).

papax – *grabiteff oó cuffaar* (B. f.122).

Të njëjtën dukuri e ndeshim edhe tek Gazulli e Dema. Por, përveç sinonimeve të thjeshta, këtu kemi përdorimin e vargut sinonimik, që e gjejmë në mjaft shembuj:

matushue – *matushitë, coptue, grimcue* (G. f.251).

mballim – *mbarë, gjithëkah, t'i biem ballim* (G. f.252).

mundshtim – *brigim, qortim* (G. f.273).

navig – *shul, shiluer, drang* (G. f.277).

ndërkalitë – *përdredhë, ndërmblysë* (G. f. 283).

ndryçë – *shtypë, ndrydhë* (G. f.287).

përfetue – *diftue, kallxue* (G. f.307).

përkye – *m'u kulë, çplâ, lakue, shtrëmbënue* (G. f.311).

rrezg – *flug, fuqi* (G. f.355).

sklinë - *skëlinë, deblim, bati, ligështi trupi* (G. f.371).

shdredhue – *shvillue, shpalue* (G. f.389).

tajkë – *ezigi, rrogazi* (M.M), *parti* (G. f.418).

tutukue – *me tutukatë, me ngucë me fjalë, me potamisë* (G. f.435).

Tek Benedikt Dema:

kaltue – *shtupue, kalktue* (D. f.95).

kurdec – *pelivrom, sifilit* (D. f.113).

lavere – *lvere, zhele* (D. f.117).

lugzë – *fillore, sovajkë, meqik* (D. f.121).

melak – 1. kacorr, zog lepuri, pegun. 2. bimë barore e fam. drandofillore (D. f.131).
nutrue – nunukue, peshperitë (D. f.146).
pakujti – pavemendje, pamendim (D. f.153).
perzimtar – ngatrrretar, perzies (D. f.167).
rumzue – shkurtue (flokët); rruckue (D. f.185).
rripue – me u ba rryp, tha, fiktue (D. f.189).
skerbaç – dredhë, frushkull (D. f. 195).
tefmtef – gjithkah, gjithkund, anemanë, anëperanë (D.f. 217).

Vargu sinonimik zgjerohet e pasurohet vazhdimisht duke u mbështetur “ te gjuha e gjallë e popullit, te bashkëveprimi ndër dialektor e te shkrirja e vlerave më të mira të ish-varianteve të mëparshme letrare në të gjitha nënsistemet e gjuhës letrare e kombëtare, te veprimtaria e shumanshme gjuhëkrijuese e popullit dhe e mjeshtërive të gjuhës, të dalë nga gjiri i tij, si edhe te rritja e vijueshme e vetëdijes gjuhësore të masave punonjëse”.¹³¹

Sinonimia dialektore luan një rol të shumëfishtë në pasurimin e gjuhës letrare. Megjithatë, gjuha letrare ka mënjeluar shumë fjalë dialektore që e ngarkojnë së tepërmi atë. Por, sa më shumë të ketë sinonime gjuha letrare, aq më i begatshëm është leksiku i saj. Duke qenë se pasuria leksikore e këtyre fjalorëve është me të vërtetë e madhe, duhet të merret në konsideratë fakti, se ka fjalë, që mund të përfshihen në gjuhën letrare, të cilat mund t'i quajmë fjalë me “ mundësi normative, për të cilat gjuha letrare ka nevojë që të zhvillojë më tej aftësitë a saj shprehëse, pavarësisht nga burimi i tyre.”¹³²

Fjalësi i fjalorëve është zgjeruar shumë edhe nga formimet e prejardhura, të përbëra, ose të përngjitura që autorët kanë pasqyruar.

Frang Bardhi përveç mjeteve fjalëformuese, kuptimin e së njëjtës fjalë është munduar ta shprehë edhe përmes formimeve me togfjalësha e shprehje foljore. Po i vërejmë me radhë:

Nga rrënja **prit** janë formuar emrat **preitesa, pritues** (f.1).

Nga **sëmur** janë krijuar mbiemri **i sëmutë**, format e pashtjelluara **me u sëmutë** dhe **sëmutë** dhe emri prejpjesor **të sëmutë** (f.2).

Kemi emrin prejpjesor **te dashunë**, dhe format e pashtjelluara **me dashunë, me u dashunë** (joveprorja), **dashunë** (f.3).

Nga **mik**, kemi emrat **miqësia** dhe ndajfoljen **miqësisht**, por edhe **migjësia** (f.4). Me prapashtesa zvogëluuese-përkëdhelëse kemi formimet **mikëth, mikësia, mikëshëza** (f.5).

Nga **shpirt** kemi **shpirti, shpirtëthi** (f.5).

Nga forma e pashtjelluar paskajore **me ndëguem**, kemi emrin **ndëgues**, pjesoren **ndëguem** (f.7).

Nga rrënja **verbo** kemi formën e pashtjelluar paskajore **me u verbuem**, mbiemrin **i verbënë**, emrin asnjës **të verbënitë** (f.9).

Nga rrënja **nxe** kemi formën e pashtjelluar paskajore **me e nxem**, mbiemrin e emëruar **të nxetë**, si dhe ndajfoljen **nxetë** (f. 9-10).

Nga **kangë**, kemi formimet **kangëtuer**, dhe formën e pashtjelluar paskajore **me kënduem** (f.10).

¹³¹ A. Kostallari, *Mbi disa drejtime të përsosjes së sistemit e të strukturës së gjuhës sonë letrare*, ”Studime filologjike”, Tiranë, 1982, 2, f.4.

¹³² A. Hidi, *Sinonimet dialektore dhe pasurimi i leksikut të gjuhës letrare shqipe*, ”Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe”, III, Tiranë, 1989, f.375.

Nga rrënja *njof* kemi emrin prejpesor *të njofunë*, format e pashtjelluara *me njofunë, njofunë* (f.13).

Nga *rëfytes* gjejmë emrin prejpesor *të rëfymitë* dhe formën e pashtjelluar paskajore *me u rëfyem* (f.14-15).

Kemi formimet nga emri *këshill, këshills, këshilltar*, por edhe togfjalëshin *me lypunë këshill* (f.15).

Gjithashtu kemi formimet *me bām*, në formë togfjalëshi *bām ashtë*, emrin prejpesor *të bām*, emërzimin e mbiemrit *e bameja* (f.25), por edhe forma e pashtjelluar joveprore *me u bām* (f.26).

Nga *vëllā*, kemi ndajfoljen *vëllazënisht* dhe emrin përmbledhës *vëllazënia* (f.27).

Kemi formimet *t ikunë, me ikunë, ikë ti* (f.28).

Nga emri *ngjënim* kemi formën e pashtjelluar *me ngjinuem* dhe togfjalëshin *ngjënueshim jam* (f.33).

Ndeshim formime interesante nga emri prejpesor *të dëguem, ai gji dëgon*, emrin *ndëgues*, formën e pashtjelluar *me të dëguem, të dëguemitë* (f.38).

Për ndajfoljen *mbrendë* kemi mjaft formime me togfjalësha, *përmbrenda, me hī brendë, me shukuem mbrendë, me e thirë mbrendë* (f.40), por edhe formën *mbërendë* (f.41).

Ndeshim formimet nga *mnia*, ndajfoljen *mënīshim, ō mnīshim*, emrin *mnīs* (f.42).

Nga *me urdhënuem*, kemi togfjalëshat *urdhënoinj ty, t urdhënuemitë tat* (f.43).

Ndeshim formimet, *fëdigë, fëdigëtë, fëdigëtār, me fëdigë, fëdigues, me u fëdigunë* (f.44).

Nga folja *dëlīr* kemi emrin prejpesor *të dëlirëtë*, formën e paskajores *me dëlīrnë*, dhe togfjalëshin *dëlira shtëpīnë* (f.45).

Gjithashtu kemi formimet *kusërija, kusarëtë, me kusëruem* (f.46).

Nga ndajfolja *lēbdueshim* ndeshim emrin prejpesor *të lēbduemitë*, format e pashtjelluara *lēbduem, me lēbduem* dhe togfjalëshin *lēbdoinj ty* (f.46).

Nga *të ligunitë* kemi format e pashtjelluara *ligunë, me ligunë* dhe *u lig deleja* (f.52).

Nga emri *qūd* kemi ndajfoljen *qūdueshim* dhe mbiemrin *i qūduem* (f.95).

Nga rrënja *urti, kemi i urtë, urtisht* (f.114), por edhe *urtia* (f.115).

Nga emri *dhunë* ndeshim paskajoren *me u dhunuem*, mbiemrin prejpesor *i dhunuem*, ndajfoljen *dhunisht* (f.115).

Nga fjala *i shëndoshë* kemi formimet *i shëndoshënd*, ndajfoljen *shëndosh*, mbiemrin *i shëndoshunë*, emrin prejpesor *të shëndoshunitë* (f.140).

Nga Gazulli kemi mjaft leksema të cilat janë zgjeruar më së tepërmi nga formimet me prejardhje ose edhe me anë të togfjalëshave të thjeshtë. Kjo dukuri ka pasuruar dhe e ka bërë më të larmishëm Fjalorthin e tij.

Nga emri *bāngë*, kemi foljen *bangëzue*, por edhe mbiemrin *bāngëc* (f.55).

Gjejmë formimet nga *bri, brie, brien* dhe foljet *bricue, brienue* (f.69), por edhe *brijoke, brijue* (f.70).

Nga tema *dasi*, kemi *dasik, dasim, dasue* (f.105).

Duke u nisur nga folja *dëkë*, gjejmë emrin *dekan* dhe foljen *dekësue* (f.107).

Nga rrënja *dhamb* kemi kompozitat *dhambësutë, dhambëhekurt, dhambzezë* por edhe formimet me prapashtesim *dhambtuer, dhambzak, dhambzakue, dhambzëz* (f.118-119).

Gjithashtu ndeshim formimet *dhândrri, dhândrrorë, dhandrrue* (f.119).

Nga rrënja *fjalë* kemi kompozitat *fjalë-lashtë, fjalëmujshtë, fjalërrëxuem, fjalërrëshëm* (f.133).

Nga *gërdhâm, gërdhamue, gërdhatë* (f.146).
 Takojmë formimet *gican, gicëm* nga rrënja *gicë* (f.151).
 Nga *gryk* kemi formimet me kompozim *grykakuq, grykele, grykë-furre, grykëhollë* (f.159).
 Nga *harma* ndeshim foljen *harmatue*, emrin prejfoljor *harmatim* por edhe *harmi* (f.172).
 Kemi formimet *hijeç, hijelehtë, hijenue* (f.176).
 Nga rrënja *hut*, kemi emrin prejfoljor *hutim* dhe foljen *hutue* (f.179).
 Me rrënjën *kambë* kemi kompozimet *kambëpulë, kambëshum, kambëzezë* si dhe ato me anë prapashtesash *kambëcuër, kambështue* (f.190).
 Nga *kandi* kemi format foljore *kandetë, kandisë* (f.190).
 Me rrënjën *lâng* takojmë foljet *langshtue, langue* (f.228).
 Nga emri *lypë*, kemi *lypësi, lypësue* (f.243).
 Me rrënjën *mal*, kemi formimet me prapashtesim *maltuer, maluer* (f.248).
 Nga *mbrakulli, mbrakullue, mbrakullues* (f.257).
 Kemi formimet *miellajë, i mjellajtë, miellishtë* (f.263).
 Gjithashtu nga *motë* kemi *motisë, motkeqe, motmotak, motmotar, motni* (f.269).
 Nga rrënja *ngul*, takojmë *i ngulshëm, ngulshëm, ngulim, ngulue* (f.290).
 Nga *pikë*, kemi formimet me prapashtesim *pikësore, piklue, piktue* (f.321).
 Nga *prâjë, prâjës, i prâjshëm* (f.333).
 Kemi formimet *prekatar, prekëcar, prekëc, i prekun* nga rrënja *prekë* (f.335).
 Nga *shkapërcim*, ndeshim *shkapërcye, i shkapërcyem* (f.394) etj.

Tek Benedikt Dema edhe këtu kemi formime fjalësh me anë të mënyrave të ndryshme fjalëformuese.

Nga tema *adhrue*, ndeshim formimet me prapashtesim *adhrim, adhrimtar* (f.11).
 Nga fjala *anmike* ndeshim mjaft formime fjalësh me prapashtesim *anmikeshë, anmikneshë, anmiqsi, anmiqsisht, anmiqsue, anmiqsuer* si dhe me nyjëzim e prapashtesim *i anmiqsueshëm* (f.13).
 Me rrënjën *bashkë*, ndeshim *bashkarim, bashkaz, bashkëni* (f.21).
 Nga *belbë* takojmë *belban, belbëzujë, belbuc* (f.22).
 Gjithashtu me *besëtytni*, kemi formimet me prapashtesim *besëtytnisht*, dhe nyjëzim e prapashtesim *i besëtytshëm* (f.23).
 Ndeshim formimet *blerë, i blerë, blerisë, blerush* (f.25).
 Nga mbiemri *i bylmetshëm* takojmë foljen *bylmetë* dhe ndajfoljen *bylmyeshëm* (f.31).
 Ndeshim formimet me fjalën buzë: *buzë, buzëdele, buzëkerveshë, buzëkjamë, buzëlepuri, buzështrembët, buzëvarun, buzëvjerrun, buzoç, buzore* (f.31).
 Nga *çudni* kemi *çudini, çudnar, çudnue, çudue* (f.41).
 Nga folja *damue* kemi formimet *damsi, i damtueshëm, i damueshëm* (f.43).
 Ndeshim *daralli, darallim, darallosë* (f.44).
 Nga *dasë* kemi *dasi, dasim, dasie, i dashëm* (f.44).
 Nga mbiemri *i fajshem* kemi foljen *fajisë* dhe mbiemrin *i fajisëshem* (f.56).
 Ndeshim: *fershllue, fershllye, fershllim, fershllimzë* (f.58).
 Kemi: *gazitë, i gazmueshem, gazullue* (f.68).
 Gjithashtu kemi formimet: *gerdi, i gerdiçem, gerdimë, gerditë* (f.68).
 Nga *i gjalltë* kemi *gjallesë, gjallë, gjallë(fol), gjallitë, gjallnesë, gjallni* (f.77).
 Nga folja *gjitë* ndeshim ndajfoljen *gjitas* dhe emrin *gjitoni* (f.79).

Kemi: *harbë, harbim, harbimsi, harbitë* (f.83).
 Takojmë formimet: *hiejç, hijak, hijelehtë, hijenue, hijenuer, hijerandë, hijesue, hijetar, hijetinë, hiezi, hijezue* (f.85).
 Nga *imti* kemi *imtim, imtisht* (f.89).
 Ndeshim formimet: *jetik, i jetshem, jetsi, jetsim* (f.91).
 Gjithashtu kemi, *kadalas, kadalëkadalë, kadalue* (f.94).
 Nga *lbogur*, takojmë *lbogurue, lbokë* (f.117).
 Nga *lejthi e eger* kemi *lejthiç, lejthiçore, lejthishtë* (f.118).
 Gjithashtu kemi formimet: *ligci, ligcinë, ligcue, ligë, ligrue, ligsi, ligsinë, ligsue* (f.119).
 Ndeshim *malsiak, malsisht, malsori* (f.128).
 Takojmë formime të tilla: *miqasi, miqasisht, miqasue, i miqasueshem, i miqsueshem* (f.135).
 Gjithashtu: *i ndiem, ndiemje, ndiesuer, ndigjesë, ndigjue, i ndigjueshëm* (f.142).
 Nga *i njomtë*, kemi *njomisue, njomshiti, njomtue* (f.148).
 Ndeshim kompozitat *orëçuet, orëfjetë, orëshambë* (f.149).
 Gjithashtu: *padeksi, i padekshem, i padekun* (f.151).
 Takojmë formimet: *i pazot, i pazotsi, i pazotnueshem* (f.161).
Qelbak, qelbinë, qelbsë, qelbsim, qelbsuer, qelbzim (f.179).
Të randët, randi, randim, randue, i randueshem (f.183).
 Po ashtu: *shterngojë, shterngues, i shterngueshem, shterngueshem* (f.212).

Kjo pasuri e madhe fjalëformuese që vërehet tek këta autorë në formimin e fjalëve të reja me formantë e tipa fjalëformues të ndryshëm, dëshmon për zotërimin e një ndjenje gjuhësore dhe dëshirën për të nxjerrë në pah larmishmërinë e gjuhës me variantet dialektore e krahinore që mbart ajo.

1.b.Shtresa e huaj e Fjalorëve:

- Turqizmat

Depërtimi i turqizmave në gjuhën shqipe ka kulmin e saj në shekullin e XVIII, kryesisht me zhvillimin e letërsisë së bejtexhinjve. Kështu, qytetet që u prekën më tepër nga vërshimi i turqizmave, ishin Berati, Shkodra, Gjirokastra, Elbasani.

Por Kostallari është i mendimit, se vërshimi i turqizmave në gjuhën shqipe, kishte filluar para sundimit osman. Sigurisht që ishin të pakta, fjalë si: *çarçaf, çorape, gajtan, penxhere, fitil, mejdan* etj.¹³³

Përsa i takon Fjalorit **latinisht – shqip** të Bardhit, aty kemi të përfshirë vetëm 45 turqizma. Ky numër i vogël shpjegohet edhe me faktin, se ai ishte klerik dhe vepra e tij ishte në shërbim të kishës, kështu që mbetet si një dëshmi e peshës specifike mjaft të vogël të turqizmave në gjuhën tonë dy-tre shekujt e parë të pushtimit osman. Edhe tek Buzuku e Bogdani e vërejmë këtë dukuri.

Ndryshimet që u bënë në jetën ekonomiko-shoqërore, politike e ideologjike, krijuan edhe mundësinë e depërtimit të turqizmave në mënyrë të vrullshme.

Sipas Çabejt, ndikimi turk mbi gjuhën shqipe u ushtrua shumë më fort në jetën e qytetit sesa të fshatit.

Këtë e dëshmon vetë rrethana që terminologjia e bujqësisë dhe e blegtorisë e kësaj gurre është shumë më e vogël në krahasim me pjesën që ka turqishtja në leksikon e rrethëve qytetare.¹³⁴

Konkretisht, tek Fjalori **latinisht – shqip** i Frang Bardhit numri i turqizmave është i vogël dhe i ndeshim vetëm atëherë, kur ai, krahas latinishtes, jep përkthimin edhe në italisht dhe ndisa raste në turqisht. Po i vërejmë me radhë duke i bërë një përjasje me Fjalorin e Orientalizmave të Tahir Dizdarit (2005) dhe Fjalorit të Bashkimit (1908), nëse i ka.

apparitor – *turcicè chiauff* (B. f.6). Në Fjalorin e Bashkimit nuk e ndeshim fare si fjalë, ndërsa Në Fjalorin e Orientalizmave e kemi, **çaush-i** – *në Jugë, ku dhe me kalim të afrikates ç:c në krye të fjalës dhe me ramje të –v- çaush, në Veri me shpërngulje theksi çaúsh; në kohën e sundimit osman, nenoficer me gradë midis marshallit dhe rreshterit në ushtri, në gjindarmeri, në kalori etj; kapter* (F.O. f.156).

cerebrum - *mend, turcicæ bein* (B.f.11). Fjalori i Bashkimit dhe Fjalori i Orientalizmave nuk e ka të shpjeguar këtë fjalë.

chrijianus – *i cherftene; turcicæ gaur* (B. f.11). Në Fjalorin e Bashkimit nuk e ndeshim, ndërsa Fjalori i Dizdarit e jep jo me të njëjtin kuptim, dhe me një trajtë tjetër, **kaur-i** – *Jugë, ku dhe me një epentezë të një guturali velar për t'i ikë hiatit kahur; në geg. me theks në a dhe fortim të dridhsës kaurr. Para 45 vjetësh: i pabesë, i patënzonë, i pafe, pagan; jo-musliman në disa vise, por në Veri ma së forti armik i kombit e i atdheut* (F.O. f.523).

citó – *gna ciaff; turcicæ thes* (B. f.12). Kjo fjalë nuk ndeshet në asnjë nga fjalorët e marrë në shqyrtim.

¹³³A. Kostallari, *Rreth depërtimit të turqizmave në gjuhën shqipe gjatë shek. XVII-XVIII*, "Studime mbi leksikon dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhë shqipe", Tiranë 1989, f. 94.

¹³⁴E. Çabej, *Për një shtresim kronologjik të huazimeve turke të shqipes*, "Studime mbi leksikon dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe", Tiranë, 1989, f.122.

cochlearium – *lughe*; *turcicè kaffik* (B. f.13). E ndeshim vetëm tek Fjalori i Orientalizmave, **kashik-u** – *lugë* – Bardhi. *Nji shekull e këndeje të paktën asgjakundi në truëllin shqiptar s'asht ndigjue kjo fjalë, përposë në ato qendra turqishtfolëse të Kosovës, e Manastirit. Imz. Bardhi, si e ka zakon shpesh në fjaluer të vet, mos ka dashtë me ba të dijtun se lugës (doracake, e nevojës së parë për njeriun) në tur. i thonë kasik?* (F.O. f.519).

ecce, ecco – *ge*; *turcicè giore* (B. f.22). Nuk e ndeshim si turqizëm në asnjë prej Fjalorëve të shqyrtuar.

epirote – *i arbenefe*; *turcicè arnautlar* (B. f.141). E kemi tek Fjalori i Dizdarit, **arnaut-i** – “*shqiptar*” në gojë të turqve dhe të disa popujve të tjerë ballkanas...por edhe arnautlar “ i arbëneshë” lat. *Epirote ke Bardhi* (F.O. f.36).

fortuna - *giucata* ; *turcicè nasijp* (B. f.151). Nuk e ndeshim të shpjeguar në asnjë nga Fjalorët e shqyrtuar.

frate – *vellaa*; *turcicè Kardafch* (B.f.27). Ndërsa Dizdari i jep një kuptim më sqarues, **kardash-i** - *s'ka hy në gjuhë tonë kjo fjalë me kuptimin konkret, por aty-këtu përdorë si në ledhatim për shokun, mikun, dashamirin* (F.O. f. 511).

fulmen – **fæta** – *reffeeia*; *turcice ildrin* (B. f.28). Nuk e gjejmë të shpjeguar në asnjë nga fjalorët e sipërpërmendur.

funis – *corçe*; *turcicè organ* (B. f.28). Nuk e gjejmë të shpjeguar në asnjë nga fjalorët e sipërpërmendur.

græcia – *gerghia*; *turcicè vrumli* (B. f.29). Nuk e gjejmë të shpjeguar në asnjë nga fjalorët e sipërpërmendur.

ræcus-grech; *turcicè vrum* (B. f.29). Nuk e gjejmë të shpjeguar në asnjë nga fjalorët e sipërpërmendur.

grandævitas – *plechenia*; *turcicè doli* (B. f.30). Nuk e gjejmë të shpjeguar në asnjë nga fjalorët e sipërpërmendur.

guttur-fyti, *turcicè bogas* (B. f.30). Nuk e gjejmë të shpjeguar në asnjë nga fjalorët e sipërpërmendur.

hebdomas- *iaua*; *turcicè iok* (B. f.30). Nuk e gjejmë të shpjeguar në asnjë nga fjalorët e sipërpërmendur.

hera – *εogna*; *turcicè cadun* (B. f. 1). Nuk e gjejmë të shpjeguar në asnjë nga fjalorët e sipërpërmendur.

herba – *baar*; *turcicè oth* (B. f.31). Nuk e gjejmë të shpjeguar në asnjë nga fjalorët e sipërpërmendur.

heri, hieri – *die*; *turcicè dun* (B. f.31). Nuk e gjejmë të shpjeguar në asnjë nga fjalorët e sipërpërmendur.

hic – *chyyi*; *turcice bu* (B. f. 31). Nuk e gjejmë të shpjeguar në asnjë nga fjalorët e sipërpërmendur.

hic, qui – *chetu*; *turcicè bunda* (B. f.31). Nuk e gjejmë të shpjeguar në asnjë nga fjalorët e sipërpërmendur.

hodie – *sod*; *turcicè bugiun* (B. f.31). Nuk e gjejmë të shpjeguar në asnjë nga fjalorët e sipërpërmendur.

hordeum - *helb*; *turcicè arpa* (B. f.31). E ndeshim tek Fjalori i Orientalizmave si vazhdim të fjalës **arpallëk-u** -.....*arpalik* (**arpa** “elb”) *brimë, nishan në dhambët e kalit qëpërftohet me kalim të moshës. Kjo fjalë në lidhje me tagjinë, marrë edhe këta vështrime: 1. arë, toka e së cilës asht shumë kompakte, e majme. 2. vende apo vise, tëardhunat e të cilëve i akordoheshin një dignitari të naltë të shtetit. 3. racion në natyrë ose në të holla që u jepej deri tashti vonë, ylemavet, simbas rangut të tyne* (F.O. f.37).

huc, qua – *cheha*; *turcicè buraija* (B. f.32). Nuk e gjejmë të shpjeguar në asnjë nga fjalorët e sipërpërmendur.

ianitor – *deretaar, ai ghi ruon derene*; *turcicè capegi* (B. f.33). Nuk e gjejmë të shpjeguar në asnjë nga fjalorët e sipërpërmendur.

ianua – *dera*; *turcicè, capi* (B. f.33). Nuk e gjejmë të shpjeguar në asnjë nga fjalorët e sipërpërmendur.

ianitorum praefectus - *turcicè, capigibassa* (B. f.33). Nuk e gjejmë të shpjeguar në asnjë nga fjalorët e sipërpërmendur.

ibi - *nd ate uend*; *turcicè onda* (B. f.33). Nuk e gjejmë të shpjeguar në asnjë nga fjalorët e sipërpërmendur.

ille – *ai*; *turcicè burada* (B. f.33). Nuk e gjejmë të shpjeguar në asnjë nga fjalorët e sipërpërmendur.

illicitum – *malecuem*; *turcicè haram* (B. f.33). Tahir Dizdari i jep një shpjegim më të hollësishëm, **haram-i** – *ndalesë kategorike nga ana e fesë; e kundraligjshme*.

Për besimtarët musliman janë haram në mënyrë të theksueme: dejmenija, bixhozi, kurvënimi, vjedhja, rushveti, para me faiz etj. (F.O. f.354).

immundus - *i pegaam*; *turcicè lekeli* (B. f.34). Nuk e gjejmë të shpjeguar në asnjë nga fjalorët e sipërpërmendur.

imperator – *perendij*; *turcicè fultan* (B. f.34). Nuk e gjejmë të shpjeguar në asnjë nga fjalorët e sipërpërmendur.

infidelis – *i paafee*; *turcicè giaur* (B. f.36). Këtu vërejmë se bardhi ka përdorur fjalën turke **giaur** për **chri-fianus** – *i cherftene*; *turcicæ giaur* (B. f.11) dhe **infidelis**. Në lidhje me shpjegimin që ka bërë Dizdari, ai i referohet më tepër kuptimit të dytë të fjalës, sesa të parit, në lidhje me *i cherftene*: **kaur-i** – *Jugë, ku dhe me një epentezë të një guturali velar për t'i ikë hiatit kahur; në geg. me theks në a dhe fortim të dridhësës kaurr. Para 45 vjetësh: i pabesë, i patënzonë, i pafe, pagan; jo-musliman në disa vise, por në Veri ma së forti armik i kombit e i atdheut* (F.O. f.523).

inter – *der*, *turcicè erade* (B. f.38). Nuk e gjejmë të shpjeguar në asnjë nga fjalorët e sipërpërmendur.

iudex – *gycues*, *turcicè kadi* (B. f.43). Tek Fjalori i Orientalizmave kemi një shpjegim më të detajuar, **kadi-u** – *hoxhë gjyqtar i ligjës muslimane, që në kohën e sundimit osman gjykonte dhe vendoste simbas sheriatit për punë civile dhe fetare. Deri në kohën e tanzimatit gjykonte mbi çdo dava e proces; mbas tanzimatit, me hymjen në fuqi të mexhelesë, ka veprue sallde për kunorëzime, çkunorëzime, trashigimina e nafaka dhe me kodin civil ka pushue së qenmi si institucion* (F.O.f. 468).

leo, leone – *luaa*, *turcicè aslan* (B. f.47). E ndeshim tek Fjalori i Bashkimit (1908), **asllan,i** - *luaa,ni* (F. Bs.27). Gjithashtu tek Fjalori i Orientalizmave (2005) e kemi, **asllan-i** - *luan, ala në vlerësimin fizik të burrit, trupi i tij krahasohet me të asllanit, si trim, burrë i fortë, i bamshëm, i rreptë, azgan* (F.O. f.39).

lex, legge – *liggia*; *turcicè zuna* (B. f.47). Nuk e gjejmë të shpjeguar në asnjë nga fjalorët e sipërpërmendur.

libenter – *mb urçene*; *turcicè nola* (B. f. 48). E kemi tek Dizdari, **nolla** –1. “*gati- jam gati*” në Fjalorthin e Mbledhës të hershëm të Folklorit shqiptar, 2. *në Shkodër qytet, para 40 vjetësh me sa e kam ndigjue un në anën muslimane “ nuse e qenun, lepe nolla gjithsecilit ” = i përgjigjet dhe i gjendet aty për aty seicilit* (F.O. f.721).

magifter – *miefstre*, *turcicè vftat* (B. f.52). Nuk e gjejmë të shpjeguar në asnjë nga fjalorët e sipërpërmendur.

mercenarius, mercenario – *rogjetaar*; *turcicè argat* (B. f.58). Tek Dizdari e kemi, **argat-i** – *puntuer krahi me mëditje; ai që ban punët ma kabahe në ndërtime sidomos, në bartje llaçi, qeresteje; mundqar* (F.O. f.34).

non – *io; turcicè ioch* (B. f.67) . E ndeshim tek Fjalori i Orientalizmave (2005), **jo** – *mohimi*. Kështu Kristoforidhi 142. Simbas Meyerit EW 163 jo “nein”....turq. jok (F.O. f. 457).

non eft – *s afte; turcicè iochdur* (B. f.67). Nuk e gjejmë të shpjeguar në asnjë nga fjalorët e sipërpërmendur.

novem – *nande; turcicè dochus* (B. f.68). Nuk e gjejmë të shpjeguar në asnjë nga fjalorët e sipërpërmendur.

Oois – *delleie; turcicè coin* (B. f.81). Nuk e gjejmë të shpjeguar në asnjë nga fjalorët e sipërpërmendur.

Këto ishin edhe turqizmat e përdorur në Fjalorin e Bardhit. Ajo që bie në sy është se Bardhi me pasqyrimin e fjalës në gjuhën turke, ka dashur të na tregojë se jo domosdo ajo fjalë ka hyrë në gjuhën shqipe dhe ka zënë vend, por thjesht ka dashur të e japë variantin e saj në turqisht, ashtu siç e ka dhënë herë pas here edhe në italisht. Këtë e tregojnë pothuajse të gjitha fjalët që nuk kanë gjetur përdorim, as në Fjalorin e Bashkimit 1908, as në Fjalorin e Orientalizmave të Tahir Dizdarit, 2005. Fjalë si: *bein, giore, nasijp, ildrin, buraija, lekeli, fultan, zuna, vftat, iochdur, dochus* etj., nuk i ndeshim të shpjeguar në fjalorët e sipërpërmendur.

Po vijojmë më tej me Fjalorin e Nikollë Gazullit, i cili edhe ky mbart mjaft turqizma. Do mundohemi t’i bëjmë një përjasje me Fjalorin e Bashkimit (1908) dhe Fjalorin e Orientalizmave (2005).

ag-u – 1. *agu i driës*. 2. *gjysë-terri*. 3. *agu u synit: bebja (tyrq.) e synit* (G. f.43). Në Fjalorin e Orientalizmave e kemi, **bebë-ja** – *tosk, bebe geg, por edhe bebënë Jugë e Shq. të Mesme: bebeja e synit, drita e synit, minzë - Bashkimi, agu i synit, Gazulli, nusja e synit, lilëz-a* (F.O. f.80).

aktund-i – *rend, kurá (tyrq)* (G. f.43). Tek Dizdari e kemi të shpjeguar më qartë, **kurá-ja** – *datëlindja e caktueme pë t’u thirrë nën armë e shtetasit që ligjërisht kanë detyrim ushtarak; mbledhje rekrutë simbas datëlindjeve të paravendosuna* (F.O. f.567).

andaq-e – *andaq pune, mësimi: tyrq. qefli* (G. f.44). E kemi tek Fjalori i Dizdarit, **qejfli-je** – *Jugë, Shqip. e Mesme; qefli Veri: 1. i dhanun mbas një qëfit, andaq, amator. Qefli me u veshë mirë, qefli kafjet, gjuetijet, ahengut, piktoret, femnash etj. 2. Jugë: ishte bërë qejfli; kish pirë sa për të qenë alegro* (F.O. f.791). Tek Fjalori i Bashkimit e kemi thujse me të njëjtin kuptim, **cefli,ja** – *kuur nnokui preje piuet bahet dreite ghithkunn, kannues,i syghighil* (F.Bs. f.61).

ashkja e synit – *qerpiku i synit (tosk. qepalla = tyrq. kepmak: ma bâ me sy)* (G. f.50). Të njëjtin shpjegim ka dhënë edhe Dizdari në lidhje me këtë fjalë, **qepalla-t** – *qerpikët e synit. Gazulli këtë fjalë të toskënishtes e barason me tur. Kepmak. Në turq. ”kipmak” me çilë me mbyllë shpejt syt*, (F.O. f.797). Në Fjalorin e Bashkimit e kemi, **cerpik,u** - *mlexat e synit* (F.Bs. f.63).

balluer-ori – *shpi me balluer, me kallkan (tyrq); përkundra: shpi me mahi* (G. f.54). Për këtë fjalë Dizdari ka dhënë disa shpjegime, **kallkan-i** – *për këtë fjalë shumkuptimshe në shqipet përballë turqishtes që s’i ka, u shtërguem të ia hyjmë kësaj analize tue pasë parasysh edhe fjalorët me tekste të tjerë: 1. parzmak, pansir, tek Meyer EW-simbas Hahn; “mburojë, shqyt”- Leotti 43, Cordignano 68, Fgish 165 195. 2. copë hekuri me të cilin mbyllet porta, në MHFSH. 3. tek Leotti edhe “tubo, saracinesca. 4. dy skajet e çatisë, mbi të cilët mbështetet kulmi i ndërtesës: shtëpi e*

moçme me kallkan. 5. akull, hejet e akullit që mvaren nga pikat e strehëve në kohë dimëni të randë. 6. fig. ndajf. i rri kallkan, i rri përballë (F.O. f.487).

bankë-a – gânc-i (tyrq) (G. f.55). Këtë fjalë nuk e ndeshim si turqizëm tek Dizdari.

basterr-e - 1. qen a shakë qi s'lehin. 2. njeri qi siellet pa punë, bjerraditës (belesh, tyrq) (G. f.57). E kemi tek Fjalori i Orientalizmave, **belesh** – ma së forti në të folmen e Jugut: kotas, për hiçgja, falas, xhaba gja që shtihet në dorë lirë e shkret (F.O. f.92).

birth-i – puçrra majuce qi dalin shtatit e qi djegin fort; tyrq. çiban (G. f.63). Të njëjtin kuptim ka edhe në Fjalorin e Orientalizmave, **çiban-i** – fjalë e toskënishtes: i thatë, puçë, koqëz, puçërr, fuskë, fulltak, brith në Malësi të Krues (F.O. f.168).

bulë-a – 1. idhull-i, put-i (tyrq). 2. bula e gishtit. 3. bula e veshit, copa e kërcelës s'veshit qi viret teposhtë, palëca e veshit (G. f.75). Dizdari e shpjegon, **put-i** – trupore a shëmbëllesë fytyre e adhurueme si hyjni, idhull. Taptis mbas putnave, u falet putnave (F.O. f.781).

camuruk-u – tyrk. kotrum, avrom (G. f.80). Këtë fjalë nuk e ndeshim tek Dizdari.

capâ-ni – 1. 2 konopët e samarit me se lidhen ânët e barrës në kal., zenji-ja (tyrq) (G. f.80.) Këtë fjalë nuk e ndeshim tek Dizdari.

capë-a - dhe a shtrat dheu i forcuem prej motesh si çemento, i gurzuem, harasan (tyrq) (G. f.80). Tek Dizdari e kemi në këtë trajtë, **harasan-i** – në Shqipni të Mesme, kështu dhe Jungu 187 “cemento”, tur. horasan, pers. khorasan një nga provincat ma të mëdha të Iranit në verilindje të tij. Në lashti ka qenë një nga vendet ma të përparuem, një nder ata kande ku njeriu i zhvilluem ka ma së pari. Edhe në epokën islame popullsija e këtij vendi ka tregue intelektin e zotsinë. Edhe fjala harasan, horasan me vështrimin lloçit të përzime me gëlqere, ranë e pluhun tullash, që përdorej në ndërtime – një solucion ky, që zente vendin e çimentos, - rrjedh prej emnit të kësaj treve, ku ma së pari ka qenë çipikë e vu në përdorim (F.O. f.356).

cënuq-u – 1. mbështetës kreje. 2. jested-u (tyrq) (G. f.81). Tek Dizdari e kemi, **jastëk-u** – Jugë; jastik në Tiranë, Krue, Dumre; jastak, jastak në disa vise të Kosovës: një farë qeseje e madhe me cipë pambuku, lini a mëndafshi, mbushun mbrenda me lesh, me pambuk, me pupla, ose me kashtë për të mbështetun kryet ose shtatin: nënkrejce, perkres, kulter, cumër cënuq, pericë (F.O. f.446).

cokël-a – 1. shkurtica drush. 2. cokla-t: shoje druni, nallat (tyrq) (G. f.84). Dizdari e pasqyron në një trajtë tjetër dhe me një shpjegim më të gjerë, **nallane-ja** – Shqip. e mesme; nallëne Jugë, dhe në Veri në trajtë të apokopueme **nallë-a** – këpucë prej druri me një rryp të mbërthyem përsipër, kaliqe, cokël, këcë dhoge (F.O. f.699).

qejtë – ngrehë e qejtë; qi ka bâ bark pullaz shtëpie qi ka bâ bat (tyrq), (G. f.89). E ndeshim tek Fjalori i Orientalizmave me të njëjtin kuptim, por e kemi me një shpjegim më të qartë, **bat-i** – Shkodër, një rrasë pranë një gropëze e përkulun dhe e mbështetun mbi një copë shkop, qi ngrehet me anë të një spage a teli të lidhun për të, për të zane zogj (F.O.f.74).

qepër-a – pullazinë e çame: shikull, fregull, drrasë baskore, (baski, tyrq). 2. njeti, shgjetullë-a, gërshanëz-a; brezi ku mbështeten trenët në mur (G. f.91). Në Fjalorin e Orientalizmave e kemi **baski-ja** – gozhdë e madhe; kunj i ngulun në mur, ku vareshin armët // pullazinë, dërrasëz në madhësi të tjegullës, me të cilën mbulohet çatija në disa vise malore (F.O. f.70). Tek Bashkimi e kemi me të njëjtin kuptim, **baskii,a** - gni fare goxhdet e rrumullakte (F.Bs. f.35).

qyne – asht bâ qyne: plakë e stërplakë; sh. qino (tyrq), (G. f.97). Këtë nuk e ndeshim tek Dizdari.

çakraman-e – shakllaban-e (tyrq), (G. f.97). E kemi tek Fjalori i Orientalizmave në këtë formë, **shakllaban-e** – njeri qi s'i pranë goja kurr, fjalaman, gojaç, llomotitës,

llaptuer, çakraman, llaçk, llakabere, farëfjalësqaqulan (Ulqin), sdërranuk (Berat), (F.O. f.945).

çêjnë-a – *shpotë-a, qesti-ja (tyrq: me shpotitë, me qestisë (tyrq), me vu në gaz (G. f.99). Këtë turqizëm nuk e ndeshim tek Dizdari.*

dengël-a – 1.*me qitë dengla, dokrra, bente (tyrq), 2. arsyena qi s'ecin (G. f.108). Këtë nuk e ndeshim tek Dizdari.*

dollmat e fytit – *zhanglat e pshtymës, (tyrq) dollmá (G. f.112). Tek Fjalori i Dizdarit të njëjtën fjalë e ndeshim me një kuptim tjetër nga ai që na ka dhënë Gazulli, por që e ndeshim edhe versionin e tij, **dollmá – ja – tosk.**, në geg. *me shpërngulje theksi döllëm-a. gjellë kimet, orizit, rrush të thatë, fistikë dhe erëzina të ndryshme që mbështillen me fletë laknet ose edhe në kunguj, specat e mollatarta, të mbushun me kësi içi; kuvare./ jallanxhi dollëm-a Shkodër: **dollma** në trajtë të suxhukut me gjeth hardhijet ose laknet që mbushet sallde me oriz e qepë, dhe mylmehen me voj.... dollma-t dy gjandrat në trajtë të bajamit që ndodhen në rranxë gjuhës (F.O. f.225). Në Fjalorin e Bashkimit e kemi, **dollme,a - barth,i** (F.Bs. f.91).**

dordull – *plot sa s'zên mâ; e kam barkun dordull (tyrq. dordur?), (G.f.113). Vërejmë se Gazulli e ka lënë me pikëpyetje versionin në turqisht, por tek Dizdari e ndeshim me të njëjtin version, por me plot sinonime të kësaj fjale **dòrdull** – *mbushje plot e përplot të njëri ajet a enet, deri në grykët; plym, deng, dingaj, bruz, gargull, lamzë, vica, shaz, grafulluem, rrafsh, kapul dhe në kat. të Tiranës thyes më thyes (F.O. f.227).**

duhaç-i – 1. *duhi e madhe, tufâ, rrushgjer-i (tyrq), 2. duhaç ere (G. f.116). Me të njëjtin kuptim e kemi edhe tek Dizdari, i cili e ka shoqëruar edhe me mjaft sinonime këtë fjalë **rushgjer** – *duhi e madhe, duhaç, studi, goren, shi me rrembese, shi me rrëshekë, me rremet (F.O. f.847).**

dykme - *lojca, gjerdan-i (tyrq) kolanë grash me çingla e noca (G. f.117). E ndeshim me të njëjtin kuptim tek Dizdari, **gjerdan-i** – *kudo, por në tosk. edhe me kalimin e **d: dh** dhe ambigjene: gjerdhan, gjordhan, gjerdhane-ja “ varg me florinj, me inxhi a me gurë të mirë që varin gratë në qafë, por Dizdari jep edhe një kuptim tjetër të kësaj fjale, **gjerdan, gjerdhan** tosk. në pjestimin e mishit të berrit a të gjethit, quhet kështu ajo copë e kraharorit që përfshinë krahin e parshëm dhe gjysmën e qafës për së gjati; kolle në të folmen e Tiranës (F.O. f.304).**

dyzme-ja – *njeri me dyzme (tyrq?), me hollime (G. f.118). E takojmë me një kuptim krejt tjetër tek Fjalori i Orientalizmave, gjithashtu dhe me variante të ndryshme në zona të ndryshme, **dyzme** – *pabesi, tradhëti, **dyzmeli-ja** – në Mirditë për grue natare (që din me punue gjithfarë rangësh shtëpije), në Kurbin **dizmeli:** grua e qenun e hishme dhe e përmendun për këto cilsina. Përdoret zakonisht nëpër vajtime sidomos kur vajtohet një grue nuse a vajzë e re. në turq. Düzme “ gja e sajueme, e trillueme prej së paqënmeje, çpikje, rrene, falsitet” (F.O. f. 243).**

egërti-a – 1. *egërci-ja, bishë e egër. 2. ledh, mur egërti, me ngrehë shpin veç, egërti bân kaq; tyrq. Karabina. 3. mur i lyem egërti: mur veç i stërkritun me gëlqere, jo i lëmuem, 4. Lesh (G. f. 121). E kemi tek Dizdari vetëm me kuptimin e dytë, **karabina-ja** – *ndërtesë që i janë ngritë të katër muret e vu çatija, por që s'asht goditë përbrenda, s'asht mistrue kurrkah, pa dritare etj., egërti (Gazulli), (F.O. f.503).**

fëshehëz-a – *ushezë-a; pritë gjoje, pusi (tyrq) (G. f.129). E ndeshim me të njëjti njëjtin kuptim edhe tek Fjalori i Orientalizmave, **pusi-a** – *pritë, fshehëz, ushejzë (Shkodër, për pusinë në gjueti), shteg (F.O. f.780).**

fili-ja – *fëmni; i kishte mushkënit me fili, i kishte hi lisit fili: ixhram (tyrq) (G. f.131). Tek Dizdari kemi një shpjegim më të detajuar të kësaj fjale, **ixhram-i** – *Shkodër edhe sot: defekt trupor, e posaçërisht lëngatë e msheftë në trup (për njeri, për shtasë e për druj), çyrykllëk, ilet, gjymtim (F.O.f.431).**

flâmë-a – *me bâ vendin flâmë, i bâni gurët flâmë; m'e dlire vendin krejt, me bâ nuri (tyrq)* (G. f.134). E kemi tek Dizdari të pasqyruar me disa sinonime të kësaj fjale, **nur-i** – *ndriçim, shkëlqim, dritë, shndrimë, shajtrë, dritë shpirtërore, bukuri e hyjnueshme, bashkësi hiresh; hijeshi; fytyrë, dukë, të pamë të hirshëm* (F.O. f.722).

fli-ja – *kurban-i, sodak-u (tyrq)*, (G. f.135). Dizdari jep të njëjtin shpjegim madje, duket sikur këtë fjalë e ka hasur vetëm tek Gazulli, **sodak-u** – *fli, kurban (Gazulli)*, (F.O.f.918).

fogû-ni – *çikmâ-ni, qymlek-u (tyrq)* (G. f.136). Dizdari përdor dy variante për të njëjtin kuptim, **qymlek** dhe **çomlek-u** – *çymlek geg. Gjellë e bame me mish të trashë, qepë, hudra, ufull, pistil e e erëza, që zihen së bashku në një vorbë; asht njisoj si jahnija e Shkodrës* (F.O. f.179). Siç e vërejmë Dizdari i ka dhënë një shpjegim të detajuar kësaj fjale.,

frutë-a – 1. *e shtime për të keq, fitme (tyrq)*. 2. *sherr, bataçillek* (G. f.138). Tek Dizdari e ndeshim në variantin me **n**, kjo sipas besimit fetar, **fitne-ja** – *Jugë në Veri me theks të çvendosun fitne, por në anën katolike edhe me këthim të n:m në silabë të dytë, fitme, gërgasë, kalla, frucë, sica, ngicë (Mirditë), skëricë, ferrcë (Gazulli), farë (kat e Tiranës)*, (F.O.f. 280).

gapërr-a – *mertek-u (tyrq), gershanzë e hollë dhe e drejtë me se ngrëhet mbëloja e njiç pullazi të vogël* (G. f.143). Këtë variant turk nuk e ndeshim të shpjeguar tek Fjalori i Orientalizmave. E kemi vetëm tek Fjalori i Bashkimit me një kuptim të tillë, **mertek,u** - *traa i vogel* (F.Bs. f.262).

god-i - *ujdi-ja (turq) me ra në godi, me lidhë godin, nji shtëpi, nji punë me ndreqë; me goditë nji lojë* (G. f.152). E kemi tek Dizdari edhe në trajtë foljore, **ujdis** – 1. *ndreq, godis, ve për fije, ndërtoj, masaraj, rregulloj, sajoj, nasqiris, shestoj*. 2. *përkoj, përshtatem*. 3. *me pajtue, me shkue dakord, me pëlqye*. 4. *ujdisem: ndreqem, goditem, kërpitem në të veshun, në tualet, nisem, derti*. 5. *me ra në godi, me u ndreqë, me u marrë vesht*. 6. *perbluej, trilloj, sajoj, sendërgjoj*. 7. *si term fetar me iu ujdisë Imamit në ushtrimet e namazit* (F.O. f.1066). Siç e vërejmë Dizdari na ka dhënë një mori kuptimesh për këtë fjalë, ku vetëm njëra përkon me kuptimin e dhënë nga Gazulli. E njëjta gjë ndodh edhe me Fjalorin e Bashkimit për shpjegimin e kësaj fjale, **uidise (me)** - *me marshtue: me nreçe* (F. Bs. f.504).

gracel-e - *idhnak e i shpejtë, tyrq. sert* (G.f.154). E takojmë në Fjalorin e Orientalizmave me të njëjtin kuptim si tek Gazulli, **sertë (i,e)** – 1. *i fortë, i ngurtë*. 2. *i ashpër, i vrazhdë, idhnak, egërshan, nervoz, gracel, spûç, dejnuer* (F.O. f. 902).

grap – *njeri bark-grap: hollak, qeskin (tyrq)*, (G. f.155). E ndeshim me një shpjegim më të qartë tek Dizdari, i cili na ka dhënë shumë sinonime të kësaj fjale, **qeskin-a** – *Veri; në Jugë edhe qesqin – i shkathtë nga mendja dhe lëvizjet, syquet, i zhdërvjellët, i gjallë, mendje mpreftë, i shpejtë, veshtar, syçelë, grap, i shpërdhazëm, i vergjilët* (Gazulli), (F.O. f. 806). Tek Bashkimi e kemi, **ceskin,e** - *shpejte (i,e,t')*; *shdervjellte (i, e, t')* (F.Bs. f.64).

gjani lojse – *fj. tyrq., vegël zdrukthatarësh* (G. f.164). Tek Fjalori i Orientalizmave nuk e ndeshim këtë fjalë turke.

gjedheshtër-a – *interesë të hollash, fajde (turq); gjeth-i, bagëtija e trashë (lopë, që, bujë)*, (G. f.165). Me kuptimin e parë të dhënë nga Gazulli e kemi të shpjeguar mirëfilli tek Dizdari, **fajde-ja** – *geg. me shpërngulje theksi në tosk. fajdë: dobi, përfitim, prokopi, fruit Bardhi, venjim* (F.O. f. 263).

gjollë-a – 1. *rrasë ku u vehet para krypa delmevet, dhivet*. 2. *shms. gjolla – t, njollë, lye-ja, zhig, dangë (tyrq)*, (G. f.168). Ndonëse Gazulli na e paraqet si turqizëm fjalën **dangë** tek Dizdari nuk e ndeshim fare. Fjalori i Bashkimit e ka me të njëjtin kuptim, **dange,a** - *tserke,a* (F.Bs. f.80).

harcek-e – *i çvidhët, shdërvjellët, qeskin (tyrq); njeri, kal harcek (G. f.172)*. Gazulli ka përdorur turqizmin **qeskin** për dy fjalë shqipe, *grap* (f.155), të cilin e kemi të shpjeguar më sipër dhe *harcek* (f.172).

horatë-a – *mahi, hokë (tyrq) (G. f.177)*. E ndeshim me të njëjtin kuptim në Fjalorin e Orientalizmave, ndonëse Dizdari na e ka pasqyruar më qartë kuptimin përmes sinonimeve, **hoka -t** – *shaka, mahi, jereni, lojë fjalësh, gaz, gumçi, gaxhi, shagale (F.O.f. 392)*.

jereshtisë – *me i u vu kuj në shpindë, stërqitë, m'u pejditë (tyrq) (G. f.183)*. Dizdari jep të njëjtin shpjegim tek Fjalori (F.O.f.454), si Gazulli, madje i referohet atij, në lidhje me këtë fjalë që gjen përdorim në zonën e Malësisë së Madhe.

karriname-ja – *naze-ja (tyrq), me folë, me hangër etr. me karriname (G. f.193)*. Tek Dizdari e gjejmë me të njëjtin kuptim, **naze-t** – *sjellje, tëpruem, lëvizje që bahen për t'i pëlqye botës; të bamit sikur nuk due një gja që më jepet që të më luten të tjerët (F.O. f.706)*.

katik-u – *çeleng-u (tyrq), nishan i fituem me trimni ndër lufta (G. f.195)*. Dizdari në lidhje me këtë fjalë pajtohet me Gazullin, por ai na jep edhe prejardhjen e fjalës turke, **çelenk** – *tufël e stolisun me gur të çmueshëm që ngjitesh përmbi kësulë (F.O. f. 160)*, pra kemi thujse të njëjtin kuptim.

kejt – *thirrja ndër shprehje: medet (tyrq), kejt prudha! Kejt bar; fatzi-zezë (G. f.196)*. E gjejmë në kuptime tek Fjalori i Orientalizmave, **medet** – 1. *veri, ndihëm, nevojë, hall*. 2. *pasthm. ofshe, vaeme (Bardhi), kejt (Gazulli), kuku (në fatkeqësi) (F.O. f.632)*.

kërthaç-i – *kësaç-i (tyrq: kësatmak: me shkurtue), (G. f.201)*. Pak a shumë e ndeshim me të njëjtin kuptim tek Dizdari, **kësaç-i** – 1. *Shkodër: vegël e vogël sahatçishë si danë, që vlen për të kapë pjesët e imta ose për të shtrëngue*. 2. *Kosovë,Tiranë, vegël argjendarësh në trajtë të pincëzës (F.O. f.536)*.

kikirike-ja – *(persisht-tyrq) bimë qi bân bështajë me kokrra , të cilat, të rreshkuna, hahen (G. f.203)*. Këtë fjalë nuk e ndeshim tek Dizdari, ndoshta edhe nga fakti, se kjo fjalë mund të jetë një fjalë perse e jo turqizëm.

kipëcue – *me bâ kipë, çift (tyrq), (G. f.204)*. Një kuptim më të qartë të kësaj fjale na e jep Dizdari në Fjalorin e tij, **çift-i** – *numër që s'asht cub, tek, dhe që ka mundësi të pjestohet me numra të barabartë (F.O. f.170)*. E kemi tek Fjalori i Bashkimit, **chift,i -paar, paal,a (F.Bs. f.74)**.

kocë-a – 1. *gardh thuprash me pritë peshkun, dajlan (tyrq)*. 2. *shrrregull-a (Ljarja) rrshegull-a (G. f.206)*. Gazulli na ka dhënë dy kuptime kësaj fjale, ndërsa tek Dizdari e ndeshim vetëm me kuptimin e parë dhe të dhënë me një qartësi të plotë, gjithnjë duke iu referuar FGJSH, 71, **dajlan-i** – *instalim me huj dhe me të hurrme kallamash e trinash afër grykës së lumenjve dhe në bregje tjera të përshtatshme për të pritë e për të zanë peshq shtegtarë me shumicë (F.O. f.189)*.

koçek-u – *koçâ-ni, kërcyell- elli, 1. koçekët e gishtavet: ashikët (tyrq), cokët e gishtavet*. 2. *gur, shkrepë majuca si tpijë (G. f.207)*. Fjalën **ashik-u**, tek Dizdari e ndeshim në dy kuptime të ndryshme, ku i pari përkon me atë të Gazullit.

Po i vërejmë si më poshtë **ashik-u** – *ashti i kyçit të kambës, koci kyç i kupës së gjunit të bagtisë së imtë që përdoret në lodren omonime (F.O. f. 41)* dhe **ashik-u** – *dashnor, dashuronjës; amator, si qefli kangësh, bejtash, gjaje së bukur etj., (F.O. f.42)*. Me këtë kuptim Gazulli nuk e përdor. Edhe në Fjalorin e Bashkimit e ndeshim njëlloj si tek Dizdari, **ashik,u** – *dashnor (F.Bs. f.27)*.

kosî-ni – *kosel-i; shtipëz-a, shap-i (tyrq), (G. f.212)*. Fjalën **shap-i**, Dizdari e jep me dy kuptime të ndryshme. Në këtë rast i pari përkon me Gazullin, **shap-i** – *kimi sulfat i aluminit e i potasit, krypë minerale qërrudh gojën (F.O. f.950)* dhe **shap-i** –

sëmundje e randë dhe ngjitëse e bagëtisë së trashë; çfaqet me flluska në gojë, në gjë dhe në thundër; shapth (F.O. f.950).

kotille-ja – *nji tog (tok, tyrq) njerzish, nji grumbull i vogël njerzish* (G. f.212). Tek Fjalori i Orientalizmave kjo fjalë na paraqitet me një kuptim tjetër, të ndryshëm nga ai i Gazullit, **tok** – *Jugë: hajt ta tokim. toke: - kur përpiqen gotat në pije e sipër* (F.O. f. 1039). Edhe në Shkodër e rrethinat përkatëse e përdorim shpesh me këtë kuptim: *hajt ta tokim gotën...*

kotmar-i - *fili-ja, ixhëram-i (tyrq)*, (G. f.212). Me një shpjegim më të qartë e ndeshim tek Dizdari, **ixhram-i** – *defekt trupor, e posaçërisht lëngatë e msheftë në trup (për njeri, për shtasë e për druj), çyrykllëk, ilet, gjymtim* (F.O. f.431).

koxholl-i – *post-i (tyrq), shtrojë lëkure dhensh* (G. f.213). E ndeshim me të njëjtin kuptim edhe tek Dizdari, **post-i** – *lëkurë e bagëtisë së imtë, ma së forti e berrit me gjithë lesh, e regjun, që shtrohet për të ndejë, për t'u falë etj., koxhol, shtrosë* (F.O. f. 775).

krahol-i – *jelek-u (tyrq)* (G. f.214). Si sinonim të fjalës **krahol**, Gazulli ka përdorur fjalën **jelek**, të cilën Dizdari në Fjalorin e tij e shpjegon: **jelek-u** – *petk i shkurtën pa mangë që veshet nën xhakëtë në rrobe civile dhe përmbi anteri në ato kombëtare; krahoçe, krahol* (F.O.f. 451).

kryqe-ja – *pjesa e katërt, çerek-u (tyrq), nji kryqe buke: nji çerek buke (kur është e rrumbullakët)*, (G. f.219). E kemi njëlloj edhe tek Fjalori i Orientalizmave, **çerek-u** – *Jugë, Shqip. e Mesme me ramje të spirantit palat. -j- në trup të fjalës, por në Shkodër dhe ke Noli çejrek; e katërta e nji tanësije* (F.O. f.165). Në Fjalorin e Bashkimit e ndeshim me të njëjtin kuptim, **cherek,u** - *t'katert* (F.Bs. f.73).

kule-t – *të linda-t: kulezaz,t: bernavekli-të (tyrq) njata qi barshin bernavekë (brandavekë)*, (G. f.222). Këtë fjalë nuk e ndeshim të shpjeguar tek Dizdari.

kulë – *1.me bâ bark, m'u bâ bat (tyrq), është kulë muri; ajë me ra mbrendë; krh. Kul-ar-i, përkulë, kul-aç-i (kulaçi është prej grunt të mblmyem me voj e i sjellun si kular. 2. ngulë* (G. f.222). E kemi me të njëjtin kuptim, kryesisht me kuptimin e parë të Gazullit, por me një shpjegim më të qartë, **bat-i** – *Shkodër: nji rrasë pranë gropëz e përkulun dhe e mbështetun mbi nji copë shkop, që ngrehet me anë të nji spage a teli të lidhun për të, për të zanë zogj* (F.O. f. 74).

kunija-t – *treska metali qi virshin nuset në qafë, gjerdelekë-t (tyrq)*, (G. f.225).

Për këtë huazim turk, Dizdari i referohet Gazullit me të njëjtin kuptim (F.O. f.305).

kur-i - *shtërngesë, masë në hae e pije, periz-i (tyrq), me hangër me kuri, me i prishë të hollat me kuri...*(G. f.225). Ndryshe nga Gazulli Dizdari në Fjalorin e tij të njëjtën fjalë e jep me një kuptim krejtësisht të ndryshëm, **periz-i** – *“çengel dere” në të folmen e Kurbinit. khs. tur. pericik “gjuhëtha e bravës ose e drynit”* (F.O. f.765).

laqemi – *berraba (tyrq), ka me mbetë vendi laqemi, berlok: mos i lëshoni bagëtin laqemi; pa zot, pa roje* (G. f.227). Me të njëjtin kuptim e kemi edhe tek Fjalori i Orientalizmave, në të cilin, pasi jepen përdorimet nga Fjalorë të ndryshëm, na del edhe përkufizimi sipas Dizdarit, **berriaba** – *Shkodër, tokë, vend i lanun shkret, llagjeni; shkretinë* (F.O. f.97).

ladicë-a – *tirqë cungj, dyzllekë-t (tyrq)*, (G. f.227). E ndeshim me një shpjegim më të qartë e të hollësishëm tek Dizdari, **dyzllëk-u** – *Veri: veshje cohet e shajakut ç'prej menkupës sgjunit e deri në nye të kambës. Para 50 vjetësh në Shkodër ka pasë dyzllekë prej cohet të punuem me gajtana të zez, shumë herë të aracuem me fije arit. Kanë qenë bartë nën fistan prej shtëpijavet të para të vendit. Dyzellekët prej shajakut, sallde anash me gajtana të zez, bareshin prej kalorësve e spahive për tu mprojtë prej baltesh* (F.O. f.243).

laricë-a – *pelhurë shumë nyejesh, allaxhë-a (tyrq)*, (G. f.230). Tek Fjalori i Orientalizmave e kemi me të njëjtin kuptim, duke shpjeguar edhe zhvendosjen e theksit nga oksiton në Jug, në paroksiton në Veri, **allaxhá** dhe **allaxhë** - *lloj pëlhure e ndritun, e thurun me fije pambuku dhe mëndafshi, e zbukurueme me lule e vija, me të cilën bahen mintanë, fustana, dimi* (F.O. f.24). Tek Fjalori i Bashkimit e ndeshim me të njëjtin kuptim, **alladxhe** - *pellhure e larme* (F. B. f.21).

latue-oni – *prîç-i (tyrq. pirinxh: paftillë, teneqe* (G. f.231). Huazimin **pirinxh**, nuk e ndeshim si turqizëm tek Dizdari.

lepe – *thirrje urdhëno! Marshallah (tyrq)*, (G. f.234). Dizdari na jep një shpjegim më të saktë të kësaj fjale, e cila gjen përdorim në mbarë trevën shqiptare, **marshalla** – *në Jugë e Shqip të Mesme me apokop në-h-, në Veri edhe me epentezë të – r-, marshallá: e faltë Zoti, rueje Zot! Gja e ligë mos e gjetët! Në Malësi të Madhe “mirëmbare”* (F.O. f.622).

lpëndër-a – *pupul-a (tyrq. pupla)*, (G. f.239). Tek Fjalori i Orientalizmave, **pupël-a** – *Shkodër: pendët e shpendë që dalin ndër krahë e në bisht, kur rriten, e u vlejné për të fluturue, lpëndër, pëndël, shpendël* (F.O. f.780).

lugë llaçi – *mistri-ja (tyrq) vegël këthistarësh, me mârre llaçin me i a vum gurit* (G. f. 240). Nuk e ndeshim të shpjeguar këtë fjalë tek turqizmat e Dizdarit.

llaqemi-ja – *me lëshue llaqemi, mos i lësho berret llaqemi: lirisht pa kurnji rojë, pazot, baskan, berraba (tyrq). fj. tyrke? All’axhami (?)*, (G. f.244). Këtu kemi një variant të fjalës **llaqemi** (G. f.227), së cilës i ka vënë sinonimin turk **berraba**, që ne e kemi shpjeguar më sipër sipas Dizdarit. Gjithashtu Gazulli ka vënë në pikëpyetje fjalën **all’axhami** si fjalë turke, por që ne nuk e ndeshim fare tek Dizdari.

Kjo të lë të kuptosh se mund të mos ekzistojë si turqizëm.

llogje-ja – *lye-ja, dângë-a (tyrq)* (G. f.244). Huazimin turk **dangë** nuk e kemi të shpjeguar tek Dizdari.

mat – *në të përulun, çpâtas, bark, bat (tyrq)*, (G. f.251). Si turqizëm fjalën **bat** e kemi shpjeguar më sipër, si sinonim të fjalës, **kulë** (G. f.222).

matosë- 1. *me marrë mbë njënen ânë:...i ka marrë dallash (tyrq)*. 2. *m’u turrë*. 3. *me dhanë krah, rrugë* (G. f.251). Ashtu siç e ka shpjeguar Gazulli, me të njëjtën trajtë na e jep edhe Dizdari, **dallash** – *terthuer, jo mbarë, ters, për së kithi, krahajt* (F.O. f. 190).

mbëkatni-ja – 1. *cilsija e atij qi mund të mbëkatnojë*. 2. *mbëkat-i; fraz. me ra në mbëkat: për: me hÿ në mbëkat; frazë tyrke: gjynaha girmek* (G. f.254). Dizdari e përmend këtë frazeologjizëm tek Fjalori i tij, në lidhje me fjalën **gjynah**, ...**gÿnaha girmek** – *me të ardhë gjynah. fraz. para 30 vjetësh (sot s’ndigjohen ma)*, (F.O. f.316).

mbëgojcë-a – *mëgjojc-a, hekuri i frënit të kalit qi hÿn në gojë; tyrq. shebes* (G. f.254). Tek Dizdari e kemi **shebesh-i** – *Shkodër e ngjeti: pjesë e hekurt e frenit të kalit që i futet në gojë, mëgojcë* (F.O. f.955).

mbrrakulli-ja – *gumçi-ja, hokë-a (tyrq), fjalë gazi*, (G.f.257). Në Fjalorin e Orientalizmave e ndeshim të njëjtën fjalë me dy kuptime, ku vetëm njëri përkon me Gazullin, **hoka-ja** – *përdorëse, vegël prej llastre, tunçi ose gastareje, në të cilën shtihet boja, mereqepi për të shkruer; kalamar, ngjyranë* (F.O.f.392) dhe **hoka-ja** – *shaka, mahi, jereni, lojë fjalësh, gas, gumçi, gaxhi, shagale* (F.O. f.392).

mejendër-a – *menjenë (tyrq)* (G. f.258). Ndryshe nga Gazulli, Dizdari na e jep me këtë trajtë, **mengene**- *Jugë ku edhe mengjene-ja; menjene Shkodër; mejëne Tiranë, Krue, ku dhe mengëne; vegël prej hekuri a prej druni e vendosun qindrueshmenisht perbri tezgjahit të punës, që vlen për të shtrëngue punimet që kanë të bajnë me sharrim, me të struguem, me të limuem, për të rrafë me çekiç etj.* (F.O. f.641).

mû – *shî, lik, bash (turq)*, (G. f.271). Këtë huazim turk tek Dizdari e kemi me një kuptim tjetër nga ai që na ka dhënë Gazulli, **bash-i** - *krye, shef, kryetar; dorë e parë, ma e mira, mezja, kryesorja; cermë* (F.O. f.71).

mush-i – *push-i (turq)* (G. f.275). Kjo fjalë nuk ekziston në Fjalorin e Dizdarit.

myzyrë-a – *mynxyrë-a, fraz. me bâ myzyrë! Me bâ alet (turq)*, (G. f. 275). Fjalën **alet** tek Fjalori i Orientalizmave nuk e kemi me të njëjtin kuptim si tek Gazulli. Vërejmë, **alet-i** – *Jugë, Shqipni e mesme, por në Veri me një -h- protetike, tue volarizue l-në dhe me asimilim në zanoren theksore hallat; vegël që asht ndërtue për të krye një punë, e vlefshme për të prodhue një efekt: në shtrim të zanatit, në fabrikim, në bujqësi, në operacione mjekësore etj.* (F.O. f.18). Edhe në Fjalorin e Bashkimit e kemi me të njëjtin kuptim, **alet,i** - *nnimduers,i, vegël, perdorse* (F.Bs. f.20).

naklim-i – *mendim qi ngulet ndër mendë, përshtypje, vesvese (turq)*, (G.f.276). Dizdari ka përdorur shumë sinonime për këtë fjalë, në mënyrë që të japë një përkufizim më të qartë të fjalës, **vesvese-ja** – *Jugë; në Kosovë e Shkodër, me shpëngulje theksi vesvèse: dyshim, mani, rure, pingil, aporri, syç droje, sticë, persekusjon* (F.O. f.1087). Nga kjo, kemi edhe foljen **naklue** – *me bâ nakël, vesvese (turq)*, (G. f.276).

ngapërr-a – *gapërr-a, mertek-u (turq)* (G. f.288). Në Fjalorin e Bashkimit e kemi, **mertek,u** - *traa i vogel* (F. Bs. f. 262).

partalle-ja – 1. *çadëm-a, (turq) frugë. 2. pishkuricë* (G. f.300).

pat-i – 1. *kat-i (turq) shpi dy-tri patesh. 2. pati i gurit: faqja e lame e gurit, siprina e gurit* (G.f.301). Me të njëjtin kuptim e kemi edhe tek Dizdari, i cili përkon me kuptimin e parë të Gazullit, **kat -i** – *në Veri ban shumësin në kete: tanësija e këthinave të një godine që gjinden mjedis të njajtës dysHEME dhe të njajtit tavan; pat, pod, golë, darathë, shkëlmë* (F.O. f.519).

pëndël-a – *pupul-a (turq)*, (G. f.303). Tek Fjalori i Orientalizmave kemi një shpjegim më të hollësishëm, **pupël-a** – *Shkodër, pendët e shpendëve që u dalin ndër krahë e në bisht, kur rriten, e u vlejné për të fluturue, lpendër, pëndël, shpendël* (F.O. f.780).

përbuzët-i – *buzëhollë, nazeli (turq)* (G. f.305). Dizdari përmes sinonimeve të shumta të kësaj fjale, që i jep sipas zonave përkatëse, na nxjerr në pah edhe përkufizimin e kësaj fjale, **nazeli-je** – *geg veriore: nazelleshë, nazetor-e, nazetorkë tosk., që ban buzë në të ngrame, që don petka të zgjedhuna në veshje etj., buzëhollë, sqimatar, spitullaq, dheksatar, qepurar* (F.O. f.707).

përdah-i – *vegël kthistarësh-dibranësh; drrasinë e vogël e lëmuet në një faqe, me një dorçë prej dore qi e kapë, me të cilën përhapet llaçi kur savisin muret. (turq)*, (G.f. 305). E kemi tek Dizdari me disa kuptime, **perdah-i** – 1.*vegël muratorësh, kthistarësh; dërrasinë e vogël, e lëmuet në një faqe, me një dorëz përsipër, që vlen për të rrafshue lloçin e gëlqeres që asht shtrur në faqe të murit kur e suvatojmë. 2. përdorëse e qeleshexhive, prej mermeri, në trajtë të një kallep sapuni të madh, që shërben për të ngjeshun leshin. 3. me ba përdah mjekren në të rrueme. 4. baj përdah me zumpare një mobilje...*(F.O. f.763).

përfati-ja – 1. *prefati-ja: iqram (turq), 2. gostë-a* (G. f.306). Me trajtën **iqram** nuk e takojmë tek Dizdari, por duhet të jetë fjala **ixhram-i**, të cilën e kemi shpjeguar më sipër në lidhje me fjalën, fili - **ixhram-i** – *Shkodër edhe sot: defekt trupor, e posaçërisht lëngatë e msheftë në trup (për njeri, për shtasë e për dru), çyrykllëk, ilet, gjymtim* (F.O.f.431). Por me këtë kuptim nuk na del tek Gazulli.

përshim – *bash, tamam (turq)*, (G. f.317). Në Fjalorin e Orientalizmave e kemi fjalën **tamam** – *në Veri dhe me ndërrim të m:n, taman, 1. aq sa duhet; plot; pikë për pikë, saktësisht, pikërisht, kryekëput, njipërnji, tunjinë; bash, cok, shi, mu, mjet (Budi), lik, pëtdhim (Gazulli)*, (F.O. f.993).

peshak-e – *njeri peshëkeq, njeri me mend pak, në çek (turq), peshkakeq-e*, (G. f.31). Dizdari jep thujse të njëjtin kuptim për këtë fjalë, ndonëse Gazulli na e jep me kuptim pexhorativ, **çeki-ja** – *njisi peshet, okë 365 derhemshe, ma e vogël se ajo e kandarit 400-she. Para 50 vjetësh: si e peshove, si e bleve, si e shite, a kandar a çeki?* (F.O. f.159).

peshim-i – *makarâ-ja (turq)*, (G. f.318). Dizdari këtë fjalë na e ka dhënë në disa kuptime, ndonëse këtu nuk sqarohet se me cilin kuptim e kemi tek Gazulli, **makarâ-ja** – 1. *makinë e thjeshtë, e përbame prej një rrote nëpër të cilën përshkohet një zingjir, një rrip a një litar, shërben për të ngritë pesha.* 2. *makarâ përi në Jugë penj makine në makarâ, rrotull, rrakël, rrotkë, çikrik.* 3. *Vegël sahatçishë e bame me qime kali.* 4. *mengene në vegjë.* 5. *plumbç me pe që përdorin murtarët në drejtim të murit, peshim, vegël kthistarësh* (F.O. f.609). Duket sikur kuptimi i fundit, që na ka dhënë Dizdari, përkon me atë që ka dashur të na thotë Gazulli.

pizar- *pishman (turq), pendueshëm (jam); krh. fjalë turke bizar: mërzitshëm, prishë qefit* (G. f.325). Të njëjtin përkufizim për këtë huazim turk na ka dhënë edhe Dizdari, **pishman** – *bahem pishman, pendohem* (F.O. f.772).

prâjshëm-i – *i qetë, i paqët, rehatshëm (turq)* (G. f.333). Tek Dizdari e kemi me ndryshim fonetik të e në a, gjithashtu na e ka pasqyruar në disa kuptime, **rahat** – 1. *qetë, pa trazim, prehje, çkujdes.* 2. *pasmeni, mirëqënje, tumirë.* 3. *në rrjedhoja e në fjalë-formime: rahati-ja, rahatim-i, rahatisht, rahatshëm, rahato etj.* (F.O. f.827).

prapët-i – *qi s'vjen mbarë, qi s'ka te mbare; njeri i prapët: njeri abrash (turq) rrugë e prapët* (G. f.333). Me një kuptim krejtësisht të ndryshëm e ndeshim tek Dizdari, **abrash-e** – *Shkodër: ngjolla të vockëla e të kuqremta të lëkurës që u beditet prej rrezeve të forta të diellit fytyrave të leshverdhëve sidomos, ma të dukshme verës; verike, prenjka// në Jugë thuhet për njeri me flokë të verdhë që shkrepin në të bardhë. Thuhet edhe për kafshë që janë të laracueme // Në Përmet, vezë abrashe, të ngjyeme kuq e bardhë, me lara* (F.O. f.2). Siç e shohim, Dizdari ka bërë një pasqyrim të kësaj fjale sipas përdorimit në zona të ndryshme të Shqipërisë.

preshqë-it – *preshtë, preshk-u (?), arbaxhikë (turq) qepujkë-a (Berati) kokarkë-a (Korça) krokar-i* (G. f.336). Huazimin **arbaxhikë**, nuk e ndeshim të shpjeguar në Fjalorin e Dizdarit.

pshtymëtar-i - *qymlek-u (turq) zguer i bâm me qitë tymin jashtë* (G. f.340). Dizdari përdor një formë tjetër fonetike për fjalën e mësipërme, **çomlek-u** – *tosk; çymlek-u geg.: gjellë e bame me mish të trashë, qepë, hudra, ufull, pistil e erëza, që zihen së bashku në një vorbë; asht njisoj si jahnija e Shkodrës* (F.O. f.179).

reks-i – *qef-i (turq)* (G. f.344). E kemi tek Dizdari në dy variante, *qefi* dhe *qejfi* duke u nisur edhe nga përdorimi sipas dialekteve, **qejf-i** – *tosk., në Veri me ramje të spirantit j qef, 1. dëfrim, zbavitje, argëtim, prehje. 2. dëshirë, kënaqësi, kompliment. 3. prekje, hatër, kondendim. 4. humor, formë. 5. andë, gusto, vullnet. 6. mirakandje, ftekje, kapricluks. 7. fantastikim* (F.O. f.790).

remëc – *paq-i, paqë-a, qeti, qetësi, rahati (turq)* (G. f.345). Këtë turqizëm e kemi të shpjeguar edhe më sipër, ndonëse Gazulli e ka përdorur si sinonim i fjalëve të ndryshme, **rahat** – 1. *qetë, pa trazim, prehje, çkujdes.* 2. *pasmeni, mirëqënje, tumirë.* 3. *në rrjedhoja e në fjalë-formime: rahati-ja, rahatim-i, rahatisht, rahatshëm, rahato etj* (F.O. f.827).

resk-u – *huj (turq)*, (G. f.345). Gazulli nuk na ka dhënë një shpjegim të qartë të kësaj fjale, ndërsa në Fjalorin e Orientalizmave kemi një shpjegim më të shkoqur, **huj-i** – *në Veri e shumkund; por në Jugë dhe Elbasan edhe tue palatalizue spirantin fundorëhuq-i: vertyt, veti, pelqyrë//vese, defekte//Skrapar, sjellje, temperament; adet, zakon* (F.O. f.398).

ries-i – *krahishtim, mbarashtim, rregullim, temizllek (? turq)*, (G. f.346). Ndonëse Gazulli e ka vendosur me pikëpyetje huazimin turk, ne e gjejmë tek Dizdari thuajse me të njëjtin kuptim, **temizllek-u** – *pastërti, dliresi, paqlllek* (F.O. f.1018).

rrabe-ja - *tokë e pa-punueme me gurë e çufrra: tokërrabe...(turq. harabë)*, (G. f. 348). Pothuajse me të njëjtin kuptim e ndeshim këtë fjalë tek Dizdari, **harab-e** – *Veri dhe në Jugë dhe harap: gja e lanun mbas doret, në shkallnim (për ndërtesë, tokë); mraztë; zhgatërr; rrenim* (F.O. f.352).

rrëfangull-a – *ilik-u (turq) bira ku hyn mbërthëca (pullë a sumbullë, etr)*, (G. f.351). Sinonimi turk i kësaj fjale përkon me shpjegimin e dhënë nga Gazulli dhe të tillë e gjejmë në Fjalorin e Orientalizmave, **ilik-u** – *syth nëpër të cilin përshkohet mbërthëhet pulli, kopsa; brimë e qepun anash, ku hyn mbërthëca, pull a sumbull; rrëfangull, goja e sumbullës, syth, thiliqe, mbërtheskë* (F.O. f.415).

skërbaç-i – *dredhë-a, kamxhik-u (turq) = kerbagj (turq)*, (G. f.370). Të dyja huazimet turke i ndeshim tek Dizdari me të njëjtën domethënie, **kamxhik-u**- *kryesisht frushkull lëkuret ngjitur në një dorëprej druni, që vlen për t'u grahë kuajve, sidomos kur ngrehin karron a karrocën; frashkull, dredhë, kështur* (F.O. f.491); **kërbaç-i** – *copë drujet e ujdusun, ose pjesë lëkuret e fortë e përdredhun dhe e zgjatun që e përdorshin për të rrafë kend; kamxhik, dredhë, kështur* (F.O. f. 531).

stërqitë – *jereshtisë...me i u gjetë kuj havale (turq) me mërzitë këndin* (G. f.377). Dizdari e shpjegon me disa variante huazimin **havale** – *vepri e riferimit, e transmetimit // bezdi, mërziti, gapërr* (F.O. f. 373).

stërf – *rrah, fet (turq) ma bâ stërf: me bâ fet, flâmë* (G. f.377). Në Fjalorin e Orientalizmave na del më i qartë kuptimi i kësaj fjale, **fet** – *me ba fet: me pushtue ngadhnimisht* (F.O. f.272).

shtërzim-i - 1. *shtërzim-it*. 2. *shtërzim barku, kapsellek-u (turq)* (G. f.412). Tek Dizdari kemi rrënjën **kaps** – *të dalunit jashtë me vështirësi*, dhe më pas formimin **kapsllëk**, me anë të prapashtesës **-llëk**, të cilën Dizdari e ka shpjeguar duke iu referuar Gazullit (F.O. f. 501).

shtonë-a – 1. *vijë nën dhe*. 2. *zavorr-i, gjiriz-i (turq)*, (G. f.414). Për këtë fjalë Dizdari i është referuar Fgjsht, 157, **gjiriz-i** – **gjeriz** – *llagëm i nevojtores; gropë e nevojtores, e sqollit* (F.O. f.309). E kemi edhe tek Fjalori i Bashkimit, **gherix,i** - *vii nën toke* (F.Bs. f.140).

tajë-a – 1. *burmë-a (turq)*. 2. *e shtyme, fuqi-ja* (G. f.418). E ndeshim me një shpjegim më të hollësishtëm tek Dizdari, **burmë-a** – *tajë, torrlë, që tue qenë e përdredhun në majë, ngulet ku dishrohet, tue e rrotullue me kaçavitë* (F.O. f.124). Ndërsa Gazulli na jep dy kuptime të ndryshme kësaj fjale.

toj – *kesh, kinse, goja(turq)* (G. f.427). Këtë huazim turk nuk e ndeshim të shpjeguar tek Fjalori i Orientalizmave.

trazë-a – 1. *qymlek-u, (turq)*. 2. *trinë bi zjarm me pritë shkëndijat, shkorsë shkorcë* (G. f.429). Fjalën **qymlek** e kemi shpjeguar më sipër.

tû-ni – 1. *tûni i të lindavet, ushkurlleku i të lindavet, pelhura e qepme kah pershkohet ushkor*. 2. *tûni i sëpatës: ana qi s'pret*. 3. *tuni i pushkës, kondaku i pushës (turq) bisht pushke* (G. f.434). Fjalën **kondak** e kemi të shpjeguar qartë tek Dizdari me dy kuptime, **kondak-u** – 1. *koka e trashë dhe e drunjtë e pushkës, drushta, tûni i pushkës, qyta*. 2. *të mbështjellunit e kërthinit me shpëgaj, skutina dhe me një bohçe a dizgë të shkurtë përsipër, në mënyrë qi të qindrojë më mirë në trup kur bartet andej e këndeje* (F.O. f.551).

thekët-i-a – 1. *qi therë, therës: miell i thekët: i bluëm trashë, ballgur-i, borgull-i (turqisht) bukë e thekët: qi vret në të hangun* (G. f.437). Këtë huazim nuk e ndeshim të shpjeguar tek Dizdari.

ushtuer-ori - *ushtoreshtë-a, grueja e ushtorit, begçi-ja (turq); vështrimi i parë: ushtar-i, tash: rojës arash e pyejesh (G. f.447). Tek Fjalori i Orientalizmave e ndeshim me bashkëtingëlloren e shurdhët **k**, **bekçi-u** – Jugë, Shqip. e Mesme: rojtar i arave e i vëneshtave në periferi ose në katund; ushtuer, polak (sllav), veshtuer (Mirditë)... (F.O. f. 90).*

verrëç-i – 1. *lëngatë, zverrëç-i, sarallek-u (turq). 2. bar verrëi (G. f.454). E kemi të shpjeguar hollësisht edhe sëmundjen, **sarallek-u** – sëmundje e mëlçisë së zezë e shkaktuar nga të hymit e vnerit në gjak dhe e karakterizuar nga ngjyra e verdhë që bje lëkurës të erdhët, zvercë, verdhëz, verrç, zbeti (F.O. f.879).*

vetllim-i – 1. *lugsim drûje. 2. zbukurim muresh si brez qi spikon përjashta; sylme-ja (turq) (G. f.455). **vigël-a** – vegël me a pa rrotë me se mësohen kalamajt me ecë, tamlik-u (G. f.456). Huazimin **sylme** nuk e kemi si turqizëm tek Dizdari.*

zânore-ja – *xharize (turq) e idhët si zana, e tërbueme si zanat kur hasë kush në tryezë të tyn'et (G. f.464). E ndeshim me të njëjtin kuptim, **xharize** – Shkodër, idhnake, potexhije, nervoze që prish qetsinë e tjetrit; grue që s'ia priton fjalëve, me qipuj (F.O. f.1101).*

zit-i – *marak-u (turq) (G. f.470). E kemi në disa kuptime tek Dizdari, **marak-u** ose **merak – u** – 1. dëshirë për të marrë vesht diçka rreth një njeriu a një gjaje; mallë, përmë; përkujdesje, kasavet, shqetësim. 2. dyshim, vesvese, shqetësim. 3. dashuni, sevda. 4. lakmi, dëshmi, pasion, mani. 5. mllef, pek, kërshëri. 6. neveri, ndoht (F.O.f. 643).*

zûmbç-i – *fëmëz-a, biz-i (turq) (G. f.472). Në Fjalorin e Orientalizmave e gjejmë këtë huazim me një shpjegim të hollësishëm, **biz** – Shkodër: lodra që luhet me hedhjen e bizit shumë herësh, i cili ngulet në dhe me bar të njomë ma së fortë, tue qenë lojë pranverore. Kjo lodër luhet edhe me brisk me majuc, por gjithnji i thonë biz...(F.O. f.109).*

zhig-u – *llogje-ja, dangë-a (turq) (G.f.474). Huazimin turk **dangë**, Dizdari e shpjegon përmes fjalës **damkë, dangë-a** – njollë llaçkë, llogje, zhigë, cerke, zhybel (F.O.f. 193).*

Siç e vërejmë, në Fjalorin e Gazullit numri i turqizmave është i konsiderueshëm. Kemi afro 123 turqizma të përdorura. Në pjesën më të madhe të rasteve huazimet turke të Fjalorit të Gazullit kanë gjetur shpjegim tek Fjalori i Dizdarit, por ka pasur nga ato që Fjalori i Orientalizmave nuk i kishte si turqizma, ndërsa tek Gazulli na dilnin si të tilla, psh.: **bankë-a** – *gânç-i (tyrq); **camuruk-u** – tyrk. kotrum, avrom; **capâ-ni** – 1. 2 konopët e samarit me se lidhen ânët e barrës në kal, zenji-ja (tyrq); **qyne** – asht bâ qyne: plakë e stërplakë; sh. qino (tyrq); **çëjnë-a** – shpotë-a, qestija (tyrq): me shpotitë, me qestisë (tyrq), me vu në gaz; **dengël-a** – me qitë dengla, dokrra, bente (tyrq), 2. arsyena qi s'ecin; **gjani lojse** – fj. tyrq., vegël zdrukthatarësh, **kikirike-ja** – (persisht-tyrq) bimë qi bân bështajë me kokrra, të cilat, të rreshkuna, hahen; **kule-t** – të linda-t: kulezaz,t: bernavekli-të (tyrq) njata qi barshin bernavekë (brandavekë); **latue-oni** – prîç-i (tyrq. pirinxh: pafillë, teneqe; **lugë llaçi** – mistri-ja (tyrq) vegël këthistarësh, me marrë llaçin me i a vum gurit; **llogje-ja** – lye-ja, dangë-a (tyrq); **mush-i** – push-i (tyrq); **thekët-i-a** – 1. qi therë, therës: miell i thekët: i bluëm trashë, ballgur-i, borgull-i (turqisht) bukë e thekët: qi vret në të hangun. Kjo të lë të mendosh dhe të vësh në dyshim prejardhjen e tyre me origjinë turke.*

Turqizmat tek Benedikt Dema

amball-i - *jamball (turq), sakarezë* (D. f.12). Tek Dizdari kemi një shpjegim të hollësishëm të kësaj lloji bime, **jamball-i** – *bimë e familjes së bishtajoreve, gjysmë shkorreze me cung të drusuem kërcyelli të gjatë e me lule të mbledhuna në vilë që binë në vende ranore të bregdetit; gliqirizë, zakarezë* (F.O. f.440). Edhe Fjalori i Bashkimit e ka një fjalë të tillë **amball,i** – *jamball* (F.Bs. f.21).

argjviz-i - *(turq), arrëvizë* (D. f.14). Këtë huazim turk nuk e ndeshim të shpjeguar në Fjalorin e Orientalizmave. Dema ka të njëjtin shpjegim si Fjalori i Bashkimit, **arghivix** - *armixe,a* (F.Bs. f. 25).

arkapi-a – *(turq), derzë, erë e vogël* (D. f.14). E kemi me të njëjtin kuptim tek Dizdari, **arkapi-ja** – *Shkodër: deriçkë që lehet midis shëpijash ose ndërmjet oborreve për të hy e dalë në mes të njani – tjetrit komshitë* (F.O. f.36).

ashkzë-a – *bakam (turq), ashkja e landës tropikale, qi përdorej dikur për me njeje kuq* (D. f.15). E kemi tek Dizdari, **bakam-i** – *kozmetik për fytyrën e gruas// ngjyrë e kuqe ose e kuqërrisme, me të cilën nuset muslimane të Shkodrës edhe të rrethit, para 25-30 vjetësh lyejshin dy mollëzat e faqeve* (F.O. f.62).

daktisë – *turq, me u largue, me marrë malin; me u dhane mbas një gjaje, me të shkue mendja, tretë* (D. f.43). Duke iu referuar Fjalorit të Bashkimit, Dizdari e shpjegon, **daktisë (me u daktisë)** - *me u largue, me marrë malin* (F.O. f.190).

Siç e vërejmë, në Fjalorin e Benedikt Demës, numri i turqizmave është tepër i vogël në krahasim me fjalorët e Bardhit e të Gazullit. Për këtë mund të ketë ndikuar fakti se Dema na ka pasqyruar një Fjalor, i cili përban fjalë të rralla të gjuhës shqipe që nuk gjenden në Fjalorin e ‘54, ose kanë një kuptim të ndryshëm nga ai. Sepse, po të kemi parasysh fjalësin e shqipes, është e pamundur të mos përfshihen huazimet turke, të cilat janë rrënjësor në gjuhën shqipe, falë ndikimit dhe pushtimit për mëse pesë shekuj në vendin tonë. Por, nuk duhet lënë pa përmendur se autori, në fund të Fjalorit, ka përfshirë një listë fjalësh, të cilat i kemi analizuar më lart. Pikërisht aty, numri i turqizmave është me të vërtetë i madh, të cilat, sipas autorit, kanë dalë nga përdorimi duke kaluar në arkaizma.

- Italianizmat

Duke filluar me Fjalorin **latinisht –shqip** të Frang Bardhit, vërejmë se italianizmat zënë një vend relativisht të madh. Biles, mund të thuhet se shkojnë thuajse një për një me fjalët latine. Demiraj shprehet se, prania e ekuivalenteve turqisht shpjegohet mjaft mirë, po të mendohet se priftërinjtë shqiptarë kanë qenë nën zgjedhën turke dhe kanë përdorur të dy gjuhët, por më pak shpjegohet kuptimi i fjalëve italisht, sidomos në ato raste kur ato janë krejtësisht të ngjashme.¹³⁵ Dhe si të tilla ka mjaft. Konkretisht: *caballus, cauallo* - *kaale* (B. f.9), *capus, capone* – *capue* (B. f.10), *cichorium, cicoria* – *rcoreia* (B. f.11), *crassus, graffo* – *maaim* (B. f. 16), *damnum, danno* – *dam* (B. f. 17), *durus, duro* – *i forte* (B.f.21), *ebrius, ebrio* – *i deeim* (B. f.22), *ecce, ecco* – *ge* (B. f.22), *efurio, efurire* – *cham uu* (B. f.23), *folium, foglio* – *gieç* (B. f.26), *filia, figlia* – *bija* (B. f.26), *flamma, fiamma* – *flacha* (B. f.26), *frumentum, frumento* – *grune* (B. f.28), *fugis tu, fugi tu* – *iche ti* (B. f.28), *fungus, fungo* – *kepurç* (B. f.28), *granarium, granaio* – *magazzij oó hambaar* (B. f.29), *innocens, innocente* – *i paatecheic* (B. f.37), *labium, labro* – *buse* (B. f.44), etj.

Gjithashtu ndeshim edhe elemente latine, të cilat kanë një rrënjë krejt tjetër me ato italiane, saqë të bën të mendosh se kemi të bëjmë me dy gjuhë të largëta. Raste të tilla janë të plota, si psh.: *calix, bicchiero* – *putyr* (B. f.10), *callidus, aftuto* – *diecheich* (B. f.10), *cancer, gambaro* – *gaforreia* (B. f.10), *caper, becco* – *siap* (B. f.10). *choerea, ballo* – *chezimm* (B. f.11), *colyphium, focaccia* – *pogaccia* (B. f.13), *crimen, colpa* – *te mguem oó mpcat* (B. f.16), *crumena, borfa* – *culeta* (B. f.16), *cubile, letto* – *strat* (B. f.16), *delambere, leccare* – *me lepyym* (B. f.18), *deeffe, mancare* – *me meguem* (B. f. 19), *depopulari, predare* – *me pruem* (B. f.18), *dives, ricco* – *i begate* (B. f.20), *domina, padrona* – *εogna* (B. f.21), *enim, percioche* – *prafu* (B. f.22), *equa, cavalla* – *pella* (B. f.22), *fætibus, puzzolente* – *i kielbete* (B. f.26), *fætor, puzzore* – *kielbef sine* (B. f.26), *immeres, innocente* – *i paatecheich* (B. f.34), *implexus, inuoluto* – *ngaterruem* (B. f.35), *inaudax, timido* – *mneerues* (B. f.35), *incubare, ftar fopra* – *me mbetune perfiperi* (B. f.36), *index, demofratore* – *deftues* (B. f.36), *initium, principio* – *te çane fjl* (B. f.37).

Po t'i bëjmë një vështrim të mëtejshëm italianizmave të Fjalorit të Bardhit, duke u nisur edhe nga fakti se këto fjalë i përkasin një italishteje para pesë shekujsh, ka mjaft raste ku kemi ndryshime në formën fonetike të fjalëve në italisht, por edhe të përkthimit të bërë nga Bardhi. Për të vënë në dukje koherencën semantike të këtyre fjalëve i kemi bërë një përqasje me Fjalorin italisht –shqip¹³⁶ të Ferdinand Lekës dhe Zef Simonit.

Në fillim ndeshim raste të ndryshimit të formës së këtyre fjalëve:

bucea, bocca – *cafsciata* (B. f.9). Në Fjalorin italisht –shqip kjo fjalë si e tillë nuk gjen përdorim, por përdoret **boccone** – 1. *kafshatë, kafshore*. 2. *gjë e shijshme*. 3. *copë, mish me helm, helm* (FISH, f.141).

calix, bicchiero – *putyr* (B. f.10). Sot përdoret me **e** dhe jo me **o**, siç na e ka paraqitur Bardhi, **bicchiere** – *gotë* (FISH, f.134).

Cancer, gambaro – *gaforreia* (B. f. 10). Në Fjalorin Italisht –shqip kjo fjalë përdoret me **e** dhe jo me **a**, **gambero** – *gaforre, karavidhe* (FISH, F. 475).

¹³⁵B. Demiraj, “Dictionarium latino –epiroticum”, Botime Françeskane, Shkodër, 2008, f. 39 .

¹³⁶F. Leka, Z. Simoni, “Fjalor italisht –shqip”, Tiranë, 2000.

genua, genocchi – *giugnete* (B. f.29). Sot e ndeshim si **ginocchio** - *gju* (FISH, f.486).
labium, labro – *buae* (B. f.44). Fonetikisht e kemi me dy **b, labbro e labbra** – *buzë* (FISH, f.606).

longus, longo – *ghiate* (B. f.50). Në Fjalorin Italisht –shqip kjo fjalë përdoret me **u** e jo me **o, lungo** – *i gjatë* (FISH, f.638).

noverca, matregna – *nierca* (B. f.68). E ndeshim tek Fjalori italisht – shqip në këtë formë, **matrigna** – *njerkë* (FISH, f.664).

Më pas gjejmë edhe fjalë italiane të përdorura tek Bardhi me kuptime të ndryshme nga Fjalori italisht – shqip:

callidus, aftuto – *diecheich* (B. f.10). Tek Fjalori italisht –shqip e kemi, **astuto** – 1. *dinak, finok, dhelpërak, dredharak*. 2. *i hollë, mendjehollë, mendjemprehtë* (FISH, f.97).

fel, file - *t ambelçite e mufcheniuet* (B. f.25). Tek Bardhi është përdorur në kuptimin figurativ, ndërsa Fjalori italisht-shqip e ka, **file** – 1. *Vrer*. 2. *mlef* (FISH, f.435).

iudæus, giudeo – *zuççij* (B. f.43). Në kontekstin fetar e kemi tek Fjalori italisht – shqip, **giudeo** -1. *judës, judeas*. 2. *hebre, çifut* (FISH, f.491).

miluus, nibbio – *schypeia* (B. f.59). E ndeshim ndryshe tek Fjalori, **nibbio** – *qift* (FISH, f. 717).

Por, kemi edhe fjalë të përdorura nga Bardhi në gjuhën italiane, që Fjalori italisht – shqip nuk i ka, siç është rasti i fjalës, *implexus, inuoluto* – *ngaterruem* (B. f.35).

Në Fjalorin e Gazullit, italianizmat janë më të pakta në numër për nga intensiteti, ndoshta për faktin se ka dhënë ekuivalentet e fjalëve në shumë gjuhë, jo vetëm italisht, por edhe frëngjisht, gjermanisht, greqisht e latinisht.

Gazulli është munduar t'i qendrojë koherent italishtes standarde në dhënien e korrespondueseve përkatëse, por kemi takuar raste, kur nuk përkojnë domethëniet e fjalëve duke i bërë një përjasje me Fjalorin italisht-shqip të Ferdinand Lekës e Zef Simonit. Psh.:

afçë-a – *shpend i vogël me pendla të verdhëmta, it. verdone* (G. f.43). Ndërkohë, **verdone** tek Fjalori italisht –shqip e kemi, **verdone** – 1. *i blertë i ndezur*. 2.1. *e blertë e ndezur (ngjyrë)*. 2.2. *gjelbërushë* (FISH, f.1150).

bati-ja – *të lodhun, të këputun shtati, it. oppressione, spossatezza, stanchezza* (G.f. 57). Vërejmë se Gazulli ka dhënë tri variante në italisht të kësaj fjale, të cilat janë sinonime të njëra-tjetrës dhe vetëm njëra, **stanchezza**, i përgjigjet kuptimit të Gazullit, **stanchezza** – 1. *lodhje fizike, lodhje mendore*. 2. *mërzitje* (FISH, f.1039), ndërsa **oppressione** – 1. *shtypje; zgjedhë*. 2. *ndrydhje, shtypje* (FISH. f.743), dhe **spossatezza**- *rraskapitje, dërrmim, sfilitje* (FISH. f.1032).

borc-i – *shpend i vogël, it. fringuello* (G. f.66). Tek Fjalori dygjuhësh e kemi, **fringuello** – *borës, zborak* (FISH, f.463). Me siguri se duhet të kemi të bëjmë me ndonjë lloj shpendi

brâjë-a – *mullâ i kuq a i irun qi del ndërshej gishtash, it. pantericcio* (G.f.67). Tek fjalori italisht – shqip e kemi **patereccio** – *panaricum, molldragë thuath* (FISH, f.777).

cog-u – *me i ba murit për rranxë një cog, me rrethue pusin me një cog, cogu i derës; guri qi veht te pragu i derës për me hÿ lehtas, it. predella, zocollatura* (G. f.84). Këto dy fjalë italisht të dhëna nga Gazulli i ndeshim si sinonime të njëra-tjetrës, por edhe sinonime me kuptimin shqip të autorit. **predella** – 1. *podium (i katedrës)*. 2.

mbështetëse këmbësh (FISH, f.821), **zoccollatura** – *xokolaturë, thembratë* (FISH, f.1181).

qepurar-e – *njeri buzëhollë, nazeli, it. sprezzante* (G. f.92). Në Fjalorin italisht-shqip e kemi me nuanca më ironizuese, **sprezzante** – *përbuzës, përcmues, mospërfillës* (FISH, f.1032).

Gjithashtu tek Gazulli ndeshim raste të dhënies së fjalëve në italisht, në të cilat, duke i bërë një përqasje me Fjalorin italisht-shqip, vërejmë se këto fjalë nuk gjejnë fare përdorim. Raste të tilla kemi disa:

ballafaçkë – *të ramë të fyeshëm, e bjerrme me zhurmë, e muer e fitoi një ballafaçkë, it. battosta*. Fjalën **battosta** në Fjalorin italisht-shqip nuk e ndeshim fare të shpjeguar.

bângëc – *nji bangëc bore. top bore, it. pallotola* (G.f.55). Këtë fjalë nuk e kemi tek Fjalori italisht-shqip i Z. Simonit dhe F. Lekës.

bërbâ-ni – *mashkulli i bletës, it. pecchione* (G.f. 59). Fjalën **pecchione** nuk e ndeshim fare në Fjalorin italisht-shqip, ndërkohë që Gazulli e jep si version italisht të fjalës së mësipërme.

bollari-i – *shtërpë qi s`ban dâm, por madje vlen me zhbî guska, kaçamiq e krymba. it. esculapio* (G.f. 66). Fjalën **esculapio** nuk e ndeshim tek Fjalori italisht-shqip.

brojçë-a – *shpend, it. apiuiuolo* (G. f.71). Kjo fjalë nuk ndeshet e shpjeguar tek Fjalori dygjuhësh.

bushtë-r-a – 1. *shakë-a*. 2. *kulshedër-a*. 3. *vegël mekanike me shtërngue rrrathë, tajë etj, it. mosetta* (G. f.77). Kjo fjalë nuk ndeshet e shpjeguar tek Fjalori dygjuhësh.

cecinë-a – *cegëm-i, mot acar, acari e madhe, it. sizza* (G. f.82). Kjo fjalë nuk ndeshet e shpjeguar tek Fjalori dygjuhësh.

Kjo dukuri të lë të mendosh se mos kemi të bëjmë me dialektizma të gjuhës italiane dhe, normalisht, Fjalorët nuk i përfshijnë të tilla fjalë.

Tek Benedikt Dema vërejmë pothuajse të njëjtat dukuri. Në shumicën prej fjalëve ka dhënë përgjegjësen në italisht, nga ku përveç atyre që konkordojnë me Fjalorin italisht-shqip, kemi edhe nga ato të cilat na japin një kuptim të ndryshëm nga ai i përcaktuar tek Fjalori i F. Lekës dhe Z. Simonit, psh.:

angarisë – *bisedue, ça kopalla, folë me kënd, it. trattare* (D. f.13). Në Fjalorin italisht-shqip e kemi, **trattare**- 1. *trajtoj, rrah, shtjelloj*. 2. *trajtoj dikë, sillem me dikë*. 3. *trajtoj, përpunoj*. 4. *përdor, zotëroj*. 5. *mjekoj, kuroj* (FISH, f.1109).

brizë,a – *brinjë kali, me të cilën i hjekin linit grathin, it. scotola* (D. f.28). E ndeshim në këtë formë tek Fjalori, **scotola** – *rrahës (liri, kërpi), shkrifërues* (FISH, f. 957).

cog,u - *guri qi vebet te pragu i derës, it. predella* (D. f.36). Në Fjalorin italisht-shqip e kemi, **predella** – 1. *podium (i katedrës)*. 2. *mbështetëse këmbësh* (FISH, f.821).

deksitë – *deksue, ba si të dekun, it. mortificare* (D. f.44). Tek Fjalori e kemi me disa kuptime jo të ngjashme me ato të Demës, **mortificare** – 1. *bëj t`i vijë turp; prek në sedër, lëndoj: përul*. 2. *mundoj trupin*. 3. *nekrotizoj* (FISH, f.699).

Gjithashtu, ndeshim edhe fjalë të dhëna në italisht nga Dema, ku në Fjalorin italisht-shqip nuk i kemi fare, psh.:

ballafaçkë,a - *e rame e fyeshme, it. battosta* (D. f.18). Në Fjalorin italisht-shqip nuk e kemi këtë fjalë.

breshzë,a – *gogla qi dalin kanjiherë nder bimë si lyetha a mullja, it. pipolo* (D. f.28). Kjo fjalë nuk ndeshet e shpjeguar në Fjalor.

cimatun (i) – *i shternguet, it. rigoboso* (D. f.35). Kjo fjalë nuk ndeshet në Fjalor.

hamsi,a- *nevojë e tepërt për të ngrane çdo gja qi të jetë përdorësh, it. polifagia* (D. f.83). Kjo fjalë nuk ndeshet tek Fjalori italisht- shqip.

Duhet theksuar se ashtu si Gazulli, edhe Dema fjalëve shqipe u ka dhënë përgjegjëset e veta në italisht, gjermanisht dhe turqisht, për të treguar në këtë mënyrë edhe erudicionin e tij si filolog.

- Sllavizmat

Marrëdhëniet që kanë pasur shqiptarët dhe sllavët gjatë historisë kanë lënë gjurmë edhe në gjuhën tonë. Ato fillojnë që me dyndjet e para sllave në Ballkan deri në ditët e sotme me kontaktet e ngushta që ekzistojnë mes shqiptarëve, kryesisht pjesës së gegërishtes veriore me popullsitë shqiptare në ish-Jugosllavi, Kosovë e Mal të Zi. Madje, siç shprehet Jorgji Gjinari,¹³⁷ ato kanë pasur marrëdhënie e kontakte fqinjësie, kryesisht me sllavët e jugut, të cilat kanë vazhduar gjatë, dhe domosdo që kanë lënë gjurmë në të folmet shqipe. Më tepër kanë hyrë elemente sllave sesa anasjelltas, por kjo nuk do të thotë se shqipja nuk ka lënë gjurmë në gjuhën e tyre.

Karlo Taliavini për këtë dukuri shprehet se “*në është e vërtetë se dialektet shqiptare gegë-lindore të Dardanisë e Maqedonisë veriperëndimore kanë asimiluar një numër elementesh sllave jugore, të panjohura në krahina të tjera të Shqipërisë, është po aq e vërtetë se edhe dialektet sllave të këtyre krahinave kanë asimiluar elemente shqiptare dhe kanë pësuar ndikim gjuhësor të shqipes*”¹³⁸.

I të njëjtit mendim është edhe studiuësja e sllavizmave në gjuhën shqipe, e cila shprehet për faktin se edhe shqipja ka lënë gjurmë në të folmet e serbishtes.

Problemi i huazimeve sllave është trajtuar nga shumë studiues shqiptarë e të huaj, si Miklošiči, Majeri, Jokli, Çabej, Desnickaja etj. Kohët e fundit ka dalë edhe studimi i bërë nga Anila Omari “Marrëdhëniet gjuhësore shqiptaro-serbe”¹³⁹.

Në Fjalorin e Bardhit janë të pakta huazimet sllave. Kjo për arsye se Fjalori është shkruar në një kohë kur marrëdhëniet e shqipes me sllavishten nuk ishin akoma në kontakt.

Në Fjalorin e Gazullit kemi disa nga ato. Kemi bërë përqasje me Leksikun e gegërishtes të pasqyruar në vëllimet e Dialektologjisë Shqiptare (I.II.III,IV), leksikun e pasqyruar nga Anila Omari sa i takon sllavizmave të shqipes, si dhe Fjalorin e Mehmet Elezit. Gjithashtu jemi konsultuar për disa raste edhe me *Fjalorin Shqip - Serbokroatisht* të Mikel Ndreçës.

arg-t – *aêjkë-a, smojë-a, smollë (slav)* (G. f.48). Fjalën **smo:ll-a**¹⁴⁰ e ndeshim tek Gj.Shkurtaj (DSH, III) për “*rrëshirë pishe*”, e cila ndeshet në të folmen e Kelmendit. Gjithashtu mund të ketë lidhje me fjalën **smojë** “*llomi i sapunit, yndyra e leshit*”, që flitet në rrethinat e Shkodrës, huazim nga skr, **smola** “*rrëshirë*”¹⁴¹.

bedatë – *njeri i bedatun (slav.? mbaresa sigurisht) njeri i mârrun mênç* (G. f.57). Këtu kemi të bëjmë me një pasiguri të Gazullit, nëse është sllavizëm apo jo. Ndërsa Mehmet Elezi e pranon si sllavizëm **bedat**¹⁴² – *budallosem, merrem mendsh*.

bëzhure-ja – *bazhure-ja; papaver(slav), (G. f. 61)*. Kjo fjalë si sllave ndeshet vetëm tek Gazulli, përmes të cilit nuk kemi një shpjegim të saktë gjuhësor.

capë-a - *dhe a shtrat dheu i forcuem prej motesh si çemento, i gurzuem, peqinë (slav)* (G. f.80). Gjovalin Shkurtaj, në të folmen e Hotit, jep këtë shpjegim të kësaj fjale, **peqin-a**¹⁴³ “*shkëmb, kërrboç që gjendet poshtë shtresës së dheut të punueshëm në arat joprodhuese me shumë zall*” .

¹³⁷ J. Gjinari, *Mbi disa elemente slave në të folmet veriore të Shqipërisë Jugore*, “Studime mbi leksikun dhe formimin e fjalëve në gjuhën shqipe” II, Tiranë, 1972, f.267.

¹³⁸ K.Taliavini, *Le parlate albanesi di tipo ghegjo orientale (Dardania e Macedonia nordocidentale)*, “Le terre albanesi redenti”, I, Roma, 1942, f.70.

¹³⁹ A.Omari, “Marrëdhëniet gjuhësore shqiptaro-serbe”, Tiranë, 2012.

¹⁴⁰ Gj. Shkurtaj, *E folmja e Kelmendit*, “Dialektologjia Shqiptare” III, Tiranë, 1975, f.87.

¹⁴¹ A. Omari, “Marrëdhëniet gjuhësore shqiptaro-serbe”, Tiranë, 2012, f.265.

¹⁴² M.Elezi, “Fjalor i gjuhës shqipe”, Tiranë, 2006, f.193.

¹⁴³ Gj.Shkurtaj, *E folmja e Hotit*, Dialektologjia Shqiptare II, Tiranë 1974, f. 413.

cokël-a – 1. *shkurtica drush*. 2. *cokla druni, krh. slav. cokla -nallat (turq)*, (G. f.84). Si sllavizëm e përdor vetëm Gazulli, ndërkohë që nuk e gjejmë të përdorur tek leksiku dialektor i gegërishtes, ndërsa në ligjërimin bisedor gjen vend përdorimi.

Mehmet Elezi përdor trajtën **cokël-a**¹⁴⁴ – 1. *cingël, kaliqe, parakë*. 2. *droçkë hirre, droçkël (Malësi e Madhe)*.

qepel-i – *qep-i, maja e ternakopit (slav) a tharakacit mâ e holla qi hyn si pyjkë në gurë (G. f.91)*. Bahri Beci në të folmen e Shkrelit e përdor si të tillë, **tërrnagop-i**¹⁴⁵ “*kazmë, në Vrith ca:p-a*” Gjithashtu edhe Anila Omari e jep **tërrnagop** “*kazmë*”.¹⁴⁶

çapër-a – *rrëshiq, rrësheku, calik-u. slav. çapra (G. f.98)*. Vërejmë se vetë Gazulli e përdor si sllavizëm, por edhe Mehmet Elezi jep një shpjegim të tillë, **çapër-ra**¹⁴⁷ (prej sll.)- 1. *rrëshek, zhabë calik lëkure me e mbajtë bulmetin, kryesisht mazën*. 2. *lëkura e lahutës*. Tek Anila Omari e kemi, **çapër** “*rrëshek, calik*”.¹⁴⁸

dash-e – *lat. amabilis (dashë slav)*, (G. f.117). E ndeshim të përdorur vetëm te Gazulli si sllavizëm.

dhaja – *Bash. 98, mbet e dhaja kres: u ndal e i a njeti kres; veshtrimi: me fuqi, lat. vi, prej vis, dhaja de, mbëshoji (slav)*, (G. f.118). E ndeshim të përdorur vetëm te Gazulli si sllavizëm.

fëmni-ja – *igjram-i, ixhram(turq), kotmar-i (PK. slav), paska lisi femni, paska nisë m`u kalbë; mushkëni me femni (G. f.127)*. Ky sllavizëm **kotmar-i**, del vetëm tek Gazulli, ndërsa në leksikun dialektor të gegërishtes nuk e ndeshim në studimet e bëra rreth tij. Mehmet Elezi e përdor në këtë kuptim, **femni-a**¹⁴⁹ – (*prej femën, ndoshta në kuptimin e plasave, çarjeve, ose në kuptimin që përdoret për tumoret femën a mashkull?*). Sëmundje që prish përbërjen, kalbje.

figullue – 1. *përtha, kuritë (SP, slav.)*. 2. *përflikë*. 3. *mekë (G. f.130)*. E ndeshim të përdorur vetëm te Gazulli si sllavizëm. Elezi e përdor si të tillë, **figullohem**¹⁵⁰ – *përfikem, mekem*. Anila Omari e jep si **kuris** “*thaj drutë te zjarri*”.¹⁵¹

firikac-i – *shaterkaz-i, çaterkaz-i; cape e madhe me çepel, slav. ternakop, tharakac (G. f. 132)*. Shpjegimin për fjalën **ternakop** e kemi dhënë më sipër, shih **qepel-i**.

fue-oni – *hue-oni, një hue mjalte; fashuell-olli, foshtinë-a (slav.)*, (G. f. 139). E ndeshim të përdorur tek Xhabir Topalli për të folmen e Pukës, **foshtin-a**¹⁵² “*hojt me mjalt , voshtina*”.

gorrlë-a- birë, bigore (slav.), (G. f. 153). E ndeshim të përdorur vetëm te Gazulli si sllavizëm. Ndërsa Mehmet Elezi e përdor si të tillë, **gorrlë-a¹⁵³ – *birë, vrimë, plasë*.**

heqâme-ja – *pometë (slav) dallkë e madhe: ra shi (borë, breshën) (G. f. 173)*. Xheladin Gosturani jep trajtën **ometë**, e cila përdoret në të folmen e Çeremit (DSH IV), ndërsa studiuesja Omari, jep trajtën **ometë** “*dëbora e grumbulluar nga era, tog dëbore*” Pra, vërejmë se ka të njëjtin kuptim si Gazulli. Sipas saj, është huazuar nga skr. **omësti, omëtem** “*fshij me fshesë*”.¹⁵⁴

¹⁴⁴M. Elezi, “Fjalor i gjuhës shqipe”, Tiranë, 2006, f.281.

¹⁴⁵B.Beci, *E folmja e Shkrelit*, “Dialektologjia Shqiptare” I, Tiranë, 1971, f.320.

¹⁴⁶A. Omari, “Marrëdhëniet gjuhësore shqiptaro-serbe”, Tiranë, 2012, f.289.

¹⁴⁷M. Elezi, “Fjalor i gjuhës shqipe”, Tiranë, 2006, f.298.

¹⁴⁸A. Omari, “Marrëdhëniet gjuhësore shqiptaro-serbe”, Tiranë, 2012, f.117.

¹⁴⁹M. Elezi, “Fjalor i gjuhës shqipe”, Tiranë, 2006, f.420.

¹⁵⁰M. Elezi, “Fjalor i gjuhës shqipe”, Tiranë, 2006, f.426.

¹⁵¹A.Omari, “Marrëdhëniet gjuhësore shqiptaro-serbe”, Tiranë, 2012, f.180.

¹⁵²Xh.Topalli, *Disa vërejtje për të folmen e krahinës së Pukës*, “Dialektologjia shqiptare” II, Tiranë, 1974, f.327.

¹⁵³M. Elezi, “Fjalor i gjuhës shqipe”, Tiranë, 2006, f.500.

¹⁵⁴A. Omari, *Disa sllavizma të pavënëre në të folmet veriore të shqipes*, “Studime filologjike”, 1-4, Tiranë 1994, f.123.

ipësht-a – 1. *ipësht ahash, imshti ahash; lisni ahash së rij, vend me lisa të rij, imshtak*. 2. *lugu ku prej gurit të mullinit derdhet mielli i bluem, dishtë-a* (krh. slav. **diza**), (G. f.181). E ndeshim të përdorur tek Bahri Beci, **ipshtak-u**¹⁵⁵ “*ah i ri*”; **i:sht-a**¹⁵⁶ “*pyll me aha të rinj*” e përdor Gjovalin Shkurtaç për të folmen e Kelmendit. Ndërsa trajtën **disht-a**¹⁵⁷ “*arka ku bie mielli nga guri kur bluhet*” e ndeshim në të folmen e Pukës nga Xhabir Topalli.

jar-i – *êdhi* (SHK), slav. **jarac, jarad** (G. f.182). Si fjalë e ndeshim tek Anila Omari, **jar** “*kec*”¹⁵⁸

kapër-a – *kapërr-a, mbajs hardhijash, gagjarrâ-ni* (MR), **grebenicë-a** (M.M) *ff. slave* (G. f.191). Ndonëse Gazulli e jep si fjalë të Malësisë së Madhe, ne nuk e ndeshim në leksikon e gegërishtes veriperëndimore, për të folmet përkatëse që janë bërë, aq më tepër si huazim sllav. Mehmet Elezi përdor të njëjtën formë të kësaj fjale, duke iu referuar Gazullit, **kapër-ra**¹⁵⁹ – *mbajtës hardhish*.

këllânë-t – *dita e mbrâm e motmotit; me lutë këllânat*, krh. *ff. shkodranishte:kudhânë-a*, krh. slav. **koleda?**, (G. f.197). Ndonëse gjen përdorim në ligjërimin bisedor, nuk e ndeshim të përdorur në fjalorët përkatës.

kërrabë-a – *ternakop-i* (slav), *shaterkaz-i*: (G. f.201). Kuptimin e fjalës **ternakopi-i** e kemi dhënë më sipër, shih **qepel-i**.

kllaçë-a – *ligatë* (slav.) **brraçinë**, (G. f.205). E përdor Gjovalin Shkurtaç për të folmen e Hotit, **brrakçinë-a**¹⁶⁰ “*gropë e vogël në rrugë ose në fushë që mbushet me ujë kur bie shumë shi*”. Gjithashtu i referohet Çabejit, si huazim sllav, **brrak** – *bërrakë* të zgjeruar në mënyrë sllave.

kllap-i – *gjumë i lehtë: më xuni kllapi* (slav. **klapa**), (G. f.206). Siç e vërejmë Gazulli ka dhënë origjinën e kësaj fjale si sllave, duke treguar mirëfilli edhe dijen e tij në fushë të etimologjisë. A.Omari e jepsi, **kllapi** “*jerm*”¹⁶¹.

komçë-a – **komçar - i** slav. *kovçe, kovçar* (G. f.209). E përdor Shefqet Hoxha në të folmen e Vilë-Kalisit të Lumës **ko:mc-a**¹⁶² “*kapse prej teli: përbëhet nga dy pjesë mashkull dhe femër, që përdoret sidomos në veshje të trasha prej zhguni*”. Gjithashtu Xheladin Gosturani në të folmen e Hasit, **komc-a**¹⁶³ “*mbërtheckë, komçë*”.

kopaç-i – **obluk-u** (slav.), (G. f.210). E kemi tek Bari Beci, në të folmen e Luznisë së Dibrës, **kopáçe-ja**¹⁶⁴ – “*kazëm,*” Xheladin Gosturani në Has, **kopaç**¹⁶⁵ “*kazmë*”, Shefqet Hoxha, Lumë jep **kopaç-i**¹⁶⁶ “*kazëm vetëm me sqepin e gjerë*”. Ndërsa Xheladin Gosturani në të folmen e Hasit përdor trajtën **obluk-i**¹⁶⁷ “*pjesa e përparme e samarit*”. Edhe Anila Omari e ka, **obluk** “*kaptelli i samarit; kërdhokull*”¹⁶⁸.

¹⁵⁵B.Beci, *E folmja e Shkrelit*, “Dialektologjia Shqiptare” I, Tiranë, 1971, f.314.

¹⁵⁶Gj. Shkurtaç, *E folmja e Kelmendit*, “Dialektologjia Shqiptare” III, Tiranë, 1975, f.84.

¹⁵⁷Xh. Topalli, *Disa vërejtje për të folmen e krahinës së Pukës*, “Dialektologjia shqiptare” II, Tiranë, 1974, f.326.

¹⁵⁸A.Omari, “Marrëdhëniet gjuhësore shqiptaro-serbe”, Tiranë, 2012, f.156.

¹⁵⁹M. Elezi, “Fjalor i gjuhës shqipe”, Tiranë, 2006, f.661.

¹⁶⁰Gj. Shkurtaç, *E folmja e Hotit*, “Dialektologjia Shqiptare” II, Tiranë, 1974, f.407.

¹⁶¹A.Omari, “Marrëdhëniet gjuhësore shqiptaro-serbe”, Tiranë, 2012, f.165.

¹⁶²Sh. Hoxha, *Vëzhgime mbi të folmen e Vilë-e- Kalisit të Lumës*, “Dialektologjia Shqiptare” III, Tiranë, 1975, f.185.

¹⁶³Xh. Gosturani, *E folmja e Hasit*, “Dialektologjia Shqiptare” III, Tiranë, 1975, f.255.

¹⁶⁴B.Beci, *E folmja e Luznisë së Dibrës*, “Dialektologjia Shqiptare”, II, Tiranë 1974, f.263.

¹⁶⁵Xh.Gosturani, *E folmja e Hasit*, “Dialektologjia Shqiptare” III, Tiranë, 1975, f.255.

¹⁶⁶Sh. Hoxha, *Vëzhgime mbi të folmen e Vilë-e- Kalisit të Lumës*, “Dialektologjia Shqiptare” III, Tiranë, 1975, f.185.

¹⁶⁷Xh. Gosturani, *E folmja e Hasit*, Dialektologjia Shqiptare III, Tiranë, 1975, f. 255.

¹⁶⁸A.Omari, *Marrëdhëniet gjuhësore shqiptaro-serbe*, Tiranë, 2012, f.206.

kopitë-a- 1. *shpori i shpendit*. 2. *kopita e kalit: dallëndysha e thundrës së kalit; krh. slav. kopito: thundra e kalit, formë këpucësh* (G. f.210). E përdor Bari Beci për të folmen e Shkrelit **kopit-a**¹⁶⁹ “*fundi i thundrës së kafshëve*”. Anila Omari e ka, **kopitë** “*thundër*”.¹⁷⁰

kosaq-i – *kostar-i: një kosaq livadh: kosë-a (slav. kosa: kosaç)*, (G. f.212). Si të tillë nuk e ndeshim, vetëm Shefqet Hoxha, për të folmen e Vilë-Kalisit, jep trajtën **kostar-i**¹⁷¹ “*ai që kosit*”. Anila omari e përdor si, **kosë** “*vegël bujqësore*”.^{172,}

kotar-i – 1. *çarranik, strehë për bylmet*. 2. *thark thish* (krh. slav. **hotar, kotar**, fj. shqipe: kot-i), (G. f. 212). E takojmë tek A.Omari, **kotar** “*qymez pulash*”.¹⁷³

kot-i – *muq-i, kapuliq, plllastë (slav): grumbull i vogël gruni, sane, kashte* (G. f.212). Gjovalin Shkurtaj përdor trajtën **kapuliqe-ja**¹⁷⁴ “*grumbull misri më i vogël se kapa*”, por edhe **plllast-a**¹⁷⁵ “*grumbull i vogël sane të porsa kositur*”. A.Omari e ka, **plllastë** “*grumbull bari i kositur*”.¹⁷⁶

kozholl-i – *post-i, shtrojë lëkure dhensh (krh. slav. kozha, shqipen kozhun-i, shtrosë-a* (G. f.213). Bahri Beci përdor trajtën **kozhun-i**¹⁷⁷ “*veshje e hershme e burrave të Shkrelit, lëkurë berash e bërë si setër*”.

larë-a – 1. *nafele-ja, nafe-ja, nafë-a, vidër, ngjollë (njollë) e bardhë në parzëm t’egërcinës*. 2. *larë qesh...slav ralj: parmendë-a* (G. f.229). E përdor Shefqet Hoxha për të folmen e Vilë-e-Kalisit **la:r-a**¹⁷⁸ “*dhi a lopë e larme m.larosh*”.

Gjithashtu edhe Xhabir Topalli për Pukë, **lar-a**¹⁷⁹ “*lopa e larme*”.

lezar-i – 1. *shkallë e vogël*. 2. *shelqënuer-ori, slv. lesa: trinë*, (G. f.235). Gjovalin Shkurtaj në të folmen e Kelmendit përdor, **trin-a**¹⁸⁰ “*lesë*”. A.Omari e ka, **lesë** “*trinë*”¹⁸¹

mbrapshti-ja – *hiejesinë, vend ku s’bjen dielli, osojnë-a (slav)*, (G. f.256). Këtë fjalë e ndeshim tek Anila Omari, **osojna** “*vend ku bie dielli me vonesë, vend i hijezuar, vend me hije*”.¹⁸²

meqave-ja – *meqave bore (fjal. slave) mbledhaje, çfrë bore* (G. f.258). Anila Omari e jep si të tillë, **meqave**¹⁸³ “*mbledhaje, çfre bore*” huazim nga skr. **mečava** “*stuhi me borë, llohë*”.

meteh-i,- metef-i 1. *kufi, shefi*. 2. *vend i nalcuem e në të lam slav. metohija*, (G. f.262).

meti-ja – *slav. (metil), kelbazë-a, kandërr si kaçamill qi jeton nder vende ujtake; bagtija e perdijne me bar e u shkon në zgrof, me gjak; kandrri (qi asht i vogël sa mos*

¹⁶⁹ B. Beci, *E folmja e Shkrelit*, “Dialektologjia Shqiptare” I, Tiranë, 1971, f.314.

¹⁷⁰ A.Omari, “Marrëdhëniet gjuhësore shqiptaro-serbe”, Tiranë, 2012, f.170.

¹⁷¹ Sh. Hoxha, *Vëzhgime mbi të folmen e Vilë-e- Kalisit të Lumës*, “Dialektologjia Shqiptare” III, Tiranë, 1975, f.186.

¹⁷² A.Omari, “Marrëdhëniet gjuhësore shqiptaro-serbe”, Tiranë, 2012, f.172.

¹⁷³ A.Omari, “Marrëdhëniet gjuhësore shqiptaro-serbe”, Tiranë, 2012, f.174.

¹⁷⁴ Gj. Shkurtaj, *E folmja e Hotit*, “Dialektologjia Shqiptare” II, Tiranë, 1974, f.410.

¹⁷⁵ Gj. Shkurtaj, *E folmja e Kelmendit*, “Dialektologjia Shqiptare” III, Tiranë, 1975, f.79.

¹⁷⁶ A.Omari, “Marrëdhëniet gjuhësore shqiptaro-serbe”, Tiranë, 2012, f.229.

¹⁷⁷ B.Beci, *E folmja e Shkrelit*, “Dialektologjia Shqiptare” I, Tiranë, 1971, f.315.

¹⁷⁸ Sh. Hoxha, *Vëzhgime mbi të folmen e Vilë-e-Kalisit të Lumës*, “Dialektologjia Shqiptare” III, Tiranë 1975, f.187.

¹⁷⁹ Xh.Topalli, *Disa vërejtje për të folmen e krahinës së Pukës*, “Dialektologjia Shqiptare”, II, Tiranë, 1974, f.330.

¹⁸⁰ Gj. Shkurtaj, *E folmja e Kelmendit*, “Dialektologjia Shqiptare” III, Tiranë, 1975, f.79.

¹⁸¹ A.Omari, “Marrëdhëniet gjuhësore shqiptaro-serbe”, Tiranë, 2012, f.183.

¹⁸² A.Omari, “Marrëdhëniet gjuhësore shqiptaro-serbe”, Tiranë, 2012, f.213.

¹⁸³ A. Omari, *Disa sllavizma të pavënëre në të folmet veriore të shqipes*, “Studime Filologjike”1-4, Tiranë, 1994, f.123.

m'u veçue me sy), kalon ndër mushkëni, aty grin mushkënit e shndërrohet ndër flegula mishatake, qi quhen flutra (G. f. 262). A.Omari e ka, **meti** - “këlbazë e dhenve”.¹⁸⁴

murrfice-ja – 1. *mbrapshti-ja*, **osojnë-a** (slav) vend ku dimnit bjen pak a aspak dielli. 2. dheu i murrfices, krahi i murrfices; vende me akuj të pamemë e me diell të pakët a pa të krejt (G. f.274). Këtë fjalë e ndeshim tek Anila Omari, **osojna** “vend ku bie dielli me vonesë, vend i hijezuar, vend me hije”.¹⁸⁵

nipe-ja – ndikim slav për mbesë-a (G. f.279). E ndeshim tek Bahri Beci për të folmen e Shkrelit, **nipe-ja**¹⁸⁶ “vajza e vëllaut (përdoret rrallë)”.

pamollë-a – shtyllat në ball t'urës, **pomollë-a** (slav?), (G. f.298). Nuk e ndeshim si fjalë, ndoshta sepse vetë Gazulli nuk jep siguri për burimin sllav të saj.

përfiskë- 1. përfiktue, me përfiskë drûn, me tha. 2. përtha, kuritë, **koritë** (fjalë slave) me pshymë, pshtymë, (G. f.307). Siç shihet, Gazulli na ka dhënë dy kuptime të kësaj fjale. Me kuptimin e parë e ndeshim tek Bahri Beci në të folmen e Shkrelit, **korit (me u)**¹⁸⁷ “thuhet për drutë e njoma, kur i venë afër zjarrit që të thahen”. Gjithashtu e përdor edhe Shefqet Hoxha për të folmen e Vilë-e-Kalisit, në një kuptim krejtësisht të ndryshëm **korit:t-a**¹⁸⁸ “enë për të larë rrobot, govatë”. Me të njëjtin kuptim si Hoxha, Bahri Beci e përdor për të folmen e Dibrës **korit-a**¹⁸⁹ “govatë”. A. Omari e ka njëllor, **koritë** “govatë; lugu i mullirit”.¹⁹⁰

përvanue – *provanue, me radit, me bâ radin* (slav), (G. f.315). Bahri Beci përdor trajtën **radit**¹⁹¹(**me**) “sajoj: (a pa mun raditish nōj tjetër khâ° n'bjeshk.)”. A.Omari e ka, **radit** “ndreq, rregulloj”.¹⁹²

pihë – me i ra mbë të...(sla. **piehati**, gulshue, shmue, shëmue), (G. f.321). Bahri Beci përdor trajtën foljore **pihat (me u)**¹⁹³ “lodhem”. Edhe A.Omari e përdor me të njëjtin kuptim, **pihatem** “këputem, lodhem shumë”.¹⁹⁴

plotonicë-a – *drûna të faqueme qi i vëjnë malsoret te veshet, vjerrëcat. Në Malësi të Madhe grat, me sa Tartareshat, s'barin vathë, fj.slave, krh. pletenica, shikull, fregull* (G. f.329). E përdor Bahri Beci në të folmen e Shkrelit duke dhënë edhe prejardhjen sllave, **plotonicë-a**¹⁹⁵ “një copë rubë që në të kaluarën veshin gratë e moshuara (krh. sll. pletenica). Gjovalin Shkurtaj e sjell në këtë formë në të folmen e Kelmendit, **plotoni:c-a**¹⁹⁶ “një farë shtojce prej druri që vinin gratë në kokë për të mbajtur flokët të ngritur anash; nuk përdoret më prej shumë vjetësh”. Të njëjtin shpjegim bën edhe Omari, **plotonicë** “një farë shtojce prej druri që vinin gratë në kokë për të mbajtur flokët të ngritur anash; nuk përdoret më prej shumë vjetësh”.¹⁹⁷

prologj-i – **kerdi-ja**, fj.slave? (G. f.338). Nuk e ndeshim të përdorur këtë fjalë.

rabush-i – fj. slave **rabosh** (G. f.343). Mikel Ndreca e jep si të tillë, **rabush-i**¹⁹⁸ “raboš, rovaš, urez, zarez”.

¹⁸⁴ A.Omari, “Marrëdhëniet gjuhësore shqiptaro-serbe”, Tiranë, 2012, f.195.

¹⁸⁵ A.Omari, “Marrëdhëniet gjuhësore shqiptaro-serbe”, Tiranë, 2012, f.213.

¹⁸⁶ B. Beci, *E folmja e Shkrelit*, “Dialektologjia Shqiptare” I, Tiranë, 1971, f.317.

¹⁸⁷ B. Beci, *E folmja e Shkrelit*, “Dialektologjia Shqiptare” I, Tiranë, 1971, f.314.

¹⁸⁸ Sh. Hoxha, *Vëzhgime mbi të folmen e Vilë-e-Kalisit të Lumës*, “Dialektologjia Shqiptare” III, Tiranë 1975, f.185.

¹⁸⁹ B.Beci, *E folmja e Luznisë së Dibrës*, “Dialektologjia Shqiptare” II, Tiranë, 1974.

¹⁹⁰ A.Omari, “Marrëdhëniet gjuhësore shqiptaro-serbe”, Tiranë 2012, f.171.

¹⁹¹ B.Beci, *E folmja e Shkrelit*, “Dialektologjia Shqiptare” I, Tiranë, 1971, f.318.

¹⁹² A. Omari, “Marrëdhëniet gjuhësore shqiptaro-serbe”, Tiranë 2012, f.248.

¹⁹³ B.Beci, *E Folmja e Luznisë së Dibrës*, “Dialektologjia Shqiptare”, II, Tiranë, 1974.

¹⁹⁴ A.Omari, “Marrëdhëniet gjuhësore shqiptaro-serbe”, Tiranë 2012, f.223.

¹⁹⁵ B.Beci, *E folmja e Shkrelit*, “Dialektologjia Shqiptare” I, Tiranë, 1971, f.318.

¹⁹⁶ Gj.Shkurtaj, *E folmja e Kelmendit*, “Dialektologjia Shqiptare” III, Tiranë, 1975, f.90.

¹⁹⁷ A. Omari, “Marrëdhëniet gjuhësore shqiptaro-serbe”, Tiranë 2012, f.228.

¹⁹⁸ M. Ndreca, “Fjalor shqip-serbokroatisht”, Prishtinë, 1980, f.270.

rogjâ-ni – *degë lumi, kur uji dahet shumë krihësh para se m'u derdhë; rrogjâ-ni, rrozhâ-ni (krh. slav. rogja, brin-i?* (G. f.346). Nuk e ndeshim si fjalë të shpjeguar në fjalorët e sipërpërmendur.

samakres-i – *fj.slav. cube-ja, take-jam pushkë fëmijsh* (G. f.366). Mehmet Elezi jep trajtën **samakreshë-a**¹⁹⁹ – 1. *pushkë e vjetër*. 2. *pushkë lodër prej shtogu prej shtogu me “fishekë” druri*.

skylfer-i – *skyfer-i, kaçubet-i, sokol-i (slav), shpend rrëmbyes* (G. f.373). Tek Bahri Beci për Shkrel, ndeshim trajtën **kaçubet-a**²⁰⁰ – *kaçubet-i, zogu i pashës, kaçirutan, çafkulan*. Ndërsa trajtën **sokol-i**²⁰¹ e përdor Gjovalin Shkurtaj, për të folmen e Kelmendit, “*skifter; del edhe me kuptimin: njeri i shkathët, i shpejtë*”. A.Omari e jep, **sokol** “*skifter*”.²⁰²

sovajkë-a – *meqik-u (turq), drugë-a, vegël vektorësh, për me pëshkue indin neper tymën, slav. sovilja, sovjelo* (G. f.374). Mehmet Elezi e përdor si të tillë, **sovajkë-a**²⁰³ – *dërrasë mbi të cilën sitet miell në magje*.

stërpi-ja – *lëngatë qi mbaron trupin e njeriut tue i thithë gjakun... slav. trpija* (G. f.378). Mehmet Elezi²⁰⁴ jep të njëjtin shpjegim si Gazulli. A.Omari e ka, **tërpi** “*verem, kollë e keqe*”.²⁰⁵

surmë-i-a – *krh.slav. sur, njeje e përhimë në të mbyllun (të zi)*, (G. f.381). A.Omari e ka, **surmë (i)** “*i përhimë i mbyllët, i murrmë*”.²⁰⁶

shiemz-a – *shkjezë-a, trine-a, vlačë-a (slav) trine thuprash me se imitojnë bûcat qi çon parmenda* (G. f.391). Gjovalin Shkurtaj në të folmen e Kelmendit përdor dy rastet e fjalëve, **trin-a**²⁰⁷ “*lesë*” dhe **trinoj** “*punoj arën me trinë*”, si dhe huazimin sllav, **vllaç-i**²⁰⁸ “*trinë, lesë*” dhe **vllaçis** “*trinoj, lesoj*”. A. Omari e jep, **vllaç, vllaçë** “*lesë, trinë*”.²⁰⁹

shmijue – *çorodite (slav. me dalë rodit) svetue, shnjertzue* (G. f.403). Bahri Beci përdor trajtën **shnjertzue**²¹⁰ “*bëhem i keq, prishem me dike*” për në Shkrel. Xhabir Topalli përdor fjalën **rod-i**²¹¹ “*lloj, soj (zba asnji rod najet)*”.

shpneshë-a - *zotë shtëpije, zojnore, stajanicë (slav)*, (G. f.408). Mehmet Elezi jep këtë shpjegim, **shpneshë-a**²¹² - *sipas Çabejt prej shtëpan + eshë; apo prej shtëpineshë ose shpi + eshë? Në qoftë kështu n duhet të jetë shtuar si te thî: thîneshë). shtëpineshë; shih edhe zojnore (Plavë, Guci)*. A. Omari e ka, **stajanicë** “*amvisë*”.²¹³

¹⁹⁹ M.Elezi, “Fjalor i gjuhës shqipe”, Tiranë, 2006, f.1296.

²⁰⁰ B.Beci, *E folmja e Shkrelit*, “Dialektologjia Shqiptare” I, Tiranë, 1971, f.314.

²⁰¹ Gj.Shkurtaj, *E folmja e Kelmendit*, “Dialektologjia Shqiptare” III, 1975, f.92.

²⁰² A.Omari, “Marrëdhëniet gjuhësore shqiptaro-serbe”, Tiranë 2012, f.266.

²⁰³ M. Elezi, “Fjalor i gjuhës shqipe”, Tiranë, 2006, f.1317.

²⁰⁴ M. Elezi, “Fjalor i gjuhës shqipe”, Tiranë, 2006, f.1328.

²⁰⁵ A.Omari, “Marrëdhëniet gjuhësore shqiptaro-serbe”, Tiranë 2012, f.290.

²⁰⁶ A.Omari, “Marrëdhëniet gjuhësore shqiptaro-serbe”, Tiranë 2012, f.280.

²⁰⁷ Gj. Shkurtaj, *E folmja e Kelmendit*, “Dialektologjia Shqiptare” III, 1975, f.79.

²⁰⁸ Po ai, po aty.

²⁰⁹ A. Omari, “Marrëdhëniet gjuhësore shqiptaro-serbe”, Tiranë 2012, f.312.

²¹⁰ B. Beci, *E folmja e Shkrelit*, “Dialektologjia Shqiptare” I, Tiranë, 1971, f.320.

²¹¹ Xh. Topalli, *Disa vërejtje për të folmen e krahinës së Pukës*, “Dialektologjia Shqiptare”, II, Tiranë, 1974, f.332.

²¹² M.Elezi, “Fjalor i gjuhës shqipe”, Tiranë, 2006, f.1411.

²¹³ A. Omari, “Marrëdhëniet gjuhësore shqiptaro-serbe”, Tiranë 2012, f.268.

tirk-u- 1. *cohë, zhgun, shajak*. 2. *tirqit*. 3. *tirqë çûj...slav. latica* (G. f.426). Bahri Beci për Shkrel përdor shumësin e kësaj fjale, **tirq**²¹⁴ “*të mbathura të malësorëve që vishen përmbi brekë; në Vrith çakçir*”.

toçë-a – *m’u ndi me pije, me pi shum, me çue brrylin*; (krh. slav. **toçiti** (G. f.427). Edhe Mehmet Elezi jep të njëjtin shpjegim si Gazulli, **toçi-a**²¹⁵ – *me toçë (prej sll.)*, ngop me të pirë.

traktue – *me vû sheje, me shkrue*, (krh. slav. **trag, trak**; *shê, gjurmë*), (G. f.429). Mehmet Elezi jep këtë shpjegim, **traktoj**²¹⁶ – *me traktue (prej trakt, sll.)*, bëj shenjë, shkruaj. A.Omari e ka, **trak** “*gjurmë, shenjë*”²¹⁷.

trellë-a – *vathë-a* (krh. slav. **trlo, torishtë-a, slav. tor**), (G. f. 429). Xheladin Gosturani për të folmen e Hasit e përdor në gjininë mashkullore, **trell-i**²¹⁸ “*vend në të cilin bora është ngjeshur poshtë, për t’iu hedhur bagëtisë ushqim*”. Xhabir Topalli përdor trajtën **torisht-i**²¹⁹ “*vatha e deleve*”. A.Omari e ka, **trellë** “*vathë*”²²⁰.

trop-i – *undajë-a, skrop, fj.slave të dyja (?)* krh. slav. *trop, fundrri-ja, shkrob, niseshte, pulendër* (G. f.431). Gjovalin Shkurtaç, për të folmen e Kelmendit, përdor trajtën **skrop-bi**²²¹ “*gjellë me miell si (qull), që përdornin banorët e këtyre anëve kur u mungonte buka*”.

tym-i – *të ftohtë-it...slav. zima, shqipen, dimën-i* (G. f.435). A.Omari e ka, **trop** “*bërsi, lënda që mbetet në kazan pas nxjerrjes së rakisë*”²²².

ushtuer-ori - polak-u (M.M fj.slave) *begçi-ja (turq); vështrimi i pare: ushtar-i, tash: rojës arash e pyjesh* (G. 447). Ndonëse Gazulli na jep dy kuptime të kësaj fjale, Bahri Beci e përdor në Luzni të Dibrës në një tjetër domethënie **polak-u**²²³ “*pjella e gomari*”. Me kuptimin e dytë të Gazullit e përdor Shefqet Hoxha për të folmen e Vilë-e-Kalisit të Lumës, por në trajtën **polak-i**²²⁴ “*rojtari fushe; lajmëtar*”, kjo sepse gegërishtja verilindore i shquan emrat e gjinisë mashkullore që mbarojnë me **k,g,h**, me **i** (*miki,zogi, krahi*) ndryshe nga gegërishtja veriperëndimore, të cilat i shquan me **u** (*miku, zogu, krahu*).

valanicë-a – *mangel me shkelë zhguna, shajak etr. Ka këto pjesë: koritë, ku qiten zhgunat, majat, qi shkelin zhgunat, rrotën, boshtin e rrotës, fletët e rrotës, nkrejcat, bucelat e bushtit; fj.slave. krh. valjati: me shkelë zhgunin* (G. f.448). Bari Beci tek e folmja e Shkrelit e përdor **vajanicë**²²⁵ “*vegël druri që shërben për të shkelur zhgunin në ujë*”. Xhabir Topalli për Pukë përdor **vajanicë**²²⁶ “*valanicë, derstil*”. Anila Omari e ka, **valanicë** “*dërstil*”²²⁷.

²¹⁴B. Beci, *E folmja e Shkrelit*, “Dialektologjia Shqiptare” I, Tiranë, 1971, f.320.

²¹⁵M. Elezi, “Fjalor i gjuhës shqipe”, Tiranë, 2006, f.1476.

²¹⁶M. Elezi, “Fjalor i gjuhës shqipe”, Tiranë, 2006, f.1482.

²¹⁷A. Omari, “Marrëdhëniet gjuhësore shqiptaro-serbe”, Tiranë 2012, f.292.

²¹⁸Xh. Gosturani, *E Folmja e Hasit*, “Dialektologjia Shqiptare” III, Tiranë 1975, f.260.

²¹⁹Xh. Topalli, *Disa vërejtje për të folmen e krahinës së Pukës*, “Dialektologjia Shqiptare”, II, Tiranë, 1974, f.334.

²²⁰A. Omari, “Marrëdhëniet gjuhësore shqiptaro-serbe”, Tiranë 2012, f.294.

²²¹Gj. Shkurtaç, *E folmja e Kelmendit*, “Dialektologjia Shqiptare” III, 1975, f. 87.

²²²A. Omari, “Marrëdhëniet gjuhësore shqiptaro-serbe”, Tiranë 2012, f.296.

²²³B. Beci, *E folmja e Luznës së Dibrës*, “Dialektologjia Shqiptare” II, Tiranë 1974, f.265.

²²⁴Sh. Hoxha, *Vëzhgime mbi të folmen e Vilë-e-Kalisit të Lumës*, “Dialektologjia Shqiptare” III, Tiranë, 1975, f.191.

²²⁵B. Beci, *E folmja e Shkrelit*, “Dialektologjia Shqiptare”, I, Tiranë 1971, f.321

²²⁶Xh. Topalli, *Disa vërejtje për të folmen e krahinës së Pukës*, “Dialektologjia Shqiptare” II, Tiranë, 1974, f.334.

²²⁷A. Omari, “Marrëdhëniet gjuhësore shqiptaro-serbe”, Tiranë 2012, 304.

vir-i – vijë uji, vende ku buron ujët bregut të liqenit të Shkodrës, (krh. fj. slav. *navreda*), (G. f.457). Mikel Ndreca në Fjalorin e tij *shqip – serbokroatisht* e përdor me të njëjtin kuptim, **vir-i**²²⁸ - kanal za vodu (ku kalon uji), odvodni kanal .

vizit-i – trap vëllësh, rrypinë toke me vëllaj, *rasat* (slav), (G. f.459). E përdor edhe Mehmet Elezi, duke iu referuar Gazullit, **vizit-i**²²⁹ – rrypinë toke e ndarë në lehë.

vred-i – gjak i çartun, gjak i helmatuem qi kullon prej së zgrapmes së gjarpnit, krh. slav. *vried* = dhunë, varrë, mullâ, lingarthë-a (G. f.462). E ndeshim tek Mehmet Elezi si një fjalë sllave me këto kuptime, **vred-i**²³⁰ – (prej sll. lidhet me varrë; apo kryqëzim i të dyjave? Kuptimet 2,3,4 i largohen fjalës sllave e i afrohen varrës). 1. mavi, nxirje rreth një plage ose për shkak të një goditjeje, lodhjeje etj. 2. lëng i errët, gjak i përzier me qelb, që del prej një plage të infektuar; të keq, shtratëz, ujer, vrujer. 3. helmi i gjarpnit. 4. gjak i çartur. 5. si mb. i vreditur. 6. si nd. me vred. A. Omari e ka, **vred** “helmi i gjarpnit”²³¹.

vrem-i - mend-i, ças-i (krh. slav. *vreme*; kohë), (G. f.462). E kemi në Kartotekën e leksikut të shqipes të Institutit të Gjuhësisë, për Pukë, si ndajfolje **vremë-vremë** “nganjëherë”²³² Gjithashtu edhe Omari e ka, **vrëm** “çast”²³³.

zavorr-i – 1. shtonë nëpër dhe; gjiriz-i (turq) ulluk-u (turq). 2. gjavorr-i (krh. slav. *zavor*, shul hekuri), (G. f.464). Në këtë trajtë nuk e ndeshim të përdorur gjëkund.

zumbçi - femëz-a, biz-i (turq), krh. fjalën thumbull-thumbullë, sumbullë, krh. slav. *zumba*, turjelë e vogël = thumb-i (G. f.472). Gjovalin Shkurtaç në të folmen e Hotit jep trajtën **zumç-i**²³⁴ “biz”, Bari Beci për të folmen e Shkrelit, jep trajtën **zumc-i**²³⁵ “biz”. Ndërkohë që Gazulli jep trajtën **zumbçi**, kemi kalimin e grupit të bashkëtingëlloreve *mb – b*.

zhugë-a – 1. kromë berresh. 2. bimë drujçe (krh. slav. *zhukva*, zungth, gjineshtër), (G. f.475). Anila Omari jep mendimin se, si fjalë e gegërishtes verilindore ka shumë gjasa të vijë nga skr. **šuga** “zgjebe”, **šugav** “i zgjebosur, qeros”²³⁶.

Numërojmë rreth 70 sllavizma në Fjalorin e Gazullit, të cilat i kemi marrë në shqyrtim. Autori është munduar të bëjë përqasjen e fjalës shqipe me sllavishten, madje në shumë prej rasteve ka pasqyruar edhe afrinë që kanë me njëra-tjetrën këto fjalë duke i marrë si huazime të mirëfillta sllave, gjithmonë duke iu referuar etimologjikisht prejardhjes së tyre. Kjo dukuri nxjerr në pah se sa njeri i plotësuar ishte Gazulli si gjuhëtar, ku përveç anës leksikore, ai merret edhe me etimologjinë e fjalës, duke na dhënë në një pasqyrë të saktë të huazimeve turke, italiane e sllave në Fjalor.

Nuk duhet lënë pa përmendur se lemat sllave janë përdorur dhe vazhdojnë të përdoren edhe sot në pjesën e gegërishtes veriore, kryesisht të folmes veriperëndimore, zonat e Malësisë së Madhe. Janë pjesë e ligjërimit të përditshëm, pse jo dhe disa nga ato, janë përfshirë edhe në fjalorët normativë të shqipes.

²²⁸ M. Ndreca, “Fjalor shqip-serbokroatisht”, Prishtinë 1980, f.356.

²²⁹ M. Elezi, “Fjalor i gjuhës shqipe,” Tiranë, 2006, f.1579.

²³⁰ M. Elezi, “Fjalor i gjuhës shqipe,” Tiranë, 2006, f.1592.

²³¹ A. Omari, “Marrëdhëniet gjuhësore shqiptaro-serbe”, Tiranë 2012, f.318.

²³² A. Omari, *Disa sllavizma të pavënëre në të folmet e shqipes*, “Studime Filologjike I-IV”, Tiranë, 1994, f.128.

²³³ A. Omari, “Marrëdhëniet gjuhësore shqiptaro-serbe,” Tiranë 2012, f.319.

²³⁴ Gj. Shkurtaç, *E folmja e Hotit*, “Dialektologjia Shqiptare” II, Tiranë, 1974, f.415.

²³⁵ B. Beci, *E folmja e Shkrelit*, “Dialektologjia Shqiptare”, I, Tiranë 1971, f.321.

²³⁶ A. Omari, *Disa sllavizma të pavënëre në të folmet e shqipes*, “Studime Filologjike I-IV”, Tiranë, 1994, f.128.

Kreu III

1. Leksiku autorëve (Bardhi, Gazulli, Dema) që ka gjetur pasqyrim në fjalorët shpjegues të shqipes.

1.1. Fjalori i Bardhit

Në Fjalorin e Bardhit janë marrë në shqyrtim fjalë dialektore a krahinore, të veçanta, duke i bërë një përjasje me Fjalorët e Gjuhës Shqipe, 1954,1980. Gjithashtu kemi marrë në shqyrtim edhe *Leksikon Historik të gjuhës shqipe III* nga K.Ashta.

a) Fjalë që nuk janë përfshirë në Fjalorët 1954, 1980.

Kemi veçuar 53 fjalë të marra në shqyrtim.²³⁷

me gheçeletciem (me gëdhelëtuem), (f.2). Duke u nisur nga latinishtja, vetë fjala *adulari* do të thotë *miklues*, kështu që edhe vetë Bardhi me këtë fjalë do të japë të njëjtin kuptim. Në Fjalorin e '54, '80 nuk është e pasqyruar si lemë më vete. Sipas K.Ashtës e kemi, *argëtohem, josh* (Leksiku historik i gjuhës shqipe 3, Shkodër, 2000, f.139).

ching (kingj), (f.3). Këtë variant dialektor nuk e ndeshim në Fjalorët përkatës.

ngetai (ngjetai),(f.3). Bardhi këtu e përdor për *gjetkë*, ndërsa variantin dialektor **ngjetai** nuk e takojmë tek F.54 dhe F.80.

e praftu (e prashtu), (f.3). Nënkupton, *për këtë arsye*. Në një formë të tillë nuk e kemi tek F.54 dhe F.80. Edhe Ashta jep kuptimin: *prandaj, pra, për këtë, për arsye që* (Leksiku historik i gjuhës shqipe 3, Shkodër, 2000, f.236).

angurre (angurrë), (f.5). Nuk e ndeshim në F.54 dhe F.80. Ashta e jep për *Ankaraja e sotme* (Leksiku historik i gjuhës shqipe 3, Shkodër, 2000, f.94).

ndeguefcim (ndëgueshim), (f.5). Kjo fjalë nuk gjendet në Fjalorin e 54 dhe 80. Duke u nisur nga latinishtja, përkthimi në shqip është *qartë*. Ashta e jep për *haptas, çeltas* (Leksiku historik i gjuhës shqipe 3, Shkodër, 2000, f.208).

mirechiep (mireqep), (f.7). Sipas K.Ashtës: *ngjyrë a bojë shkrimi*; turq. mürekkeb (Leksiku historik i gjuhës shqipe 3, Shkodër, 2000, f. 198).

tatagiys (tatagjysh), (f.7). Në të njëjtën formë nuk e ndeshim tek Fjalori '54 dhe '80, por kemi trajtën *tatë-a - baba, atë* (F.80, f.1970). Me siguri kemi të bëjmë me fjalën babagjysh, për gjyshin nga babai, trajtë e cila gjen përdorim mjaft, sidomos në ligjërimin bisedor. Kolë Ashta e ka: *gjysh* (Leksiku historik i gjuhës shqipe 3, Shkodër, 2000, f.272)

deue, oo camile (deve o kamile), (f.10). Fjalën *kamile* nuk e gjejmë në Fjalorët e 54 dhe 80.

cimech (çimëk), (f.12). Këtë fjalë nuk e ndeshim të shpjeguar në Fjalorin e 54 dhe atë të 80, por gjendet tek Fjalori i vitit 2006. Gjithashtu Ashta e ka: *çimkë, tartabiqe* (Leksiku historik i gjuhës shqipe 3, Shkodër, 2000, f.111)

²³⁷ Po shënojmë një kod leximi kryesisht për fjalët e vjela nga Fjalori i F. Bardhit: **ch = k; ci = ç; gn = nj; fci=shi;f= s; z = c; ξ=dh.**

- rmata** (f.12), (rmata, armata, shpjegon edhe K.Ashta, Leksiku historik i gjuhës shqipe 3, Shkodër, 2000 f. 246; ushtri). Këtë fjalë nuk e kemi të shpjeguar në F.54 e F.80.
- me derquutune** (me dërkütunë), (f.13). Këtë fjalë nuk e gjejmë të shpjeguar në F.54 e F.80. Tek Ashta e kemi: (Leksiku historik i gjuhës shqipe 3, Shkodër, 2000. f.118).
- kondend** (kondend, i kënaqur – edhe te F. Leka & Z.Simoni, në Fjalorin Italisht - shqip), (f.15). Ky është një huazim i mirëfilltë nga italishtja, të cilën nuk e kemi të pasqyruar në Fjalorët shpjegues.
- chembegnenia** (këmbënjenia, f.18) si arkaizëm. Nuk e ndeshim si fjalë në F.54 dhe F.80. Sipas K.Ashtës: 1. *marrëzi*. 2. *të lanun mendsh*. 3. *pallavra*. 4. *punë e turpshme, faqe e zezë*. 5. *ai që thotë fjalë të jashtëzakonshme* (Leksiku historik i gjuhës shqipe 3, Shkodër, 2000, f.162).
- me fdripune vendit ze nalte** (me sdripunë vendit cë naltë), (f.19). Foljen *sdrip*=zbrës, nuk e gjejmë në F.54 e F.80, në këtë formë dialektore.
- i kebuem afte mefiale, e me tebaane** (i këbuem ashtë me fiale e me të bāme), (f.25). Foljen *këboj* nuk e ndeshim në F.54 dhe F.80. Sipas K.Ashtës: *këmbon, tingullon* (Leksiku historik i gjuhës shqipe 3, Shkodër, 2000, f.161).
- fineftra, oó balcue** (finestra ò balkue, me kuptimin “*dritare*” – Zadrimë; edhe tek poezia e Mjedës: “*Qet balkoni pjalm e borë*”), (f.25). Trajta *finestra* është një huazim nga italishtja.
- fuffgnana (fushnjana)**, (f.28). Nuk e ndeshim të shpjeguar si fjalë në F.54 dhe F.80. Sipas K.Ashtës, *vegël peshkimi në trajtë të tfurkut dhe me shumë dhëmbë, fuzhnje* (Leksiku historik i gjuhës shqipe – 3, Shkodër, 2000, f. 138).
- cianciatuer** (çançatuer), (f.29). Nuk e takojmë në F.54 dhe F.80. Sipas K.Ashtës: *tallje, llapazan* (Leksiku historik i gjuhës shqipe – 3, Shkodër, 2000, f. 110).
- cherrilate** (kërrilatë), (f.30). Nuk e gjejmë në F.54 dhe F.80. Tek K.Ashta e kemi: kurilë “*grues, gru: kërrilatë*” (Leksiku historik i gjuhës shqipe 3, Shkodër, 2000. F.164).
- me voruem** (me voruem), (f.32). Nuk e ndeshim si trajtë foljore në formë të tillë në F.54 dhe F.80. Ashta e shpjegon *me vorruem* (Leksiku historik i gjuhës shqipe 3, Shkodër, 2000, f.288).
- sceregiuer** (sherëgjuer), (f.32). Këtë fjalë nuk e kemi tek F.54 dhe F.80. Ashta jep variantin latinisht për *hipokrit* (Leksiku historik i gjuhës shqipe 3, Shkodër, 2000, f.258).
- te keçolete** (të këthollëtë), (f.33). Nuk e gjejmë në F.54 dhe F.80. Tek K.Ashta e kemi me dy kuptime: 1. *i ligshtë*. 2. *të qënit i plogët, i pakët* (Leksiku historik i gjuhës shqipe 3, Shkodër, 2000, f.166).
- meedifchiaruem** (me e diskia ruem), (f.39). Nuk e kemi në F.54 dhe F.80. K.Ashta e jep për *disqaruem* (Leksiku historik i gjuhës shqipe 3, Shkodër, 2000, f.120). Këtu kemi veçorinë e gegërishtes veriperëndimore ku grupi i bashkëtingëlloreve *kl* nuk është palatalizuar në *q*, por në *ki/kj*.
- deluçete** (dëludhëtë), (f.41). Nuk e gjejmë në F.54 dhe F.80. Tek K.Ashta e kemi: *vërshim, përmytje* (Leksiku historik i gjuhës shqipe 3, Shkodër, 2000, f.117).
- meu gumezune** (me u gumeacunë), (f.41). Nuk e kemi si fjalë në F. 54 dhe F.80. K. Ashka e ka: *argtohem, tallem, vë në lojë* (Leksiku historik i gjuhës shqipe 3, Shkodër, 2000, f.143).
- taleia** (taleja), (f.42). Në formë të shkurtuar, me një rënie të tingullit nistor, Bardhi përdor Taleia për Italia.
- talian (talian)**, (f.42). E njëjta gjë si më sipër.

- zuçëj** (xhuhdī), (f.43). Nuk e kemi në F.54 dhe F.80. K.Ashta e jep nga latinishtja, *judaeus* e italishtja *giudeo* (Leksiku historik i gjuhës shqipe 3, Shkodër, 2000, f.292), nga Juda, një nga dishepujt në besimin e krishterë.
- tamble** (tamblë), (f.44). Ky dialektizëm nuk ndeshet në F.54, F.80. Tek K.Ashta e kemi *tambël-i* (Leksiku historik i gjuhës shqipe 3, Shkodër, 2000, f. 271).
- mufterach** (musterak), (f.46). Nuk e kemi në F.54 dhe F.80. K.Ashta e ka për *nevojto* (Leksiku historik i gjuhës shqipe 3, Shkodër, 2000, f.205).
- scriuaa** (shkrivār), (f.49). Këtë fjalë nuk e ndeshim në F.54 dhe F. 80. Tek K.Ashta e kemi: *ai që mëson tjetrin të shkruajë* (Leksiku historik i gjuhës shqipe 3, Shkodër, 2000, f. 262).
- maaga** (māga), (f. 54). F. 54 dhe 80 nuk e kanë. K.Ashta e jep për *mangë-a* (Leksiku historik i gjuhës shqipe 3, Shkodër, 2000, f.185).
- labdurij** (labdurī), (f. 59). Nuk e gjejmë në F.54 dhe F.80. E ndeshim tek K.Ashta, *mburrjet për kërcënim ndaj dikuj* (Leksiku historik i gjuhës shqipe 3, Shkodër, 2000, f.175).
- mchana** (mkana), (f.60). Nuk e ndeshim në F.54 dhe F.80. Por e takojmë tek K.Ashta: *mokën, mokër, gur mulliri, është një gur i madh e i rrumbullakët, me një vrimë në mes që rrotullohet sipër një guri tjetër që s'lot, për të bluar drithë* (Leksiku historik i gjuhës shqipe 3, Shkodër, 2000, f.200).
- felchigna** (fëlqinja), (f. 56). Nuk e ndeshim në F.54 dhe F.80.K.Ashta e shpjegon: *fulqi, nofull* (Leksiku historik i gjuhës shqipe 3, Shkodër, 2000, f.132).
- me difcuem**(me dishkuem), (f.60). Nuk e kemi në F.54, F.80. K.Ashta e ka për *ndishkuem* (Leksiku historik i gjuhës shqipe 3, Shkodër, 2000, f.120).
- me stimuem** (me stimuem), (f.62). Këtë folje nuk e ndeshim në F.54 e F.80, sepse është një huazim nga italishtja me përshtatje gramatikore të shqipes së formës së pashtjelluar geqe. K. Ashta e ka: *çmoj vlerën e një njeriu* (Leksiku historik i gjuhës shqipe 3, Shkodër, 2000, f.256).
- statpulchyer** (shtatpulqyer), (f.63). Këtë kompozitë nuk e gjejmë të shpjeguar në F.54 dhe F.80. Tek K.Ashta e kemi: *ai që e ka truën si pulqyer, si gishti i madh i dorës, shkurtabiq, xhuxhimaxhuxh* (Leksiku historik i gjuhës shqipe 3, Shkodër, 2000, f.267).
- nauil** (navill), (f.64). Nuk e kemi në F.54 e F.80. K. Ashta e jep për *anije* (Leksiku historik i gjuhës shqipe 3, Shkodër, 2000, f.206).
- ciallefcites** (çallëshitës), (f.64). Nuk e ndeshim në F.54 dhe F.80. Por tek K.Ashta kemi një shpjegim domethënës: *fjala latine negotiator, që do të thotë shqip tregtar, u përkthye prej Bardhit çallëshitës, në qoftë se transkriptimi ynë nuk është gabim. Kuptimi i kësaj fjale shqipe e marrë kështu në vetvete del i errët, ndoshta kemi të bëjmë me një fjalë të kompozuar mallëshitës-i, ai që shet mall, që bën tregti* (Leksiku historik i gjuhës shqipe 3, Shkodër, 2000, f.110).
- dellues** (dellues), (f.65). Me këtë fjalë Bardhi do të tregojë një njeri nevrrik, por në F. 54 e F.80 nuk e ndeshim fare. Të njetin shpjegim jep edhe K.Ashta për *nevrrik* (Leksiku historik i gjuhës shqipe 3, Shkodër, 2000, f.115).
- repina** (rëpina), (f.66). Nuk e kemi në F.54, F.80.K.Ashta e jep: *rrëpinë* (Leksiku historik i gjuhës shqipe 3, Shkodër, 2000, f.244).
- berfut** (bërshut), (f.97). Nuk e ndeshim në F.54 e F.80.Tek K.Ashta e kemi: *bërshuteja* (Leksiku historik i gjuhës shqipe 3, Shkodër, 2000, f.103).
- scughetaar ai chi ftie vene** (shugëtār, ai qi shtie venë), (f. 100). Nuk e kemi të përdorur në F.54 dhe F.80. K.Ashta e ka: *verëqitës, ai që mbush kupat e verës* (Leksiku historik i gjuhës shqipe 3, Shkodër, 2000, f.270).

- gutta** (guta), (f.100). Nuk e ndeshim në F.54, F.80. K.Ashta e ka: *cermë, priq-t, përdhes, inflamacion kyçesh e gjymtyrësh të trupit, artrit* (Leksiku historik i gjuhës shqipe 3, Shkodër, 2000, f.144).
- chiemal** (qemal), (f.104). Nuk e takojmë në F.54 dhe F.80.K.Ashta e jep si fjalë turke: *lajmëtar* (Leksiku historik i gjuhës shqipe 3, Shkodër, 2000, f. 241).
- me leecitune** (me leçitunë), (f.115). Nuk e gjejmë si fjalë në F.54 dhe F.80. E takojmë tek K.Ashta: *shpall* (Leksiku historik i gjuhës shqipe 3, Shkodër, 2000, f.178).
- mengij** (mengjī), (f.128). Nuk e ndeshim si fjalë në F.54 dhe F.80. Sipas K.Ashtës, fjala etimologjikisht është *mjeki*. Prej *mëngji* sot ka kaluar në *mnji: shërim* (Leksiku historik i gjuhës shqipe 3, Shkodër, 2000, f.196).
- me ufcuæuem, e me vlaam** (me u skuzuem e me u lām), (f.142). Edhe folja *skuzoj* është një huazim nga italishtja, së cilës Bardhi i ka bërë një përshtatje gramatikore të formës së pashtjelluar geqe. Tek K. Ashta e kemi: më fal gabimin (Leksiku historik i gjuhës shqipe 3, Shkodër, 2000, f.255).
- chiervafareia** (qervasareja), (f.170). Nuk e kemi të shpjeguar në F.54 dhe F.80. Tek K.Ashta e gjejmë: *pijetore* (Leksiku historik i gjuhës shqipe 3, Shkodër, 2000, f.241).
- alfier, bairachtaar** (alfier, bajraktār), (f.183). Fjalën *alfier* nuk e takojmë në F.54 dhe F.80. K.Ashta e ka për *flamurtar* (Leksiku historik i gjuhës shqipe 3, Shkodër, 2000, f.92).

b) Fjalë me kuptim shtesë, të shpjguara në Fjalorët e viteve 1954,1980.

Kemi 25 fjalë të marra në shqyrtim.²³⁸

temaimite (të maimitë), (f.1). E ndeshim tek F.'80 si emër të gjinisë asnjësore, por edhe si folje (majm), si mbiemër (i majmë). **të majmët** – 1. *të qenët i majmë, majmëri (për kafshët e për njerëzit)*. 2. *fig. bised. jetesë me të gjitha të mirat; e mira, bollëku*. (F.'80, f.1049).

me beghenifune (me begenisunë). F.'80 e ka në pjesë të ndryshme të ligjëratës, si emër (begeni, begenisje), si mbiemër (i begenisshëm, i begenisur) dhe si folje, **begenis** - 1. *pres një tjetër, zakonisht të një shkalle më të ulët, duke i bërë nderet; i bëj dikujt një vizitë për ta nderuar*. 2. *pranoj të kem marrëdhënie me dikë, që qëndron në një shkallë më të ulët se unë, sillem i afërt e i thjeshtë me të; pranoj diçka që e quaj më poshtë se shkalla ime; e përfill*. 3. *pranoj të bëj diçka, megjithëse e quaj të papërshtatshme për shkallën time* (F.'80, f.121).

zotyne ipameguem, oi i paafoffune (Zotynë i pāmëguem o i pāsosunë), (f.2). Ndeshim të përdorur vetëm fjalën e dytë në Fjalorin e '80, **i pasosur** – 1. *që nuk ka mbarim, që s'ka të sosur, i pafund (në hapësirë)*. 2. *që është shumë i madh në sasi e në numër, që nuk mund të numërohet; i pafund*. 3. *që zgjat shumë kohë a që duket tepër i gjatë; që vazhdon pa ndërprerje; i pafund*. 4. *shumë i madh, i pakufishëm*. (F.'80, f.1378).

sceplaca (shëplaka), (f.3). Fjalori i '80 e ka në disa kuptime, **shuplakë-a** – 1. *pëllëmba e dorës*. 2. *goditje me pëllëmbë, pëllëmbë, shpullë*. 3. *veprim që është për dikë një goditje e fortë a një fyerje e rëndë*. 4. *masë gjatësie sa katër gishtat e dorës (pa pëlqerin) për së gjëri e të puqur me njëri-tjetrin; si frazeologjizëm, i dha shuplakën - e mori më sysh (kur kujtohej sipas besëtytnive se një fëmijë ishte sëmurrur ngaqë e kishin goditur hijet a syri i keq)*. (F.'80, f.1956).

camareia (kamareja), (f.6). Në F.'54 e kemi me dy kuptime, **kamare-ja**- 1. *vend i çelur në mur në formë qemeri, zakonisht në të dy anët e vatrës, ku vihen filxhanet; përgjithësisht çdo vend i hapur në mur në formë qemeri, për të vendosur diçka*. 2. *vapori, kabinë* (F.'54, f.196). Në F.'80. e kemi me katër kuptime : **kamare-ja** – 1. *vend i hapur në murin e një shtëpie, zakonisht në të dyja anët e oxhakut, ku mbahen enë e sende të vogla që përdoren përditë (xhezeve, filxhanë etj.); dollap i vogël pa kanata në mur; vrimë në mur*. 2. *hapësirë e vogël si dritare në murin midis dy qemereve të urës*. 3. *krah. vendi ku pula pjell vezët, furrik*. 4. *kabinë në vapor*. (F.'80, f.775). Ashta shkon më tej në shpjegimin e kësaj leme: *merimangë*, (Leksiku historik i gjuhës shqipe 3, Shkodër, 2000, f.157).

rgiand (rgjand), (f.6).E ndeshim në trajtën e plotë, në F.'80, **argjend-i** – 1. *metal i rrallë e i çmuar, me ngjyrë të bardhë e të shkëlqyer, që punohet lehtë dhe që përdoret për të bërë sende zbukurimi, monedha, enë etj.* 2. *fill i larë me këtë metal, që përdoret për qëndisje*. 3. *zakon*. 4. *në ngjyrë të bardhë, të shkëlqyer, i argjendtë* (F.'80, f.47). K. Ashta: *denër i rgjandë*, (Leksiku historik i gjuhës shqipe 3, Shkodër, 2000, f. 245).

²³⁸ Vërejmë se, krahasuar midis tyre (1954), Fjalori i vitit 1980, ka përparësi në dhënien e kuptimeve shtesë, të cilat po i pasqyrojmë më sipër (Shënim i autores).

- grumafi** (grumazi) (f.7). F.'80, **gurmaz-i** – 1. *gypi i ushqimit që nga fundi i gojës e deri në stomak; pjesa e sipërme e këtij kanali, fyt.* 2. *gabzherr, rryl.* 3. *gllënjëkë* (F.'80, f.591). Në këtë rast do të kemi të bëjmë me dukurinë e metatezës.
- margaac, gomaar** (margaç, gomar), (f.7). Në trajtën *margaç*, nuk e ndeshim tek F.'80, ndërsa gomar, përdoret edhe në gjuhën letrare, **gomar-i** – 1. *kafshë njëthundrake, që mbahet në shtëpi për ngarkesë, me trup më të vogël se kali, me kokë të madhe, me veshë të gjatë dhe me qime zakonisht në ngjyrë të hirtë.* 2. *sasia e barrës a ngarkesa që mban kjo kafshë.* 3. *fig. thjeshtligj.,shar. njeri i trashë nga mendja, budalla; hajvan* (F.'80, f.563). Edhe tek Ashta e gjejmë me të njëjtin kuptim (Leksiku historik i gjuhës shqipe 3, Shkodër, 2000, f.187).
- mefciucuem** (me shukuem), (f.7). Në variantin e sotëm është **shikoj**. Fjalori i '80 e ka në disa kuptime, **shikoj** – 1. *hedh sytë mbi dikë a diçka për ta parë, drejtoj vështrimin mbi të; përpiqem të dalloj diçka me anën e të parit; ndjek me vëmendje, vështroj për një kohë të gjatë, sodit.* 2. *hedh vështrimin në një drejtim të caktuar, i kam sytë të kthyer drejt diçkaje, vështroj.* 3. *këqyr a vërej me kujdes, shqyrtoj; lexoj a kontrolloj diçka për të gjetur atë që më intereson; i hedh një sy duke e lexuar; vëzhgoj, këqyr; kontrolloj mirë për të gjetur diçka a për të marrë vesh çfarë ka; provo.* 4. *edhe jok. shoh.* 5. *dëgjoj, i vë veshin, marr parasysht; kam kujdes.* 6. *kujdesem për dikë a për diçka, e ndihmoj, e shoh, e vështroj; ruaj.* 7. *përdoret në kuptim pasthirmor për të shprehur habinë e folësit për diçka, për të tërhequr vëmendjen e dëgjuesit ose për të thumbuar a për të tallur dikë,(shiko, ç'sy)!* 8. *përdoret në kuptim pasthirmor për të shprehur paralajmërim a kërcënim për dikë. shiko, hap sytë!* (F.'80, f. 1842).
- achfcianii driteffe, oó ndenateia** (akshani i dritësë o ndëneteja), (f.7). E ndeshim tek Fjalori i '80 në dy kuptime, *aksham-i* – 1. *shih mbrëmje-a.* 2. *lutja e mbrëmjes që bëhej nga myslimanët sipas dogmës fetare* (F.'80, f.19). Ashta shton edhe prejardhjen: *tq. aksham;* më tej Çabej e sjell si fjalë i.e. Por, sipas tij, Bardhi e përdor me kuptimin e *dritës së pakë, kur fillon e del drita, lind dielli,ag,* (Leksiku historik i gjuhës shqipe 3, Shkodër, 2000, f. 92).
- cufcia, caçan** (kusia, kazan), (f. 9).Në Fjalorin e '80 e ndeshim si të tillë, **kusi-a-** *enë e rrumbullakët dhe e thellë, zakonisht prej bakri, me fund të sheshtë, me një dorezë si të kovës, që përdoret për të ngrohur ujë, për të mjelë bagëtinë, për të zier gjellë, rroba etj; rrethje* (F.'80, f. 927). Edhe fjala **kazan-i** përdoret me të njëjtin kuptim si **kusi-a**, vetëm se në Fjalorin e '80 e ndeshim me tri kuptime- 1. *enë e madhe prej metali (zakonisht prej bakri), e rrumbullakët dhe me dy veshë, që shërben për të zier ujë, ndërresa, gjella etj.* 2. *pjesë e kaldajës, e lokomotivës etj., që përbëhet nga një enë e mbyllur e metaltë, ku prodhohet avull uji ose përpunohet diçka në temperaturë të lartë.* 3. *vendi ku zhvillohet vazhdimisht një veprimtari e ethshme, ku zien lufta e mendimeve etj., vendi ku përpunohet një mendim për të mashtruar të tjerët, burimi nga lind dhe përhapet një trillim, një shpifje etj* (F.'80, f.803).
- suta** (suta), (f.11). E gjejmë tek Fjalori i 80, **sutë-a-** 1. *femra e drerit, drenushë.* 2. *vajzë e hijshme dhe e shkathët; vajzë e urtë, e butë.* 3. *figurë e përrallave popullore, që përfytyrohej me trup si të lopës* (F.'80, f.1805).
- scefte** (sheste), (f.12).E kemi me të njëjtin kuptim edhe në Fjalorin e '80, **shestë** – 1. *kompas, pergjel.* 2. *qëllim, plan, shestim, rregull, rend* (F.'80, f.1829).
- denaar** (dënar), (f.18). Në F.'54, **dinar-i** – *njësi monetare e jugosllavisë.* 2. *marcel* (F.'54, f.85). Në Fjalorin e '80 e takojmë njëlloj në formën **dinar-i** – 1.*njësia*

monetare bazë e Jugosllavisë, e Algjerisë, e Tunizisë, e Irakut etj.; monedhë që ka këtë vlerë. 2. marcel (F.'80, f.337).

puftetia (pushtetia), (f.25). F.'54 e përdor në këtë formë, **pushtet-i** – 1. *sundimi politik, qeverisja, organet qeveritare, qeveria, struktura shtetërore*. 2. *e drejta dhe mundësia për t'urdhëruar diçka a dikë* (F.'54, f. 441). Në F.'80 e ndeshim në gjininë mashkullore, **pushtet-i** – 1. *sundim politik i një klase, i një grupi shoqëror etj., që shprehet në të drejtën dhe mundësinë për të qeverisur shtetin, një krahinë, një rreth etj. nëpërmjet organeve të zgjedhura a të emëruara, kolegjiale a të përbëra nga një njeri i vetëm*. 2. *organet e qeverisjes së shtetit, të një krahine, të një rrethi etj.; qeveria*. 3. *e drejta dhe mundësia që ka dikush për të urdhëruar dikë, për të vepruar ose për të ndikuar mbi dikë a mbi diçka; fuqia që ka dikush a diçka; ndikimi që mund të ushtrojë dikush a diçka mbi një tjetër* (F.'80, f.1578). Bardhi e ka përdorur në gjininë femërore ashtu siç ndodh edhe me shumë emra të tjerë në zonat e gegërishtes veriperëndimore, Malësi e Madhe (mjalta, shnedja, lodja etj). Ashta shkon më tej me sinonime: *fuqi, zotësi, vlerë*, (Leksiku historik i gjuhës shqipe 3, Shkodër, 2000, f.239).

fatoff (fatos), (f.27). E kemi në F.'80, **fatos-i** – 1. *nxënës i ciklit të ulët të shkollës tetëvjeçare deri në moshën nëntë vjeç, para se të hyjë në organizatën e pionierit*. 2. *trim i fortë; kreshnik* (F.'80, f.458). Tek Ashta, edhe me kuptimin “*fatlum*”, (Leksiku historik i gjuhës shqipe 3, Shkodër, 2000, f.131).

chalata (qallata), (f.29). F.'54 e përdor, **çallatë-a** – 1. *një e çarë që bën sëpata dhe çdo vegël tjetër prerëse, kur bie më dru*. 2. *vendi ku është ngrënë presja e thikës, e sëpatës kur bie më një gur etj; garbë* (F.'54, f.61). Tek F.'80 e kemi në këtë trajtë: **çallat-a** – 1. *e thelluar që mbetet në dru, në gur a në diçka tjetër kur hiqet një pjesë duke e prerë a duke e goditur; plasë*. 2. *e thelluar në tehun e një vegle kur thyhet një copë e vogël*. 3. *thellë dhe duke i hequr një copë* (F.'80, f.242). Kemi ndeshur, në Zadrimë, edhe foljen “*çallis/t*”- me të çallitë në krye. K.Ashta jep kuptimin: *përkrenare* (Leksiku historik i gjuhës shqipe 3, Shkodër, 2000, f.240).

macche (makë), (f.29). E ndeshim në F.'80 në disa kuptime, **makë-a** – 1. *cipë që zënë përsipër disa lëngje; cipë*. 2. *makrosë*. 3. *pëlhurë merimange, cergë*. 4. *lëndë ngjitëse e përgatitur me miel a me niseshte; qiriç* (F.'80, f.1051). Mungon tek Ashta.

miestra (mieshtra), (f.52). F.'54 jep shumë kuptime të kësaj fjale, ku ndër të tjera përkon me kuptimin e Bardhit, **mjeshtër-mjeshtri**- 1. *punëtori që ndërton mure dhe ndërtesa*. 2. *ai që ja ka marrë dorën mirë një zanati a një arti dhe e zotëron më së miri*. 3. *mësonjës* (F.54, f.319). Bardhi e ka përdorur për *mësuese*, ndërsa në F.'80 e kemi me këtë kuptim, **mjeshtre-ja** - fem. e *mjeshtër-ri- mjeshtre reparti, mjeshtre baleti...*(F.'80, f.1157). Tek K.Ashta e kemi: 1.*mësues*. 2.*zejtari, zanatçi* (Leksiku historik i gjuhës shqipe 3, Shkodër, 2000, f.199).

chelogene (këllogjënë), (f.60). Në F.'80 e kemi me dy kuptime, **kallogjer-i** – 1. *murg ortodoks (në vendet ku vepron kisha ortodokse)*. 2. *njeri që bën jetë të mbyllur, ai që është shkëputur nga jeta e gjallë* (F.'80, f.773). Shënojmë se në trajtën “*këllogjen- kllogjna*” emërohet një sëmundje e bimës së misrit, që del pranë kallëzës, në formë boçeje me ngjyrë të zezë, M.Madhe, Zadrimë).

reeea, (rëza), (f.68). F.'80, e ka në disa kuptime, **re-ja**- 1. *grumbull avujsh uji, që rrinë pezull lart në qiell*. 2. *shtëllungë e madhe grimcash të imëta që enden në ajër; grumbull i dendur i diçkaje që ngrihet e që lëviz në ajër*. 3. *diçka që*

pengon vështrimin, perde. 4. diçka e zyrtë, që paralajmëron një të keqe; diçka që sjell një shqetësim. 5. grumbull fjalësh ose veprimesh, zakonisht të mbledhura për të errësuar a shtrembëruar diçka. 6. krah. rrufe (F.'80, f.1635). Edhe K.Ashta e jep me të njëjtin kuptim: re e vogël (Leksiku historik i gjuhës shqipe 3, Shkodër, 2000, f.245).

pallaree, e mase, oó tepffy (palarë e madhe o tepsī), (f.84). E ndeshim me tri kuptime në F.'80, **palare-ja** – 1. *dërrasë e gjerë, e rrumbullakët dhe e lëmuar, mbi të cilën tëhollin petët e lakrorit, të byrekut etj.. 2. pjatë e madhe dhe e nderë, zakonisht prej balte; tepsi a tavë prej balte. 3. pjatë me grurë të zier, që e çonin në kishë besimtarët ortodoksë dhe ua ndanin njerëzve për të përkujtuar një të vdekur (F.'80, f.1335).*

torch (tork), (106). F.'54 e ka, **tork-u** – 1. *dërrasë e trashë që mëshon mbi kanistrat e mbushura me ullinj që të shtypë ullinjtë e të dalë vaji. 2. shkelësi i rrushit (F.'54, f.568). Në F.'80 e ndeshim me tri kuptime, **tork-ë/a** – 1. *sasi filli prej leshi, prej pambuku etj., që mblidhet në qerthull, në makinë a midis dy duarve, për t'u larë ose për t'u ngjyer më lehtë etj.; shkul, çile, liter. 2. sasi duhani prej katër a pesë vargjesh të mbështjella e të lidhura si top. 3. shami a peshqir, që e lidhin një nga njëra anë dhe që e përdorin për të goditur me të një lojë fëmijësh; turrë,turra; lojë me shami, që e vendosin në fund të një shkopi të ngullur në tokë, të cilin e mbron me një brez njëri nga lojtarët për të mos e marrë lojtarët e tjerë (F.'80, f.2008). K.Ashta e shpjegon: dërrasë e trashë për shtrydhjen e rrushit; shtrydhës (Leksiku historik i gjuhës shqipe 3, Shkodër, 2000, f.275).**

zambaf, oó mafcaar, (xhambas o maskār), (f.145). Fjalën xhambaz e ndeshim në F.80, **xhambaz-i** – 1. *ai që shet e blen kuaj a kafshë të tjera për të nxjerrë fitim; ai që shtron e stërvit kuajt xanxarë. 2. njeri që bën dallavere; njeri dredharak që përpiket t'ua hedhë të tjerëve e të nxjerrë përfitime për vete, dallaveraxhi, bataqçi. 3. përdorimi sipas kuptimit të 2 të emrit, njeri xhambaz (F.'80, f.2196). Tek Ashta, edhe me kuptimin “shakaxhi” dhe “pehlivan”, akrobat, (Leksiku historik i gjuhës shqipe 3, Shkodër, 2000, f. 292).*

pafnich (pashnik), (f.165). Në F.'80 e kemi, **pashnik-u** – 1. *copë pëlhure e hollë, mbulesë e hollë; shami e hollë të cilën e hidhnin në kokë zakonisht gratë e moshuara. 2. mbulesë e hollë me të cilën mbështillej i vdekuri në arkivol, savan (F.'80, f.1383). Tek Ashta edhe me kuptimin “peshqir”, (Leksiku historik i gjuhës shqipe 3, Shkodër, 2000, f.225).*

c) Fjalë që përfshihen vetëm tek Fjalori i 1954.²³⁹

Janë marrë 16 fjalë te Bardhi.

- brunze** (bruncë), (f.2). Bardhi, për **bruncë** ka kuptimin e **bakrit**, duke u nisur edhe nga përkthimi nga latinishtja në shqip i kësaj fjale. F.'54 e përdor si të tillë, **brunc-i** –*brunc* (F.'54, f.48). K. Ashta shkon më tej në shpjegim, 1. *rrem, brunc*. 2. *pare bronci* (Leksiku historik i gjuhës shqipe 3, Shkodër, 2000, f.106).
- i ftemanchte** (i shtëmanktë), (f.4). F.'54 e përdor me të njëjtin kuptim, **i shtëmëngët** – *i mëngjër* (F.'54, f.544).
- meufedigune** (me u fëdigunë), (f.4). F.'54 e përdor me të njëjtin kuptim, **fëdigë-a** – 1. *mundim, punë*. 2. *barrë (grua)*, (F.'54, f.117). Duke u nisur nga latinishtja, përkthimi në shqip është **për të punuar**, ndërsa në trajtën dialektore të Bardhit nuk e ndeshim në Fjalorët e shqipes. K. Ashta e ka: 1. *punë*. 2. *të marrun mendsh* (Leksiku historik i gjuhës shqipe 3, Shkodër, 2000, f.132).
- streit** (shtreit), (f.5). Në F.'54 e ndeshim me dy kuptime, ku kuptimi i dytë përkon me atë të Bardhit, **shtrenjtë** – 2. *jo i lirë, ngushtë* (F.'54, f.546). Ky është një krahinorizëm, i përdorur kryesisht në zonat e Malësisë së Madhe, Dukagjin, me kuptimin **ngusht**, *xhupi më rri shtreit*.
- chiauff** (qaush), (f.6). Në shqip ka ekuivalenten, *oficer*. Bardhi shpjegimin e kësaj fjale e ka dhënë direkt në turqisht. E ndeshim në F.'54, **çauh-i** – *rreshter (në kohën e turqisë)*, (F.'54, f.63).
- te prugnete** (të prunjëtë), (f.12). F.'54 e përdor me të njëjtin kuptim, **i,e prunjte** – *i përvujtë, modest* (F.'54, f.436). Tek K. Ashta e kemi me katër kuptime: 1. *i përlur, i përkulur*. 2. *i vënë nën të*. 3. *vënie poshtë*. 4. *Përkulje* (Leksiku historik i gjuhës shqipe 3, Shkodër, 2000, f.238).
- me fuguem** oó me ngām rend (me fuguem o me ngām rend), (f.17). Forma e pashtjelluar e foljes *me fuguem*, vjen nga një huazim nga italishtja, *fuggire* (ik) dhe është një përshtatje me format gramatikore të shqipes. E ndeshim vetëm në F.'54, **fugoj** - *iki me vrap, harboj* (F.'54, 131).
- cheha**, (këha), (f.32). F.'54 e përdor njëlloj, **këha** - *këtu* (F.'54, f.209). Ky dialektizëm përdoret në standard me fjalën këtu.
- mneerues** (mnēruēs), (f.35). Në F.'54 ndeshim emrin **mnerë** - *a – tmerr, frikë e madhe, si dhe mbiemrin i mnershim, e mnershme me të njëjtën domethënie* (F.54, f.319). Edhe K. Ashta e jep me të njëjtin kuptim, *i frikshëm* (Leksiku historik i gjuhës shqipe 3, Shkodër, 2000, f.200).
- tudign** (tudinj), (f.60). F.'54 përdor, **tudi-tudini** – *gjerdan* (F.'54, f.578). Tek K. Ashta e kemi: *gushore (kolonë) ari o argjendi si vargonj për stoli grash* (Leksiku historik i gjuhës shqipe 3, Shkodër, 2000, f.277).
- dugagne** (duganjë), (f.76). F.'54 e përdor, **dugajë-a** – *dyqan* (F.'54, f.96).
- lofnich** (losnik), (f. 82). F.'54, **losnik-u**– *leshnik* (F.'54, f.276).
- nechim** (nëkim, me rotacizëm), (f.119). F.'54, **nëkim-i** – *rënkim, rëkim* (F.'54, f.342).

²³⁹ Vërejmë se fjalët e mësipërme prej Fjalorit të Bardhit, kanë gjetur pasyrim vetëm në Fjalorin e vitit 1954 (me autorë hartues: Anton Krajni, Osman Myderrizi, Kostaq Cipo, E. Çabej); kjo, mbase për faktin që ky Fjalor ishte i pari që hartohet si fjalor shpjegues pas Luftës II Botërore. Tek ky fjalor gjenden mjaft krahinorizma dhe dialektizma të gegërishtes veripërendimore.

scandule (shkandullë, leksemë e sferes fetare), (f.143). F.'54 e ka, **shkandull-i** – 1. *fjalë a punë që e shtyn tjetrin në mëkat; shembëll e keqe. 2. lapërthi* (F.'54, f. 524).

terfoiene (tërfojëne), (f.176). F.'54 ka fjalën **tërfojë-a** – *trifil* (F.'54, f.563). K.Ashta e shpjegon: *bar që i ka fletët tri e nga tri në një kërcyell, tërfojë-a* (Leksiku historik i gjuhës shqipe 3, Shkodër, 2000, f.273).

ç) Fjalë që përfshihen vetëm tek Fjalori i 1980.

Janë veçuar 4 raste të tilla.

rcoreia (rkoreja), (f.11). Fjalori i '80 e shpjegon në këtë mënyrë, **rëkore-ja** – *radhiqe, resë* (F.'80, f.1654).

mbarreia, suna (mbarreja, dhuna), (f.33). Këtë dialektizëm e ndeshim me të njëjtin kuptim në F.'80. **marre-ja** – *turp* (F.'80, f.1064).

zurlla (curla), (f.49). Në F.'80 e kemi, **curle-ja** – *melodi me curle* (F.'80, f.234).

d) Fjalë që janë përfshirë në të dy Fjalorët ('54,'80).

Janë marrë në shqyrtim 79 fjalë.

tepercuerm (të përkuerm), (f.1). Në F.'54 e ndeshim si emër dhe mbiemër, **përkore-përkorja** – *masë e qokë në të ngrënë e në të pirë, i përkorë* - *që ka masë e qokë në të ngrënë e në të pirë* (F.'54, f. 399). F.'80 e përdor si emër, **përkore-ja** - 1. *masë a përmbajtje në të ngrënë e në të pirë, qokë*. 2. *kufizim në kënaqësitë trupore, heqje dorë nga këto kënaqësi; heqje dorë nga përdorimi i disa ushqimeve dhe i pijeve alkoolike (sipas disa paragjykimeve fetare)*, (F.'80, f.1443). Gjithashtu përdoren edhe trajtat mbiemërore, *i përkorë, i përkormë* me të njëjtin kuptim.

baaff (bās), (f.1). F.'54 e përdor me të njëjtë formë si Bardhi, **bas-i** – *ai që është krijuesi, autori i një pune, i një vepre; ai që ka kursyer një punë të prapë* (F.'54, f.30). F.'80 e përdor në trajtën **bërës-i** – *ai që ka krijuar ose që ka hartuar diçka, ai që ka bërë diçka; autor* (F.'80, f.136). Siç vërejmë, Bardhi përdor variantin dialektor të kësaj fjale, ku bie në sy dyfishimi i zanoreve dhe bashkëtingëlloreve.

temaimite (të maimitë), (f.1). Në F.'54 e kemi si mbiemër, **i,e majme** – *që ka dhjamë në trup* (F.'54, f.287). E ndeshim tek F.'80 si emër të gjinisë asnjënjëse, por edhe si folje (majm), si mbiemër (i majmë). **të majmët** – 1. *të qenët i majmë, majmëri (për kafshët e për njerëzit)*. 2. *fig. bised. jetesë me të gjitha të mirat; e mira, bollëku*. (F.'80, f.1049).

me beghenifune (me beghenisunë). F.'54 përdor si folje, **begenis** –sh. **Bejendis** - *pres me nder një më të vogël* (F.'54, f.33). F.'80 e ka në pjesë të ndryshme të ligjëratës, si emër (*begeni, beghenisje*), si mbiemër (*i beghisshëm, i beghisur*) dhe si folje, **begenis**- 1. *pres një tjetër, zakonisht të një shkalle më të ulët, duke i bërë nderet; i bëj dikujt një vizitë për ta nderuar*. 2. *pranoj të kem marrëdhënie me dikë, që qëndron në një shkallë më të ulët se unë, sillem i afërt e i thjeshtë me të; pranoj diçka që e quaj më poshtë se shkalla ime; e përfill*. 3. *pranoj të bëj diçka, megjithëse e quaj të papërshtatshme për shkallën time* (F. '80, f.121).

zotyne ipaameguem, oi i paafoffune (Zotyne i pāmëguem o i pāsosunë), (f.2). F.'54 e ka si mbiemër, **i pasosur** – *që s'ka të sosur, i përjetshëm, i amëshuar* (F.'54, f.381). Ndeshim të përdorur vetëm fjalën e dytë në Fjalorin e '80, **i pasosur** – 1. *që nuk ka mbarim, që s'ka të sosur, i pafund (në hapësirë)*. 2. *që është shumë i madh në sasi e në numër, që nuk mund të numërohet; i pafund*. 3. *që zgjat shumë kohë a që duket tepër i gjatë; që vazhdon pa ndërprerje; i pafund*. 4. *shumë i madh, i pakufishëm*. (F.'80, f.1378).

bastine (bashtinë), (f.3). F.'54 e përdor si të tillë, *bashtinë-a* – *arë a tokë, sa mund të punojë njëfamilje* (F.'54, f.31). F.'80 e gjejmë, **bashtinë-a** – 1. *copë toke e trashëgueshme, që e zotëronte një familje fshatare në sistemin e timareve dhe që e punonte si arë*. 2. *kopsht, bahçe* (F.'80, f.116). E ndeshim edhe si **bashtinar-i** – *pronar i një bastine në sistemin e timareve*.

sceplaca (shëplaka), (f.3). Në F.'54 e kemi, **shuplakë-a** – *pëllëmba e dorës* (F.'54, f.551). Fjalori i '80 e ka në disa kuptime, **shuplakë-a** – 1. *pëllëmba e dorës*. 2. *goditje me pëllëmbë, pëllëmbë, shpullë*. 3. *veprim që është për dikë një goditje e fortë a një fyerje e rëndë*. 4. *masë gjatësie sa katër gishtat e dorës (pa pëlqerin) për së gjëri e të puqur me njëri-tjetrin; si frazeologjizëm, i dha*

shuplakën - e mori më sysh (kur kujtohej sipas besëtytnive se një fëmijë ishte sëmurrur ngaqë e kishin goditur hijet a syri i keq). (F.'80, f.1956).

mighefsia (migjësia), (f.4). Ndeshet në Fjalorët e shqipes, thuajse me të njëjtën trajtë, por me një ndryshim fonetik të *gj-q*; F.'54 e ka, **miqësia** – 1. *dashamirësi midis dy a më shumë vetave, që mbështetet në nderimin e në besnikërinë e njerit ndaj tjetrit*. 2. *gjithë miqtë*. 3. *krushqi* (F.'54, f. 314). F.'80, **miqësia** – 1. *ndjenjë dashamirësie e ndërsjellë, që lind mes dy a më shumë vetave pa lidhje gjaku dhe që mbështetet në besimin e nderimin ndaj njëri-tjetrit, në ideale e synime e interesa të përbashkëta; terësi lidhjesh e marrëdhëniesh që frymëzohen nga ndjenja të tilla, lidhje e ngushtë shoqërore ndërmjet njerëzve që e duan dhe e përkrahin njëri-tjetrin, që i ndajnë bashkë gëzimet e hidhërimet*. 2. *lidhje e marrëdhënie të mira në mes dy a më shumë vendeve, popujve ose partive, që udhëhiqen nga ideale, nga qëllime dhe interesa të përbashkëta*. 3. *gjithë miqtë e dashamirët; njerëzit e afërm*. 4. *krushqi* (F.'80, f.1142).

mialzate (mialcatë), (f.5). F.'54 e ka, **mjalcë-a** – *bleta* (F.'54, f.318). Në F.'80 e ndeshim si të tillë: **mjaltëz-a** – *bletë* (F.'80, f.1154).

ndai tatene (ndai tatënë), (f.6). F.'54 e ka njëlloj, **tatë-a** – *emër me të cilin thërret fëmija t'anë* (F.'54, f.556). Në F.80 e kemi fjalën **tatë-a** – *baba, atë* (F.'80, f. 1970).

meiuavitune (me iu avitune), (f.6). F.54, **avis** – *afroj* (F.54, f.23). E takojmë në F.'80, **avit** (avis) – 1. *afroj*. 2. *le të afrohet, lejoj të vijë pranë, qas*. (F.'80, f.77).

umbi, plori (umbi, plori), (f.6). F.'54, **umb-i** – *pluar i vogël i parmendës* (F.'54, f.590). Fjalori i '80 e jep si të tillë, **umb-i** – *plori i vogël i parmendës* (F.'80, f. 2088).

camareia (kamareja), (f.6). Në F.'54 e kemi me dy kuptime, **kamare-ja** - 1. *vend i çelur në mur në formë qemeri, zakonisht në të dy anët e vatrës, ku vihen filxhanet; përgjithësisht çdo vend i hapur në mur në formë qemeri, për të vendosur diçka*. 2. *vapori, kabinë* (F.'54, f.196). Në F.'80. e kemi me katër kuptime : **kamare-ja** – 1. *vend i hapur në murin e një shtëpie, zakonisht në të dyja anët e oxhakut, ku mbahen enë e sende të vogla që përdoren përditë (xhezeve, filxhanë etj.); dollap i vogël pa kanata në mur; vrimë në mur*. 2. *hapësirë e vogël si dritare në murin midis dy qemereve të urës*. 3. *krah. vendi ku pula pjell vezët, furrik*. 4. *kabinë në vapor*. (F.'80, f.775).

rgiand (rgjand), (f.6) – F.'54 e ka në këtë formë, **argjend-i** – *ergjënd* (F.'54, f. '15). E ndeshim në trajtën e plotë, në F.'80, **argjend-i** – 1. *metal i rrallë e i çmuar, me ngjyrë të bardhë e të shkëlqyer, që punohet lehtë dhe që përdoret për të bërë sende zbukurimi, monedha, enë etj*. 2. *fill i larë me këtë metal, që përdoret për qëndisje*. 3. *zakon*. 4. *në ngjyrë të bardhë, të shkëlqyer, i argjendtë* (F.'80, f. 47).

grumafi (grumazi) (f.7). Mund të kemi të bëjmë me të njëjtën fjalë, **gurmaz-i** – *gryka e kanalit që nis nga fyti dhe mbaron në astomak* (F.'54, f.150). F.'80, **gurmaz-i** – 1. *gypi i ushqimit që nga fundi i gojës e deri në stomak; pjesa e sipërme e këtij kanali, fyt*. 2. *gabzherr, rryl*. 3. *gllënjë* (F.'80, f.591). Në këtë rast kemi të bëjmë me dukurinë e metatezës.

margaac, gomaar (margaç, gomar), (f.7). F.'54 e përdor njëlloj si Bardhi, **margaç-i** – *gomar, magjar* (F.'54, f.291). Në trajtën *margaç*, nuk e ndeshim tek F.'80, ndërsa *gomar*, përdoret edhe në gjuhën letrare, **gomar-i** – 1. *kafshë njëthundrake, që mbahet në shtëpi për ngarkesë, me trup më të vogël se kali, me kokë të madhe, me veshë të gjatë dhe me qime zakonisht në ngjyrë të hirtë*.

2. *sasia e barrës a ngarkesa që mban kjo kafshë*. 3. *fig. thjeshtligj., shar. njeri i trashë nga mendja, budalla; hajvan* (F.'80, f.563).
- achfcianii driteffe, oó ndenateia** (akshani i dritësë o ndenateja), (f.7). F.'54 e ka si të tillë, **aksham-i** – *mbrëmje, lutja e mbrëmjes ndër muslimanët* (F.'54, f.6). E ndeshim tek Fjalori i '80 në dy kuptime, **aksham-i** – 1. *shih mbrëmje-a*. 2. *lutja e mbrëmjes që bëhej nga myslimanët sipas dogmës fetare* (F.'80, f.19).
- cufcia, cağan** (kusia, kazan), (f.9). F.'54 e ka, **kusi-a-** *enë e bakërt pa kapak, me madhësi të ndryshme, që vihet në zjarr për të zier gjellë a për të ngrohur ujë* (F.'54, f.254). Në Fjalorin e '80 e ndeshim si të tillë, **kusi-a-** *enë e rrumbullakët dhe e thellë, zakonisht prej bakri, me fund të sheshtë, me një dorezë si të kovës, që përdoret për të ngrohur ujë, për të mjelë bagëtinë, për të zier gjellë, rroba etj; rrethje* (F.'80, f.927). Edhe fjala *kazan-i* përdoret me të njëjtin kuptim si *kusi-a*, vetëm se në Fjalorin e '80 e ndeshim me tre kuptime - 1. *enë e madhe prej metali (zakonisht prej bakri), e rrumbullakët dhe me dy veshë, që shërben për të zier ujë, ndërresa, gjella etj*. 2. *pjesë e kaldajës, e lokomotivës etj, që përbëhet nga një enë e mbyllur e metaltë, ku prodhohet avull uji ose përpunohet diçka në temperaturë të lartë*. 3. *vendi ku zhvillohet vazhdimisht një veprimtari e ethshme, ku zien lufta e mendimeve etj., vendi ku përpunohet një mendim për të mashtruar të tjerët, burimi nga lind dhe përhapet një trillim, një shpifje etj.*(F.'80, f.803).
- putyr** (putir), (f.10). F.'54 e përmend si të tillë, **putir-i –potir-i** - *gotë qelq, kupë; gotë e vogël për liker; qelqi i meshës, kelshejti; putir* (F.'54, f.425). Në Fjalorin e '80, **potir-i** – *kupë prej argjendi, prej qelqi etj, për të pirë verë; gotë* (F.'80, f.1526).
- ruffa** (rufa), (f.11). F.'54 e përdor, **rrufë-a** – *inflamacion i mukozave të hundës, që çfaqet me të kulluar të hundës; nganjëherë prek edhe fytin dhe shkakton kollë, të ngjirur të zërit dhe ethe* (F.'54, f.480). E ndeshim në Fjalorin e '80 në trajtën, **rrufë-a** – *pezmatim i cipës së brendshme të hundës zakonisht nga të ftohtët, që bën të zihen hundët e të kullojnë vazhdimisht dhe që shoqërohet me të teshtitura të shpeshta* (F.'80, f.1717).
- suta** (suta), (f.11). F.'54, **sutë-a** – *femra e drerit, drenushë* (F.'54, f.511). E ndeshim tek Fjalori i '80, **sutë-a-** 1. *femra e drerit, drenushë*. 2. *vajzë e hijshme dhe e shkathët; vajzë e urtë, e butë*. 3. *figurë e përrallave popullore, që përfytyrohej me trup si të lopës* (F.'80, f.1805).
- scefte** (sheste), (f.12). Në F.'54 e kemi, **shestë-a** – *kompas, pergjel* (F.'54, f.519). E kemi me të njëjtin kuptim edhe në Fjalorin e '80, **shestë-a** – 1. *kompas, pergjel*. 2. *qëllim, plan, shestim, rregull, rend* (F.'80, f.1829).
- mfefaxe** (mshefazë), (f.12). Në këtë trajtë dialektore nuk e ndeshim, por kemi këtë formë në F.54, **fshehtas** - *në mënyrë të fshehtë, pa e parë njeri* (F.'54, f.130). Në Fjalorin e '80, **fshehtazi** – *fshehtas, fshehur* (F.'80, f.509).
- hacfcij ó coc** (hakshī o kok), (f.13). F.'54 jep një shpjegim të qartë të fjalës, **kok-u** – *qymyr me pore në ngjyrë hiri t'errët, që nxirret duke distiluar më të thatë qymyrin e gurit; përdoret mjaft n'industrinë metarlugjike* (F.'54, f. 221). Fjalën *kok-u*, e ndeshim në Fjalorin e '80, pa ndonjë shpjegim të mirëfilltë, *kok-u* – *koks, prodhimi i kokut* (F.'80, f.841).
- me pegaam** (me pëgām), (f.13). F.'54 e ka, **pëgëj-** *fëlliq, ndyj, ndrag; pugaj* (F.'54, f. 392). Fjalori i '80 ka këtë formë, **pëgëj-** *ndyj, fëlliq, ndrag* (F.'80, f.1413).
- me lebduem**, (me lëbduem), (f.13). Në fjalorin e '54 **lëvdoj** – *nderoj dhe çmoj, flas mirë, ia ngre vlerën në sy të botës; mburr* (F.'54, f.269), e në F.'80 e kemi në formën **lëvdoj-** *lavdëroj, mburr* (F.'80, f.987).

- detoreff**(detorës), (f.17). Në F.'54 e kemi, **detorës-i** – *ai që i ka tjetrit një borxh* (F.'54, f.81). Në Fjalorin e '80 e kemi të pasqyruar në këtë formë, **detorës-i** – *shih detyrës-i – ai që i ka dikujt një borxh, borxhli* (F.'80, f.318).
- denaar** (dënār), (f.18). Në F.'54, **dinar-i** – *njësi monetare e jugosllavisë. 2. marcel* (F.'54, f.85). Në Fjalorin e '80 e takojmë në formën **dinar-i** – *1. njësia monetare bazë e Jugosllavisë, e Algjerisë, e Tunizisë, e Irakut etj.; monedhë që ka këtë vlerë. 2. marcel* (F.'80, f.337).
- me e renuem, me e ciartune**, (me e renuem, me e çartunë), (f.19). F.'54 e përdor si folje, **çartoj** – *prishem menç, luaj menç, shkalloj* (F.'54, f.63). Foljen **çart** e kemi në F.'80, **çart-** *1. prish. 2. shkel* (F.'80, f.247).
- zacon, oó zanes** (xhakon o xanës), (f.20). F.'54 e përdor në dy forma, **xhakoni-a-koha** që kalon xhakoni në seminar, para se të bëhet prift, dhe **xhakue-xhakoni** – dhjak (F.'54, f.622). E ndeshim në F.'80, **xhakon-i** – *ai që ndjek një shkollë fetare për t'u bërë prift; titull kishtar më i ulët se prifti; ai që mban këtë titull, ndihmës i priftit në kryerjen e shërbesave fetare (në vendet ku vepron kisha katolike)*, (F.'80, f.2195).
- tefale, oó žunetije** (të falë o dhunëtijë), (f.21). F.'54 e ka **dhunti-a** – *dhurëti, dhuratë* (F.'54, f.103). Edhe F.'80 e ka me të njëjtin kuptim, **dhunti-a** – *dhurëti. Dhunti morale (shpirtërore)*, (F.'80, f.411).
- ifchedeem** (i skëdëim), (f.22). F.'54 e përdor njëlloj, **i skërdejmë** – *i dehur, i dejmë* (F.'54, f.496). Fjalor i '80 e përdor njëlloj, **i, e skërdehur** – *i dehur keq, i bërë xurxull* (F.'80, f.1764).
- puftetia** (pushtetia), (f.25). F.'54 e përdor në këtë formë, **pushtet-i** – *1. sundimi politik, qeverisja, organet qeveritare, qeveria, struktura shtetërore. 2. e drejta dhe mundësia për t'urdhëruar diçka a dikë* (F.'54, f.441). Në F.'80 e ndeshim në gjininë mashkullore, **pushtet-i** – *1. sundim politik i një klase, i një grupi shoqëror etj., që shprehet në të drejtën dhe mundësinë për të qeverisur shtetin, një krahinë, një rreth etj. Nëpërmjet organeve të zgjedhura a të emëruara, kolegjiale a të përbëra nga një njeri i vetëm. 2. organet e qeverisjes së shtetit, të një krahine, të një rrethi etj.; qeveria. 3. e drejta dhe mundësia që ka dikush për të urdhëruar dikë, për të vepruar ose për të ndikuar mbi dikë a mbi diçka; fuqia që ka dikush a diçka; ndikimi që mund të ushtrojë dikush a diçka mbi një tjetër* (F.'80, f.1578). Bardhi e ka përdorur në gjininë femërore ashtu siç ndodh edhe me shumë emra të tjerë në zonat e gegërishtes veriperëndimore, Malësi e Madhe (mjalta, shnedja, lodja etj).
- cham uu** (kam ū), (f.25). Në trajtën dialektore të përdorur nga Bardhi, nuk e gjejmë, në F.'54 e kemi, **uri-a** – *nevojë e madhe për të ngrënë* (F.'54, f.592); në F.'80 e kemi, **uri-a** – *1. dëshirë e nevojë e theksuar që kemi për të ngrënë, ndjenja që kemi kur jemi pa ngrënë; të pangrënë për një kohë të gjatë. 2. mungesë shumë e madhe buke dhe ushqimesh në një krahinë, në një vend etj., për shkaqe të ndryshme; zi buke. 3. dëshirë e madhe për diçka; pangopësi e madhe për diçka* (F.'80, f.2094).
- scundilli** (skundilli), (f.26). F.'54 e ka, **skundill-i** – *pëqi, shpëlqi* (F.'54, f.497). E gjejmë në F.'80, **skundill-i** – *buzë ose cepi në fund të një rrobe; pëqi, kind* (F.'80, f.1769).
- meraaij** (mërāi), (f.26). F.'54 e ka, **mera-ja** – *kullotë, qoftë e fshatit qoftë private*. Në F.'80 ndeshim trajtën **mera-ja** – *kullotë* (F.'80, f.1114).
- fatoff** (fatos), (f.27). F.'54 e përdor, **fatos-i** – *trim i fortë, trim me fletë* (F.'54, f.115). E kemi në F.'80, **fatos-i** – *1. nxënës i ciklit të ulët të shkollës tetëvjeçare deri*

- në moshën nëntë vjeç, para se të hyjë në organizatën e pionierit. 2. trim i fortë; kreshnik (F.'80, f.458).*
- chalata** (qallata), (f.29). F.'54 e përdor, **çallatë-a** – 1. *një e çarë që bën sëpata dhe çdo vegël tjetër prerëse, kur bie më dru. 2. vendi ku është ngrënë presa e thikës, e sëpatës kur bie më një gur etj.; garbë (F.'54, f.61). Tek F.'80 e kemi në këtë trajtë, **çallat-a** – 1. *e thelluar që mbetet në dru, në gur a në diçka tjetër kur hiqet një pjesë duke e prerë a duke e goditur; plasë. 2. e thelluar në tehun e një vegle kur thyhet një copë e vogël. 3. thellë dhe duke i hequr një copë (F.'80, f.242).**
- macche** (makë), (f.29). F.'54 e përdor, **makë-a** - *cipa që venë gjërat e lëngëta (F.'54, f.287). E ndeshim në F.'80 në disa kuptime, **makë-a** – 1. *cipë që zënë përsipër disa lëngje; cipë. 2. makrosë. 3. pëlhurë merimange, cergë. 4. lëndë ngjitëse e përgatitur me miell a me niseshte; qiriç (F.'80, f.1051).**
- deretaai ghi ruon derene** (derëtar, ai gji ruon derënë), (f.33). F.'54 e ka, **derëtar-i** – *sh.derës-i – ai që rri në derë dhe ruan (F.'54, f.79). E ndeshim me të njëjtin kuptim tek F.'80, **derëtar-i- derës, portier (F.'80, f.314).***
- me fcofcune** (me shoshunë), (f.35). F.'54 e ka, **shosh** – *e shkoj nëpër shoshë; fig. shoshit, rrah një çështje (F.'54, f.534). Foljen shosh e ndeshim si të tillë, **shosh-** 1. *tund shoshën ku kam hedhur grurë që të bien poshtë gëzhutat e papastërti të tjera, pastroj drithin me shoshë; kaloj diçka në shoshë (F.'80, f.1886).**
- vobezia** (vobëzia), (f.37). E ndeshim me të njëjtën trajtë, **vobësi-a** – *vobeksi (F.'54, f.616). E kemi në F.'80, **vobektësi-a** – varfëri (F.'80, f.2177).*
- emiri** (zmiri) (f.41). Me të njëjtën trajtë të Bardhit e përdor F.'54, **smir-i** – *cmir, resë (F.'54, f.498). Në F.'80 e kemi në këtë formë, **smirë-a** – ndjenja e lakmisë, e keqardhjes dhe e keqdashjes, që na ngjallet kur shohim dikë më mirë se veten; resë (F.'80, f.1771).*
- me egrifcune** (me e grishunë), (f.41). F.'54 e ka, **grish-ftoj** në një gëzim, në një *dasmë (F.'54, f.147). E ndeshim në F.'80, **grish** – 1. *ftoj dikë të marrë pjesë në një dasmë, në një gosti, në një festë. 2. i bëj thirrje dikujt që të marrë pjesë në një punë a veprimtari të përbashkët, thërres (F.'80, f.576).**
- chendelle** (këndellë), (f.45). E takojmë si folje në F.'54, **këndell** – *i jap fuqi, gjallëri (F.'54, f.211). E ndeshim si folje, **këndell** – 1. *i jap fuqi e gjallëri dikujt, ia përtërij trupin a shëndetin; i jap njomësi a freski, e bëj të shëndetshëm. 2. i gëzoj zemrën dikujt, e kënaq; e gjallëroj shpirtërisht (F.'80, f. 816).**
- paterçana** (patërçana), (f.45). Në F.'54 kemi **patërshanë-a** – *shtizë, heshtë (F.'54, f.383). Tek F.'80. e kemi, **patërshanë-a** – heshtë, shtizë (F.'80, f.1386).*
- tine sift** (tinëzisht), (f.46). F.'54 e ka në këtë formë, **tinzisht** – *fshehuraz, tinëz, çefas (F.'54, f.565). E ndeshim me të njëjtin kuptim, **tinëzisht** – në mënyrë të fshehtë, fshehtas, tinëz (F.'80, f.1998).*
- gruchefte** (grukësitë), (f.48). F.'54 e ka, **grykësi-a** – *vesi i grykësit (F.'54, f.149). E kemi në këtë formë, **grykësi-a-** lakmi e madhe për të ngrënë; të qenët grykës; pangopësi (F.'80, f.583).*
- dauj** (davī), (f.49). F.'54 e ka në formën **dava-ja** – *padi, gjyq; ankim (F.'54, f.75). Në F.'80 e kemi **dava-ja** – 1. *grindje a mosmarrëveshje mes dy a më shumë njerëzve' sherr. 2. punë, telash. 3. ankim, padi, gjyq (F.'80, f. 297).**
- figna** (finja), (f.50). F.'54 e ka, **finjë-a** – *ujë i valuar bashkë me hi që shërben për të larë rrobat dhe enët (F.'54, f.120). E ndeshim me këtë kuptim, **finjë-a-** ujë i valuar, ku është tretur një sasi hiri i situar, që përdoret për të larë rroba, enë etj. (F.'80, f.474).*

- miestra** (mieshtra), (f.52). F.'54 jep shumë kuptime të kësaj fjale, ku ndër të tjera përkon me kuptimin e Bardhit, **mjeshtëri-mjeshtri**- 1. *punëtori që ndërton mure dhe ndërtesa*. 2. *ai që ja ka marrë dorën mirë një zanati a një arti dhe e zotëron më së miri*. 3. *mësonjës* (F.'54, f.319). Bardhi e ka përdorur për *mësuese*, ndërsa në F.'80 e kemi me këtë kuptim, **mjeshtre-ja** - fem.e **mjeshtëri** - *mjeshtre reparti, mjeshtre baleti...*(F.'80, f.1157).
- miegħia** (miegħia), (f.56). Në F.'54 e kemi, **mjekësi-a** – *dija që ka për qëllim të ruajë shëndetin e njerëzve e të shërojë sëmundjet; profesioni i mjekut* (F.'54, f.318). Në Fjalorin e '80 këtë fjalë e ndeshim, **mjekësia** – 1. *shkenca që merret me mbrojtjen e shëndetit të njerëzve, me studimin e sëmundjeve të ndryshme, me parandalimin dhe mjekimin e tyre*. 2. *mjeshtëria e mjekut, profesioni i mjekut* (F.'80, f.1155).
- chelogene** (këllogjënë), (f.60). F.'54 e përdor, **kallojjer-i** - *murg ortodoks, klllogjën* (F.'54, f.195). Në F.'80 e kemi me dy kuptime, **kallojjer-i** – 1. *murg ortodoks (në vendet ku vepron kisha ortodokse)*. 2. *njeri që bë jetë të mbyllur, ai që është shkëputur nga jeta e gjallë* (F.'80, f.773).
- munestyr** (munështir), (f.60). F.'54, **manastir-i** – *ndërtesë a një radhë ndërtesash larg qytetit, të banuara nga kallogjërë e kallogre; kuvend* (F.'54, f.289). F.'80 e përdor, **manastir-i** – *institucion fetar, me prona e ndërtesa banimi rreth një kisha e zakonisht larg qytetit, ku jetojnë, sipas disa rregullash të caktuara, murgj a murgesha; kuvend (në vendet ku vepron kisha; në të kaluarën edhe në Shqipëri)*, (F.'80, f.1055).
- granues** (granues), (f.62). F.'54 e ka, **gruar-i** – *ai që është shumë pas grave* (F.54, f.147). Në F.'80 e kemi në këtë formë, **gruar-i**– *ai që është i dhënë shumë pas grave, ai që përpiket t'u pëlqejë grave* (F.'80, f.578).
- herçe** (herdhe), (f.65). F.'54, **herdhe-herdhja** – *çerdhe, fole* (F.'54, f.169). E ndeshim me të njëjtin kuptim tek F.'80, **herdhe** – *çerdhe, fole* (F.'80, f.670).
- rijste** (rištë), (f.68). F.'54 e ka, **rishtas** – 1. *tani shpejt, s'ka shumë kohë*. 2. *përsëri, prapë* (F.'54, f.466). F.'80, **rishtas** – 1. *tani shpejt, s'ka shumë kohë*. 2. *përsëri, prapë; edhe një herë nga e para* (F.'80, f.1666).
- reeea**, (rëza), (f.68). F.'54 e ka, **re-ja** – *grumbull i madh piklash uji që rri pezull në qiell* (F.'54, f.457). F.'80, e ka në disa kuptime, **re-ja**- 1. *grumbull avujsh uji, që rrinë pezull lart në qiell*. 2. *shtëllungë e madhe grimcash të imëta që enden në ajër; grumbull i dendur i diçkaje që ngrihet e që lëviz në ajër*. 3. *diçka që pengon vështrimin, perde*. 4. *diçka e zyrtë, që paralajmëron një të keqe; diçka që sjell një shqetësim*. 5. *grumbull fjalësh ose veprimesh, zakonisht të mbledhura për të errësuar a shtrembëruar diçka*. 6. *krah. rrufe* (F.'80, f.1635).
- te gnefunë** (të njefunë), (f.69). F.'54 ka trajtat *njuh, njehsim, njehsoj* (F.'54, f.355). Në F.'80 kemi trajtat *njuhje-a, numërim*, por edhe emrat *njuhsim, njehsor* dhe foljet *njuhsohet, njehsoj* dhe mbiemrin *njuhshëm* (F.'80, f.1281).
- scues, legaat** (shkues, legāt), (f.69). F.'54 e ka, **legate-a** – 1. *përfaqësia diplomatike e drejtuar nga një ministër fuqiptotë*. 2. *selia e përfaqësisë* (F.'54, f.262). Në F.'80 e kemi në këtë formë, **legatë-a** - *përfaqësi diplomatike e përhershme një shteti pranë një shteti tjetër, e cila është e një shkalle më të ulët se ambasada dhe drejtohet nga një i dërguar i jashtëzakonshëm e ministër fuqiptotë; ndërtesa e kësaj përfaqësie* (F.'80, f.958).
- britmi idyte** (britmi i dytë), (f.75). F.'54, **britmi** – *i parë, i dytë, i tretë, shtator, tetor, nëntor* (F.'54, f.47). F.'80 jep një sqarim më të saktë të kësaj fjale, **britm-i** – *një nga tre muajt e vjeshtës. Britmi i parë, vjeshta e parë, shtatori. Britmi i dytë, vjeshta e dytë, tetori. Britmi i tretë, vjeshta e tretë, nëntori*. (F.'80, f.181).

- meu chiuduem** (me u quduem), (f.76). F.'54 ka trajtën, **çudë-a** – çudi (F.'54, f.70). Tek F.'80 e ndeshim si emër, **çudë-a**- 1. çudi. 2. diçka që ngjall ndot e frikë, gjë e pështirë (F.'80, f.278).
- hefaap** (hesap), (f.78). F.'54 e ka, **hesap-i** – llogari (F.'54, f.169). E kemi të pasqyruar në F.'80, **hesap-i** – 1. llogari. 2. përdoret pas një emri për të shprehur mospërfillje ose përçmim për dikë a diçka (F.'80, f.673).
- teploteia** (teploteja), (f.81). F.'54 e ka, **terplote-terplotja** – lopatë e gjerë prej druri për të bajtur e për të hedhur drithë (F.'54, f.561). E kemi si të tillë, **terplote-ja** – lopatë e gjerë prej druri, që përdoret zakonisht për të hedhur drithin në erë, kur duam ta pastrojmë; lopatë e vogël, e lugët, që përdoret për të marrë nga thesi a nga një enë tjetër sheqerin, miellin, orizin, kripën etj. (F.'80, f.1988).
- pallaree, e maæe, oó tepffyy** (palarë e madhe o tepsī), (f.84). F.'54, **palare-ja** – 1. pjatë e përfushët. 2. pjata me gjithë grurë të zier, që besimtarët ortodoksë dërgojnë në kishë për ndjesë të të vdekurit (F.'54, f.369). E ndeshim me tri kuptime në F.'80, **palare-ja** – 1. dërrasë e gjerë, e rrumbullakët dhe e lëmuar, mbi të cilën tëhollin petët e lakrorit, të byreikut etj. 2. pjatë e madhe dhe e nderë, zakonisht prej balte; tepsi a tavë prej balte. 3. pjatë me grurë të zier, që e çonin në kishë besimtarët ortodoksë dhe ua ndanin njerëzve për të përkujtuar një të vdekur (F.'80, f.1335).
- meu per mcatune** (me u përmatunë), (f.86). Në F.'54 kemi **mëkatnoj, mëkatoj** - bëj mëkat, bie në mëkat (F.'54, f.309). Në kuptimin e dhënë nga Bardhi, në F.'80 e kemi si të tillë, **mëkat-oj** – shkel rregullat e porositë fetare, veproj kundër dogmës fetare e kundër rregullave të kishës, bëj mëkat, bie në mëkat (F.'80, f.1124).
- noëule** (nozullë), (f.88). F.'54 e ka, **nozull-i**- ushqim, shujtë (F.'54, f.352). Tek F.'80 e kemi, **nozull-i** – ushqime që ruhen për dimër, zahire; ushqime që merren për një rrugë të gjatë (F.'80, f.1271).
- baftine** (bashtinë), (f.102). F.'54, **bashtinë-a** – arë a tokë s mund të punojë një familje (F.54, f.31). F.'80 e pasqyron si të tillë, **bashtinë-a** – 1. copë toke e trashëgueshme, që e zotëronte një familje fshatare në sistemin e timareve dhe që e punonte si arë. 2. kopsht, bahçe (F.'80, f.116).
- torch** (tork), (106). F.'54 ka, **tork-u** – 1. dërrasë e trashë që mëshon mbi kanistrat e mbushura me ullinj që të shtypë ullinjtë e të dalë vaji. 2. shkelësi i rrushit (F.'54, f.568). Në F.'80 e ndeshim me tri kuptime, **tork-ë/a** – 1. sasi filli prej leshi, prej pambuku etj., që mblidhet në qerthull, në makinë a midis dy duarve, për t'u larë ose për t'u ngjyer më lehtë etj.; shkull, çile, liter. 2. sasi duhani prej katër a pesë vargjesh të mbështjella e të lidhura si top. 3. shami a peshqir, që e lidhin nyjë nga njëra anë dhe që e përdorin për të goditur me të një lojë fëmijësh; turrë, turra; lojë me shami, që e vendosin në fund të një shkopi të ngullur në tokë, të cilin e mbron me një brez njëri nga lojtarët për të mos e marrë lojtarët e tjerë (F.'80, f.2008).
- tumire** (tumirë), (f.114). E kemi në F.'54, **tumir** – jap pëlqimin, pranoj (F.'54, f.578). E ndeshim në F.'80, **tumirë** - në gjendje të mirë, shëndoshë e mirë, mirë e bukur (F.'80, f.2038).
- zambaf, oó mafcaar**, (xhambas o maskār), (f.145). F.'54, **xhambaz-i** – ai që shtron e stërvit kuajt xanxarë; ai që shet we blen kafshë; fig. njeri dredharak e dallaveraxhi (F.'54, f.622). Fjalën xhambaz e ndeshim në F.'80, **xhambaz-i**- 1. ai që shet e blen kuaj a kafshë të tjera për të nxjerrë fitim; ai që shtron e stërvit kuajt xanxarë. 2. njeri që bën dallavere; njeri dredharak që përpiqet

- t'ua hedhë të tjerëve e të nxjerrë përfitime për vete, dallaveraxhi, bataqçi. 3. përdorimi sipas kuptimit të 2 të emrit, njeri xhambaz (F.'80, f.2196).*
- vftreeff** (ushtrë), (f.157). F.'54 e kemi, **ushtre-ja** – *pemë e paarrirë* (F.'54, f.594). Në F.'80 e ndeshim me të njëjtin kuptim, **ushtre-ja** – *shih ushtër-ra* – 1. *kalli gruri i paarrirë, që është ende i njomë. 2. i paarrirë, shumë i njomë; i papjekur* (F.'80, f.2099).
- tefcme** (teshme), (f.159). F.'54 e përdor, **teshëm** – *teshtij* (F.'54, f.562). F.'80 e pasqyron në këtë mënyrë, **teshtimë-a** – *dalja e ajrit me vrull, papritur e pa dashje nga hunda e nga goja, zakonisht me stërpika pështyme e me një zhurmë të veçantë, kur kam rrufë a jam ftohur ose kur kam ndonjë ngacmim në hundë; zhurma karakteristike kur teshtijmë* (F.'80, f.1989).
- haracnich** (haraçnik), (f.159). F.'54 e ka, **haraç-i** – 1. *taksa që i paguante një shtet një shteti tjetër, në shenjë nënshtrimi; telozna. 2. taksa e veçantë që paguanin të krishterët në kohën e Turqisë* (F.'54, f.164). Në F.'80 kemi fjalën **haraç-i** – 1. *detyrim a taksë që i jepte ose i paguante një shtet një shteti tjetër kur mundej prej tij ose kur pranonte t'i nënshtrohej atij. 2. taksë e veçantë që jepte në të holla ose në natyrë popullsia jomuslimane gjatë kohës së pushtimit feudal ushtarak osman* (F.'80, f.651). Bardhi e ka përdorur me prapashtesën *-nik*.
- pafnich** (pashnik), (f.165). F.'54 e përdor, **pashnik-u** – *mbulesë e hollë; mbulesë me të cilën pështillet i vdekuri në tabut* (F.'54, f.382). Në F.'80 e kemi me dy kuptime, **pashnik-u** – 1. *copë pëlhure e hollë, mbulesë e hollë; shami e hollë të cilën e hidhnin në kokë zakonisht gratë e moshuara. 2. mbulesë e hollë me të cilën mbështillet i vdekuri në arkivol, savan* (F.'80, f.1383).
- zarine** (carinë), (f.180). F.'54 e ka, **carinë-a** – *njëlloj takse e kohës feudale* (F.'54, f.55). E ndeshim në F.'80, **carinë-a** – *taksë e kohës feudale, që paguhej si vergji ose për doganë* (F.'80, f.214).

Si përfundim, mendojmë se, në Fjalorin e Bardhit, ndonëse kanë kaluar rreth 400 vjet, mund të gjenden fjalë të cilat duhen aktivizuar në Fjalësin aktiv të shqipësisë sotme, përndryshe të variantit të shkruar të Veriut; prej këtej, në stile të ndryshme, të përdoren në gjuhën e njësuar. Fjalë të tilla, mund të jenë: **dellues** (dellues), (f.65), **ciancier** (çançatuer), (f.29), **sceregjuer** (sherëgjuer), **me leccitune** (me leçitunë), (f.115) etj.

Fjalori i Bardhit, pasqyrimi i leksikut në Fjalorët normativë të shqipes (1954,1980).

- 1) Fjalë që nuk janë përfshirë në Fjalorët e 1954,1980
- 2) Fjalë me kuptim shtesë
- 3) Fjalë që janë përfshirë vetëm në Fjalorin e 1954
- 4) Fjalë që janë përfshirë vetëm në Fjalorin e 1980
- 5) Fjalë që janë përfshirë në të dy Fjalorët (1954,1980)




Fig. 1

1.2. Fjalori i Gazullit

a) Fjalë që nuk janë përfshirë në Fjalorët (1954, 1980)

- afçë-a** (f.43) – *shpend i vogël me pendla të verdhëmta.*
- aktund-i** (f.44) – *rend, kurá (turq.).*
- akulltar-e** (f.44)– *njeri qi e ka menden akull, qi i peshon fjalët.*
- allçënik-u** (f.45) – *nji farë guriu njeje së rubinit qi në katund të Komanit gjindet edhe mbi dhe, në zjarm digjet; përdoret me shkrymbë varret.*
- andaq-e** (f.45) - *andaq pune, mësimi; turq. qefli.*
- ângël** (f. 47) – 1.?, 2. *jam ftofë e bâ angel: jam ftofë e bâ koçâ .*
- arrrs-i** (f.49) – *arrrës-i; barojë me gjeth si petroseli, del shkambijsh, përdoret si bar mjeksuer.*
- ashkja e synit** (f.50) – *qerpiku i synit.*
- azull-i** (f. 51) - *hija e muzgut të mbrâmes.*
- azhgat-i** (f.51) – 1. *polemi i imë, vogjlja, polemi kundruell paris.* 2. *fundrrija e popullit.*
- babarrun-e** (f.51)- *i fortë, trimaloç-e: i fuqishëm shtatit.*
- bacan – i** (f.51) – *dash me turÿj të bardhemë e të lkuqëm.*
- baçû-ni**(f.52) - *stomije ndër kneta, shkaktue prej rrâçash.* Edhe “bacun-i” në të folmet e zonës së Zadrimës.
- bagëll-a** (f.52)– *mbagëll-a, me qitë mbaglla; me folë broshkulla (tosk.).* Këtu kemi asimilimin e grupit të bashkëtingëlloreve **mb:b**.Fjala formon edhe frazeologji pexhorative (sharëse), kresisht në të folurit informal: mos qit baglla (bagla).
- bagjë-a** (f.52) – *lëvorja e kallit të kallomboqit.*
- bahlul-e** (f.52) – *jam bâ bahlul; i marrun mendësh.*
- ballzinë-a** (f.54) – *tra, gur qi vëhet në ball të jashtëm të derës.* Edhe “ballinë-a” në disa të folme.
- bângëc-i**(f.55) – *nji bangëc bore: top bore.*
- baner-i** (f.55) – 1. *shkop i njomun me gjeth qi e ngulin ndër Rrëshajë në mâje të Rumis.*2. *bajrak-u.*
- bardhë-a** (f.56) – *potkë, 1. thupër e lvorueme qi ngulin ditën e Shën Jozefit për shêj të xânmes së kullosës.*2.*bardha-t - të lashtat, bimët e mbjellme herët, grûni, elbi, tërshana, etj.*
- bërdhamët,i,e** (f.59) - *njeri i bërdhâmët fëtyre; dhe i bërdhâmët; bardhul-e:bardhavele.*
- bëzhure-ja** (f.61) –*bazhure –ja .*
- bëzhure** (f.61) - 1. *me stërpikë, me stërklatë.* 2. *me bushurdisë.*
- bibrak-e** (f.61) – *lakur, (i,e), blec-e, curak-e.*
- bîjcë-a** – *send qi vjen prej bimësh, p.sh. pa bîjc: pê prej lini, pambuku, hîthi, etj.*
- bljedë-a** (f.64) – 1. *dell guri.* 2. *mjet a e çame guri.*
- bodrozhele** (f.65) – *drasë bodrozhele, potrozhele, patrozhele, drrasë breu, e dobët.*
- bofte-ja** (f.65) – 1. *mënyrë; qepe, bane, fol në këtë bofte.* 2. *mostër-a.* 3. *ekzemplar-i.* 4. *mostër-a për it. campione.*
- boh-i** (f.66) – *tinëzi-ja, fshehësi-ja.*
- bollapjeshkë-a**(f.66) – *grue madhoshe.*
- bracunar-i** (f.67) – 1. *varg hejsha akulli, qi viren prej strehe së shpis.* 2. *sbukurim në gjasim të të bracanarvet në styllin klasik.*
- bracâ-ni** (f.67)- *hell akulli qi viret prej strehe së shpis, shkopÿj akulli, krongjill-i.*

brave-ja(f.67) – 1. bagti qi me një shpërblim të venduem merret në bjeshkë për m'e kullotë verës. 2. grumbull gjindësh të parandsi.

bravnak-u (f.68) – hekuri si vjercë ku hin shuli i bravës së derës.

brojë-a(f.70) – 1. shrrëgull-a. 2. të mbajtunit e zanit ndër kangë shrrëgullash.

broshkull-a (f.71) – broçkulla; me qitë broçkulla, mbaglla, baglla.

brue (f.71)- me shkue një jetë nomade; ndoshta; me shkue si brujët: barijt.

brugë-a (f.71) – krypcë-a.

brraukue (f.72) - me folë shumë e me zâ të marrun; me ushtue zani si të dilte prej barku.

brrokë-a (f.72) - 1. kërraqe, kaçie bâ me lëvoreblini. 2. rreth i gjânë lëvoresh, qi u a vejnë dhijvet në qafë mos me thithë vedin.

brrezë-a (f.72) – bërskot-i; njaj njeri ka ra brrezë, njeri i rrëxuem prej pleqnije, së lodhmi, smundë.

bukurishtë-a (f.74)- 1. bimë, bar livadhesh. 2. bukurisha i nânës, gishti i vogël i dorës.

bundërr-a (f.75) – shtazë e egër katërkambëshe, me shtat sa një macë, veshcurre, me ngjyje të kripit të zezë, jeton ndër zgorëça lisash, han lendë e tjera bîmë.

buritë (f.76) – m'u turpnue, kuqë, me pasë mbarre.

bûs-i (f.77) – 1. kûji i pushkaliqes. 2. bûs mangële a makine.

bushulinë-a (f.77) – bazhgare-ja; bushël: mbushë, bushë.

cacë-a (f.79) - bimë.

cahë (f.79) – me pague.

cakël-a (f.79) - grumbull a kapë e vogël kollomboqi, grûni etr.

caktâr-e (f.79) – që rrin në cak, që ruen cakun.

camë-a (f.80) - 1. hamall-i. 2. êmën kombtar.

camrûk-u (f.80) – 1. camruk kështëje, kokërr kështëje e qërueme, thalb, thalbok kështëje.2. fraz., m'u ba camrruk prej së ftofti, m'u ngrucë së ftofti...

cângull-i (f.80).- brash-i, pjepën a sharqi i pa-pjekun; brâmç-i; me mbetë cângull; m'u ngri trupi.

capâ-ni (f.80) - 1. konopët e samarit me se lidhen ânët e barrës në kal. 2. zenji-ja (tyrq).

capllue (f.80)- me mungue, me firue.

caruk –e (f.80) - 1. blec, lakuriq, i çveshun. 2. êmën kombtar.

catë (f.81) – me ecë kadalë si fëmija i vogël qi nxën së pari.

cbihë (f.81) – m'u vërtetue, m'u përnjimendë, m'u realizue.

cbutë-a (f.81).- një farë qarri.

crukël (f.85) - 1. lesh rud a i shkurtën, crukël leshi, mjetë leshi. 2. spathok leshi. 3. crukël bore:flog bore.

crûngël (f.85)- leshi mbassi të të lnuret, shka âsht crugël jet pa u bâ shëllungë, pse i shkurtën fort.

curakë (f.87) - 1. me, m'u shveshë lakuriq. 2. me curakë kollomboqin: me qëruë, me çveshë, çvoshkë. Me çvoshkë misrin = me qëruë misrin, me e zhveshë.

currakzue (f.87) - curakë (me).

curufitë (f.87) - me rrëxue për tokë.

currek-u (f.88) - gogël djathi, mëshere e vogël.

curritë (f.88) - i drejtë, fill, fillak.

qëllëxue (f.90) - m'u kullë pak.

qellimtar-e (f.90) - njeri qi punon qellimas, aventurjer-e.

qiçillim-i (f.93) - çuçullim-i, kuvend me zâ t'ulët por të shpejtë e të pa dam.

qipillue (f.93) - 1. *me folë shum e me zâ t'ulët.* 2. *vertllue, mos me dijtë me mê së folmi.*

qillës-a (f.93) - 1. *tërthorcat qi vëhen mbî hû të qerrit, a mâ mire.* 2. *mbuloja e qerrit e karrocës.* 3. *qillsa e odës:tavani i odes.*

qipzue (f.93)- *po qipzon bora: po bjen bore fije fije e në të rrall; trajtat e tjera: qimbzue, qipzatë:me ra si qimbe floku.*

qindrák (f.93) - *qitrak, drejt, thik, fill.*

qingje-ja (f.93) – *kingje-ja, fraz. burr si qingje, fêmën: burr i pa burrni.*

qino (f.93) - *qyno, plakë e bâ qino, plakë e shplakë, mishnue.*

qiroke-ja (f.94) - *shtrati i pjllës lëkurëza qi del prej ânit mbas mares.*

qofe-ja (f.94) - *zêmër qofe, njeri qofe, njeri i shtruem e i paburrni.*

qýet (f.96)- *mandej.*

qyme (f.96) - 1. *bar qyme femën.* 2. *bar qyme mashkull.*

qyne (f.97) - *âsht bâ qyne: plakë e stërplakë.*

qyrlik-u (f.97)- *shpend i vogël qi siellet zâjesh.*

çafúrde (f.97) - *mâ se furde.*

çakraman-e (f.97) - *shakllaban-e (tyrq); vagabond (it).*

çplâ (f.101) - 1. *me bâ nji send bat, bark.* 2. *me bâ bark, a bat.*

çrukët (f.102) – *njeri i çrrukët, i dobët, qyqan; zhelan.*

çrukë (f.102) - *çrukue, m'u bâ i çrukët.*

çuhâ-ni (f.102) –1. *bucak-u.* 2. *jebrik me çep.* 3. *fëmij të vogjël të curakët.*

çukulinë (f.103) - *zhele, petk i shkyem.*

çum-i (f.103) - *plumb-i.*

çurr-i (f.103) - *gomar-i .*

çvjedhë (f.103) - 1. *çvidhe lamshin: zhdrivilloje, shdrivillue.* 2. *m'u përmbledhë tue u turrë.*

çvidhët (f.103) - *njeri i çvidhët, shdërvjedhët, shdërvjellët.*

çyçafëll-e (f.103) - 1. 2. *njeri me tureçka të shembëtueme.*

dae-ja (f.104) - *të dam-t; de-ja, krh. dreja,për: droe-ja.*

dafrong-u (f.104) - *majûngë, maçarungë.*

danisë (f.104) - *me danue, me e da mênnden, me vendue, me këputë.*

darallim-i (f.104) – *të mârrun mendësh, turbullim, jerm.*

daradhosë (f.105) - 1. *m'e e bâ me luejtë mendësh, m'e çue peshë, m'e harlisë.* 2. *m'u harlisë mendësh sikurse i smundi, m'u turbullue ndër mendë.*

domli-u (f.112)- *domlic.*

domriz-i (f.112) - *domlic.*

dordull (f.112) - *plot sa s'zen mâ.*

dorcàk-e (f.113) - *kal dorcak: i vogël e i shpejtë.*

dor-i (f.113) - *koha e përshtatëshme.*

dorgje-ja (f.113) - *ênë uji me dy rrëfânë.*

dosë-a (f.113) - *fraz. bani vel dose, iku tym dose: iku shpejt.*

dushmue (f.117) - 1. *me dushmue shtrigat; qitshin edhe tash vonë gratë e mjera ndërshej dy zjarmash, për me i ngushtue m'u diftue për shtriga; thonë se shtriga kështu e ngushtueme difton vorbën e lyesavet qi përdorë me lye shtatin për m'u bâ flakë qi mandej me fluturue kudo qi t doj me hangr këndon. me dashmue kendin; me ngushtue me fjal, brigade, 2. Me dushmue shtrigën.*

dyllvésh-i (f.117). 1. *balçim veshi, balta e kuqlême qi qet veshi.* 2. *dyell-ell, për kontaminacjon, sikurse: gavyell-elli, fyell-elli etr.*

dy-velçe (f.118) - *lejthi harushë, nji fare lejthi kokërr-madhenuk ekziston.*

dyzme-ja (f.118) - *njeri me dyzme, me hollime, dyzmeli-ja, për grua nature.*

dhaja (f.118) - *u ndal e i a njiti kres; vështrimi; dhaja de, mbëshoji de.*
dhajë-a (f.118) - *fuqi, forcë.*
dhândrrorë-t (f.119) - *të dy të martuemit rishtaz.*
dhân-i (f.119) - *ëmën kombtar.*
dhëndë (f.120) - *me dhëndë në të lam, me dhëndë në të hupun.*
gjemujë-a (f.166) – *rrqeshk.*
gjé-ni (f.166) – *burg bagtish.*
gjergjël-i (f.166) – *peshk i vogël ujnash s'âmbila.*
gjergji (f.166) – *bimë.*
gjymkë-a (f.168) – *gjymkë muri, brryl muri, bark qi bân muri i shplam.*
gjymt-i (f.169) – 1. *gjim-i, qêmër-a.* 2. *gjymti i kishës: gunga e kishës.*
gjymth-i (f.169) – *ishte lugu (i malit) gjymtha gjymtha.*
hagjan-i (f.169) – *dash i zi.*
halë-a (f.170) – *të shëndritun, shkëlqim-i.*
hâm (f.170) - *pitë, pa punë.*
hamadak-u (f.170) - *turr, sulm: thohet: me marrë desht hamadak: kur ndërzehen beret.*
hânë-t (f.170) – *të dliun të përmuejshëm ndër fëmna të gruenueme, e qi ndodhë krye katër javësh.*
hangërshëm-i-e-ja (f.171) – 1. *qi hahet, bukë e hangërshme.* 2. *qi âsht i hangerm, i ngim prej haeje.*
hangroç-i (f.171) - 1. *bimë.* 2. *hangroç i butë: bizhi.*
hyllj-t (f.179) – *hyj,t; poftja e shkrimit: hy-u s'ka kurrnji arsye me qënë.*
hysë (f.179) – *me i dishrue kuj një të keqe të madhe, me habinue.*
idhëz-a (f.180) – *bimë si bregça, del buzë rrugash e ndër livadhe, lulon kah vjeshta, e familjes së kompozitevet, lulen e ka në njeje të portokalit, e gjethin si calendula officinalis, rritet nja ½ metri mbi tokë, âsht e idhët në të gjinuem.*
kabûth-i (f.184) – *grumbull i vogël.*
kacanelë (f.184) – *thohet për valë qi rende rende ulen teposhte kur rriten ujnat.*
kacibulë-a (f.185) – *lule shege, kokërr shege sa ka le.*
kacimare-ja (f.185) – *bimë ujce.*
kac-i (f.185) – *zog thiu, derk.*
kacirâm-i (f.185) – 1. *nji farë grami i fortë.* 2. *bar n'uj si tel.* 3. *ferrë qi del nëpër fusha me 5 – 6 çeporë.*
kacirutan-i (f.185) – *zog i vogël, zog me kaçirubë.*
kacub-i (f.185) – *thopërç-it, qipuj.*
lauri-ja (f.232) – *kangë laurije, kangë dashtënije, shum herë edhe të pa-hijeshme.*
lauricë-a (f.232) – *grue e pambarre, kalore-ja.*
lbokë-a (f.233) – *lëvore e hollë pëmësh.*
lebarue (f.233) – *me terrteverrtue.*
lëqêth-i (f.233) – *liqê i vogël.*
lefjuer-ore (f.233) – 1. *banuer i nji katundi të quejtun: lejthizhë.* 2. *sý lefjorë: në trajtë lejthije.*
lêjetar-e (f.233) – *kush xir lëjën.*
lëket-i (f.233) – *lëqêth-i.*
lepurî (f.234) – *me lepurî drita: me nisë me ague.*
leshëc-i (f.234) – *bimë.*
leshujë-a (f.234) – *ëmën lope, lopë e leshtë, leshatake.*
llaçkue (f.244) – *me folë shum; me folë keq .*
llapuh-i (f.244) – *bimë.*

lloqe-ja (f.244) – *lloçe-ja, llome, grue lloqe: e ndÿtë në veshë të shtatit, në të gatuem haenash.*
llogje-ja (f.244) – *lye-ja, dângë-a.*
lokatiq-i (f.245) – *tâmbël i tundun qi i âsht hjekë tlyeni.*
macurrel-i (f.235) – *mackë.*
mâqën-a (f.245) – *lopë mâzatore, qi piell krye tri vjetësh.*
maçarungë-a (f.245) – 1. *kandërr ujëc, me krye të math e shtat të vogël.* 2. *mollëza e pipit të duhanit, dorëca e shpatës.* 3. *njeri krye math.*
magë-a (f.246) – *jargu me se len pjella.*
mâgjën-i (f.246) – *kungimi fetar.*
mâgjër-a (f.246) – *shullâ-ni.*
mahlue (f.246) – *maklue, gdhelë, me marrë me të mirë.*
majnishtë-a (f.247) – *bîmë.*
mbëllugjë-a (f.254) – *mbëllogjë-a, mllugjë-a, dorëc brisku qi vlen si mill tehi.*
mbelmesë-a (f.254) – 1. *voj, tlyen, ushûj me se mbelmehet haeja.* 2. *Fjalë të mbelmyeme, me mbelmesë shpirtnore.*
mbëndore-ja (f.254) – *mjet-i.*
mbëngoje-a (f.254) – *pensjon-i.*
mbëgojcë-a (f.254) – *mëgjojcë-a, hekuri i frënit të kalit qi hÿn në gojë.*
mbërdostë (f.254) – *mërdostë.*
mbërdheztë (f.254) – *i kuqun fëtyret.*
mbrrakulli - ja (f.257) – *gumçi-ja, hokë-a, fjalë gazi.*
mbrrakullue (f.257) – *me folë fjalë gazi.*
mbrrakullues-e (f.257) – *çudënar-e, gaztuer-ore.*
mbrrutë (f.257) – *m'u tha, m'a gëzhitë prej thatine, dergje.*
mbuhovinë-a (f.257) – *pluhnajë, pluhun.*
mbushulinë-a (f.257) – 1. *bushulinë, bazhgare, hÿ pluhun, fundulina qi çohen flauri ndër enë e qi bijnë ndër haena.* 2. *fundërri byku, kashte.*
mqes-i (f.257) – *koha e mritzimit (krh. mgjes-i, mjes-i).*
mëcukth-i (f.258) – *bîmë.*
meqafe-ja (f.258) – *përgjegjësi-ja.*
meqave-ja (f.258) – *meqave bore, mbledhajë, çfrë bore.*
meçue (f.258) – *meçitë; mekë, pakë.*
mekashna (f.258) – *sëpaku, nemose, bile.*
melcak-u (f.258) – *melcë.*
melqys-i (f.258) – *baltë e hollë.*
mëllaxë-a (f.259) – *stap, pip hardhije.*
meshnuer-ore (f.262) – *i meshnuem.*
metisë-a (f.262) – *kelbazë.*
mêtun-i,-ë,-a (f.262) – 1. *kalamâ dhetë vjetësh e teposhtë, qi s'e kapte kanûja e malevet për dâme.* 2. *i fjeshtë, i patëkeq, i pafaj.*
micke-ja (f.263) – *mâja e majes.*
miclim-i (f.263) – *kërthi sa i lem, i vocërr fort.*
miellëc-a (f.263) – 1. *bimë haese.* 2. *dergjë barishtash, kur u bardhen gjethët, pse u bjen hÿni qi përftohet prej pëjsh së mykëzavet.*
mihajnë-a (f.263) – *krahinë.*
mitnue (f.264) – *m'u meshnue, m'u bâ fëmi.*
mjeçkë-a (f.265) – *mjelcë, ênë mbë se mielet tâmbli.*
mjaukue (f.265) – *mjagullue.*
mjekërdhizë-a (f.265) – *bimë.*

mjerthi (f.265) – *mjerthin, dernathi, djerë, derë, deri, gjerë.*
mrrat-i (f.270) – *thi i egër.*
mrrodel-e (f.270) – *garravel-e, gorrovel-e: njeri si një degë lisi së pa-latuem, njeri i palatuem.*
nepshue (f.278) – *me firue, me mungue: haku i tokës.*
nërkue (f.278) – *me ndëjë në kllap a fjetë.*
nie-ja (f.279) – 1. *ânë bagëtish, shtallë, plevicë.* 2. *odë-a: shpi dy, tri, katër pësë niejesh.*
nimnye (f.279) – *pezmatue.*
nipe-ja (f.279) – *ndikim slav për: mbesë-a.*
nkastëshëm-i,-e,-ja (f.279) – *i punuem me zëje, me mjeshtri.*
nogë-a (f.279) – 1. *noga e kres, sutaku i kres.* 2. *noga e gishtit; koçeku, ashiku i gishtit.*
noke-ja (f.279) – *me një kokërrme një thalb kështjê.*
nokël-a (f.280) – *kokërr?, imtisht, adile adile.*
norushë-a (280) – *shpend ujëc, me shpinë të murrme, skjepin të mprehtë si thumbat, me pak krahë, barkun e bardhë, qafën e zezë me një larë të kuqëlme, s'ka pupla por i a mbulon shtatin pushi, me kambë të përpjekëta (si rika) shtatin sa një rosë, ka tufël në krye; dikur shitej lëkura e saj 4-8 mixhidije. Nuk është mjellme.*
ndërdomna (f.282) – *me mbetë, me qënë ndërdyzash, mos me dijtë m'e da njënen dysh.*
ndërkllisë (f.283) – *ndërkue (ndërlikue): me qitë në një lik tjetër.*
ndërkye (f.283) – *rrebisë, majue.*
ndërkalitë (f.283) – *përdredhë, ndërmblyësë.*
ndërmblyësë (f.283) – *përdredhë.*
ndërmblysun-it (f.284) – *të përdredhun-it.*
ndërshejçë-a (f.284) – *pikëzore, drrasë tjegulle kalore.*
ndeshëtar-e (f.284) – *kush del me ndeshë kendin, me i dale para kuj.*
ndeshëzi-zezë (f.284) – *ogur-zi-zezë, përkundra: ndeshëmirë, orgurmire.*
ndêtë-i,-a (f.285) – *ratë.*
ngiatshtëm-i-e,-ja (f.289) – 1. *i afërm.* 2. *i afërm me gjak: fqî-ni, ilaka.*
ngolë-a (f.289) – *gozhdë-a.*
ngredhun-it (f.289) – *të nzitun, të ngucun, eskcitacion-i.*
ngreh-i (f.289) – *lojë, cicmic-i.*
ngufë (f.289) – *gufë, gufue.*
ndërkye (f.283) – *rrebisë, majue*
ngufshëm-i,- e, -ja (f.289) – *qi ngufë, a gufon shpejt.*
njakesh (f.291) – *me lypë, me dashtë, me kërkue për njakesh: me gjakim të math.*
njâsh-e (f.291) – *njij cope, i krejtë, i tânë.*
njegj-i (f.291) – *mot vere i xet e me njegullinë të hollë .*
njykë(f.293) – *ndërzye.*
obluk-u (f.293) – 1. *balldan'ja e samarit.* 2. *kopaçi (pjesë anatomike).*
oblla (f.293) – *fjalë shqipe? mbarë, unji, krejt.*
oç-i (f.293) – 1. *oç buelli, viç buelli.* 2. *njeri si oç, koç buelli: budallë.*
odokët-i,-a (f.293) – *i dobët, i pa mire, i pa-pashi.*
ogerc-i (f.293) – *kandërr.*
ogrishtë-a (f.293) – *bîmë, rrëshyell=elli, rrëshuell-olli.*
omish-i (f.294) – *krymb qi i bân fytat (celulet) e vet and ndër plasa gurësh, të cilat janë sî shpûza.*

orbën-i,-ë,-a (f.294) – i verbena, i verbët.
orbënue (f.294) – verbue.
ordisë (f.294) – me i vû kuj faj .
orrlë-a (f.294) – 1. urrlë-a, velgjê i parrëshinë. 2. molikë-a. 3. sbardhulinë-a një rreth i ri prej së bardhi qi i shtohet për gjithë vjetë lisit.
oskaç-i (f.294) – puskaç, uskaç-i.
pamollë-a (f.298) – shtyllat në ball t'urës.
pandritë (f.298) – vardisë, jereshtisë.
pândël-a (f.298) – lpandël-a 1. pupul, pëndël-a. 2. zhele-ja.
paragashë (f.299) – fik qi e bân kokrrën sa një trangull, bân fiq shënjinës e verakë, të parët të këqij.
paragon-e (f.299) – i atillë, i fortë, i fuqishëm.
parane (f.299) – kangë të moçme fetare, idhujtar, pagan.
paravang-e (f.299) – si në të kiem, të përkyem; mur me kind (qoshe) paravang, me kand të përkyem, shtrembënuem.
patushue (f.301) – me rrasë me dorë, me ia patushitë kuj një flakaresh: me i hjekë kuj një flakaresh.
patur-i (f.301) – ipasun e rrodhëc, koprrac.
pavajçëm (f.302) – nevojisht.
plakrri (f.328) – me nisë m'u plakë.

Vërejmë se nga shumësia e lemave që ndodhen në Fjalorthin e Ri të N.Gazullit, të paraqitura më lart, prej tyre, mendojmë se fjalët e mëposhtme mund të gjejnë hapësirë përdorimi edhe në Fjalorët normativë të shqipes së sotme, (mbi bazën e usudit gjuhësor) si: **akulltar-e** (f.44)- njeri qi e ka mendën akull, qi i peshon fjalët. **caktár-e** (f.79) – që rrin në cak, që ruen cakun. **danisë** (f.104) - me danue, me e da menden, me vendue, me këputë. **dae-ja**(f.104) - të dam-t; de-ja, krh. dreja,për: droe-ja. **dhândrrore-t** (f.119)-të dy të martuemit rishtaz. **dyzme-ja**(f.118)- njeri me dyzme, me hollime, dyzmelija, për grua nature. **hangërshëm-i-e-ja** (f.171) – 1. qi hahet, bukë e hangërshme. 2. qi është i hangerm, i ngim prej haeje. **lêjetar-e** (f.233) – kush xir lëjën. **lëqêth-i** (f.233) – liqê i vogël. **ndeshëtar-e** (f.284) – kush del me ndeshë kendin, me i dale para kuj. **ndeshëzi-zezë** (f.284) – ogur-zi-zezë, përkundra: ndeshëmirë, orgurmirë. **patur-i** (f.301) – ipasun e rrodhëc, koprrac. **ngufshëm-i,- e, -ja** (f.289)- qi ngufë, a gufon shpejt. **plakrri** (f.328) – me nisë m'u plakë.

b) Fjalë me kuptim të ndryshëm në Fjalorët e tjerë të shqipes (1954,1980)

- bâjuk-a** (f.52) – *lopë me larë të bardhë në ball*. Me kuptimin e dhënë nga Gazulli, nuk e kemi, por F.'54 e jep, **bajukë-a** – *shpesë uji nga familja e rosës s'egër* (F.'54, f.24).
- bigë-a** (f.61) – *birë, vrimë*. Jepet me këtë kuptim të veçantë, pasi në Fjalorin e sotëm të shqipes 2006, ka edhe kuptimin: 1. *dru a diçka tjetër që mbaron me një degëzim më dysh; vendi i degëzimit ose vetë degëzimi; furkaçe*. 2. *vinç i madh me dy krahë*. 3. *çift e drejt përpyjetë*.
- bobël-a** (f.65) – *kokërr kështëje e paqirume*. F.'54, **bobël-bobla** – *një farë kërmilli që del në prëndverë në kohë të lagshtë e të ngrohët* (F.'54, f.41). F.'80, **bobël-la** – 1. *lloj kërmilli që del në pranverë, zakonisht pas shiut*. 2. *vegël frymore prej briri të gjethit ose prej një guaske të madhe të detit, që përdoret zakonisht për të dhënë një sinjal* (F.'80, f.159).
- brojcë-a** (f.71) – *shpend*. F.'54 e ka me një kuptim tjetër, **brojcë-a** – *enë balte a metali me një vesh, që përdoret për ujë; masë drithi(1/2 kilo)*, (F.'54, f.47). F.'80, **brojcë-a** – 1. *enë balte a metali e vogël, me një vesh, që përdoret zakonisht për ujë*. 2. *masë drithi prej druri, që nxë rreth një gjysmë kilogrami* (F.'80, f.182).
- huri-ja** (f.76) – *bulirë, buljerë, bucelë*. F.'54, **huri-a** – *sasi e madhe; plotësi, mbushullim, hape, bollëk* (F.'54, f.52). F.'80, **huri-a** – *sasi e madhe, shumicë, mori, mbushullim* (F.'80, f.199).
- hallajkë-a** (f.170) – *lavirë-a, putanë-a, kurvë-a*. F.'54, **hallajkë-a** – *shërbyese* (F.'54, f.162).
- lëmesë-a** (f.234) – *mos m'u prishë në pleqni, por as m'u ndreqë krejt*. F.'54, **lëmesë-a** – *shkazmë bore* (F.'54, f.267). F.'80, 1. *vend i lagët, me baltë ose me borë, ku të rrëshqasin këmbët; rrëshqitë, shkazmë*. 2. *cipë shumë e hollë dhe e tejdukshme ndërmjet lëvoreve të disa bimëve e perimeve; cipë e hollë e diçkaje; guaskë* (F.'80, f.977).
- lezar-i** (f.235) – 1. *shkallë e vogël*. 2. *shelqënuer-ori*. F.'54, **lezar-i** – *purteka që vihet mbi furkat që të mbështeten hardhitë; shul për të varur pastërma e suxhukë* (F.'54, f.266). F.'80, **lezar-i** – 1. *thupër e hollë, e cila vihet mbi furkat që të kapen lastarët e degët e hardhisë*. 2. *dru i hollë e i drejtë, ku varen pastërmatë dhe suxhukët* (F.'80, f.970).
- llaçk-u-e-ja** (f.244) – 1. *burr llaçk, grue llaçe: qi flet shumë*. 2. *kush prozhmon*. F.'54, nuk e ka. F.'80, **llaçkë-a** - 1. *tufa e flokëve që mbledhin gratë pas kokës me shami a me rrjetë; nyja e shamisë, kur i lidhin ceat e saj në majë të kokës*. 2. *mendje, kokë*. 3. *grua a vajzë budallaqe* (F.'80, f.1033).
- maçkë-a** (f.246) – *zog kuble, kubël e vogël*. F.'54, **maçkë-a** – *tokë që mezi punohet* (F.'54, f.285.)
- mbrapshti-ja** (f.256) – *hiejesinë, vend ku s'bjen dielli, osojnë-a*. F.'54, **mbrapshti-a** – *dreqni, shkandulli, punë të mbrapshta*. (F.'54, f. 300). F.'80, **mbrapshti-a** – *punë a sjellje e mbrapshtë, prapësi* (F.'80, f.1092).
- mëkue** (f.258) – *mkue, mbërrî*. F.'54, **mëkoj-koj** (F.'54, f.309). F.'80, **mëkoj** – 1. *ushqej dikë që nuk mund të hajë vetë (një foshnjë, një të sëmurë etj.), koj*. 2. *i jap sisë foshnjës, ushqej me gji; koj*. 3. *e ushqej dikë vazhdimisht me ide, pikëpamje etj. që e ndihmojnë të edukohet, të brumoset a të zhvillohet* (F.'80, f.1124).
- mështekën-a** (f.262) – *terthore-ja*. F.'54, nuk e ka. F.'80, **mështekën-na** – *dru pylli i viseve të ftohta, me trung të drejtë, me lëvore të lëmuar e të bardhë dhe me gjethe*

- si zemër e të dhëmbëzuara, lënda e të cilit përdoret zakonisht për orendi; krahjetë, balosh* (F.'80, f.1133).
- përgjegjë** (f.309)– *përgjakë, lëvyrë, gjaknue*. F.'54, **përgjegj** – *përgjigjem* (F.'54, f. 397). F.'80, nuk e ka.
- pot-i** (f.332) – *ênë dheu në të cilën shkrihen metalat*. F.'80, **pot-i** – 1. *fëmijë, foshnjë; tërësia e njerëzve të një barku; brez*. 2. *pjella e kafshës, i vogli i kafshës; brezi i ri i kafshëve*. 3. *mashkulli i kafshëve që lihet për ndërzim; damaz* (F.'80, f.1525).
- pruejtë** (f.339) – *shporrë, largue: qi i pruejshin gjindën prej shërbimit të Zotit*. F.'54, nuk e ka. F.'80, **pruaj**– *pretoj, plaçket; pruaj* – *i bie pas një sëmundjeje duke bërë mjekime popullore*; (F.'80, f.1561).
- pruzhë-a** (f.339) – *puprra, puçrra qi mbulojnë shtatin a një pjesë të tijën*. F.'54, **pruzhë-a** - *fshesë e vogël me qime të bishtit të kalit për të fshirë thërrmijat e sofrës* (F.'54, f.436). F.'80 nuk e ka.
- resk-u** (f.345) – *huj*. F.'54, nuk e ka. F.80, **resk-u**- 1. *lesh deleje i gjatë dhe i ashpër*. 2. *sipas kuptimit të emrit. lesh resk* (F.'80, f.1648).
- rrajë-a** (f.349) – 1. *rave, shteg qi çilet nëpër bore*. 2. *vazhda qi lën landa e lisat e ngrehun rrëshqanë tue i ulë teposhtë*. F.'80, ka një kuptim tjetër- **rrajë-a** – *peshk me trup të gjerë, me lëkurë të forte, që e ka kokën si të breshkës* (F.'80, f.1678).
- rrûnë-a** (f.363) – *red-i, kura-ja*. F.'80, **rrunë-a** – *qengj motak femër* (F.'80, f. 1721).
- stërvale-ja** (f.379) – *tepri në veshë, mbathë, gosta* etr. F.'54, nuk e ka. F.'80, **stërvalem** – *biem radhë-radhë përdhe, rrëzohemi a këputemi në mes pale-palë njëri pas tjetrit* (F.'80, f.1792).
- shqip-e** (f.388) – *i thjeshtë, i pastër, i pa shtirun*. F.'54, **shqip** – *në gjuhë shqipe; fol shqip, qartë, copë; ja thashë shqip, s'ha shqip, s'ha kuvend, s'merr vesh, s'kupton* (F.'54, f.541). F.'80, **shqip-e – ja** – 1. *shqiponjë*. 2. *shumë e shkathët dhe e zonja në punë; trime (për vajzat e gratë)*, (F.'80, f.1915).

c) Fjalë me kuptim shtesë në Fjalorin e vitit 1954, 1980

- acar-e** (f.43) – *grue acare = e dliirët, veshëacare; mot acar = i ftofët*. F.'80, **acar-e** – 1. *i acartë*. 2. *shumë i pastër e i kulluar, shumë i kthjellët*. 3. *shumë i pastër e i rregullt në veshje, që mbahet akull; që mban pastërti e rregull*. 4. *i mprehtë, i shkathët* (F.'80, f.3).
- avër-a** (f.51) – 1. *avër pëlhure: vel-i*, 2. *avër akulli, rrasa akulli qi barin ujn*. F.'80, **avër-ra** – 1. *ajër i ngrohtë ose erë e ngrohtë që të zë frymën; zagushi*. 2. *afsh i nxehtë, afsh zjarri; vapë*. 3. *erë e hollë dhe e ftohtë, thëllim, acar*. 4. *akullishtë; rrasë akulli që rri mbi ujë* (F.'80, f.76).
- blozë-a** (f.65) – *thirr-i, çagjë-a, lbozë-a, pështym-i*. F.'80, **blozë-a** – 1. *lëndë e zezë si pluhur, që lë tymi kur kalon nëpër oxhak ose në vende të tjera*. 2. *pluhur i zi, që del nga djegia jo e plotë e disa lëndëve dhe që përdoret në industri*. 3. *sëmundje bimësh, që shkaktohet nga disa kërpudha, prej të cilave pjesët e prekura mbushen me pluhur të zi; tymth.* (F.'80, f.157).
- brishtë, i, e** (f.70) – *qi thehet shpejt*. F.'80, **brishtë (i,e)** – 1. *që thyhet lehtë; që thërmohet shpejt*. 2. *që vjen i dobët e i mekët nga natyra a nga ndonjë sëmundje, i hollë (për njerëz); delikat*. 3. *që është shumë i ndjeshëm, që preket shpejt*. 4. *që nuk ka një bazë të shëndoshë, që nuk përliqjet nga vetë jeta, që nuk qendron, i pathemeltë; i kotë* (F.'80, f.181).
- bulë-a** (f.75) – 1. *idhull-i, put-i*, 2. *bula e gishtit, mâja e përfundme e trashë e gishtit*. 3. *bula e veshit, copa e kercëles së veshit që viret teposhtë, palëca e veshit*. F.'54, **bulë-a** – 1. *sythi që nxjerr pema në prëndverë, nga i cili del pastaj bisku a lulja*. 2. *bula veshit, pjesa e butë në fund të veshit; bula e gishtit, mollëza e gishtit*. 3. *s'kishte një bulë ujë, asnjë pikë* (F.'54, f.50). F.'80, **bulë-a** – 1. *syth bimësh, mugull; syth që del te disa qenie, prej të cilit zhvillohet qenia e re*. 2. *pikë (uji, shiu, djerse, loti etj.)*. 3. *flluskë e vogël*. 4. *pjesë e tultë, e butë dhe e rrumbullakët e ndonjë organi të trupit*. 5. *lungë e rrumbullakët dhe e fryrë; puçërr e madhe*. 6. *pjesë e disa frutave, të cilët ndahen në disa copë të veçanta e të shkëputura; thelb* (F.'80, f.195).
- currî-ni** (f.88) – *çurril, çurrel, çurg-u*. F.'54 nuk ekziston. F.'80, **curril-i** – 1. *fill i hollë uji ose i një lëngu tjetër që rrjedh a del me forcë; çurg*. 2. *gyp i hollë, që vihet në burime a në një enë për të rrjedhur uji; krua me pak ujë*. 3. *duke rrjedhur çurg e me forcë*. 4. *fill, drejt* (F.'80, f.234).
- qokë-a** (f.94) – 1. *birë, vrimë në dru a gur, rrumbullake a e gjatë, vi, ku hyn shtërgueshëm një copë tjetër e përputhme; fjalë landëtarësh, edhe: femën-a, fraz. me kenë në qokë, me i pasë mend mbë të*. F.'80, **qokë-a** – 1. *shenjë që bëhet mbi një dru a mbi një gur duke e gdhendur pak, duke i prerë një cope të vogël a duke e bërë vrimë*. 2. *gur a diçka tjetër që vihet si shenjë ose si kufi*. 3. *vend i caktuar, cak*. 4. *shih furrik-u*. 5. *masë në të folur, në të ngrënë ose në një punë, kufi; përkorë*. 6. *pikë që përcaktohet si kusht për një punë a vendim të marrë së bashku*. 7. *pikë e zgjedhur ose e përfytytuar, që ndihmon për të gjetur me përpikmëri një drejtim*. 8. *rast i lindjes së njeriut, lindje, fejesë, martesë, vdekje etj, në të cilin duhet shkuar për të bërë zakonet, vajtja për t'u takuar sipas zakonit* (F.'80, f.1616).
- qokatâr-e** (f.94) – 1. *kush i bjen në të fjalës, punës*. 2. *njeri qi asht në qokë, në qef*. F.'80, **qokatar-e** – 1. *që është i matur në punë e në fjalë, që flet e vepron me vend e pa u ngutur*. 2. *që i ndjek zakonet, që nuk lë pa i bërë vizitat sipas zakonit në*

- rastet e jetës së përditshme. 3. përd.em. sipas kuptimeve të mbiemrit. 4. njeri i shquar (F.'80, f.1616).*
- qyqe-ja** (f.96) - 1. *shpend qi bëzân në prendverë. 2. lot qyqe këpujë si gogël qi del ndër gjethë t'ahit. F.'80, qyqe-ja* - 1. *zog shtegtari i pyjeve, me pendë ngjyrë hiri në të zezë, me sqep të përkulur e me këmbë të shkurtra, që këndon me një zë të përvaishëm dhe që nuk bën fole, por i lëshon vezët në çerdhet e zogjve të tjerë. 2. grua që ka mbetur fill e vetme, pa burrë e pa fëmijë. 3. grua fatkeqe e mjerë (F.'80, f.1623).*
- lëshim-i** (f.234) – 1. *të lëshuem, lëje. 2. lëshim gruaje: divorc-i. F.'80, lëshim-i* - 1. *veprimi sipas kuptimit të foljeve lëshoj, lëshohem. 2. qëndrim i butë, jokërkues e joparimor ndaj atyre që shkelin rregullat a që nuk plotësojnë detyrat; lejimi i veprimeve jo të drejta e i çrregullimeve, duke mos marrë masat e duhura e duke mos kërkuar llogari deri në fund; pranimi i kërkesave të një pale tjetër për të arritur në një marrëveshje, duke hequr dorë nga qëndrimi parimor e i prerë. 3. lëshesë. 4. bleta e re që sapo është ndarë nga zgjoi mëmë për të zënë zgjua të ri (F.'80, f.985).*
- leshtë-i,-ë-a** (f.234) - *njeri i leshtë, i pasherr, por i trashë ndër mend. F.'80, leshtë (i,e)* – 1. *që është bërë me lesh, që është prej leshi; që është punuar me fije a me stof leshi. 2. që ka të bëjë me delen, i deles; që merret nga delja, që del nga delja; që është bërë me qumësht deleje. 3. që ka shumë lesh, që është mbuluar plot me qime, leshtor. 4. që është në gjendje të mirë, i pasur. 5. që është i urtë, i qetë, i matur e i drejtë; që është i njerëzishëm e i butë dhe nuk i bie më qafë njeriu, që nuk ndihet; i patëkeq; baballëk. 6. që nuk ka zgjuarsin, që nuk kupton shumë; leshko, sylesh (F.'80, f.968).*
- lvere-ja** (f.242) – 1. *lvere fiku, lëvorja e hollë e fikut, lbogurë. 2. lvere fiqsh, çapella fiqsh. 3. llapë qi u vëhet varrvet. 4. lveret, ndë, rresat. F.'80, lëver-ja* – 1. *leçkë, rreckë. 2. shami; një copë pëlhurë që vënë në kokë fshatarët në disa krahina, rizë. 3. rrobat e brendshme të trupit, ndërresat; rrobat. 4. diçka fare pa vlerë, njeri a gjë që ka humbur pa vlerë. 5. gazetë pa vlerë, fletushkë (F.'80, f.987).*
- llashtë-r-a** (f.244) – *kashtë grûni, elbi, tërshane. F.'80, llashtë-r-a* - 1. *bimë e egër barishtore, me gjethë të holla e të vogla, me lule të bardha në tufë, bishtat e të cilave, kur thahen, i përdorin zakonisht si kruese dhëmbësh. 2. kashta e grurit, e elbit a e tërshërës (F.'80, f.1037).*
- madhue** (f.246) – *me bâ, m'u bâ i math. F.'80, madhoj* – 1. *përkujdesem për dikë që të rritet e të bëhet i madh, e rrit. 2. shih zmadhoj. 3. i rrit vlerën a rëndësinë dikujt a diçkaje; e mburr dikë më shumë sesa e meriton a sesa duhet, e lëvdoj veten (F.'80, f.1046).*
- mjekatar-e** (f.265) – *njeri qi mbahet për mjek, por s'është. F.'80, mjekatar-i* – 1. *mjekës, mjek. 2. magjistar (F.'80, f.1156).*
- natare-ja** (f.277) – *grue natare: qi din me punue gjithfarë rângësh shpije. F.'80, natar-e* – *mendjehollë, që ia pret mendja; i shkathët, që i vjen ndoresh për çdo punë; natare-ja* – *secila nga të dy rrotullat e vogla në trajtë makaraje ku varen liqtë e vegjës (F.'80, f.1198).*
- njuh-i** (f.291) – *numër-i, i panumrueshëm, qi s'numrohet. F.'54, e kemi si folje, njeh-numëroj, fut në hesap; thuhet edhe për ligjet në vajtim kur të vdekurit ia numërojnë të gjitha në vaj. (F.'54, f.355).*
- pat-i** (f.301) – 1. *kat-i shpi dy tri patesh. 2. pati i gurit: faqja e lame e gurit, siprina e gurit. F.'80, pat-i* – 1. *kat. 2. dhoma përdhese e katit të parë, zakonisht dhoma e zjarrit ose dhoma ku rrinë në dimër; pat-i* – 1. *barabar për të dy palët, njëlloj si*

- për njërin dhe për tjetrin. 2. në gjendje kur mbreti në lojën e shahut nuk ka ku të bëjë lëvizjen e radhës dhe loja përfundon me barazim (F.'80, f.1385).*
- piktue** (f.321) – 1. *me hanger shpesh. 2. me hanger sende të zgjedhme, bucilajë.* F.'54, **pikëtoj**- 1. *ha nga pak e shpesh; ha me të zgjedhur. 2. kërcej, lodroj pak* (F.'54, f.410).
- piktue** (f.322) – *me këcye.* F.'80, **pikëtoj** – 1. *ha shpesh e nga pak; ha pak e duke zgjedhur. 2. kërcej, lodroj. 3. më shkakton një hidhërim të thellë a një dhembje të madhe, më pikëllon pa masë, më helmon* (F.'80, f.1482).
- pile-a** (f.322) – 1. *dy arra vû njëna mbi tjetrën. 2. tra qi i vëhet murit për të gjatë me mbështetë trenët qi vijnë tërthuer. 3. drû agur ku mbështetet pilca.* F.'54, **pilë-a** – 1. *dy arra një mbi një, a tri arra dhe një përsipër, me të cilat lozin kalamajtë. 2. gur a dru ku mbështetet pilsa; tra që i vihet murit për së gjati e mbi të cilin mbështeten trarët që vijnë tërthori; brez muri. 3. gjurmë* (F.'54, f.411). F.'80, **pilë-a** - 1. *dy arra njëra mbi tjetrën ose tri arra të afuara me një kokërr tjetër përsipër, që i vënë fëmijët në tokë kur luajnë duke i gjuajtur me një arrë më të madhe. 2. gur a dru ku mbështetet pilca. 3. këmbë ure prej betoni e me përmasa të mëdha. 4. secili nga trarët e mëdhenj, që vihen në urat e drunjtja. 5. brezi i murit . 6. breg i vogël, bregore, sop. 7. nja mbi tjetrën, në dy shkallë (për arrat kur luajnë fëmijët); njëri mbi tjetrin* (F.'80, f.1484).
- pishak-u** (f.324) – 1. *vrvashke. 2. të xet të math.* F.'54, **pishak-u** – 1. *dritë me flakë që bëhet me pishë e që era s'e shuan. 2. të nxehtë të madh* (F.'54, f.413). F.'80, **pishak-u** – 1. *pishë me trung të trashë; cung pishë. 2. pyll i vogël me pisha. 3. copë, pishë e ndezur për të ndriçuar, pishtar. 4. nxehtësi e madhe* (F.'80, f.1489).
- pishinë-a** (f.324) - *të bardhët e pishës, sbardhulinë-a, zbardhulinë-a.* F.'80, **pishinë-a** – 1. *pyll i vogël me pisha, pishak. 2. zbardhulina e pishës; pishinë-a – pellg i madh me ujë të pastër, i ndërtuar posaçërisht për t'u larë ose për të zhvilluar gara noti* (F.'80, f.1489).
- pitërr** (f.325) – *shpesh, me të dendun.* F.'80, **pitër-ra** - 1.*zbokth. 2.plot e përplot,mbushur* (F.'80, f.1489).
- plaze-ja** (f.328) – *lëngatë qi mbyttë shpejt bagtin.* F.'54, **plasje-plasja** – 1. *të plasurit. 2. sëmundje ngjitëse e rëndë e njeriut dhe e bagëtisë, që shkaktohet nga një bacil i veçantë dhe çfaqet zakonisht me një puçërr si të zezë: erëkuqe, dale* (F.'54, f.417). F.'80, **plasje-a** – 1. *veprimi sipas kuptimeve të foljeve plas, plasët. 2. forca shkatërruese dhe zhurma e një lënde plasëse, e një bombe etj., kur shpërthen; shkatërrimi i diçkaje me anë të ndonjë lënde të veçantë plasëse; shpërthim. 3. e çarë e vogël në diçka, plasë. 4. sëmundje e rëndë ngjitëse, që zë kafshët shtëpiake (sidomos barngrënëset) e njerëzit, që shkaktohet nga një bacil dhe shfaqet zakonisht me një puçërr të zezë me qelb, me shumë zjarrmi, me shkumë nga goja e me skuqje të cipave të syve* (F.'80, f.1499).
- plis-i** (f.329) – 1. *tirk i bâm pa pêj, por me lesh të shkelun mire. 2. plah a shtrojë prej plisi. 3. plys-i: bucë me bar.* F.'54, **plis-i** – *copë dhe që ngre parmenda; copë dhe me bar; bûcë* (F.54, f.418); **plis-i** – 1. *një cohë jo e endur, po që bëhet me lesh të shkelur mirë dhe të larë disa herë me sapun; 2. plaf a shtrojë prej plisi. 3. kësulë prej plisi. 4. copë plis a cope thes i mbushur me kashtë që venë nën samar a nën zgjedhë që të mos vritet kafsha* (F.'54, f.418). F.'80, **plis-i** – 1. *copë e madhe dheu që ngre plugu kur çan tokën; copë e tillë dheu me bar e prerë me bel a me ndonjë mjet tjetër. 2. si plëndës, pa lëvizur; si lësh,si huk. 3. plot, mizë. 4. shumë (me mbiemrin i rëndë).; plis-i* – 1. *lloj cohe, që bëhet me lesh delesh të shkelur disa here, duke e lagur me ujë të vakët e duke e fërkuar me sapun derisa të trashet e të forcohet; një cohë e tillë që përdoret si plaf. 2. kësulë e bërë prej kësaj cohe, e cila*

sipër vjen zakonisht e rrumbullakët si kupë; qeleshe. 3. copë prej cohe të tillë ose copë thesi e mbushur me kashtë thekre si jastëk, e cila vihet nën samar që të mos vritet kafsha në kurriz; një copë cohe prej leshi, prej thesi a prej lëkure, që i vihet kaut në qafë të të mos e vrasë zgjedha, qafëz. 4. lëmysk që zënë drurët, zakonisht nga ana e veriut (F.'80, f.1504).

- prajë-a** (f.333) – 1. *pushim-i*. 2. të *prâmë-it*, të *prâmë-t*. F.'54, **prajë-a** - *prehje, pushim, shlodhje; banesë* ; *prajë-a* – *infekcion* (F.'54, f.426). F.'80, **prajë-a** - *prehje, pushim* ; *prajë-a* – *prekja e një qënijeje a e një bime nga mikrobe ose nga baktere që shkaktajnë sëmundje, infeksion* (F.'80, f.1528).
- pres-i** (f.336) – 1. *temperi-ja, brisk-u*. 2. *preset e fluskës*. F.'54, **pres-i** – 1. *thikë xhepi, sojak, brisk*. 2. *fig. gajle, kujdes* (F.'54, f.429). F.'80, **presë-a** – 1. *pjesa e metaltë e briskët, e thikës, e shpatës etj., pa dorezën; ana e mprehtë e thikës, e sëpatës a e një mjeti tjetër prerës, pjesa që prët, the*. 2. *goditje kryesore, ana më e mprehtë dhe më e rëndësishme e diçkaje*. 3. *vendi ku ndahet uji i kanalit a i vijës për të ujitur arën; secila nga vijat e vogla që e çojnë ujin nëpër hullitë e një are; hulli e hapur tërthorazi me plug në një arë për t'u prerë rrugën ujërave*. 4. *ledh me gurë a cfrat në një lumë për t'u prerë rrugën peshqve* (F.'80, f.1543).
- prize-a** (f.338) – *vi e vogël qi bâjnë ujnat kur rrjedhin*. F.'80, **prizë-a** – 1. *pajisje prej gypash, dërrasash etj., që vendoset në lumë ose nëpër kanale për të marrë ujin ose për ta shpërndarë atë në drejtime të caktuara; lëshues; pajisje që vendoset në gypat e ujit të pijshëm për të marrë ujë*. 2. *pajisje prej lënde veçuese, me dy vrima, që shërben për të lidhur një aparat (furnelë elektrike, radio, televizor, hekur raobash etj.) me burimin e rrymës elektrike* (F.'80, f.1550).
- pufe-ja** (f.341) – *cingare duhani e mbështjellun*. F.'80, **pufe-ja** - 1. *ndenjësë e ulët dhe e butë, si kolltuk i vogël, por pa mbështetëse*. 2. *përdorësë e vogël e rrumbullakët, e bërë prej një cope të butë e me push, me të cilën gratë lyejnë fytyrën me pudër*. 3. *cigare duhani* (F.'80, f.1566).
- punë-madh-e** (f.341) – *mburravec-e, qi mburret, qi mbahet punë e madhe*. F.'80, **punëmadh-e** – 1. *që merret me punë të rëndësishme a të mëdha; që punon shumë, që është punëtor i madh*. 2. *që mburret shumë për punën që bën, që mbahet sikur merret me punë të mëdha*. 3. *përd. sipas kuptimeve të mbiemrit* (F.'80, f.1571).
- rejë-a** (f.344) – *guzhëm-a*. F.'80, **rejë-a** - 1. *thupër ose degë e njomë, që përdridhet së bashku me të tjerat për të lidhur diçka, guzhëm; filiz ose degë e njomë*. 2. *kunj druri i përkulur, që shërben për të lidhur shtizën e parmendës e zgjedhën; dru i përkulur a me gëthapë, që ngulet në një tra për ta tërhequr zvarrë* (F.'80, f.1643).
- rogë-a** (f.346) – *vend, log ndër bjeshkë i pa lisa, por me bar*. F.'54, nuk e ka. F.'80, **rogë-a** – 1. *lëndinë me bar në mes të pyllit, lirishtë; vend i zhveshur në mes të pyllit; lëndinë me bar në një faqe mali*. 2. *pjesë e zhveshur ose e rrjepur; pullë; larë; në rogë të ballit, në mes të ballit, në lule të ballit* (F.'80, f.1669).
- rye** (f.347) – *me pësue, hjekë keq, vuejtë*. F.'54, nuk e ka. F.'80, **rys** – 1. *e stërvit dikë, e bëj të regjur, e kalit*. 2. *i mbush mendjen, e bind* (F.'80, f.1674).
- rragjë-a** (f.349) – *rrash-i, rrashë-a, shikull drûje: përdoret me rrafshue babûnën e mbushëme*. F.'54, **rraxhë-a** - *një copë dërrasë, me të cilën rrafshojnë qasen që është mbushur me drithë, plot, buzë për buzë* (F.'54, f.471). F.'80, **rraxhë-a** – 1. *një copë dërrasë që shërben për të rrafshuar drithin, miellin etj., në grykën e një ene të mbushur buzë më buzë*. 2. *plot e përplot, buzë më buzë* (F.'80, f.1681).
- rrahëc-i** (f.359) – *pirajkë-a, laes-i, drû shpatuke për me rrahë petkat në të lam*. F.'54, **rrahës-i** - *dru shpatuke për të rrahur petkat, kur i lajnë; kopan, pallë* (F.'54, f.470). F.'80, **rrahës-e** – *që shërben për të goditur a për të rrahur; rrahëse-ja – 1. *thupër pushke*. 2. *rrahëse brumi (vezësh, mishi)*, (F.'80, f.1677).*

- rrungajë-a** (f.363) – 1. vend mbulue me lisa të rrumbulluem, të rrotuëm, të rrahuem. 2. me shkue rrungajë teposhtë, i shkuen rrungajë te dera. F.'54, **rrungajë-a** – *rungajë-a* 1. ortek bore, reshme. 2. ç'bie lumi me vete. 3. rrëshqitë pllajave të maleve. 4. shtrati i një përroi; prroskë që sjell me vete në dimër gurë, kërcunj etj. (F.'54, f.469). F.'80, **rrungajë-a** – 1. ortek dëbore. 2. turmë e madhe njerëzish a kafshësh që lëviz me rrëmbim; ortek. 3. rrëmujë, pështjellim. 4. dru i rrëzuar dhe i kalbur a i tharë; drurë, gurë e dhe që shemben nga mali a që sjell lumi me vete. 5. rrëngallë; tokë gurishtë, që nuk jep prodhim, rrëgallinë. 6. përrua i rrëmbyer, që sjell me vete kërcunj e urë. 7. njeri i trashë, kërcu. 8. në rrëmujë, në pështjellim. 9. plot e përplot me diçka, zakonisht në pështjellim a të shtrirë (F.'80, f.1721).
- rrye** (f.364) – me vuejtë, m'u stërkeqë, me ardhë rryeshëm, me ngurrue në të rritun. F.'80, **rryej** – 1. heq keq, vuaj; lodhem me diçka a me dike. 2. fitoj përvojë me mund e me lodhje; stërvitem; rryhem. 3. rritet ngadalë, mezi rritet. 4. stërvit (F.'80, f.1723).
- rryl-i** (f.364) – burr i hajthëm e i gjatë. F.'54, **rryli** – 1. gabzherri, skërfyelli. 2. gryka e shishes; fig. budallë (F.'54, f.481). F.'80, **rryl-i** 1. gabzherr, skërfyell. 2. damarët e fytit. 3. grykë, lëfyt. 4. makarona të vogla si guaska kërmilli, bobole. 5. kalli misri i madh, i mbushur plot me kokrra. 6. njeri me trup të gjatë e të madh, por zakonisht pak i trashë nga mendja (F.'80, f.1723).
- shkimë** (f.398) – me fikë, ndalë. F.'54, **shkim- shqym; shqymb** – shuaj, çfaros, përfaroj (F.'54, f.542). F.'80, **shqim-** 1. shuaj, fik. 2. shfaros, përfaroj (F.'80, f.1915).
- shkërpicë-a** (f.397) – arësye kote, qi s'ecë, furde, pa temel. F.'54, **shkërpicë-a-shkëndijë, xixë; fig. pretekst, shkak** (F.'54, f.527). F.'80, **shkërpicë-a** – 1. shkëndijë, xixë. 2. arsye e kotë, vjegëz (F.'80, f.1859).
- shtonë-a** (f.414) – 1. vijë nën dhe. 2. zavorr-i, gjiriz-i. F.'80, **shtonë-a** – 1. llagëm, gjiriz; vijë uji nën dhe. 2. kanal, vijë uji, lug. 3. vend ku buron e mblidhet ujë (F.'80, f.1933).
- shtirë** (f.413) – me kalie ujët njatý ku ásht má të cekët. F.'80, **shtir-** 1. kaloj lumin a një rrjedhë uji, kapërcej, dal matanë. 2. kapërcej një pengesë, përballoj një të keqe a një vështirësi, e hedh (F.'80, f.1930).
- turrahi-ja** (f.434) – bishtni, dredhi në fjalë. F.'80, **turrahi-a** – 1. dredhi në fjalë, qëndrimi i atij që i bën lak fjalës. 2. potere që bën dikush kur është i inatosur (F.'80, f. 2043).
- taç-i** (f.417) – kallafat, i lânun, i kadalshëm. F.'54, **taçi** – dirku më i vogël i dosës; fig. rigoni, djali më i vogël, më i përkëdheluri; **taç-i** – qylahu i shehut dhe i dervishit e i babait bektashi (F.'54, f.553). F.'80, **taç-i** – 1. derrkuci që dosa e pjell të fundit, derrkuci më i vogël. 2. i fundit i fëmijëve, djali më i vogël e më i përkëdhelur; fëmija i pleqërisë dhe **taç-i** – qylaf i bardhë me një rrip të gjelbër, që e mbante shehu, dervishi e babai i bektashinjve (F.'80, f.1962).
- vilar-i** (f.457) – 1. kopësht i gjatë e i ngushtë. 2. kopësht afër shtëpije. F.'54, **vilar-i** – 1. top pëlhurë, pjesë pëlhure; një rryp pëlhurë, një rryp lëkurë; 2. kopsht i gjatë e i ngushtë; kopsht afër shtëpisë (F.'54, f.611). F.'80, **vilar-i** – 1. rrip i gjatë e i ngushtë i diçkaje; rrip i gjatë pëlhure, stofë, letre etj., i mbështjellë si rrotull, top. 2. brez i ngushtë, rrip (toke, etj.); vijë, varg, rresht. 3. si rrotull, si top pëlhure (F.'80, f.2167).
- zhigël-a** (f.475) – arrë qi s'ka thalb mbrendë. F.'54, **zhigël-zhigla** – çiklat e cigarisura që mbeten në fund, kur tretim dhjamin, ushunjin a pakën; mb. arrë që s'ka thelb brenda, arrë fyrbël, arrë pa bukë (F.'54, f.641).

ç) Fjalë që përfshihen vetëm tek fjalori 1954

- agullue** (f.44) - *më janë agullue sÿt: terratisë* . F.'54 e përdor njëlloj, **agullue** – *më janë veshur sÿtë, më janë vagëlluar sÿtë* (F.'54, f.4).
- akëllaç-i** (f.44) – *avër, rrasë akulli*. F.'54 e përdor, **akillaç-i** – *rrasë akulli* (F.'54, f.5).
- âncak-u** (f.45) – 1. *gur qi del jashta murit*. 2. *gurët e derës që mbajnë ballorin*. 3. *trevesë -petë para një pasqyre*. E kemi në F.'54, **ancak-u** – *guri që qitet pak jashtë murit dhe shërben për të varur a për të mbështetur ndonjë send më të* (F.'54, f.10).
- asharitë** (f.50) - *me mrrî në kohë t'asharis, kur nisë me vlue gjaku; burzue, fëmi ashari; i pahajr*. F.'54 e ka **hashari-e** – *i prapë për kalamajtë* (F.'54, f.165).
- ballungë** (f.54) – *mbëllungë*. F.'54, **ballungë** – *sh.bullungë*- 1. *xhungë që del në kokë anë trup të njeritu, në trup të shtazëve a të drurëve*. 2. *një e dalë n'enët e metalta, si në kazanë etj* (F.'54, f.51).
- bândërr-a** (f.55) – *pranga, hekura*. F.'54 e ka, **bandër-bandra** – *pranga* (F.'54, f.27).
- bluzhdue** (f.65) – *me bâ bluzhdë*. F.'54, **bluzhdoj** – *bëj bluzhdë, grimcoj* (F.'54, f.41).
- borc-i** (f.66) – *shpend i vogël*. F.'54 e ka, **bors-i** – *zog këngëtor i rendit të Harabelavet, me krahë e me bisht të zi, me njolla e me vija të bardha, me kurriz të murmë dhe me gjoks si të kuq; zborak, avdos, finik* (F.'54, f.43).
- botuem-i** (f.67)- *njeri qi i bjen bota a ajo e tokës, prej ligështis së dejet* . F.'54 e ka, **botuem-botueme (e)** – *që i bie ajo e botës, që e zë ajo punë, ajo e tokës* (F.'54, f.44).
- brakî-ja** (f.67) – *bërkî*. F.'54, **braki-a** – *vodhviçe* (F.'54, f.44).
- bravishtë-a** (f.68) – *nji grumbull bravesh, berre të përzieme*. F.'54 e kemi, **bravare** – **bravarja** – 1. *dele që mbahet nës htëpi për qumësht*. 2. *kope e përzier me dhentë e shumë vetave, me që azta s'janë në gjendje të mbajnë nga një bari më vete* (F.'54, f.45).
- bukuritue** (f.74) – *me i dhanë nji sendit bukuri, zbukurue*. F.'54 ka trajtën, **bukuroj** – *zbukuroj* (F.'54, f.50).
- bûn-i** (f.75) – 1. *bân-i: tëbaen-i: vështrimi i parë: vënd banimi*. 2. *kësollë bjeshke e mbëlueme me gjethë a me drresa*. F.'54, **bun-i** – *kasolle stanarësh në bjeshkë, mbuluar me dërrasa e em gjethe: tëbanë* (F.'54, f.75).
- burzue** (f.77) – *me nisë djali m'u pjekë, m'u qymë, m'u rudithë mustakësh, m'u ndjersë musteqesh*. F.'54, **burrëzohem** – *thuhet kur nis djali të piqet, t'i dirsë mustaqja* (F.'54, f. 52).
- buti (i kres)**, (f.77) – *ashti irrashtës së kres mbi ball*. F.'54, **but-i-** *i kresë, maja e kresë, e kokës* (F.'54, f.53).
- çumë-a** (f.103) - *mastelë-a, gjysë vozge për me përvlue petkat mbrendë*. F.'54, **çumë-a** - 1. *kovë*. 2. *gjysmë vozge për të vënë këmishët në finjë*. (F.'54, f.70).
- darë** (f.105) - *m'ushpërnda*. F.'54 **dar** - *humbas, shpërndajë, perhap, darem, humbas, shpërndahem, përhapem: u darnë gjindja, u përhapën ,u përndanë*. (F.'54, f.73).
- dykme,t** (f.117) - *lojca,t, gjerdani, kolanë grash me çingla e noca*. F.'54, **dykme-ja** - *pare ari e vjetër;dykmén*. (F.'54, f.97).
- letue** (f.235) – *lecue, lenue; lehtue*. F.'54, **letohem** –**lehtësohem**; *fig. bëhem matuf* (F.'54, f.266).
- lyerth-i** (f.243) – 1. *kokrrizë, mullâ qi spikon jashtë vizës së ndrejtë e së dëjun*. 2. *kercël e forte qi trajtohet në gishta të kambvet, lez-i, broka ndër gishta të duervet,*

- qi s' dhâmbin, por shtohen fort.* F.'54, **lyth-i** – 1. kallo që del në gisht të këmbës. 2. lez (F.'54, f.282).
- llaqemi-ja** (f.244) – *lirisht, pa kurrnji rojë, pa-zot, baskan, berraba.* F.'54, **llaqemi** – *pa rojë, pa zot* (F.'54, f.283).
- lloç-e** (f.244) – *dardhë, mollë lloçe: e sbutme fort mishit, nisë m'u kalbë.* F.'54, **lloç-i** – 1. *gëlqere e shuar e përzier me rërë e me ujë, që shërben për të lidhur murin; horasan.* 2. *baltë, llucë; bore e shkrirë e përzier me baltë; dardhë, mollë lloçe, e ndulkur, e pjekur tepër dhe bërë qull* (F.'54, f.283).
- mâ** (f.245) – *çplâ, kulnue.* F.'54, **mâ** – *më* (F.'54, f.285).
- macolle-ja** (f.235) – *mâj drûni.* F.'54, **macolle-macollja** – *çekiç druri* (F.'54, f.285).
- mae-ja** (f.246) – *mâje-a.* F.'54, **maje-maja** – *t'ushqyerit mirë* (F.'54, f.287).
- mbledhëtar-e** (f.254) – *kush merr pjesë në një mbledhë.* F.'54, **mbledhëtar-i** – *që merr pjesë në një mbledhje* (F.'54, f.299).
- mbëshic-i** (f.255) – *mbëshilëc-i, kapk-u.* F.'54, **mbëshilc-i** – *kapak, klytyrë, mbyllës* (F.'54, f.298).
- mbollungë-a** (f.256) – 1. *t'âjun prej së vrami, së rami.* 2. *ballungë-a.* F.'54, **ballungë-a** – *bollungë* (F.'54, f.27).
- mbrijaza** (f.256) – 1. *brîjâza, brîjas, si për brîjësh.* 2. *tërthuer.* F.'54, **mbrijaza-tërthori** (F.'54, f.300).
- megue** (f.258) – *me ague.* F.'54, **megon** – *agoi* (F.'54, f.308).
- meshnue** (f.262) – *m'u bâ fëmi, me ra trûtë mbas qafe, thohet për pleq qi ka nisë me i lânë mendja.* F.'54, **meshnohem** – *bëhem matuf, matufosem; lenohem.* (F.'54, f.307).
- meteh-i, metef-i** (f.262) – 1. *kufi, shefi.* 2. *vend i nalcuem e në të lam.* F.'54, **metef-i** – *vend kufitar; vend i lartë në mejdan* (F.'54, f.307).
- murrçak-u** (f.274) – *shpend voglar.* F.'54, **murrak-u** – *harabel-i* (F.'54, f.328).
- murrelë-a** (f.274) – *mizë e madhe.* F.'54, **murrelë-a** – *një fare mize a zekthi që nget lopët, qetë, kuajt e gomarët* (F.'54, f.328).
- nafele-ja** (f.276) – *larë e bardhë në lëkurë të shkjerret.* F.'54, **nafele-nafelja** – *larë e bardhë në lëkurë të shqarshit.* (F.'54, f.331).
- najue** (f.276) – *me vokë pak.* F.'54, **najoj-** *e vak pak* (F.'54, f.331).
- nashël-a** (f.277) – *përmbrendëca,t.* F.'54, **nashla-t** – *të brendshmet, rropullitë* (F.'54, f.332).
- nrâte-ja** (f.280) – *nade-ja.* F.'54, **nade-nadja** – *mëngjes; nadja e mire, mirëmëngjesi* (F.'54, f.331).
- ndëjaz** (f.281) – *tue ndëjë, ndëjas, në ndëjë.* F.'54, **ndejas** – *duke ndenjuri* (F.'54, f.334).
- ndiç** (f.285) – *grimcë lidhëse: pra.* F.'54, **ndiç** – *pra* (F.'54, f.337).
- njicë-a** (f.292) – *rred me gjue peshk.* F.'54, **njicë-a** – *rjetë e madhe peshkimi me një gjatësi prej 50 m; lëshohet pingul n'ujë dhe mbahet në këtë drejtim me anë gurësh të lidhur varg në fund e me një seri rrjedhash që e mbajnë mbi ujë* (F.'54, f.357).
- ofshe** (f.293) – *thirrje dhimbe, medet, kej neshtrasha! Kej!.* F.'54, **ofshe** – *që tregon mbledhje* (F.'54, f.359).
- pegelë-a** (f.303) – *gjylpânë si gërshânë me njênën mâje të prehët e në të tjetrën ka një take: gjylpânë hinglize si kapcë me mbërthye mafra (facoleta) e tjera petka shtati.* F.'54, **pegelë-a** – *karficë e madhe; paramanë* (F.'54, f.386).
- përfatue** (f.306) – *prefatue, prefatitë; me i bâ nderë e iqram, gostitë.* F.'54, **përfatoj** – *e pres mirë, i bëj nder, e gostit* (F.'54, f.396).
- përfetue** (f.307) – *diftue, kallxue.* F.'54, **përfetoj** – *kallëztoj, tregoj* (F.'54, f.396).

përfëlitë (f.307) - *përfulitë, profulitë; përsellue, pësëllue, përcullue*. F.'54, **përfëlit** – *përcëlloj* (F.'54, f.396).

përgiasi-ja (f.308) - *përgishi-ja, cilsija e nntij qi âsht i përgjashëm*. F.'54, *përgjasim-i* – *të përgjarët që kanë dy a më shumë veta a sende të ndryshme në mes të tyre* (F.'54, f.397).

përkye (f.311)- *m'u kulë, çplâ, lakue, shtrëmbënuë*. F.'54, **përkyej** – *ndrydh, shtrembëroj, lakoj* (F.'54, f.400).

përllim-i (f.311) - *detyrë; me la borxhin*. F.'54, **prelim-i** – *detyrë* (F.'54, f.400).

përmbarëshëm-i,-e,-ja (f.312) - *qi ka mbarre*. F.'54, **përmbarëshëm (i)** - **përmbarëshme(e)** – *që skuqet në fytyrë nga turpi, që turpërohet kollaj* (F.'54, f.401).

përmbëshëm-i,-e, -ja (f.312) - *qi gjindet përmbi një tjetër, vendue mâ nalt se një tjetër*. F.'54, **përmbëshëm (i)** – **përmbëshme (e)** – *që gjindet përsipër* (F.'54, f.401).

përspjek (f.314) – *përkundra, kundra*. F.'54, **përspjek** – *kundra, përkundra* (F.'54, f.404).

përshkye (f.314) – 1. *me shkye mishin*. 2. *me i marrë gjâ kuj përdhuni*. F.'54, **përshkyej** – *ja rrëmbej* (F.'54, f.405).

perverse-a (f.316)- *prove, sprovë*. F.'54, **pervesë –a** – *sprovë* (F.'54, f.406).

përzânë-a (f.316) – 1. *bagti të mira e të këqija qi me një shpërblim, merren m'u bjeshkue*. 2. *kecan i keq, rob-i*. F.'54, **përzânë (i,e)** – *i djemnuem, i xhindosur* (F.'54, f.407).

pështesë-a (f.318)- *pështim-i, shpëtim-i*. F.'54, **pështesë-a** – *shpëtim* (F.'54, f.408).

picëlim-i (f.320) - 1. *të qindisun t'îmë*. 2. *të veshun me shije*. F.'54, **picëlim-i**- 1. *të qëndisurit imtë*. 2. *të veshurit bukur* (F.'54, f.408).

picëlue (f.320)- *me veshë petka të zgjedhëme*. F.'54, **picëlohem** – *vesh petkat e mira, vishem elegant* (F.'54, f.409).

pigal-i (f.320) – *pip-i, çep-i (i ênvet qi mbajnë lânje)*. F.'54, **pigal-i** – *lëfyti, fyti, çepi i enës* (F.'54, f.409).

pikatshëm(f.321) – *mbeshënueshëm*. F.'54, **pikatshëm (i)- pikatshme (e)** - *që shquhet, që dallohet përmbi të tjerët* (F.'54, f.409).

pitërr-i,-a (f.325) – *i shpeshët, i dëndun; me pitrrue, me shpeshtue*. F.'54, **pitër(i,e)** – *i shpeshtë, i dendur* (F.'54, f.414).

pjegullue (f.326) – *tha, përtha, përfiskë*. F.'54, **pjegulloj- pegulloj** (F.'54, f.414).

pjediposhtë (f.326) – *pidiposhtë, pjeteposhtë*. F.'54, **pjetëposhtë** – *nga lart poshtë* (F.'54, f.415).

plahë (f.327) – *mbulue, m'a vrugoi ftyrën*. F.'54, **plah** – *mbuloj ftyrën* (F.'54, f.416).

plajm - i (f.327)- 1. *pluhun i îmë fort*. 2. *plajm mielli: miell paskaj, paskaq*. 3. *plajm bore: borë e îmë qi hyn ndër plasa*. F.'54, **pjalme-i** – *miell i situr imtë; maja e miellit; borë e imtë që çon bora përpjetë* (F.'54, f.414).

plajë-a (f.328) – *drû qi çon e ulë gurin e mullinit për m'e bâ me blue trashë a îmë*. F.'54, **plajë-a** – *vegël e zdrukthëtarëve, me anën e së cilës ata drejtojnë dërrasat që do të mbërthehen* (F.'54, f.416).

plâng-u (f.328) – *plângu i odës; çardaku, shtroja, trolli*. F.'54, **plâng-u** – *pasuri, mall; gjithë pasuria; la shtëpinë e vet dhe shkoi gjetiu* (F.'54, f.416).

poftë-ja (f.331) – 1. *mënyrë-a; qepe, bane, fol në këtë poftë*. 2. *mostër-a*. 3. *ekzemplar-i*. 4. *kampjon-i*. F.'54, **poftë-poftja** – *model, mostër* (F.'54, f.421).

rejtë (f.344) – 1. *kursye*. 2. *me skutlue, ruejtë, kursye*. F.'54, **rethem** – *lë peng një gjë në dorë të kreditorit për të siguruar të larët e borxhit* (F.'54, f.460).

sabitë (f.365) – *tkurë, kuritë, përfiskë, përfikë, fiktue*. F.'54, **sabitëm-** *është sabitë druja, është koritur, përfikë* (F.'54, f.482).

samadak-e (f.366) – *camadak-e, bujar, fisnik, dai, xhymert, trim; burr me të gjitha virtytet që i lypen.* F.'54, **samadak** – *i ri e i zoti.* (F.'54, f.484).

savitë (f.366) – *me lye murin me mastar.* F.'54, **savit** – *lyej murin me mastar.* (F.'54, f.486).

skâjulluer-ori (f.370) – *vegël sdrukthatarësh, mbë të cilën ndeshin drrasën e pështesin për m'e sdrugue (sdrukthue).* F.'54, **skajulluer-skajullori** – *vegël zdrukthtarësh, mbi të cilën këta mbështetin dërrasën, kur duan ta zdrugojnë.*(F.'54, f.495).

I sollëm këto lema nga Fjalori i Gazullit për arsyet e mëposhtme:

- Fakti që mjaft fjalë nga Fjalori i Gazullit (1941), janë pasqyruar vetëm në Fjalorin e vitit 1954 dhe jo më vonë, gjen shpjegim me afrinë në kohë të publikimit të këtyre veprave, me një dekadë ndërmjet.
- E dyta, hartuesit e Fjalorit të 1954-ës e kanë njohur dhe çmuar në mënyrë të veçantë si një prej botimeve të njohura të serisë së Visareve të Kombit.
- Mendojmë gjithashtu se gjuhëtarët leksikografë që punuan për mbledhjen dhe përzgjedhjen e fjalës të fjalorit të parë shpjegues të shqipes (1954), kanë pasur mendimin se, në rrjedhën e natyrshme të zhvillimit të variantit të shkruar të Veriut, shumë fjalë dialektore të mbledhura nga N.Gazulli, mund të ishin përdorur sot e gjithë ditën brenda standardit të shqipes.
- Së katërti, duhet vënë në dukje se edhe Fjalori i vitit 1954 ka mjaft trajta fjalësh krahinore, të cilat në kohën tonë, jo vetëm që nuk përdoren, por edhe kalojnë në harresë.

d) Fjalë që përfshihen në Fjalorin e 1980-s

- afërmendësh** (f.43) – *mos fol neper të, dishka atypari, jo gjâ të njimendët*. F.'80, **afërmendsh-** 1. *kuptohet vetvetiu, është e qartë vetvetiu, s'ka dyshim*. 2. *po, sigurisht, ashtu vërtet* (F.'80, f.7).
- âmë-a** (f.45) – *ka âmë vojquri...;shije*. F.80, **amë-a** – *shih amëz-a , amë e mirë a e keqe* (F.'80, f.28).
- bjezgë-a** (f.64) – *qëzë-a, qëjzë-a ; ashkël e imtë fort*. F.'80, **bjezgë-a-** *ashkël e vogël druri, spicë* (F.'80, f.155).
- blogur-a** (f.64) – 1. *blogur hudre, molle, groshe*. 2. *blogur ahi: lëvore ahi*. F.'80, **blogurë-a** – *lëvozhga e drurëveose lëkura e fryteve të bimëve* (F.'80, f.157).
- bogël-a** (f.66) – *kokrra pëmësh të vogla, pëmë kokërr vogla*. F.'80, **bogël-la-** *pemë e vogël ende e papjekur* (F.'80, f.160).
- bollar-i** (f.66) – *shtërpî qi s'bân dâm, por madje vlen me zhbi guska, kaçamij e krymba*. F.'80, **bullar-i** – *gjarpër johelmues, me trup të trashë e të gjatë rreth një metër, mjaft i ngathët në lëvizje, që ushqehet me kërmij, minj, zogj etj.* (F.'80, f.196).
- bollur-i** (f.66) – 1.*krh. me it. bollore= të vluem prej së xeti, të vluem ndër mend, kryengritje*. 2. *më xûni bolluri; rreziku, sherri*. F.'80, **bullur-i** – *e keqe, barrë e padëshiruar, bela, taksirat* (F.'80, f.197).
- bonjake** (tokë), (f.66) – *tokë e trashë e me ujcinë, vruinë*. F.'80, **bonjake-ja** – 1. *jetie*. 2. *tokë e varfër dhe me lagështi* (F.'80, f.164).
- bijim** (f.62) – *të lindun*. F.'80, 1. *veprimi sipas kuptimit të foljes bijoj*. 2. *të gjithë fëmijët e lindur nga dy bashkëshortë; brezni* (F.'80, f.144).
- blojc-i** (f.65) – *ai qi bluen; mullisi*. F.'80, **blojtës-i** – *mullis* (F.'80, f.157).
- brizë-a** (f.70) – *brî delme me se i hjekin linit grathin*. F.'80, **brizë-a** – *bri deleje, që përdoret për t'i hequr grathin lirit* (F.'80, f.182).
- bryth-i** (f.72) – *yr-i, uri , hamurik-u;byr-i*. F.'80, **bryth-i** – *urith* (F.'80, f.185).
- butue** (f.77) – *me e butue gavixhin, me bâ me mbajtë lâje, mbutue*. F.'80, **butoj** -1. *vë në ujë a mbush me ujë një enë druri, që të bymehet e të mos rrjedhë*. 2. *zbutet nga uji (zakonisht për tokën)* (F.'80, f.204).
- cacë** (f.79) - *ka nisë fëmija me cacë*. F.'80, **cac** – 1. *mësoj foshnjën të ecë, e përkëmb*. 2. *eci ngadalë e me zor, duke u mbajtur me fëmijët e vegjël* (F.'80, f.211).
- cakërrí-ja**(f.79) – *shi përzie me bore e me akull*. F.'80, **cakërri-a** – *shi i ftohtë i përzier me borë* (F.'80, f.212).
- cûmërr-a** (f.87) - *cûmrrak-u, qefull i ri, me krye të vogël, shtat-trupalec, i shkurtë e i trashë, me bisht të vocërr*. F.'80, **cumër-ri** – *lloj qefulli me trup boshtor e të zhdërvjellët, qefulli i verës, gushtak* (F.'80, f.233).
- curan –e** (f.87) - *njeri a shtâzë veshcure*. F.'80, **curran-e** – 1. *shih, curr-e*. 2. *shih currak-e* (F.'80, f.234).
- cur-i** (f.87) - *me veshë të vogjël*. F.'80 **currë-a** – *dhi ose dele me veshë të vegjël a të prerë, dhi ose dele curre* (F.'80, f. 234).
- curue** (f.87) - *me i shkurtue, me i a bâ cure*. F.'80, **curroj** – 1. *i pres veshët; i shkurttoj veshët ose bishtin (një kafshe)*. 2. *ngreh përtpjetë (veshët)* (F.'80, f.234).
- qelbësuer** (f.90) - *qi shtjen erë të keqe*. F.'80, **qelbësirë-a-** 1. *diçka shumë e ndyrë ose e prishur dhe që bie erë të keqe*. 2. *njeri që mbahet shumë i papastër, qelbanik*. 3. *njeri me vese të ulëta e i prishur nga ana morale, qelbanik*. 4. *veprim që të ngjall neveri, punë e ndyrë* (F.'80, f.1592).

- çup-i** (f.103) - *burr me flokë të shkurtën; çupë-a, fëmën flokëshkurtë*. F.'80, **çup-ë** – 1. *që i ka veshët të shkurtër; curr*. 2. *që nuk ka fare brirë, shyt*. 3. *që e ka bishtin a një pjesë tjetër të trupit të prerë, cung*. 4. *që nuk ka hala, me kalli pa thekë (për të lashtat)*. 5. *përd. em. sipas kuptimeve të mbiemrit* (F.'80, f.280).
- çyçë-a** (f.103) - *çyçë opange, këpuce= fliq-i*. F.'80, **çyçë-a** – 1. *fytyrë e hollë që del nga kroji ose nga një enë për të derdhur nga pak ujë ose një lëng tjetër, çep; lëfytyrë*. 2. *pjesa e hollë dhe e zgjatur përpara një sendi; maja e këmbës ose e këpucës etj; fliq* (F.'80, f.281).
- dak-u** (f.104) - 1. *dash-i*. 2. *ëmën kombtar*. F.'80, **dak-u** – *pjesëtar i popullsisë së vjetër të Dakisë, e cila njihet si paraardhëse e popullsisë rumune; banor i Dakisë* (F.'80, f.284).
- doracak-e** (f.112) - 1. *vegël, almise që vjen përdorshëm*. 2. *libër doracak*. F.'80, **doracak-e** – 1. *që mund të përdoret lehtë, i volitshëm a i lehtë në përdorim; që mbahet nëpër duar e hyn në punë vazhdimisht*. 2. *tekst shkollor ose libër tjetër që përdoret gjerësisht si udhëzues mësimor e praktik* (F.'80, f.358).
- dyllçue** (f.118) - 1. *me zhytë, me ngjye me dyll*. 2. *m'u ngjeshë dhe si dylli*. F.'80, **dyllçet-et** – *zbutet, bëhet i butë si dyllë a si brumë* (F.'80, f.392).
- dhandrrue** (f.119) - 1. *u dhandrruen, u martuen, m'u bâ dhandrrorë*. 2. *m'u krushkue, me xânë miqasi me krushkina*. F.'80, **dhëndëroj** – 1. *bëhem dhëndër; jam dhëndër, nisem dhëndër*. 2. *rri si dhëndër, qëndroj si dhëndri ditën e dasmës* (F.'80, f.405).
- dushkue** (f.117) - *m'u dushkue mali: me qitë gjethë*. F.'80, **dushkoj** – 1. *mbulohet me gjethë të reja, lëshon gjethë të reja, lëshon gjethë të reja, gjethon; dushkohet*. 2. *mbushet me dushqe; dushkohet*. 3. *pres degë të vogla dushku me gjethë për t'i përdorur si ushqim për bagëtinë, bëj dushk* (F.'80, f.388).
- lavrak-u** (f.232) – 1. *lakim-i*. 2. *adv. lavrakë lavrakë: i bâm në të lakuem si valët*. F.'80, **lavrak-e** – *që e ka trupin të hollë, të dobët e jo të lidhur mirë* (F.'80, f.956).
- lypësue** (f.243) – *me lypë shpesh*. F.'80, **lypësoj** – *kërkoj lëmshë, lyp* (F.'80, f.1030).
- mbërdhezë-a** (f.254) – *m'u kuqë*. F.'80 **mbërdhezem** – *skuqem në fytyrë* (F.'80, f.1082).
- mbrijue** (f.257) – 1. *me kthye në trajtë të brisë, me pë përkulë*. 2. *shtrembënie*. F.'80, **mbrijohem** – *prish marrëdhëniet me dikë, acarohem me të; ndeshem me dikë, shkoj keq, grindem* (F.'80, f.1094).
- mëkës-i** (f.258) – *mëngëc-i, të mângët, visi ku shputa e kambës ban si gjë*. F.'80, **mekës-i** – *pjesa e lakuar, e futur dhe më e butë në shputë e këmbës; barbull* (F.'80, f.1107).
- melcë-a** (258) – *zog i vogël që rrin hamallesh*. F.'80, **melcë-a** – *kubël e vogël deri në moshën katër muajsh* (F.'80, f.1107).
- mështekën-a** (f.262) – *terthore,ja*. F.'80, **mështekën-na** – *dru pylli i viseve të ftohta, me trung të drejtë, me lëvore të lëmuar e të bardhë dhe me gjethë si zemër e të dhëmbëzuara, lënda e të cilit përdoret zakonisht për orendi; krahjetë, balosh* (F.'80, f.1133).
- mëdhexë-a** (f.258) – *mëllezë*. F.'80, **mëllezë-a** - *shkurre me lëvore të kuqrrime në të murrme, me gjethë të vogla si të shkozës së bardhë, me kokrra si rezhde, që përdoret zakonisht zakonisht për zjarr* (F.'80, f.1125).
- miellajë-a** (f.263) – *send i bâm me miell; borë si mielli që s'mban me ecë mbi të*. F.'80, **miellazë-a** – *borë e imët si miell; pluhur bore që ngrihet kur fryn era* (F.'80 f.1135).

- muhar – i** (f.271) – 1. *bimë qi del livadhesh*. 2. *muhar kënete*. F.'80, **muhar-i** – *bimë barishtore njëvjeçare, me kërcell të gjatë deri një metër, me lulesë në trajtë kalliri e me gjethe të mbuluara me push, që mbin e rritet sidomos në orizore dhe misërore, që ngjitet rrobave si rrodhja dhe përdoret si ushqim për bagëtinë* (F.'80, f.1179).
- ndëjshëm-i,-e,-ja** (f.281) - *qi gjindet në ndëjë, qi mund të lêhet në ndëjë, i mbajtur në fjalë, në të prûm*. F.'80, **ndeishëm (i)- me (e)** – *që nuk rrëmbehet në gjykime e në veprime, që i peshon mirë punët e fjalët, i matur, i shtruar, i qetë* (F.'80, f.1203).
- njimendët-i,-a** (f.292) – *i sakët, i sigurtë, qi âsht përnjimend*. F.'80, **njëmendtë (i,e)** - *që është në të vërtetë, i vërtetë, i përnjëmendtë; real* (F.'80, f.1288).
- njimendue** (f.292) – *me bâ të një mendit, rendit*. F.'80, **njëmendoj** - *vërtetoj diçka, provoj që është e njëmendtë* (F.'80, f.1287).
- përhoshë** (f.309) - 1. *përyoshë joshë: me i hÿkuj në hater, me pasë kend në hater, m'u joshë me kendin*. 2. *m'u përhoshë, me pasë simpati*. F.'80, **përhosh** – *përkëdhel, ledhatoj; e marr dikë me të mirë* (F.'80, f.1439).
- përpalnë-a** (f.313) - *përpajnë-a*. F.'80, **përpajnë-a** – *degë e hollë hardhie, që futet në tokë për të lëshuar rrënjë dhe pastaj pritët për ta mbjellë në një vend tjetër, llashkë, shermend* (F.'80, f.1454).
- përvashë-a** (f.315)- *bimë; përvashë e egër, kur krehej grûni së fshûmit e kanë pasë vû në maje të grumbullit të grûnit të fshim; përvashëzë, përvashën*. F.'80, **përvashë-a** - *përvashëz* (F.'80, f.1470).
- perrick-u** (f.317)- *qesat-i*. F.'80, **perrick-u** - *pakicë; zgrip* (F.'80, f.1405).
- piejshëm (i,e)**, (f.320)- *uj' i piejshëm, uj piejs*. F.'80, **pijshëm (i) –me (e)** – *që është i mirë për t'u pirë; që mund të pihet, që nuk të dëmton shëndetin po ta pish (për ujin)*. (F.'80, f.1478).
- pikatë** (f.320) – *m'u da në shenj*. F.'80, **pikat (pikas)** – 1. *stërpik*. 2. *të rrok, të prek pak* (F.'80, f.1479).
- piliherdhe-ja** (f.322) – *grue e hajthëme, e keqe, qyqe*. F.'80, **piliherdhe** – 1. *që dridhet e përdridhet kur flet, kur ecëne etj., nazemadhe; e lëvizur, bishtdredhur*. 2. *përd.sipas kuptimit të mbiemrit* (F.'80, f.1484).
- resk-u** (f.345) – *huj*. F.'80, **resk-u**- 1. *lesh deleje i gjatë dhe i ashpër*. 2. *sipas kuptimit të emrit, lesh resk* (F.'80, f.1648).
- rogë-a** (f.346) – *vend, log ndër bjeshkë i pa lisa, por me bar*. F.'80, **rogë-a** – 1. *lëndinë me bar në mes të pyllit, lirishtë; vend i zhveshur në mes të pyllit; lëndinë me bar në një faqe mali*. 2. *pjesë e zhveshur ose e rrjepur; pullë; larë; në rogë të ballit, në mes të ballit, në lule të ballit* (F.'80, f.1669).
- rogjâ-ni** (f.346) – *degë lumi, kur uji dahet shumë krahësh para se m'u derdhë*. F.'80, **rogja-ni** – *degë e një lumi, që ndahet në shumë krahë, para se të derdhët në det* (F.'80, f.1669).
- rye** (f.347) – *me pësue, hjekë keq, vuejtë*. F.'80, **rys** – 1. *e stërvit dikë, e bëj të regjur, e kalit*. 2. *i mbush mendjen, e bind* (F.'80, f.1674).
- ryzue** (f.348) – *m'u dale për petkavet, m'u vjetruet petkat*. F.'80, **ryzoj** – *vjetroj, bëj që t'i dalin fÿjet (për rrobat)* (F.'80, f.1674).
- shbordue** (f.388) – *birue, me përshkue me vegël prese*. F.'80, **zhbordo** – *e bëj vrima -vrima; e gris* (F.'80, f.2259).

Siç shihet, numri i fjalëve të vjela nga Gazulli dhe të pasqyruara në Fjalorin normativ të gjuhës shqipe (1980), është numerikisht më i madh; çka do të thotë se natyrshëm ai është më gjithëpërfshirës, megjithëse nuk mund të quhet *thesarius* i gjuhës sonë. Së dyti, duhet shënuar se ky fjalor me mbi 40 mijë fjalë përmban edhe kuptime – shtesë në krahasim me fjalorin e Gazullit.

e) Fjalë që janë përfshirë në të dy fjalorët (1954,1980)

Në Fjalorin e Gazullit ka fjalë që janë përfshirë në të dy fjalorët normativë të shqipes, gjë që do të thotë se fjalësi dialektor krahinor i gegërishtes veriore ka shërbyer për pasurimin e gjuhës dhe larmishmërinë e saj përmes nuancave e ngjytimeve leksikore. Duhet theksuar se Fjalori i Gazullit u hartua në kohën kur nuk kishim të bënim me një fjalor të mirëfilltë, normativ, të gjuhës shqipe.

Po i vërejmë me radhë si më poshtë disa prej tyre:

- abe-ja** (f.43) – 1. *je bâ si abe: je bâ si hije*. 2. *mënyrë e zgjedhun, të prûm e zgjedhun*. F.'54 e jep me kuptimin e parë të Gazullit, **abe-ja**- *hie a fantazmë* (F.'54, f.1). F.'80, **abe-ja** – 1. *hije, fantazmë*. 2. *hijeshi* (F.'80, f.2).
- acar-e** (f.43) – *grue acare= e dliirët,veshëacare; mot acar = i ftofët*. F.'54 jep të dy kuptimet e Gazullit, **acar** – 1. *i ashpër, i vrazhdë*. 2. *i kthjelltë, i pastër* (F.'54, f.1). F.'80, **acar-e** – 1. *i acartë*. 2. *shumë i pastër e i kulluar, shumë i kthjelltë*. 3. *shumë i pastër e i rregullt në veshje, që mbahet akull; që mban pastërti e rregull*. 4. *i mprehtë, i shkathët* (F.'80, f.3).
- aft-i** (f.43) – *ajri, tafti*. F.'54 përdor formën, **taft-i** – *erë e keqe, e qelbët që të bie menjëherë në hundë; afshi* (F.'54, f.553). F.'80, **taft-i** – 1. *erë e qelbur që vjen menjëherë e të shpon hundën, kundërmim i keq, erë e rëndë*. 2. *afshi i zjarrit ose i diçkaje tjetër të ngrohtë; afsh i ftohtë; valë ajri, avulli, tymi etj.*. 3. *froni mbretëror; shkallë e lartë në qeveri, në një punë etj* (F.'80, f.1962).
- aht-i** (f.44) – 1. *e fshâme*. 2. *tepricë e kusure mëkatesh*. E ndeshim në F.'54 me dy kuptimet, **aht-i**- *psherëtimë; nemë* (F.'54, f.4). F.'80, **aht-i** -1.*psherëtimë, rënkim i thellë; nemë që del nga dhembja shpirtërore, ahu*. 2. *grahma e fundit para vdekjes* (F.'80, f.14).
- aliver-i** (f.44) – *zgrofi i shtasvet përtypse*. F.'54, **aliver-i** – *i dyti nga të katër lukthet e përtypësve që e ka sipërfaqen hoje-hoje* (F.'54, f.7). F.'80, **aliver-i** – *pjesa e dytë e stomakut të kafshëve ripërtypëse, që e ka faqen e brendshme hoje-hoje; nanuq* (F.'80, f.24).
- amulli-ja**(f.45) – *uj i thellë amull*. F.'54 e përdor si mbiemër **amull-** *i ndenjur (thuhet vetëm për ujë) dhe si emër*, (F.'54, f.9). F.'80, **amull-lli** – *pellg i mbushur me ujë të ndenjur, që vjen nga një burim* (F.'80, f.30).
- ânas-i** (f.45) – *banuer autokton*. 2. *fiset e gjetuna në vend prej ardhacakësh*. F.'54 e ka me të njëjtin kuptim, **anas-i** – *banori i parë i një vendi, quhen fiset e vjetra që gjen ardhacaku kur ngul në një vend* (F.'54, f.10). F.'80, **anas-i** – *banor i hershëm i një krahine a i një vendi, kundrejt të ardhurve më vonë, vendës, rrënjës* (F.'80, f.32).
- arrnjet-i** (f.49) – *arraz-i; pyll arrash*. F.'54, **arrnjet-i** – *pyll me arra; arrëz* (F.'54, f. 18). F.'80, **arrnjet-i**- *arrishtë* (F.'80, f.59).
- avër-a** (f.51) – 1. *avër pëlhure: vel-i*. 2. *avër akulli, rrasa akulli qi barin ujnât*. E ndeshim në F.'54, **avër - avra** - *rrasë akulli që rri përmbi ujë* (F.'54, f.22). F.'80, **avër-ra** – 1. *ajër i ngrohtë ose erë e ngrohtë që të zë frymën; zagushi*. 2. *afsh i nxehtë, afsh zjarri; vapë*. 3. *erë e hollë dhe e ftohtë, thëllim, acar*. 4. *akullishtë; rrasë akulli që rri mbi ujë* (F.'80, f.76).
- bac-i** (f.51) – 1. *babë*. 2.*vllau i madh*. 3. *ëmën i dhânun pleqvet në shêj nderimi e dashunije*. E ndeshim me të njëjtin kuptim tek F.'54, **bacë-a** – 1. *vëllai i madh*. 2. *ungji, xhaxhai*. 3. *emër që i jepet një shoku, ose një plaku për nderim* (F.'54, f.24). F.'80, **bacë-a** – *emër, me të cilin në disa krahina të Shqipërisë Veriore*

vëllai i vogël thërret vëllanë e madh ose fëmijët thërresin babanë a xhaxhanë; përdoret me nderim përpara emrit të babait, të vëllait të madh ose të një njeriu më të moshuar (F.'80, f.82).

barcë-a (f.56) – *lope, dhi, delme barcë, a barca:bartë, barcue, m'u bâ e me mbetë me barrë*. F.'54 e përdor në një trajtë tjetër, **barrse** - *thuhet për një shtazë që është me barrë* (F.'54, f.30). F.'80, **barrsë-** *që është me barrë (kryesisht për kafshët)* (F.'80, f.108).

bigë-a (f.61) – *bligë, blikë, blickë*. 1. *dru a send tjetër qi në mâje dahet dy rrëmash*. 2. *dheshkrojë: mal qi dahet dysh në të trajtuem*. E ndeshim me dy kuptime edhe tek F.'54, **bigë-a** – 1. *dru a send tjetër që ndahet te maja me dy degë*. 2. *mal me dy maja:biga e Shalës* (F.'54, f.37). F.'80, **bigë-a** – 1. *dru, degë a një send tjetër, që mbaron në një rën anë me një degëzim më dysh; vendi i degëzimit; secila nga a nët e degëzimit*. 2. *shkop i gjatë, që ndahet më dysh në një anë dhe që përdoret për punë të ndryshme; furkë, bigaçe*. 3. *mashë; darë prej druri*. 4. *tufë me lule në majë të një shkopi të vogël pak të çarë më dysh; tufë prej dy-tri sendesh të lidhura bashkë*. 5. *shkëmb me majë; vendi midis dy shkëmbinjve me majë; mal me dy maja*. 6. *vinç madh me dy krahë*. 7. *përd. ndajf. çift e drejt përpjetë* (F.'80, f.143).

bigëzim-i (f.62) – *trajtë e bigëzueme, të bigëzuem*. F.'54, **bigëzim-i** – *ndarje në formë të bigës* (F.'54, f.37). F.'80, **bigëzim-i**- 1. *veprimi sipas kuptimeve të foljeve bigëzoi, bigëzohet*. 2. *vendi ku ndahet më dysh një dru, një rrugë, një lumë ose diçka tjetër* (F.'80, f.143).

bigëzue (f.62) – *me bâ a me u bâ në trajtë bigëze*. F.'54, **bigëzoi** - *e ndaj më dysh në formë të bigës* (F.'54, f.37). F.'80, **bigëzoi** – *ndaj më dysh si bigë majën e një sendi a diçka tjetër* (F.'80, f.143).

bijue (f.62) – *me lindë, me qitë fëmijë në dritë*. F.'54, **bijoi**- *bëj fëmijë* (F.'54, f.37). F.'80, **bijoi** – *bëj fëmijë* (F.'80, f.144).

bilashnjok-u (f.62) – *pilashnjoku*. 1. *shka qet lisi në prendverë, mbassi t'i prehet trupi*. 2. *vishk-u: lis i ri*. F.'54, **bilashnjok-u** – *filizi që lëshon në prendverë trunqun i lisit të prerë* (F.'54, f.37). F.'80, **bilashnjok-u** – *bisk që lëshon trunqun i një lisi të prerë* (F.'80, f.144).

bjeshki-ja (f.64)- *zënja me gatue bylmetin*. F.'54, **bjeshki-ja**-*mjeshtëria e gatitjes së bulmetit* (F.'54, f.40). F.'80, **bjeshki-a** – *mjeshtëria e përpunimit të qumështit në stanet verore* (F.'80, f.155).

blojë-a (f.65) – *drithi i bluem; bloja e miellit*. F.'54, **blojë-a** – *veprimi i të bluarit; sasia e miellit të bluar me një të vajtur në mulli* (F.'54, f.41). F.'80, **blojë-a** – 1. *kthimi i kokrrave të drithit, të kafesë etj. në miell ose në pluhur, duke i bluar në mulli; bluarje*. 2. *gjithë mielli i bluar njëherësh në mulli*. 3. *pluhuri që del nga sharrimi i diçkaje* (F.'80, f.157).

blozë-a(f.65) – *thirr-i, çagjë-a, lbozë-a, pështym-i*. F.'54, **blozë-a** – *lënda e zezë që mbetet n'oxhak nga tymi; çagjë, thir*(F.'54, f.41). F.'80, **blozë-a** – 1. *lëndë e zezë si pluhur, që lë tymi kur kalon nëpër oxhak ose në vende të tjera*. 2. *pluhur i zi, që del nga djegia jo e plotë e disa lëndëve dhe që përdoret në industri*. 3. *sëmundje bimësh, që shkaktohet nga disa kërpudha, prej të cilave pjesët e prekura mbushen me pluhur të zi; tymth*. (F.'80, f.157).

blysh-i (f.65) – *peshk me turi si krapime njeje të bardheme, rritet një okë*. F.'54, *mlysh-i* – *peshk grabitqar i ujërave të ëmbla, me turi si sqep; mishin s'e ka të mirë* (F.'54, f.319). F.'80, **mlysh-i** – 1. *peshk grabitqar i ujërave të ëmbla, me trup gjatosh dhe me turi të mprehtë e petashuq, që nuk e ka mishin të shijshëm*. 2. *njeri i trashë nga mendja; budalla* (F.'80, f.1158). Këtu kemi

kalimin e grupit të bashkëtingëlloreve, më saktë asimilimin *mb:m:b*, dukuri e së folmes së Malësisë së Madhe.

- bobe-ja** (f.65) – *kalibobë, galibobë, kokrrat qi bân fojleta a caraci*. E ndeshim në F.'54, **kalibobë-a-** *carac;kokrra e caracit* (F.'54, f.193). F.'80, **kalibobë-a** – *vidhëz* (F.'80, f.765).
- bobël-a** (f.65) – *kokërr kështëje e paqirume*. F.'54, **bobël-bobla-** *një farë kërmilli që del në prëndverë në kohë të laghtë e të ngrohët* (F.'54, f.41). F.'80, **bobël-la** – 1. *lloj kërmilli që del në pranverë, zakonisht pas shiut*. 2. *vegël frymore prej briri të gjethit ose prej një guaske të madhe të detit, që përdoret zakonisht për të dhënë një sinjal* (F.'80, f.159).
- bokërr-a** (f.66) – *mî fushe në njeje të ndryshkut, rrënon bimët e biron bagtin, sidomos n'eshke e në të leth*. F.'54, **bokërr-bokrra** – *mi fushe* (F.'54, f.42). F.'80, **bokërr-rra-** *mi fushe në ngjyrë të ndryshkut, që dëmton bimët* (F.'80, f.162).
- borde-ja** (f.67) – *birë çfarëdo*. F.'54, **borde-bordja** – *një vrimë e hapur në mur; vrimë përgjithësisht*. (F.'54, f.43). F.'80, **borde-ja** – *e çarë në mur a në vende të tjera, çepojë* (F.'80, f.164).
- brâjë** (f.67) – 1. *mullâ i kuq a i irun qi del ndërshej gishtash*. 2. *sh. bashk, f.49 shëji si mullâ qi lën të ziemit në landë të preme, e n'asht të thyem qi njiten*. F.'54, **brajë-a** – *bullungë që del në bimë, ose n'eshtrat e njeriut, kur këto lëndohen* (F.'54, f.44). F.'80, **brajë-a** – *xhungë që del në dru ose në trup të njeriut pas një goditjeje* (F.'80, f.170).
- bravë-a** (f.67) – *vi uji, vadë uji, qi çon ujin te tokët, brazdë*. F.'54 nuk e ka në këtë formë, por e takojmë si të tillë, **brazdë-** *sh. brazë-a – vija që hap plori në arë; hulli, zagën* (F.'54, f.45). F.'80, **bravë-a** – 1. *vegël e hekurt që ngulet në dyer, në dollapë, në sirtarë etj. dhe që shërben për t'i mbyllur në çelës*. 2. *shuli i portës* (F.'80, f.171).
- brishtë, i, e** (f.70) – *qi thehet shpejt*. F.'54, **i brishtë** – *që thyhet shpejt* (F.'54, f.47). F.'80, **brishtë (i,e)** – 1. *që thyhet lehtë; që thërmohet shpejt*. 2. *që vjen i dobët e i mekët nga natyra a nga ndonjë sëmundje, i hollë (për njerëz); delikat*. 3. *që është shumë i ndeshëm, që preket shpejt*. 4. *që nuk ka një bazë të shëndoshë, që nuk përlligjet nga vetë jeta, që nuk qendron, i pathemeltë; i kotë* (F.'80, f.181).
- brofë** (f.70) – *m'u ngrehë, çue*. F.'54, e ndeshim si pasthirmë, **brof** – *(tregon të ngriturit përnjëherë në këmbë): në këmbë* (F.'54, f.47). F.'80, **brof** – 1. *ngrihem menjëherë më këmbë, çohem me rrëmbim, hidhem shpejt më këmbë; kërcëj përpjetë*. 2. *turrem drejt diçkaje, hidhem me vrull përpara dhe si ndajfolje brof –1.menjëherë e me vrull, shpejt (kur ngrihem)*. 2. *papritmas,befas, menjëherë*. 3. *ngrihem menjëherë, çohem me vrull e shpejt* (F.'80, f.182).
- brojcë-a** (f.71) – *shpend*. F.'54 e ka me një kuptim tjetër, **brojcë-a** – *enë balte a metali me një vesh, që përdoret për ujë; masë drithi(1/2 kilo)*, (F.'54, f.47). F.'80, **brojcë-a** – 1. *enë balte a metali e vogël, me një vesh, që përdoret zakonisht për ujë*. 2. *masë drithi prej druri, që nxë rreth një gjysmë kilogrami* (F.'80, f.182).
- bulë-a** (f.75)- 1.*idhull-i, put-i*. 2. *bula e gishtit, mâja e përfundme e trashë e gishtit*. 3. *bula e veshit, copa e kercëles së veshit që viret teposhtë, palëca e veshit*. F.'54, **bulë-a** – 1. *sythi që nxjerr pema në prëndverë, nga i cili del pastaj bisku a lulja*. 2. *bula veshit, pjesa e butë në fund të veshit; bula e gishtit, mollëza e gishtit*. 3. *s'kishte një bulë ujë, asnjë pikë* (F.'54, f.50). F.'80, **bulë-a** – 1. *syth*

bimësh, mugull; syth që del te disa qenie, prej të cilit zhvillohet qenia e re. 2. pikë (uji, shiu, djerse, loti etj.).3. flluskë e vogël. 4. pjesë e tultë, e butë dhe e rrumbullakët e ndonjë organi të trupit. 5. lungë e rrumbullakët dhe e fryrë; puçërr e madhe. 6. pjesë e disa frutave, të cilët ndahen në disa copë të veçanta e të shkëputura; thelb (F.'80, f.195).

bung-u (f.75) – 1. *bungë-a. 2. bar kënete, trajton stomije, gjethja e tij pret si ajo e shqirrës. 3. bungvogli, një farë bunge. F.'54, **bung-u** - lloj dushku, 18 gjer më 30 m i lartë, me lëkurë t'errët, me fletë si vezake dhe me lëndë që i grumbullohen nga dy gjer më pesë në një bisht; bungë (F.'54, f.51). F.'80, **bung-u** – lloj dushku tridhjetë-dyzet metra i lartë, me trung të trashë, me kurorë të gjerë e të çrregullt, me lëkurë të murrme e me gjethe vezake, që nxjerr tri deri shtatë lende së bashku në një bisht (F.'80, f.197).*

bûnishtë-a (f.76)- *vend në bjeshkë me bûne. F.'54, **bunishtë-a** – vend në bjeshkë ,me bune (F.'54, f.51). F.'80, **bunishtë-a** – stan në bjeshkë, ku janë ngritur bunet e barinjve gjatë shtegtimit të bagëtisë (F.'80, f.198).*

huri-ja (f.76) – *bulirë, buljerë, bucelë. F.'54, **huri-a** – sasi e madhe,; plotësi, mbushullim, hape, bollëk (F.'54, f.52). F.'80, **huri-a** – sasi e madhe, shumicë, mori, mbushullim (F.'80, f.199).*

burras (f.76) – *si burrë, si burrat. F.'54, **burras** - si burrat, burrërisht (F.'54, f.52). F.'80, **burras** – burrërisht; si burrat (F.'80, f.201).*

bushtër-a (f.77) – 1. *shakë-a. kulshedër-a. 2. vegël mekanike me shtërngue rrathë, tajë etj; menjene, mejendër-a. E ndeshim me një kuptim në F.'54, **bushtër-bushtra** – femra e qenit; buçe, shake, gore, kuçkë; grua e keqe nga morali, grua e ligë. (F.'54, f.52). F.'80, **bushtër-a** – 1. femra e qenit, buçe, shake. 2. grua që s'ban qëndrim të mirë moral, grua e ligë, e përdalë, bishtundur; grua llafazane e ngatërrestare. 3. qenie e përfytyruar si kuçedër, që, sipas besimeve të kota, villte zjarr e rrufe. 4. dosëz-a (F.'80, f.203).*

cabòk-u (f.79) – *stom-i, nalcinë e vogël. F.'54, **cabok-u** - kërcu. (F.'54, f.54). F.'80, **cabok-u** – 1. stom 2. copë dheu a guri, plis a popël; copë druri, kërcu i vogël (F.'80, f.211).*

capë-a (f.80) - *dhe a shtrat dheu i forcuem prej motesh si çemento, i gurzuem, peqinë (slav), harasan (turq). F.'54, **capë-a** - vegël bujqësore për të prashitur; në njerën anë është shat i vogël dhe në tjetrën si dikel. (F.'54, f.55). F.'80, **capë-a** – shtresë e fortë e tokës nën shtresën e butë që punohet; taban (F.'80, f.213).*

crogët (f.85) - *mal i crogët:mal pa lisni; kryecërrogët-i-a. F.'54, **crogët (ie)** - mal i xhveshur; thuhet edhe për një njeri,të cilit i kanë rënë flokët.(F.'54, f.59). F.'80, **crogët (i,e)** – 1. që është i zhveshur nga drurët, i rrejpur. 2. që i kanë rënë qimet ose flokët (F.'80, f.232).*

cûng-e (f.87) - *sakat në misa të trupit. F.'54 **cung-e** - me një gjymtyrë të prerë pjesërisht ose farë;shyt cungull. (F.'54, f.60). F.'80, **cung-e** – 1. që ka një gjymtyrë të prerë, i gjymtuar (për njerëzit). 2. që ka bishtin, brirët ose krahët të prerë (për kafshët e shpendët) (F.'80, f.233).*

cung-u (f.87) - 1. *cung lisi. 2. cungu i trupit të njerit. F.'54 **cung-u** - 1. pjesa e trungut të drurit që mbetet në dhe si të jetë prerë druri , kërcu, kërcëp, kucër; cung hardhie, hardhi:cungë. 2. gjeom.cungu i konit, cungu i piramidës pjesa e atyre që shkon nga baza e gjer atje ku priten nga një plan që është paralel me bazën. (F.'54,f.60). F.'80, **cung-u** – 1. pjesa e trungut a e kërcellit, që mbetet në tokë kur presim një dru a një bimë me kërcell të trashë; kërcu, kërcëp. 2. trupi i hardhisë pa lastarët e degët e reja; rrënjë hardhije. 3. pjesa e një*

- gjymtyre të prerë, që mbetet në trup. 4. trungu i një trupi gjeometrik (F.'80, f.233).*
- cupil-i** (f.87) - *cungal-i, cungal-i; copa binarësh qi mbështeten në trenë e ndeshen në gërshanëza të ndërtesës, qi i mbajnë mos me bâ bark. F.'54, e jep me një kuptim tjetër, cupil-i – një fill ujë që del çurg; i shkoi gjaku cupil (F.'54, f.60). F.'80, cupil –i – 1. shih cungal-i. 2. purtekë, thupër. 3. tra i shkurtër, që përdoret për mbështetje dhe për përforcim në tavanin e galerisë së minierës (F.'80, f.234).*
- qekth-i** (f.90)-1. *dhe qi bjen me shi prej së nalti. 2. vesë e âmbël. F.'54, qekth-i - 1. shi me dhe. 2. vesë e ëmbël.pluhur si miell që bie mbi fletët e pemëve. (F.'54, f.444). F.'80, qekth-i -1. shi me pika të turbullta, që bie zakonisht kur ka shtrëngata me erë e me pluhur. 2. pluhur i hollë që bie bashkë me vesën mbi fletët e pemëve; vesë e ëmbël (F.'80, f. 1591).*
- qelbak-e** (f.90) - *qi përfton qelbësinë. F.'54, qelbaç-e –qelbanik, qelbash.(F.'54, f.445). F.'80, qelbac-e – 1. që është i ndyrë sa të ngjall neveri, qelbanik. 2. fig. shih qelbanik-e. 3. përd. em. sipas kuptimeve të të mbiemrit (F.'80, f.1592).*
- qelbëz-a**(f.90) - *nji farë shkjarri qi ka në të ndëjun nji zhangël me nji lîng të qelbët, i gjatë nj'a 56 qindsha metri, përfundi i zeshkët, shpinet mâ i kjartë, është damtuer, por edhe mijtë i përpîn. Me e kapë në dorë lëshon langun e qelbët me i dalë zot vedit. F.'54, qelbëz-i - 1. zool.(mustela putorius)sisor nga familja e Bukiavet, i madh sa një shqarth;lëshon erë të keqe;bot.rrunja.(F.'54, f.445). F.'80, qelbës-i – 1. gjitar i egër sa një shqarth, me hundë të ngritur, me lëkurë në ngjyrë të çelur në pjesën e sipërme dhe të errët poshtë, që ha minj, pula etj. dhe që lëshon një erë të keqe për t'u mbrojtur nga egërsirat e tjera. 2. shkurre me degë të holla, me gjethe heshtake, që mbajnë erë të rëndë dhe me lule të verdha, që bëjnë bishtaja; karthë e egër, rrunjë (F.'80, f.1592).*
- qêmër-a** (f.90) - 1. *gjarpnim-i, të sjellunat qi bân gjarpni tue u hjekë rrëshqanë. 2. shtrëmbënim-i, shtrëmbë-a. F.'54, qemër-qemra - qemra dredhat që ban gjarpri,ku hiqet rrëshqanë. (F.'54, f.445). F.'80, qemër-ra – dredhë që bën gjarpri kur hiqet rrëshqanë, gjarpërim (F.'80, f.1594).*
- qiellëz-a** (f.93) - *qjellëzë, qellëzë 1. qiellëza e gojës. 2. qiellëza e derës, e furrës. 3. qiellëza e qerrit, e odës. F.'54, qiellëz-a - 1.anat.pjesa e sipërme e gojës nga përbrenda. 2. qiellëza e derës,-qiellëza e furrës,kubeja e derës, e furrës. (F.'54, f.449). F.'80, qiellzë-a – 1. pjesa e sipërme e gojës nga përbrenda, që vjen si kube. 2. pjesa e sipërme e furrës ose e derës që ka trajtën e një kubeje (F.'80, f.1610).*
- gjye** (f.169) – *me njeje. F.'54, ngjyey - 1. fut gishtin a kafshatën brenda në një lëng a në ndonjë gjë tjetër. 2. i jap ngjyrë (F.'54, f.350). F.'80, ngjyey – 1. zhyt diçka në një lëng për ta njomur; zhyt bukën në një gjellë. 2. i jap një ngjyrë tjetër nga ajo që kishte më parë, duke e zhytur në një lëng; i jap një ngjyrë të caktuar. 3. arrij të bëj a të shtie në dorë diçka; më ecën, më shkon (F.80, f.1264). Këtu kemi gruin e bashkëtingëlloreve ngj, i cili asimilohet në nj, në shumicën e rasteve, tek të folmet e gegërishtes veriperëndimore: ngjyey: njejey, ngjalë : njalë etj.*
- hakrri-ja** (f.169) – 1. *ethet qi kapin dosat para se të mbarsen. 2. përdorimi i sendeve gjinijore. F.'54, hakrri-a – epshi, zjarmia që i hypën derrit dhe dosës në kohën e ndërimit (F.'54, f.161). F.'80, hakërri-a- 1. hakërrimë. 2. afshi i dosës dhe i hakoçit në kohën e ndërimit (F.'80, f.642).*
- hakrrue** (f.170) - *m'u barcue. F.'80 hakërrohem – 1. i bërtas fort e em të egër dikujt; e shaj a e qortoj dikë me zë të lartë e me kërcënim, i kanosem dikujt, i*

- gërmushem dhe e tremb; egërsohem shumë. 2. ngrefosem, krekosem. 3. ndërzehet, merr hakoç (për dosën) (F.'80, f.642).*
- halth-i** (f.170) – *hajzë-it, krecë-a. F.'54, **halth-i**- fletët e holla si hale që ka pisha, bredhi (F.'54, f.162). F.'80, **halth-i** – 1. gjethe e hollë dhe e gjatë si gjilpërë që ka pisha, bredhi etj., gjethe halorësh. 2. halmucë, bar breshke (F.'80, f.643).*
- humbellë-a** (f.178) – 1. *gropë e madhe e çelme në dhe prej natyre. 2. haus-i. F.'54, **humbellë-a** – gropë e madhe e hapur në dhe vetiu (F.'54, f.175).F.'80, **humbellë-a** – gropë e madhe dhe e thellë që bëhet nga fundosja e tokës; shembëtirë (F.'80, f.695).*
- hutue** (f.179) – *me gabue. F.'54, **hutoj**- i marr mendjen me fjalë, e shastis, e habis; gaboj, bie në gabim (F.'54, f.176). F.'80, **hutoj** - 1. e bëj dike të mos përqëndrohet në diçka, ia turbulloj mendjen, ia marr mendtë; e trullos. 2. e habit shumë, e shastis. 3. lajthit, gaboj (F.'80, f.704).*
- lëmesë-a** (f.234) – *mos m'u prishë në pleqni, por as m'u ndreqë krejt. F.'54, **lëmesë-a** – shkazmë bore (F.'54, f.267). F.'80, 1. vend i lagët, me baltë ose me borë, ku të rrëshqasin këmbët; rrëshqitë, shkazmë. 2. cipë shumë e hollë dhe e tejdukshme ndërmjet lëvoreve të disa bimëve e perimeve; cipë e hollë e diçkaje; guaskë (F.'80, f.977).*
- lenue** (f.234) – 1. *lehtësue, lecue. 2. ngushëllue. 3. m'e mekë, pakë. F.'54, **lenoj**-liroj,lehtësoj (për sëmundje) 1. letohem. 2. bëhem matuf, meshnohem. (F.'54, f.264). F.'80, **lenoj** – 1. lehtësoj . 2. pakësoj (F.'80, f.964).*
- lerth-i** (f.234) – 1. *bimë, purrë i egër me njatë erë si i buti, por mâ djegës, del bjeshkëvet, barijt e kërkojnë m'e hangër. 2. urth-i. F.'54,**lerth-i** - urth, shermashek (F.'54, f.265). F.'80, **lerth-i** – 1. urth. 2. hurdhër e egër (F.'80, f.965).*
- leshtë-i,-ë-a** (f.234) - *njeri i leshtë, i pasherr, por i trashë ndër mend. F.'54, **leshtë (i,e)** – 1. prej leshi. 2. prej delje. 3. fig. i drejtë, i mirë, i patëkeq; leshko, sylesh (F.'54, f.265). F.'80, **leshtë (i,e)** – 1. që është bërë me lesh, që është prej leshi; që është punuar me fije a me stof leshi. 2. që ka të bëjë me delen, i deles; që merret nga delja, që del nga delja; që është bërë me qumësht deleje. 3. që ka shumë lesh, që është mbuluar plot me qime, leshtor. 4. që është në gjendje të mirë, i pasur. 5. që është i urtë, i qetë, i matur e i drejtë; që është i njerëzishëm e i butë dhe nuk i bie më qafë njeriu, që nuk ndihet; i patëkeq; baballëk. 6. që nuk ka zgjuarsi, që nuk kupton shumë; leshko, sylesh (F.'80, f.968).*
- Ivorue** (f.243) – 1. *me hjekë lvoren, me qërue. 2. m'u lodhë fort, llomitë. F.'54, **lëvoroj** – lëvorzoj – i heq lëvoren; qëroj, ceflis, xhvesh, lëvoroj; lëvorzohem; fig. këputem nga puna e tepër (F.'54, f.269). F.'80, **lëvoroj** – 1. i heq lëkurën diçe, i qëroj lëvoren; zhvesh. 2. e lodh shumë në punë dikë; e mendoj shumë, e rraskapit (F.'80, f.989).*
- llâ** (f.244) - *fraz. lopa llân viçin, e viçi e dërgon lopën (thithë, ndërgon), asht llâ toka me shi, shiu ka llâ token. F.'54, **llâj** – fâj barkun, ngop; i jap gji fëmijës; lopa llan viçin, i jep qumësht; shiu ka llâ token, e ngopi dhenë (F.'54, f.282). F.'80, **llaj** – e ngop mirë sa s'do më; i jap gji fëmijës sa e ngop mirë (F.'80, f.1034).*
- llacaman-e** (f.243) – 1. *kingj, edh, viç qi ndërgon deri vonë. 2. njeri i mësuem me haena të mira. F.'54, **llacaman-e** – për qingj, kec a viç që pi deri vonë. 2. njeri i mësuar me gjellë të mira. (F.54, f.282). F.'80, **llacaman-e** – 1. që pi për një kohë të gjatë tek e ëma, që pi deri vonë (për kafshët). 2. që është mësuar të*

hajë gjëra të mira, që i pëlqen të hajë gjellë të shijshme e sidomos ëmbëlsira (për njerëzit). 3. përd. em. sipas kuptimeve të mbiemrit (F.'80, f.1033).

miellishtë-a (f.263) – *sende të miellta, miellajë. F.'54, miellishtë-a – gjëra prej mielli (F.'54, f.313). F.'80, miellishtë-a – gatesa e ushqime prej mielli (F.'80, f.1135).*

miklue (f.264) – 1. *maklue, mahlue, gdhelë, kthelë. 2. me mârrë mendësh. F.'54, mikloj –përkëdhel, lëmoj, marr me të mirë; lajkatoj, përkëdhel me prapamendim (F.'54, f.313). F.'80, mikloj – 1. përkëdhel dikë me dashuri, duke e lëmuar a duke i shkuar dorën mbi kokë, mbi supe etj., ledhatoj. 2. e marr me të mirë dikë, ia prish mendjen duke e përkëdhelur me fjalë të bukura etë ëmblla, e lajkatoj; e josh dhe e mashtroj me përkëdhelje . 3. më tërheq, më josh (F.'80, f.1136).*

ndëjshëm (f.281) – *ndëjshim, tëjçë; me pasë ngae, me kënë pa pûnë. F.'54, ndejshëm – shtruar, ngadalë (F.'54, f.334). F.'80, ndejshëm – ngadalë e pa u nxituar; shtruar; qetë-qetë (F.'80, f.1203).*

ndërdÿ (f.282) - *me ngurrue, me mbetë ndërdyzash, mos me dijtë m'e da njënen dysh. F.'54, ndërdyj – dyshoj, mbetem ndërdyzash, ; ngurroj (F.'54, f.330). F.'80, ndërdyj – jam në dyshim për diçka; jam ndërdyshas, dyshoj (F.'80, f.1207).*

ndërlymna-t (f.283) – *ndërlumna-t, fjalë dheshkroje. F.'54, ndërlumna-t – vendi që shtrihet në mes dy lumenjve. (F.'54, f.336). F.'80, ndërlumna-t – vendi që shtrihet ndërmjet dy lumenjve (F.'80, f.1210).*

Nga paraqitja e shkurtër më sipër, del që hartuesit e Fjalorit të shqipes të vitit 1980, kanë përfshirë një numër jo të vogël lemas, vjelë prej Fjalorit të Gazullit. Për këtë mendojmë se është gjykuar i drejtë përdorimi aktiv i tyre në variantin e shkruar e të folur të Veriut, pasi shumë e shumë fjalë gjenden në gjuhën e autorëve të kohës, si, te Migjeni, Koliqi, Fishta e Mjeda etj.

Fjalori i Gazullit, pasqyrimi i leksikut në Fjalorët normativë të shqipes (1954,1980).

1. Fjalë që nuk janë përfshirë në Fjalorët (1954,1980)
2. Fjalë me kuptim të ndryshëm
3. Fjalë me kuptime shtesë
4. Fjalë që janë përfshirë vetëm në Fjalorin e 1954
5. Fjalë që janë përfshirë vetëm në Fjalorin e 1980
6. Fjalë që janë përfshirë në Fjalorët normativë (1954,1980)




Fig. 2

1.3. Fjalori i Benedikt Demës

a) Fjalë që nuk janë përfshirë në Fjalorët (1954, 1980)

- açugë-a** (f.11) - *peshk i vogel detar.*
adhëzë-a (f.11) - *veme, vemizë, vemsë kandrrash, krymb i vogël.*
afertinë-a (f.11) - *vendi për rreth, afersi.*
afiqe-ja (f.11) - *nam i keq.*
ajam-i (f.11) - *dishir, prirje, kohë e pershtatun.*
ajan-i (f.11) - *oxhak.*
ajim-i (f.11) - *t'ajun.*
ajktisë (f.12) - *ajkue, ba me ajkë.*
ajli! (f.12) - *ah! mjerim.*
ajrom-i (f.12) - *shumë, xhem, avrom.*
ajrperdimje-a (f.12) - *aerofagji.*
aksem(i) (f.12) - *guximtar.*
aksue-oni (f.12) - *bosht, timue qerrje.*
aktue (f.12) - *dendë, rrasë, kondensue.*
aktund-i (f.12) - *rend, kura.*
akulltar (f.12) - *njeri që gjykon e flet me gjak të ftoftë, me mendë të kthiellt.*
alogjë-a (f.12) - *vend shesh, patalok.*
alla! (f.12) - *hajt! braf!*
allçënik-u (f.12) - *realgar (mineral me njeje të kuqe si rubini, me lidhje të arsenit me surfull).*
allmesë-a (f.12) - *infuzion, dikim.*
allore-ja (f.12) - *soj peshku detar.*
amitë (f.12) - *pajtue femijën.*
amshtë (f.12) - *amtë.*
amshtik (f.12) - *i amshtë, me shije myku.*
anëperanë (f.13) - *gjithkah anemanë.*
angarisë (f.13) - *bisedue, ça kopalla, folë me kend.*
ange-ja (f.13) - *unt, ije, të holla (pjesa e butë e trupit të frymorëve mes koshës e brirëve).*
angel (f.13) - *shtang, koçâ.*
anglisht (f.13) - *gabim, skalapurri.*
baballok-u (f.17) - *shtyllë e shkurtë që vihet pingul mes trahut e mahive.*
babarrun-e (f.17) - *i fortë, i fuqishëm, trimaloç.*
babolitë (f.17) - *folë teper fjalë kote, krapullitë.*
babuin-i (f.17) - *soj majmuni me fëtyrë me gjasim të qenit.*
bacan-i (f.17) - *dash me tru të bardhëmtë e të lkuqem.*
bagerda-ni (f.17) - *pulender, kaçimak .*
bakal-i (f.18) - *enë nate, urinar.*
balkue (f.18) - *bredhë, këcye, kapercye .*
bale-ja (f.18) - *zagare.*

bale-ja (f.18) - *zagare.*
bashqel (f.21) - *rrokopujë, pa rregull.*

cabak (f.33) – cubel.
cadyll-i (f.33) - *strajsë,ku qiten fashojt mbasi t'u hiqet mjalta, per me xjerrë dyllin (tue e shtrydhë).*
cahë (f.33) - *pague (paret).*
cakel-kla (f.33) - *grumbull a kapë e vogel kallamoqi,gruni etj.*
caker(i) (f.33) - *i kulluet, i kthiellt.*
caklue (f.33) - *me mihë me capë.*
caktar (f.33) - *kush rrin në cak,ruen cakun.*
çaper-pra (f.39) - *rreshiq dhie.*
çaperkosë-a (f.39) – *bretkosë.*
çapëbardhë-a (f.39) – *gatë.*
çapi-ni(f.39) –*zhapi.*
çapkore-ja(f.39) – *skjeplugë.*
çapod-i (f.39) - *cilë 2 orë para mjesdite.*
çaprazë-a (f.39) - *soj gjelle.*
çaprrukal (f.39) - *me trup të vogel e mënyre komike.*
çubuk-u (f.41) - *llullë duhani.*
çudnar(f.41) - *kush flet çudni(fjalë t'ulta).*
çudni-a (f.41) - *fjalë e ultë.*
çufeleçike-ja (f.41) - *leçikë krele.*
çuherdhe-ja (f.41) – *çerdhe.*
çukulinë-a(f.42) - *zhele, strangel.*
çukurinë-a (f.42) - *çukulinë, gja e parandsi, zhele petk i vjetruem.*
çulrue (f.42) - *me u habit si i marrë.*
dulkue (f.50) - *shpla,hapë,bymye.*
dulli-a(f.50) – *Fj.dellidh.*
dulliqezë-a (f.50) - *ndryshim i dullisë së zezë.*
dulltak-u (f.50) –*granit.*
dumak-u (f.50) – *tra.*
dumash-i(f.50) - *stofe 4 liqësh.*
dumatë (f.50) - *trillue ndonji mendi ,ardhë trillidh.*
dumllue (f.50) - *ushtue,gjimue.*
dunari i veshit (f.50) - *tupani i veshit.*
dung-u (f.50) - *qen cubel.*
dhurmitë (f.53) - *këcye gjaku.*
ecatë (f.54) - *me e ba femijën qi t'ecë; me shndërrue fëmija gjurmët e para.*
eckatë (f.54) – *ecatë.*
edhishti-u (f.54) - *zog thiu,derk.*
eje-a (f.54)- *dele a dhi me shtrri të cofuna.*
elbaroviq-i (f.54) - *bimë lulishtash me gjethe të mermë.*
elpjetë-a (f.54) - *lëpjetë,barë i fam.Elpletore.*
fjakue (f.60) - *fishkullue gjarpni.*
fjalëlashtë (f.60) - *kush flet shum, edhe fjalë të pagjashme.*
fjalëmujshtëm (f.60) - *i shtymë nder fjalë të forta a të randa.*
fjalërryeshem (f.60) - *kush flet me vishtirsi.*
fjat-i (f.60) – *çmim.*
fjerake (f.60) - *firajë, firishte.*
fjere-ja (f.60) - *firë,mullar firi.*
fjerëkuqe-ja (f.60) - *ber.*
fyezë-a (f.60) - *gjeth i gjatë e lugzuem si aj i badres, i purrinit, i qepës etj.*

fygjen-gjna (f.64) – *boshtër*.
fyllc-i (f.64) – *kallam*.
fyllc (f.64) – (*gyp*) *me birë i çilun permrenda*.
fyrfiqe-ja (f.64) - *pushkaliqe,ballotë*.
fytë –a (f.64) – 1. *hojzat e fashojve të mjaltës*. 2. *qelizë, qelzë*.
fyzhnje-a (f.65) – *boshtër*.
gabimsi-a (f.66) - *ligshtia për me gabue*.
gabliqe-ja (f.66) - *çdonjera ndër deget, e nje bige, gagjarra*.
gabzhet (f.66) - *flokerude,flokeperdredhun*.
gacali-a (f.66) - *gace, thengjill i ndezur*.
gacel: (f.66) - *hollak,grap*.
gacke-a (f.66) - *laken e bardhe,grencë*.
gaçem(i) (f.66) - *i gatshëm*.
gafell (f.66) - *golle,tyte*.
gafë-a (f.66) - 1. *ajr, aft i xete që të merr frymen*. 2. *peshk detar i gjinise së serioleve*.
gaforr (f.66) - *çlirueshem:cue si gungë*.
gaft-i (f.66) - *ajr,aft, taft*.
gafur (f.66) - *gafurr*.
gaglice-a (f.66) - *glace*.
gaglicue (f.66) - *glacue*.
germishë (f.69) - *dermishe*.
germuet (f.69) - *i vështirë, i pashteg*.
germzë-a (f.69) - *zhurma që ben mica tue marre fryme ase njeri që ka mushkerite e prishuna*.
gernabut-i (f.69) - *bar erëmirë*.
ostonec-i (f.150) - *thumbi i hekurt në fund të bishtit të mullinit*.
rrabel (f.186) – *rabel*.
rraç-i (f.186) - *soj rreti*.
rraçkë-a (f.186) - *lugë,thikë e pirû*.
rradhe-ja(f.186) – *ushtri*.
rragjue (f.186) - *ryzue,grisë,hanger*.
rrahije-t (f.186) - *toka të çiluna rrah*.
rraj-i (f.186) – *shilë*.
rrajçak-u (f.186) – *dru (cung) me rrajë*.
rrake-ja (f.186) - *çdo enë druni (vozga, sheka, buljera etj.)*.
rran-i (f.186) – *shilë*.
rraputë-a (f.187) - *shputa e kambës së shqarrit*.
rrask-u (f.187) - *orendi shpije*.
rrermue (f.188) - *guzhmue, ngrehë zhag; 2. shnjertzue* .
rrerzde-ja (f.188) - *thark, vathë*.
rrerzgatë-a (f.188) - *vershim, aluvion*.
rrëgjye(f.188) - *shkelzye, shkelqarë*.
rrëkuem-a (f.188) - *bar i trashë*.
rrëmisht (f.188) - *me fuqi, perdhuni*.
rrëmye (f.188) - *gurgullue, rrjedhë*.
rrëmyshtë (i) - *i rrëmyeshëm*.
rrënjoshk (f.188) - *i gjembtë, vangosh*.
rrëshizë-a (f.189) – *rrëshitë*.
rrihun (i) (f.189) - *i pahajr,hashari*.

rrilë-a (f.189) - *thirqe*.
thabertushë-a (f.224) – *mjeder* .
thajç (-e) (f.224) - *brishtë,thaç*.
thajtë (i) (f.224) - *thuprak, i mbaruet*.
thaksë-a (f.224) – *mizë*.
thalbok-u (f.224) - *thalb i madh*.
thaprrim-i(f.224) – *therpim*.
thaqkë-a (f.224) – *mollçë*.
tharbcujë-a (f.224) – *thartore*.
ujtsue (f.227) - *kullue uji prej toke*.
uligjë-a (f.227) - *shkalbalë,shpalcë,rajë*.
vadatar-i (f.229) -*vaditsë,ujitsë*.
vaditshem (i) (f.229) - *i ujitshem*.
vadrosh-i (f.229) – *bistek*.
vagjlue (f.229) - *pajtue,krahishtue,vendue, grazhdue bagtinë*.
vajaçëm(i) (f. 229) - *i kadalshem*.
vrâ-ja (f.234) - *vade,cak,afat*.
vraçue (f.234) - *vra mizorisht,bâ plojë,kerdi*.
vrejshem (i) - *i vemendshem, i gatshem,vigjilent*.
vrell-i (f.234) - *burim,gurrë*.
vrigë-a (f.234) - *rrëfanë,verigë*.
vrujekth-i (f.234) – *ujerk*.
vrrellë-a (f.234) - *gjir uji, vrellë*.
vukamë-a (f.235) - *famë,za i mirë, nam* .
vukuell (me u ba) (f.235) - *me u ba razi*.
vushtik-u (f.235) - *vija pelhure*.
vuzdajë-a (f.235) – *shtajagë*.
xahë-a (f.236) - *dragë, kurtesh, ndjesi therje a te thekuni prej ngacmimit të nervave te likurës*.
xajë-a (f.236) - *Fj. zeje*.
zadef-i (f.238) – *krir*.
zafullue (f.238) - *zgafullur,birue*.
zagaçkë-a (f.238) - *fjalisje,poterë*.
zahollë (f.238) - *me za të hollë,të lehtë,të naltë*.
zajë-a (f.238) - *pluhun eksploziv mjes kapsulit e barotit nder fushekë etj*.
zalishem (i) (f.238) - *i volitshem, i pershtatun*.
zallandisë (f.238) - *me u entuziazmue*.
zallandisë (f.238) - *me u entuziazmue*.
zamê-ja (f.238) – *zabukë*.
zgatë (f.240) - *neperkambë,marrë me të keq*.
zgavlan-i (f.240) - *trunt,oxhak*.
zgerdhucë (f.240) - *shtrembnue sytë*.
zgidhshem (i) - *qi mund te zgidhet,qi mund t'i gjindet fija*.
zglif (f.240) - *zglif, me gloq, i skerloquem*.
zglif (f.240)- *zglif*.
zglupc (f.240) - *perpisë,gopç*.
zgorofetë-a (f.240) – *lejthiç*.

Siç vërehen, janë të shumta fjalët që nuk i ndeshim të përfshira në Fjalorët respektivë 1954,1980. Dema, kryesisht është munduar të na japë leksikun e fjalëve të rralla të malësive të Veriut, ka mbledhur fjalë në zonat më të skajshme e të thella veriore, kështu që edhe fjalësi është mirëfilli krahinor, por që edhe në ligjërimin bisedor të po këtyre trevave zor përdoren aktualisht, sepse, siç e thekson edhe vetë ai, është munduar të pasqyrojë fjalë e lema të cilat nuk janë të përfshira në Fjalorin e 1954, ose që kishin kuptime të ndryshme apo shtesë nga ato të përdorimit të përditshëm.

b) Fjalë me kuptim të ndryshëm

- ajar-i** (f.11) - *kreshnik, fatos*. F.'54, nuk e ka. F.'80, **ajar-i** – 1. *kosh i madh që përdorej për të matur drithin; masë drithërash*. 2. *sasia e pjesëve të një metali të çmuar që gjendet te një mijë pjesë të një përzierjeje me metale të tjera, karat*. 3. *barazi në peshë, baraspeshë, drejtpeshim; përpjestim i barabartë, përputhje e plotë në masë e në kohë* (F.'80, f.15).
- ajue** (f.12) – *ajë*. F.'80, **ajoj-** *lag ose mbush me ujë një vozë a një enë tjetër prej druri*(F.'80, f.16).
- alle-ja** (f.12) – *lulealle*. F.'80, **alle-ja** – 1. *ngjyra e kuqe e ndezur*. 2. *dhi me qime të kuqe të ndezur* (F.'80, f.26).
- amë-a** (f.12) - 1.*nanë*. 2. (*shih Fj. e këtu fj. ama...*). 3. *shije, erim*. F.'80, **amë-a** – 1. *vendi ku nis një rrjedhë uji, burim; shtrati i një rrjedhe uji*. 2. *burim, gurrë*. 3. *bimë ose kafshë mëmë*. 4. *vezore-ja*. 5. *dru i shkurtër, që shërben për të mbajtur a për të shtrënguar*. 6. *pjesa e kreut në një bllok biletash, çeqesh, faturash etj, që ruhet si dëshmi për pjesën e këputur*. 7. *kopje negative prej metali që bëhet për një gdhendje me relief që shërben për të nxjerrë prej saj kopje të tjera; amë-a- shih amëz-a* (F.'80, f.28).
- çapitë** (f.39)- *grimcua me dhambë sallata, lakna etj.; me u ndjekë zogjët*. F.'54, **çapitem** – *nis t'eci (thuhet për foshnjët kur fillojnë të hedhin çapat e para)*, (F.'54, f.62). F.'80, **çapit (çapis)** – 1. *eci me ngadalë ose rëndë, hedh hapat, hedh këmbët; shkoj ngadalë ose me vështirësi, çapitem*. 2. *hap këmbën ngadalë ose me vështirësi për të ecur; çapit (çapis) – shkriçeroj tokën ose thyej plisat me çapë* (F.'80, f.244).
- çull-i** (f.42) - *dash me veshë të vogjel*. F.'80, **çull-i** – 1. *mbulesë e ashpër dhe e trashë, e punuar zakonisht me lesh dhie, velenxë e trashë e me thekë të gjatë*. 2. *mbulesë e trashë leshi, që u vihet në kurriz kuajve ose mushkave për t'i mbrojtur nga shiu e nga të ftohtët: përkavë*. 3. *mbulesë ose rrobë shumë e papastër*. 4. *qilim leshi me ngjyrë të zezë, që shtrohej në raste vdekjesh* (F.'80, f.280).
- duma-ni** (f.50) - *shtyllë druni, dyreku i barkës*. F.'80, **duman-i** – 1. *re e dendur tymi, pluhuri etj.; mjegull; tym*. 2. *si re e dendur tymi, pluhuri etj.; gjithë tym a pluhur* (F.'80, f. 38).
- grill-i** (f.74) - *dokth i eger, bime e fam.bishtajore*. F.'54, **grill-i** – *nji farë guri i butë e petë petë që thërmohet lehtë; tokë që thërmohet e punohet lehtë* (F.'54, f.146).
- hutrrue** (f.87) - *gabue*. F.'54, **hutrrhem** – *hutohem;shushullatem* (F.'54. f.176).
- rragë-a** (f.186) - *fjalisje, shamatë*. F.'80, **rragë-a** – 1. *pëlhurë e trahsë prej liri, që përdoret për thasë etj., burdhë*. 2. *përparëse prej kësaj pëhure, që vihet për të mos u fëlliqur gjatë punës; rragë-a – shih rragatë-a* (F.'80, f.1676).

c) Fjalë me kuptim shtesë

- abe-ja** (f.11)- *hije*. F.'54, **abe-ja** – *hie a fantazmë* (F.'54, f.1). F.'80, **abe-ja** – 1. *hije, fantazmë*. 2. *hijeshi* (F.'80, f.2).
- ajk-u**(f.12) – *ajkë; djersë flokësh*. F.'80, **ajkë-a** – 1. *shtresë e yndyrëshme që zë sipër qumështi pasi e ziejmë dhe e lëmë në një enë; shtresë e trashë që zë përsipër një gjellë ose një lëng kur e ziejmë*. 2. *pjesa më e mirë, pjesa më e zgjedhur; balli, lulja*. 3. *lyra e leshit të palarë; djersë e yndyrshme në lëkurën e bagëtive dhe në flokët e njeriut*. 4. *gjysmë i lëngshëm e si i yndyrshëm, i butë (për salcën, baltën etj.)*. (F.'80, f.15).
- angerr-angrra** (f.13) - *si te Fj.angrra*. F.'80, **angërr-rra** - 1. *qipë e hollë, që mbështjell një organ të trupit; lëkurëz*. 2. *të përbrendshmet, rropullitë*. 3. *zgavër, pjesa e brendshme e një hapësire* (F.'80, f.35).
- angth-i** (f.13) – *angth, ankth*. F.'54, **ankth-i** – *frika që na ze nganjëherë në gjumë, kur shohim një ëndërr të trembur e na duket sikur po na zihet fryma* (F.'54, f.12). F.'80, **ankth –i** – 1. *ëndërr e rëndë, gjatë së cilës na duket sikur na zihet fryma dhe tronditemi ose trembemi*. 2. *ndjenjë e rëndë ndrydhëse, shtypëse; shqetësim i madh për fatin e dikujt ose për fundin e diçkaje* (F.'80, f.37).
- bajuk/ë-a**(f.18) - *lopë e bajme*. F.'80, **bajukë-a** – 1. *shpend i liqeneve dhe kënetave, i ngjashëm me bajzën, që ka sqep ngjyrë bari dhe lafshë të bardhë*. 2. *lopë laramane* (F.'80, f.84).
- çapuer-ori** (f.39) – *capë*. F.'80, **çapua- oi** – 1. *thua i fortë që kanë disa shpendë shtëpiakë prapa këmbës*. 2. *kthetër*. 3. *pjesë e diçkaje e kthyer si kthetër* (F.'80, f.245).
- çudue** (f.41) – *perçudnue*. F.'80, **çudoj** – 1. *i prish pamjen dikujt a diçkaje, e shëmtoj, e përçudnoj*. 2. *e përdhunoj, e çnderoj (një vajzë)* (F.'80, f.279).
- çufrok** (f.41) – *burrë i shkurtë e i fortë*. F.'80, **çufrak-e** - 1. *që është si tufë, tufshak*. 2. *që është i dendur e i dredhur (për flokët); që ka flokë të dendur e të dredhur*. 3. *që është i shkurtër nga shtati; trupvogël, shkurtabiq* (F.'80, f.279).
- dhuni-a** (f.53) - *dhunë, poshtersi*. F.'54, **dhunë-a** – 1. *turp i madh, cenim i rëndë në nder të tjetrit me fjalëma me vepra, shnderim*. 2. *punë e keqe, e dëmshme*. 3. *përdorim i forcës, i shtërngimit* (F.'54, f.102). F.'80, **dhunë-a** – 1. *përdorimi i forcës fizike, i shtrëngimit fizik ose psikik, i mjeteve e i metodave të vrazhda ndaj dikujt për ta detyruar të bëjë diçka jashtë vullnetit a dëshirës së tij, për ta nënshtruar e për ta shtypur dikë, për të kufizuar veprimet e dikujt etj.; detyrim a shtypje me anë të forcës*. 2. *shnderim, poshtërim a turp i madh që i bëhet dikujt, cënim i rëndë i nderit të dikujt me vepra e me fjalë; fyerje e rëndë që i bëhet dikujt*. 3. *e keqe; dëm* (F.'80, f.411).
- fyshkë** (f.64) - *me u veshkë*. F.'80, **fishk-a-ur** – 1. *i heq njomësinë, e rrudh dhe e bëj që të humbasë ngjyrën, shkëlqimin a bukurinë; e venit; e rrudh dhe e dobësoj*. 2. *bëj që të humbasë forcën a gjallërinë, i heq gëzimin, e bëj të mpitë, e venit*. 3. *e bëj më të dobët diçka, dobësoj, zbut, zbeh* (F.'80, f.476).
- gerthice-a** (f.69) - *kërthizë*. F.'54, **kërthizë-a** -1. *gropëza rrotullare në mes të barkut, që mbetet si pritët zorra që lidhete pjellën me nënën; 2. qendër, mes*. 3. *dërrasë rumbullake e gdhendur bukur që është vendosur në mes të tavanit në shtëpira të stilit të vendit* (F.'54, f.214).
- gris** (f.74) - *kush grine me fjale, kush flet shume*. F.'54, **gris** – 1. *ha , prish rrobat nga të përdorurit e gjatë*. 2. *shqej një copë letër a një cope, e çjerr* (F.'54, f.147).

- jarg-u** (f.91) – *jargë*. F.'54, **jargë-a** – 1. *pështymët që kullojnë nga goja*. 2. *lëngu i bardhë e ngjitës i kërminjve* (F.'54, f.186).
- rraketake-ja** (f.186) - *vegël për me kersitë*. F.'80, **rraketake-ja** – 1. *lodër prej teneqeje, prej dërrase etj., me disa guriçka brenda që trokasin kur tunden, e cila u jepet foshnjave për t'u qetësuar e për t'u zbavitur*. 2. *trakullima e mullirit, çakalle* (F.'80, f.1678).
- rrëfanë-a** (f.188) - *vegë*. F.'80, **rrëfanë-a** – 1. *vegje e një ene, vesh, dorëz*. 2. *freri i rrushit, ku qëndrojnë kokrrat; frerëz, frenjë; bishti ku lidhet kokrra e qershisë ose e kungullit; degëz* (F.'80, f.1691).
- rrëpi-ja** (f.188) - *rëmore, rrëpinë, rrëpjetë*. F.'80, **rrëpirë-a** – 1. *faqe mali a kodre shumë e pjerrët, vend shumë i pjerrët; vendi i pjerrët, i gërryer e i thelluar nga një rrëke, nga një përrua etj*. 2. *shi i shkurtër që bie me rrëmbim*. 3. *rrëke që krijohet nga një shi i rrëmbyer e që nuk zgjat shumë; vijë uji e vogël (nga shiu etj.)* (F.'80, f.1698).
- rric-i** (f.189) - *ric, ricë*. F.'54, **rricë-a** – 1. *e bani prej rricës, e bëri nga shtrëngesa*. 2. *e qepura, e qëndisura me grep në buzë të shamisë, të petkut etj.* (F.'54, f.477). F.'80, **rricë-a** – 1. *rrëth i vogël, që bëhet me një fije të përdredhur ose të qepur diku*. 2. *flokë të dredhur në rrathë të vegjël, kaçurrela të imëta, dredha, kokoridhe*. 3. *lastar i hollë e i përdredhur, që lëshojnë bimët kaca varëse për t'u kapur në një vend, dredhë, loze*. 4. *shtrëngesë e madhe, gjendje e vështirë, ngushticë*. 5. *në gjendje shumë të vështirë, pisk, ngushtë* (F.'80, f.1703).
- rrille-ja** (f.189) - *soj groshe së kullmë me kercell t' ultë e të drejtë*. F.'80, **rrillë-a** – 1. *bimë barishtore me gjethë të imëta e me lule të verdha, që bën kokrra të vogla e të rrumbullakëta dhe që lëshon një lëng helmues*. 2. *që e ka kokrrën shumë të vogël, kokërrvogël* (F.'80, f.1703).
- vragë-a** (f.234) - *gjurmë, pershtypje*. F.'54, **vrajë-a** – 1. *mbresa që le plaga*. 2. *vrima e madhe e fuçë dhe shtupa që mbyll këtë* (F.'54, f.618). F.'80, **vragë-a** – 1. *rrugë e ngushtë nëpër një pyll ose në fushë për kafshë a për kalimtarë; dhiare*. 2. *vija që lë rrota e qerres a diçka tjetër në sipërfaqen e tokës; shenjë në trupin e njeriut a të kafshës nga një plagë, nga të goditurit me shkop etj; gjurmë*. 3. *mbresë, pershtypje, gjurmë; plagë* (F.'80, f. 2181).
- zgorrovinë-a** (f.240) - *zgorre, skelet*. F.'80, **zgorre-ja** – 1. *tërësia e eshtrave të një trupi, skelet*. 2. *vend me shkurre e shira të dndura, ku kalohet me shumë vështirësi; blacë* (F.'80, f.2235).
- zgrifth-i** (f. 240) – *zgrif, skaj, buzë*. F.'80, **zgrif –i** – 1. *buza e një gremine, e një shkëmbi të thepisur etj; skaji i një sendi, ana, buza*. 2. *pika e fundit, fundi, mbarimi i diçkaje*. 3. *pakicë; shtrëngicë, kursim* (F.'80, f.2235).
- zgripue** (f.240) - *dhanë me pakicë, kursim*. F.'54, **zgriptoj** – *sa zë fill*. 1. *shpenzoi me zgrif nga pak*. 2. *e shpie gjer në zgrif, gjer në fund* (F.'54, f.634). F.'80, **zgriptoj** – 1. *kursej shumë, shpenzoi me zgrif*. 2. *e çoj diçka deri fare afër fundit, e çoj deri në zgrif*. 3. *sapo filloj, sa nis diçka* (F.'80, f.2235).

ç) Fjalë që përfshihen vetëm në Fjalorin e 1954

allkë-a(f.12) - *hallkë,rreth hekuri,qi u vehet bagtive*. F.'54, **allkë-a** – *ledh arash* (F.'54, f.8).

amball-i(f.12) – *jamball(turq), zakarezë*. F.'54, **jamball-i** – *bimë e familjes së Leguminozevet, me kërcell të gjatë e me lule të mbledhura në vile* (F.'54, f.186).

amsht-i (f.12) - *amshti,samtim*. F.'54, **amsht-i-a** – *të qenët i amshtë* (F.'54, f.9).

çukulitë (f.42) – *qukatë*. F.'54, **çukit** – *çoket me sqep; thuhet edhe për piskimin e gjarprit* (F.'54, f.70).

vuejshem (f.235) - *me vishtirsi,mund*. F.'54, **vuejshëm (i)** – **vuejshme (e)** - *që mund të durohet* (F.'54, f.620).

zalikë-a (f.238) – *zali*. F.'54, **zali-a-** *të fikët* (F.'54, f.626).

Tek Fjalori i Demës vërejmë një dukuri të tillë, siç e theksuam më lart, që shumë lema nuk gjejnë pasqyrim në Fjalorin e 1954, gjë që përkon edhe me idenë e hartimit të këtij Fjalori, që të paraqesë fjalë që nuk janë në Fjalorin e 1954, ose të kenë formë të njëjtë, por kuptime të kundërta.

d) Fjalë që përfshihen në Fjalorin e 1980

- ader-dra** (f.11) - *llafe, fjalë kote, pallavra, dokrra, shaka*. F.'80, **adër-ra** – *gjepura, profka; shaka, hoka* (F.'80, f.5).
- afçë-a** (f.11) – *vardu*. F.'80, **afçë-a** – *beng* (F.'80, f.7).
- afermeç** (f.11) - *neper te, jo gja e sigurtë*. F.'80, **afërmendsh-** 1. *kuptohet vetvetiu, është e qartë vetvetiu, s'ka dyshim*. 2. *po, sigurisht, ashtu vërtet* (F.'80, f.7).
- afetar(-e)** (f.11) - *i pafe,ateist*. F.'80, **afetar-e** – 1. *që nuk beson në zotin, që nuk pranon asnjë fe, i pafe*. 2. *përd. em. sipas kuptimit të mbiemrit* (F.'80, f.7).
- afetarizem-zmi** (f.11) – *ateizem*. F.'80, **afetarizëm-zmi** – *afetari-a* (F.'80, f.7).
- agmi-a** (f.11) - *shkelqim, bardhni*. F.'80, **agmi-a** – 1. *zbardhëllima e parë e vagët e ditës, kuqërimi i agut; koha para agut*. 2. *zbardhëllimë, dritë e butë që përhapet nga sendet e bardha*. 3. *të skuqurit e lehtë e fytyrës nga një ndjenjë* (F.'80, f.10).
- agor-i** (f.11) - *prani.n'agor te tij: para tij,ne prani te tij: pamje*. F.'80,**agor-i** – *trajtat që merr fytyra ose trupi sipas qëndrimit; vijat kryesore të një fytyre* (F.'80, f.11).
- agshol-i**(f.11) - *ag drite*. F.'80, **agshol-i** – *fillimi i agimit, agu* (F.'80, f.12).
- ajar-i** (f.11) - *kreshnik, fatos*. F.'80, **ajar-i** – 1. *kosh i madh që përdorej për të matur drithin; masë drithërash*. 2. *sasia e pjesëve të njëtali të çmuar që gjendet te një mijë pjesë të një përzierjeje me metale të tjera, karat*. 3. *barazi në peshë, baraspeshë, drejtpeshim; përpjestim i barabartë, përputhje e plotë në masë e në kohë* (F.'80, f.15).
- akth-i** (f.12) - *qeper çatie,pullazinë*. F.'80, **akth-i** – *shih makth-i* (F.'80, f.21).
- amel-mli** (f. 12) - *spirë*. F.'80, **amel-i** – 1. *bar për të dalë jashtë*. 2. *të hequrit bark, të dalët jashtë shumë*. 3. *prirje, damar, gjendje shpirtërore* (F.'80, f.27).
- arishtë-a** (f.14) – *nji farë bari*. F.'80, **arishtë-a** – 1. *arë e lënë dy-tre vjet pa u punuar pas korrjes; arë e vogël*. 2. *vend me ara* (F.'80, f.48).
- arithe-ja** (f.14) – *bimë e familjes bishtajore, e lule boça 5 dhambësh*. F.'80, **arithe-ja** – *urithe* (F.'80, f.49).
- ballafaçkë-a** (f.18) – *e rame e fyeshme*. F.'80, **ballafaqe** - *sy ndër sy, haptas, sheshit; ballë për ballë* (F.'80, f.89).
- bashtinuer** (f.21) -*çka i perket nji bashtine a nje prone tokësh*. F.'80, **bashtinar-i** – *pronar i një bashtine në sistemin e timareve* (F.'80, f.116).
- cakllimë-a** (f.33) - *ngërcllue dhambësh*. F.'80, **cakëllim-i** - *veprimi sipas kuptimit të foljes cakëlloj* (F.'80, f.212).
- cakrri-a** (f.33) - *shi perzie me borë*. F.'80, **cakërri-a** – *shi i ftohtë, i përzier me borë* (F.'80, f.212).
- çapuer-ori** (f.39) – *capë*. F.'80, **çapua- oi** – 1. *thua i fortë që kanë disa shpendë shtëpiakë prapa këmbës*. 2. *kthetër*. 3. *pjesë e diçkaje e kthyer si kthetër* (F.'80, f.245).
- çudue** (f.41) – *perçudnue*. F.'80, **çudoj** – 1. *i prish pamjen dikujt a diçkaje, e shëmtoj, e përçudnoj*. 2. *e përdhunoj, e çnderoj (një vajzë)* (F.'80, f.279).
- çuk-u** (f.41) - *maje,brengë; gropë në maje të malit*. F.'80, **çuk-u** – *mëz* (F.'80, f.279).
- çukel-kla**(f.41) - *zhele,rreckë*. F.'80, **çukël-la-** *guraçok* (F.'80, f.279).
- çukë** (f.42) - *çukitë,çukulitë*. F.'80, **çuk** – 1. *i bie fort diçkaje me një mjet a me një vegël për të bërë një punë*. 2. *çkit*. 3. *quk* (F.'80, f.279).
- dhunueshem(i)** (f.53) - *qi mund të dhunohet, i fyeshem*. F.'80, **dhunshëm (i)-me** - 1. *që bëhet a që arrihet me dhunë*. 2. *i turpshëm; shumë fyes* (F.'80, f.411).

- fjeshtsue** (f.60) – *thjeshtsue*. F.'80, **thjeshtësoj** – 1. *thjeshtoj*. 2. *thjeshtëztoj* (F.'80, f.2068).
- fjetë** (f.60) - *vu me fjetë*. F.'80, **fjeta** – *fle* (F.'80, f.481).
- fyrë-a** (f.64) - *birë, vrimë (në djathë; fyra-fyra); fire, mungesë*. F.'80, **fyrlë-a** - *vrimë shumë e vogël* (F.'80, f.525).
- fyshtë** (f.64) - *me u veshkë*. F.'80, **fishk-a-ur** – 1. *i heq njomësinë, e rrudh dhe e bëj që të humbasë ngjyrën, shkëlqimin a bukurinë; e venit; e rrudh dhe e dobësoj*. 2. *bëj që të humbasë forcën a gjallërinë, i heq gëzimin, e bëj të mpitë, e venit*. 3. *e bëj më të dobët diçka, dobësoj, zbut, zbeh* (F.'80, f.476).
- gabueshem(i)** (f.66) - *qi mund te gabojë*. F.'80, **gabueshëm (i)** – **me** - 1. *që mund të gabojë, që mund të bjerë në gabim*. 2. *i gabuar* (F.'80, f.530).
- germite** (f.69) - *curmue pulat me kambe*. F.'80, **gërmit (gërmis)** – 1. *kruaj a gërryey diçka; brej*. 2. *trazoj që të ndizet (për zjarrin), shpurrit* (F.'80, f.547).
- rrahishtë-a** (f.186) - *pjesë mali me rraha*. F.'80, **rrahishtë-a**- *shih rrah-u* (F.'80, f.1677).
- rrallesë-a** (f.186) – *rrallim*. F.'80, **rrallesë-a** – *bimët që shkulen gjatë tëharrjes* (F.'80, f.1678).
- rrille-ja** (f.189) - *soj groshe së kullmë me kercell t' ultë e të drejtë*. F.'80, **rrillë-a** – 1. *bimë barishtore me gjethë të imëta e me lule të verdha, që bën kokrra të vogla të rrumbullakëta dhe që lëshon një lëng helmues*. 2. *që e ka kokrrën shumë të vogël, kokërrvogël* (F.'80, f.1703).
- zalitë** (f.238) – 1. *si Fj.*. 2. *me u merzitë*. F.'80, **zalis** – *bëj që t'i bjerë të fikët* (F.'80, f.2208).
- zgallë** (f.240) - *çilë birë, gropë*. F.'80, **zgale-ja** – *vrimë ose e çarë (zakonisht në mur); borde* (F.'80, f.2234).

Ndryshe nga Fjalori i vitit 1954, në Fjalorin e vitit 1980, ndeshim më shumë fjalë të Benedikt Demës, të cilat kanë kuptime të ngjashme por edhe të njëjta në të dy Fjalorët. Kjo mund të jetë rastësi (duke marrë parasysh faktin se Fjalori i Benedikt Demës, u botua në vitin 2005), ose mund të shpjegohet me faktin se Fjalori i 1980, ka lëndë të pasur leksikore e frazeologjike, gjë që nuk ka lënë mënjanë përfshirjen e leksikut krahinor të gegërishtes.

e) Fjalë që përfshihen në të dy Fjalorët 1954,1980

- abe-ja** (f.11) - *hije*. F.'54, **abe-ja** – *hie a fantazmë* (F.'54, f.1). F.'80, **abe-ja** – 1. *hije, fantazmë*. 2. *hijeshi* (F.'80, f. 2).
- aferti-a** (f.11) - *Fj.afersi*. F.'54, **afërsi-a** – *të qenët afër (një vendi)* (F.'54, f.3). F.'80, **afërsi-a** – 1. *të qenët afër, të ndodhurit në një vend pranë; largësi*. 2. *tokat a vendet që shtrihen rreth e rrotull një fshati etj., vendet aty rrotull, rrethinat* (F.'80, f.8).
- ahmarrë** (f.11) - *marr uhanë, gjakun, hakmarrë*. F.'54, e gjejmë si emër, **ahmarrje-ahmarrja** – *shpagimi që merr një njeri për një dhunë që i kanë bërë; gjak, hakmarrje* (F.'54, f.4). F.'80, **ahmarrje-a** – *hakmarrje-a* (F.'80, f.13).
- aht-i** (f.11) - *permallim,pikllim*. F.'54, **aht-i** – *psherëtimë; nemë* (F.'54, f.4). F.'80, **aht-i** – 1. *psherëtimë, rënkim i thellë; nemë që del nga dhimbja shirtërore, ahu*. 2. *grahma e fundit para vdekjes* (F.'80, f.14).
- ajk-u** (f.12) – *ajkë; djersë flokësh*. F.'54, **ajkë-a** – *pjesa më e gjalpur që rri afër qumështit; mazë; yndyra e leshit; fig. pjesa më e zgjedhur* (F.'54, f.4). F.'80, **ajkë-a** – 1. *shtresë e yndyrshme që zë sipër qumështi pasi e ziejmë dhe e lëmë në një enë; shtresë e trashë që zë përsipër një gjellë ose një lëng kur e ziejmë*. 2. *pjesa më e mirë, pjesa më e zgjedhur; balli, lulja*. 3. *lyra e leshit të palarë; djersë e yndyrshme në lëkurën e bagëtive dhe në flokët e njeriut*. 4. *gjysmë i lëngshëm e si i yndyrshëm, i butë (për salcën, baltëne etj.)*. (F.'80, f.15).
- ajue** (f.12) – *ajë*. F.'54, **aj** – *e bëj të ënjtet* (F.'54, f.4). F.'80, **ajoj-** *lag ose mbush me ujë një vozë a një enë tjetër prej druri* (F.'80, f.16).
- almishte-ja**(f.12) - *almise,vegel*. F.'54, **almise-t** - *veglat bujqësore* (F.'54, f.7). F.'80, **almise-ja** – 1. *mjet i thjeshtë pune; vegël bujqësore*. 2. *pjesë e një vegle, e një mjeti pune a e një mekanizmi* (F.'80, f.25).
- angerr-ngrra** (f.13) - *si te Fj. angrra*. F.'54, **angërr-angrra** – *lëkurëz që mbështjell ndonjë gjymtyrë a lëng të trupit* (F.'54, f.11). F.'80, **angërr-rra-** 1. *qipë e hollë, që mbështjell një organ të trupit; lëkurëz*. 2. *të përbrendshmet, rropullitë*. 3. *zgavër, pjesa e brendshme e një hapësire* (F.'80, f.35).
- angth-i** (f.13) – *ang, ankth*. F.'54, **ankth-i** – *frika që na ze nganjëherë në gjumë, kur shohhim një ëndër të trembur e na duket sikur po na zihet fryma* (F.'54, f.12). F.'80, **ankth -i** – 1. *ëndërr e rëndë, gjatë së cilës na duket sikur na zihet fryma dhe tronditemi ose trembemi*. 2. *ndjenjë e rëndë ndrydhëse, shtypëse; shqetësim i madh për fatin e dikujt ose për fundin e diçkaje* (F.'80, f.37).
- argoshë-a**(f.14) – *Fj. shs, argoshë,t*. F.'54, **argoshë-t** – *puçrriza që dalin në trup të njeriut nga vapa a nga një sëmundje* (F.'54, f.15). F.'80, **argoshë-t** – *puçrra të vogla që i dalin njeriut në trup nga vapa ose nga ndonjë sëmundje*. (F.'80, f.47).
- bajuk/ë-a** (f.18) - *lopë e bajme*. F.'54, **bajukë-a** – *shpesë uji nga familja e rosës s'egër* (F.'54, f.24). F.'80, **bajukë-a** – 1. *shpend i liqeneve dhe kënetave, i ngjashëm me bajzën, që ka sqep ngjyrë bari dhe lafshë të bardhë*. 2. *lopë laramane* (F.'80, f.84).
- ballaballas** (f.18) - *ballëperballë*. F.'54, **ballaballë** – *kundruall, ballë për ballë* (F.'54, f.26). F.'80, **ballaballas** – *ballë për ballë, njëri kundrejt tjetrit, përballë* (F.'80, f. 89).
- bashkë-a** (f.21) - 1. *gjithë leshi i padamë i nje berri të qethun*. 2. *mbulesë velencë, levencë*. F.'54, **bashkë-a** - *tërësia e leshit të pandarë të një berri të qethur* (F.'54, f.30). F.'80, **bashkë-a** – 1. *gjithë leshi që merret nga një qethje e deles,*

- tërësia e leshit ë mbulon lëkurën e deles, siç del nga qethja pa u prishur. 2. diçka e bardhë, e fryrë dhe e butë, q ë i ngjan leshit të deles (F.'80, f.110).*
- cabok-u** (f.33) – *stom, naltsinë e vogël, shkamb, shkrep. F.'54, cabok-u – kërcu (F.'54, f.54). F.'80, cabok-u – 1. stom. 2. copë dheu aguri, plis a popël; copë druri, kërcu i vogël (F.'80, f.211).*
- cakë-a** (f.33) - *rret peshqish. F.'54, cakë-a – trastë e vogël (F.'54, f.54). F.'80, cakë-a – trastë e vogël prej pëlhure të hollë ose prej leshi; qese (F.'80, f.212).*
- cakllue** (f.33) - *1.britë sorra. 2. ngerçllue dhambësh. 3. me i ra kumbonës. F.'54, caklloj – kërcas: caklloj dhëmbët, kërcas dhëmbët (sidomos nga të ftohtit) (F.'54, f.54). F.'80, cakëlloj – çokas, kërcëlloj (F.'80, f.212).*
- çapitë** (f.39) - *grimcua me dhambë sallata, lakna etj.; me u ndjekë zogjët. F.'54, çapitem – nis t'eci (thuhet për foshnjët kur fillojnë të hedhin çapat e para), (F.'54, f.62). F.'80, çapit (çapis) – 1. eci me ngadalë ose rëndë, hedh hapat, hedh këmbët; shkoj ngadalë ose me vështirësi, çapitem. 2. hap këmbën ngadalë ose me vështirësi për të ecur; çapit (çapis) – shkriçeroj tokën ose thyej plisat me çapë (F.'80, f. 244).*
- çapok-u** (f.39) - *ma i trashi nder dy eshtent e gjatë të kërsisë, ma teh ma të prehtë përpara. F.'54, çapok-u – 1. kërdhokulla; kërciri i këmbës; 2. çapua (F.'54, f.62). F.'80, çapok-u – 1. kërdhokull, këllk. 2. kocka e kofshës; kofshë. 3. shih çapua-oi (F.'80, f.244).*
- çufrok** (f.41) – *burrë i shkurtë e i fortë. F.'54, çufrak-e – tufshak (F.'54, f.70). F.'80, çufrak-e- 1. që është si tufë, tufshak. 2. që është i dendur e i dredhur (për flokët); që ka flokë të dendur e të dredhur. 3. që është i shkurtër nga shtati; trupvogël, shkurtabiq (F.'80, f.279).*
- çukë-a** (f.41) – *1. shenj. 2. maje kodre skape sukë. 3. puçik, gropzë. 4. pjesë përbase kryesore e sistemit nervoz të simpatikut të madh. F.'54, çukë-a – maja e një mali a e një bregu (F.'54, f.70). F.'80, çukë-a – 1. majë e lartë, zakonisht e zhveshur e një mali a e një kodre; mal a kodër me një majë të tillë. 2. maja e një peme a e një bime (F.'80, f.279).*
- dhuni-a** (f.53) - *dhunë, poshtersi. F.'54, dhunë-a – 1. turp i madh, cenim i rëndë në nder të tjetrit me fjalë a me vepra, shnderim. 2. punë e keqe, e dëmshme. 3. përdorim i forcës, i shtërngimit (F.'54, f.102). F.'80, dhunë-a – 1. përdorimi forcës fizike, i shtrëngimit fizik ose psikik, i mjeteve e i metodave të vrazhda ndaj dikujt për ta detyruar të bëjë diçka jashtë vullnetit a dëshirës së tij, për ta nënshtruar e për ta shtypur dikë, për të kufizuar veprimet e dikujt etj.; detyrim a shtypje me anë të forcës. 2. shnderim, poshtërim a turp i madh që i bëhet dikujt, cënim i rëndë i nderit të dikujt me vepra e me fjalë; fyerje e rëndë që i bëhet dikujt. 3. e keqe; dëm (F.'80, f.411).*
- edhe-ja** (f.54) - *edh femer. F.'54, edh-i-kec, keç, kedh (F.'54, f.102). F.'80, edhe-ja - kec femër, kece (F.'80, f.415).*
- efsh-i** (f.54) - *frigë, tmerë. F.'54, efsh-i – të vështirë (F.'54, f.102). F.'80, efsh-i – të pështirë, ndot (F.'80, f. 416).*
- egërti-a** (f.54) - *egërsinë, bishë e eger. F.'54, egërtinë-a – egërsirë (F.'54, f.103). F.'80, egërti-a- terësia e kafshëve të egra, egërsirat; egërti-a -1. dora e parë që i jepet një muri kur lyhet me gëlqere. 2. muret e një ndërtese pa suva e pa shtesat e plotësimet e brendshme, karabina (F.'80, f.417).*
- egrue** (f.54) - *que peshë, nzitë, ashpersue. F.'54, egërsoj - e bëj t'egër; ashpërsoj; zemëroj (F.'54, f.103). F.'80, egërsoj – 1. e bëj që të mos i afroresh dot, e bëj më të egër (një kafshë); e bëj që të zemërohet a të inatoset shumë; e bëj të*


- ashpër e të vrazhdë (një njeri). 2. e bën më të ftohtë, më të ashpër (klimën a motin) (F.'80, f.417).*
- ehull-i** (f.54) – *efull*. F.'54, **ehull-i**- *krongjill, qiri akulli, hell* (F.'54, f.103). F.'80, **ehull-lli** – 1. *hell a qiri akulli; vesë e ngrirë*. 2. *erë e ftohtë që fryn në mëngjes herët; ehull-lli – lëndë lisi* (F.'80, f.418).
- elbze-a** (f.54) - *elbth, byc, askath, rrëgjuell*. F.'54, **elbth-i** – *një koqëz si elb, që del në kapak të syrit dhe pikërisht aty ku janë qerpikët: kath, byc, rrëgjuell, askath* (F.'54, f.105). F.'80, **elbth-i** – *puçërr me qelb sa një kokërr elbi, që del në kapakun e syrit në rrëzë të qerpikëve, kath* (F.'80, f.423).
- ende-ja** (f.54) - **endzë**. F.'54, **endzë-a** – 1. *lulja e pemëve; lulja e ullirit*. 2. *larva fluturash që fluturojnë grumbull* (F.'54, f.107). F.'80, **ende-ja** – *endë* (F.'80, f.428).
- fjalatar** (f.60) - *kush flet shumë, ka shumë fjalë, ban zhurmë të madhe*. F.'54, **fjalaman-i** – *i thonë atij, të cilit s'i pushon goja* (F.'54, f.122). F.'80, **fjalaman-e** – *llafazan* (F.'80, f.479).
- fjalisë** (f.60) – *ba fjalë, shamatë*. F.'54, **fjalohem** – *hahem, zihem me një, bëj fjalë me të* (F.'54, f.122). F.'80, **fjalos** – 1. *bisedoj, fjalosem me dikë*. 2. *flas, them fjalë*. 3. *i them a i flas dikujt për diçka* (F.'80, f.481).
- fjeshter-tri** (f.60) – *thjeshtër*. F.54, **thjeshtër-thjeshtri** - *djali që gjen gruaja e dytë e një burri nga gruaja e parë e tij, ose djali që i shpie gruaja burrit nga martesë e saj e parë* (F.'54, f.586). F.'80, **thjeshtër-ri** – *djali që gjen gruaja e dytë e një burri nga gruaja e parë e tij ose djali që i shpie gruaja burrit nga martesë e saj e parë; djalë i gjetur* (F.'80, f.2068).
- fyzuer** (f.65) - *i fyzave, i veneve*. F.'54, **fyzë-a** – *gyp i hollë* (F.'54, f.134). F.'80, **fyzë-a** – 1. *diçka që ka trajtën e një gypti të hollë të shpuar tejprtej*. 2. *gyp i hollë e i zgjatur; damar* (F.'80, f.527).
- gaculli-a** (f.66) - *xixilloje*. F.'54, **gacullinë-a** - *xixëllojë* (F.'54, f.134). F.80, **gacullinë-a** – *xixëllonjë* (F.'80, f.530).
- germuce** (f.69) - *me u kercnue, ngerdhuce, germushe*. F.'54, **gërmushem** - *i kanosem tjetrit me fjalë e me gjeste, i lavdurohem* (F.'54, f.139). F.'80, **gërmushem** – *i kërcënohem dikujt me fjalë ose me lëvizje të krahëve a të fytyrës, i hakërrohem* (F.'80, f.548).
- orrlë-a** (f.149) – *urrlë*. F.'54, **urlë-a** – *qumësht i zier me kripë; djathë shirku, të cilit i hedhim herë pas here qumësht* (F.'54, f.592). F.'80, **urlë-a** – *qumësht i zier me kripë që mbahet gjatë në napë ose në kacek; djathë kaceku të cilit i hedhim herë pas here qumësht* (F.'80, f.2094).
- oveskë-a** (f.150) – *oviskë, kollçe, qemaster, pështjellse kambësh*. F.'54, **oviskë-a** – *kordhelë, shirit* (F.'54, f.363). F.'80, **ovizgë-a** – *dizgë djepi, shirit* (F.'80, f.1312).
- rragë-a** (f.186) - *fjalisje, shamatë*. F.'54, **rragë-a** – *rrahje* (F.'54, f.470). F.'80, **rragë-a** – 1. *pëlhurë e trashë prej liri, që përdoret për thasë etj., burdhë*. 2. *përparëse prej kësaj pëhure, që vihet për të mos u fëlliqur gjatë punës; rragë-a – shih rragatë-a* (F.'80, f.1676).
- rrajosë** (f.186) – *rrënjosë*. F.'54, **rrënjos** – *ngul mirë në mendje e në zemër një ide, një ndjenjë; rrënjosem, lëshoj rrënjë, zë rrënjë* (F.'54, f.475). F.'80, **rrënjos** – *ngul mirë në mendjen e në ndërgjegjen e dikujt një dije, një mendim, një ndjenjë etj.; bëj që të zërë rrënjë te dikush* (F.'80, f.1698).
- rraketake-ja** (f.186) - *vegel per me kersitë*. F.'54, **rraketake-rrakatakja** – *lodër prej teneqeje me disa guriçka brenda për të gënjer të vegjël* (F.'54, f.470). F.'80, **rraketake-ja** – 1. *lodër prej teneqeje, prej dërrase etj., me disa guriçka*

- brenda që trokasin kur tunden, e cila u jepet foshnjave për t'u qetësuar e për t'u zbavitur. 2. trakullima e mullirit, çakalle (F.'80, f.1678).*
- rrapatë** (f.187) - *ba zhurmë,poterë. F.'54, rrapatem – rropatem (F.'54, f.470). F.'80, rropat (rropas) – përplas këmbët duke ecur dhe bëj zhurmë, eci duke përpyetur këmbët (F.'80, f.1713).*
- rraptisë** (f.187) - *me u vardisë. F.'54, rraptoj – bëj zhurmë, rrapëlloj (F.'54, f.471). F.'80, rraptoj- shih rrapëlloj (F.'80, f.1679).*
- rrëfanë-a** (f.188) - *vegë. F.'54, rrëfanë-a – veshi, vegja e një ene (vorbe, kazani etj) (F.'54, f.474). F.'80, rrëfanë-a – 1. vegje e një ene, vesh, dorëz. 2. freri i rrushit, ku qëndrojnë kokrrat; frerëz, frenjë; bishti ku lidhet kokrra e qershisë ose e kungullit;degëz (F.'80, f.1691).*
- rrëmallë-a** (f.188) - *dhëmballë. F.54, dhëmballë-a – secili nga ata dhëmbët e mëdhenj nga të dy anët e gojës, që janë të ngulur në nofulla dhe shërbejnë për të thërrmuar e për të bluar ushqimin (F.54, f.100). F.80, dhëmballë-a – secili nga dhëmbët e mëdhenj nga të dy anët e gojës që vijnë pas dhëmbëve të syritdhe që shërbejnë për të përtypur e për të thërrmuar ushqimin (F.80, f.403).*
- rrëpi-ja**(f.188) - *rëmore, rrëpinë, rrëpjetë. F.'54, rrëpinë-a – rrëpirë (F.'54, f.475). F.'80, rrëpirë-a – 1. faqe mali a kodre shumë e pjerrët, vend shumë i pjerrët; vendi i pjerrët, i gërryer e i thelluar nga një rrëke, nga një përrua etj. 2. shi i shkurtër që bie me rrëmbim. 3. rrëke që krijohet nga një shi i rrëmbyer e që nuk zgjat shumë; vijë uji e vogël (nga shiu etj.) (F.'80, f.1698).*
- rric-i** (f.189) - *ric, ricë. F.'54,rricë-a – 1. e bani prej rricës, e bëri nga shtrëngesa. 2. e qepura, e qëndisura me grep në buzë të shamisë, të petkut etj (F.'54, f.477). F.'80, rricë-a – 1. rreth i vogël, që bëhet me një fije të përdredhur ose të qepur diku. 2. flokë të dredhur në rrathë të vegjël, kaçurrela të imëta, dredha, kokoridhe. 3. lastar i hollë e i përdredhur, që lëshojnë bimët kaca varëse për t'u kapur në një vend, dredhë, loze. 4. shtrëngesë e madhe, gjendje e vështirë, ngushticë. 5. në gjendje shumë të vështirë, pisk, ngushtë (F.'80, f.1703).*
- rrig-a** (f.189) - *rrikë. F.'54, rrikë-a – shelqe lugësh; rrikë-a– repë, repane (F.'54, f.477). F.'80, rrikë-a – rrepë; rrikë-a – kuti druri e varur në mur për të mbajtur lugët, lugës, shelqe (F.'80, f.1703).*
- ujtue** (f.227) - *ujitë, vaditë. F.'54, ujtis –lëshon lagështi, lagëson (F.'54, f.589). F.'80, ujtis - lëshon lagështi, bulon nga pak ujë, lagëson (F.'80, f.2084).*
- ulmî-ni** (f.227) – *ulptî. F.'54, ulpti – ulptini – 1. lloj vidhi me trung të lëmuar, me fletë të mëdha, si të rrumbullakta dhe me majë, nga sipër me push t'ashpër e nga poshtë me push të butë . 2. tjetër lloj vidhi (F.'54, f.590). F.'80, ulpëti-ni – hithës (F.'80, f.2087).*
- xanafillë-a** (f.236) – *Fj. zanafillë. F.'54, zanafillë-a – origjina, fillimi i një gjëje (F.'54, f.626). F.'80, zanafillë-a – fillimi i diçkaje, pikënisja, burimi; prejardhja, origjina (F.'80, f.2209).*
- xanë-a** (f.236) -1. si Fj. 2. *gjerjeshtë, gjeshter, gjineshter, spartë, bime e fam.bishtajore deri në 3m e naltë. F.'54, xanë-a – gjeshtër, gjineshtër (F.'54, f.621). F.'80, xanë-a – 1. gjineshtër. 2. pëlhurë e trashë, e ashpër dhe e lirshme prej fijeve të gjineshtres, që përdoret për të bërë thasë, torba etj. (F.'80, f.2191).*
- zabullim-i** (f.238) – *zabullinë. F.'54, zabullinë-a – ufëm, bulçim, zagushi (F.'54, f.625). F.'80, zabullimë-a – bulçim, ufëm, zagushi (F.'80, f.2207).*

- zallanë-a** (f.238) - *njifarë bari*. F.'54, **zallinë-a** – *vend, tokë e mbuluar me zall, me gurë* (F.'54, f.626). F.'80, **zallinë-a** - *tokë e keqe, që ka shumë gurë, tokë e përzier me zall; zallishtë* (F.'80, f.2208).
- zgabell** (f.240) - *zgobell, rabel*. F.'54, **zgobell-e** – *thuhet për një njeri të gjatë (me kuptim të keq)* (F.'54, f.633). F.'80, **zgobell-e** – 1. *që e ka trupin të gjatë, por të shëmtuar*. 2. *përd. em. sipas kuptimit të mbiemrit* (F.'80, f.2235).
- zgardhullue** (f.240) – *zgardhue*. F.'54, *zgardhnohet* – *thuhet për fuçinë, kur i dalin dhogat jashtë gardhnës* (F.'54, f.633). F.'80, **zgardhnohet** - *i dalin fuçisë degët jashtë mbajtëseve; priset, shturet (për gardhin)* (F.'80, f.2234).
- zgebe-ja** (f.240) – *kromë*. F.'54, *zgebe-zgjebja* – *sëmundje ngjitëse e lëkurës, shkaktohet nga një parazit; çfaqet me të ngrënë të lëkurës dhe me puçrra që kanë ujth brenda* (F.'54, f.634). F.'80, **zgebe-ja** – *sëmundje ngjitëse e lëkurës te kafshët dhe te njerëzit, që shkaktohet nga një parazit dhe shfaqet zakonisht midis gishtave, në bark, në kurriz, në kofshë etj., me puçrra me ujë e me kore, të cilat kruhen shumë; kromë* (F.'80, f.2237).
- zgiebak** (f.240) – *Fj. zgjebarak*. F.'54, **zgjebarak-e** – *që ka zgjeben; përdoret edhe si sharje* (F.'54, f. 634). F.'80, **zgjebarak-e** – 1. *që ka zgjebën, që është me zgjebe*. 2. *njeri i fëlliqur e i veshur keq*. 3. *njeri i keq e i poshtër, njeri i pacipë i cili përçmohet nga të tjerët* (F.'80, f.2237).
- zgobell** (f.240) - *zgabell, gavell, me shtat të madh e të pahijshem*. F.'54, **zgobell-e** – *thuhet për një njeri të gjatë (me kuptim të keq)* (F.'54, f.633). F.'80, **zgobell-e** – 1. *që e ka trupin të gjatë, por të shëmtuar*. 2. *përd. em. sipas kuptimit të mbiemrit* (F.'80, f.2235).
- zgrifth-i** (f. 240) – *zgrip, skaj, buzë*. F.'54, **zgrip-i** – *ana, buza* (F.'54, f.634). F.'80, **zgrip –i** – 1. *buza e një gremine, e një shkëmbi të thepisur etj; skaji i një sendi, ana, buza*. 2. *pika e fundit, fundi, mbarimi i diçkaje*. 3. *pakicë; shtrëngicë, kursim* (F.'80, f.2235).
- zgripue**(f.240) - *dhanë me pakicë, kursim*. F.'54, **zgriptoj** – *sa zë fill*. 1. *shpenzoj me zgrip nga pak*. 2. *e shpie gjer në zgrip, gjer në fund* (F.'54, f.634). F.'80, **zgriptoj** – 1. *kursej shumë, shpenzoj me zgrip*. 2. *e çoj diçka deri fare afër fundit, e çoj deri në zgrip*. 3. *sapo filloj, sa nis diçka* (F.'80, f.2235).

Fjalori i Benedikt Demës dhe pasqyrimi i leksikut të tij në Fjalorët normativë (1954,1980)

- 1.Fjalë që nuk janë përfshirë në Fjalorët (1954,1980)
- 2.Fjalë me kuptim të ndryshëm
- 3.Fjalë me kuptime shtesë
- 4.Fjalë që janë përfshirë vetëm në Fjalorin e 1954
- 5.Fjalë që janë përfshirë vetëm në Fjalorin e 1980
- 6.Fjalë që janë përfshirë në Fjalorët normativë (1954,1980)



Përfundimet

Qysh në ideimin dhe hartimin e platformës së kësaj teme, kemi synuar që, nëpërmjet shqyrtimeve dhe paraqitjes sa më të gjerë të leksikut të fiksuar në disa prej fjalorëve më të njohur të gegërishtes veriperëndimore, të mbërrinim edhe në një pamje relativisht të qartë e të plotë të vlerave fiksuese e njohëse të atyre fjalorëve si të tillë, po edhe, mbi të gjitha, të shihnim se sa ka përfituar prej tyre përfshirja në fjalorët e mëdhenj të shqipes dhe sa kanë peshuar të dhënat a prurjet e gegërishtes veriperëndimore në pasurimin potencial dhe real të leksematikës dhe thesarit ligjërimor të shqipes në tërësi. Këtij synimi, qoftë edhe disi largvajtës dhe jo i lehtë për t'u rrokur e zhदारitur plotësisht, i ka shërbyer edhe struktura e kësaj teze, e cila përbëhet prej pjesësh që përfshijnë:

Së pari, e si “bazë nisjeje”, në punimin tonë synuam të paraqesim veçoritë e së folmeve të gegërishtes veriperëndimore, duke ravijëzuar tiparet fonetike dhe morfosintaksore të tyre, sipas asaj që dihej nga studimet dialektologjike të kryera në rrjedhë të viteve, qysh nga Relacioni i M.Lambercit i vitit 1916, deri në studimet më të reja për të folmet e qytetit të Shkodrës dhe të pjesës më të madhe të krahinave veriperëndimore, si ato të Malësisë së Madhe (Shkrelit, Kastratit, Hotit, Kelmendit, Rranxave të Mbishkodrës, qytetit të Lezhës, Bregut të Matës dhe të folmet e malësorëve në Mal të Zi), të përshkruara kryesisht nga B.Beci e Gj.Shkurtaç, po edhe të të folmeve të tjera veriperëndimore si të Bregut të Bunës, studiuar nga J.Gjinari, të Postripës, studiuar nga F.Luli, të Shirokës, studiuar nga T.Osmani, si dhe të Thethit, studiuar nga J.Kastrati.

Një pamje edhe më të përditësuar natyrisht do ta fitonim nëpërmjet hartave të Atlasit dialektologjik të gjuhës shqipe, vepër madhore e gjuhësisë shqiptare, hartuar nga grupi i autorëve J.Gjinari (drejtues), B.Beci, Gj.Shkurtaç, Xh.Gosturani, (botuar në Napoli, vëll.I, 2007, vëll.II, 2008).

Së dyti, sinonim (dhe shpresojmë t'ia kemi mbërritur) të shqyrtojmë krejt pasurinë leksikore të Fjalorit të Frang Bardhit (1635), duke rrokur në një vështrim të përgjithësuar disa prej problemeve të prekura edhe më parë prej studiuesve, porse pa dhënë në formë përfundimtare krejt vlerat dhe hapësirat e prurjeve dhe fiksimit aty të leksikut të shqipes në një rrafsh edhe përqasës, qoftë edhe thjesht për shpjegim, me latinishten.

Në këtë kuadër, natyrisht, detyrë me rëndësi dhe pjesë kryesore e trajtimit tonë nuk mund të mos ishte edhe shqyrtimi e pohimi a vënia në peshore e rëndësisë dhe vlerave të “Fjalorthit të Ri” të dom Nikoll Gazullit (nga seria e njohur e Visareve të Kombit), 1941, vepër që, për ironi të fatit, ndonëse autorit për shumë vjet nuk i përmendej dot as emri, sepse mbahej si “armik”(?!), e i pushkatuar nga regjimi komunist, ka qenë në dorën e studiuesve më të dalluar të shqipes dhe ka gjetur citim e mbështetje të shpeshtë sidomos në studimet etimologjike në fushë të shqipes nga mjeshtri i madh i gjuhësisë dhe i shqipes, prof.Eqrem Çabej.

Kuadri i trajtimit sa më shterues, po edhe që të përfshiheshin mbarë hapësirat e njohura e të fiksuar të fjalëve dhe kuptimeve leksiko-frazeologjike të anëve veriperëndimore na impononte që, në kufijtë e tematikës së studimit tonë të përfshinim edhe sa ishte paraqitur në “Fjalorin të fjalëve të rralla” të Benedikt Demës, me rreth 5000 fjalë, hartuar më 1967 dhe botuar “postmortem” në vitin 2005, redaktuar nga Tefë Topallit e botuar nga Dom Nikë Ukgjini e Shaban Sinani.

Ndërkaq, pasuritë e gjera të shqipes së anëve veriperëndimore janë paraqitur edhe në veprat e Gjergj Fishtës, sidomos te kryevepra e tij “Lahuta e Malcis” dhe ato, sikundër del edhe nga parashpresa jonë, kishim një studim relativisht të plotë në monografinë e shkruar nga Benedikt Dema “Fjalori i fjalvet të rralla shqipe të përdorura në veprën e Gjergj Fishtës “Lahuta e Malcis”, botimi XV, Shkodër, 2006, me mëse 1600 fjalë.

Afrimi pranë e pranë dhe kundrimi krahasimtar, përmasës dhe diferencues i veprave leksikografike të këtyre autorëve me karakteristikat kryesore të së folmes së gegërishtes veriperëndimore, është bërë për faktin se, sikundër ngulmonte qysh në ideimin e hartimin e platformës udhëheqësi im shkencor, Bardhi, Gazulli e Dema kanë qenë (ndonëse me kulturë filologjike e albanologjike të ndryshme) folës të lindur të idiomës geqe të kësaj treve.

Bardhi qe përgatitur me kulturë klasike perëndimore në Propagandën Fide në Romë, sipas gjasave zotëronte gjuhët klasike dhe italishten moderne e i takoi ta përballte për herë të parë shqipen me një gjuhë aq të lëvruar siç ishte latinishtja e shkruar – provë që ia doli me sukses.

Studiuesi Mustafa Kruja shprehet: “*Sikur t’u shkruente sod një vepër gjuhe si fjalor’i Frangut të Bardhë nuk do të vjyente as shpenzimet e shtypit. I shkruem e i botuem në 1635 është një thesar, si të gjitha dokumentet e vjetra të gjuhës s’onë prej qindvjetit XVI...*”²⁴⁰

Megjithëse kjo vepër e parë leksikografike u hartua me qëllimin që misionarët e huaj klerikë të mësonin shqipen e ta përdornin në shërbesat fetare, nuk mund të themi se në fjalësin e Bardhit mungon leksiku popullor, me fjalë të përdorimit të përditshëm në rafshin mesatar e të ulët.

Studiuesit kanë vënë në dukje jo vetëm vlera historike të këtij Fjalori të parë dygjuhësh latinisht –shqip, por janë shprehur edhe për cilësitë e tij, veçoritë shkencore të mjaftueshme për të hedhur bazat e kësaj shkence gjuhësore në Albanologji.

Edhe Gazulli ishte klerik, por i formuar gjuhësisht dhe filologjikisht jo në shkollën latine (dhe i mungon përgatitja linguistike klasike), por në atë kohë (para Luftës së Dytë Botërore) në shkollën austro-gjermane, ku prej më se një shekulli ishte bërë qendra e studimeve albanologjike evropiane. Fliste e shkruante veç latinisht, greqisht, por edhe italisht, gjermanisht e frëngjisht.

Bie në sy, së pari, tek ky leksikograf jo vetëm mbledhja e kujdesshme me kritere shkencore e lemave, por edhe shpesh shpjegimet etimologjike, etnolinguistike dhe etnografike.

Për këtë, ky Fjalor ka pasur referime dhe është bërë mbështetje për mjaft gjuhëtarë me emra të huaj dhe vendës, si: Jokli, Pedersen, Desnickaja, Çabej, Riza, Beci, Shkurtaç, Simon Pepa etj.

Ky Fjalor i serisë që thamë më lart nuk është vetëm krahinor (siç është quajtur rëndom), por ai përmban edhe të dhëna sa i takon të folmeve të tjera, të gegërishtes verilindore e qëndrore.

Bashkë me Fjalorin e Pano Tases “Fjalë të mbledhuna në Jug të Shqipërisë”, vepër e së njëjtës seri, përbëjnë një fillesë me vlerë të leksikografisë dialektore shqiptare.

Benedikt Dema, dhe ky një klerik, i cili dha ndihmesë me vlerë në gjuhësinë shqiptare, duke lënë gjurmët e tij në lëmë të leksikografisë, me “ Fjalor fjalësh të rralla të gjuhës shqipe” të mbledhura në Veri të Shqipërisë.

Në “Hyllin e Dritës” ai ka botuar më tepër se 50 artikuj e studime shkencore dhe publicistike, duke përdorur si nënshkrime dhe pseudonimet: “Ben-dea” dhe “P.B.D”.

²⁴⁰M. Kruja, *Nji studim analitik Gjuha e Frang Bardhit dhe shqipja moderne*, Tiranë, 2007, f. 73.

Dihet, gjithashtu, se edhe “Fjalori i shqipes”, krahas me “Fjalorin enciklopedik”, janë dy prej veprave më të rëndësishme filologjike të At Benedikt Demës.

2. Një studim monografik si ky yni, sigurisht, nuk mund të mos jepte edhe një vështrim historik e kulturor të krahinave veriperëndimore të shqipes dhe vatërzimin aty të qendrave të shkrimtarisë së vjetër shqipe (që nga autorët e vjetër, prej të cilëve me leksikografi ishte marrë vetëm F. Bardhi, por që ajo hulli do të vazhdonte, duke u shquar aty mbi të tjerët, së pari, N.Gazulli (Geladius) dhe B. Dema.

Lidhur me vatërzimin e qendrave të shkrimtarisë së vjetër shqipe, së pari u referohemi relacioneve të mbajtura nga prelatët rreth gjendjes së Shqipërisë veriore në shekujt XI-XVI e në vijim.

Kjo kohë për historinë e popullit e të vendit tonë, është periudha kur lufta më shumë se njëqindvjeçare kundër pushtimit osman kishte arritur kulmin.

Kryengritjet e shpeshta të shqiptarëve u kishin shkaktuar vështirësi të mëdha sundimtarëve, por këto kryengritje kishin sjellë një ringjallje në popull, duke mbajtur të gjallë dashurinë për vendin dhe për larminë e tij.

Këto relacione janë dëshmitare se Vatikani merrej për luftën e shqiptarëve për çlirim kombëtar.

Me pushtimin e vendit nga Turqia, kisha katolike u gjet pa një organ qendror brenda perandorisë dhe dalëngadalë filloi shkatërrimi i saj. Për këtë arsye, kishat katolike dhe komunitetet pësuan në Shqipërinë e Veriut e të Mesme, presionet më të rënda nga ana e feudalëve turkë.

Një ndihmesë themelore në vatërzimin e shkrimtarisë së vjetër shqipe luajtën edhe leksikografët shqiptarë të trevës së veriut Frang Bardhi, Nikollë Gazulli e Benedikt Dema, por nuk duhet lënë pa përmendur edhe ndihmesa e hullia e mbarë gjuhëlvruese e gjuhëdashëse e filluar më herët nga veprat e Buzukut, Budit dhe Bogdanit.

Si çështje të dytë, me vlerë edhe teorike të përgjithshme e këtij vështrimi historiko-kulturor dhe jo mirëfilli gjuhësor, porse i lidhur ngushtë pikërisht me kuadrin e kohës e të përpjekjeve për ruajtjen e shqipes nga bijtë e saj të shquar, qofshin meshtarë a njerëz të fesë, kemi trajtuar rolin e klerit zadrimer e më gjerë për pohimin dhe lëvrimin e gjuhës shqipe.

Kërkesa për dije e arsimim ishte edhe synimi kryesor i klerit, për këtë arsye, u hapën shkolla në gjuhën shqipe dhe mësues në to u bënë priftërinjtë. Duhet të hynin idetë e Rilindjes për të emancipuar shoqërinë shqiptare të kohës, u botuan libra, u organizuan edhe kuvende të vogla në krahina e zona që idetë e kryengritjeve të shkonin deri te njeriu më i thjeshtë. Mund të themi se kjo lëvizje pati një organizim të përsosur e drejtim intelektualësh.

Në vitet 1920-30-40, kjo lëvizje arriti nivele të larta zhvillimi nën drejtimin e patriotëve e intelektualëve të ngarkuar me detyrat e ipeshkëvinjve Pjetër Budi nga Guri i Bardhë i Matit dhe Frang Bardhi nga Nenshati i Zadrimesë.

Veprat në gjuhën shqipe gjatë shekujve të parë të pushtimit osman janë të pakta. Më e vjetra prej tyre që ka mbërritur deri në ditët tona, është "Meshari" i Gjon Buzukut (1555). Me veprën e Buzukut kemi një vazhdimësi të kulturës shqiptare edhe në kushtet e vështira të pushtimit osman, kulturë që në humanistët u përfaqësua me vepra kryesisht në gjuhën latine, që ishte gjuha e kulturës e kohës dhe që u pasurua më vonë me veprat e Budit, Bardhit, Bogdanit etj., në gjuhën shqipe.

Vepra e Buzukut nuk ka vetëm meritë letrare, por është edhe një hap i guximshëm kulturor, që bën pjesë në luftën e popullit shqiptar për çlirim e përparim.

Puna e kolosale e F. Bardhit i takon mbledhjes së fjalëve, kryesisht përkthimit shqip të fjalëve latine, sepse, sipas tij, theksonte nevojën për t'i ndihmuar gjuhës shqipe, e cila po humbiste e po bastardhohej.

Kështu Bardhi, në kushtet e një studenti në Propagandën e Fides në Romë “...*ghiuhene tane ghi po bdarete e po baftarçohete faa maa pare te vé...*”²⁴¹, ia del të hartojë një Fjalor dygjuhësh (latinisht - shqip me rreth 2500 fjalë), duke përballuar për herë të parë shqipen me një nga gjuhët më të lëvruara të botës (për shekuj me radhë gjuhë e kulturës e shkencës dhe e letërsisë).

Pjetër Bogdani është figura më e shquar e letërsisë së vjetër shqiptare. Ai shquhet jo vetëm si klerik i lartë, por edhe si atdhetar, me një dashuri të pakufi për gjuhën shqipe e për popullin shqiptar, por edhe si dijetar e letrar, si luftëtar i paepur për çlirimin e vendit nga zgjedha osmane dhe për zhvillimin e përparimin e tij kulturor.

Katër B-të (Buzuku, Budi, Bardhi e Bogdani) u nisën nga dashuria për atdheun, ashtu siç shprehej edhe vetë Buzuku: “*En seh dasunit she botesse saneh...*”²⁴² Shkrimtari i fundit i kësaj radhe mjeshtrash të gjuhës shqipe, është Bogdani, i cili zë fill me veprën e parë origjinale “*Cuneus Prophetarum*”²⁴³ 1685. Ky shkrimtar nuk përballi shqipen me gjuhë të huaja, por fakti dhe dëshmoi se gjuha jonë ka mundësi e shprehësi për fusha të ndryshme të dijës, si: teologji, pedagogji, filozofi, e drejta morale.

Të katër këta autorë (studiuar në fushë të leksikut nga gjuhëtari K.Ashta)²⁴⁴ pasqyrojnë me mjaft vërtetësi qëndresën e shqipes ndaj gjuhëve përreth si dhe depërtimin e orientalizmeve, të cilat vijnë e rriten nga Buzuku tek Bogdani.

“*Shqipja e autorëve shqiptarë të shekullit 17 – Pjetër Budit, Frang Bardhit, Pjetër Bogdanit, është letrare par excellence. Ajo shpesh paraqet veçori mbidialektore në shkallën që filologët e kanë të vështirë të identifikojnë të gjitha elementet specifike të idiomave të tyre natyrore. Ata madje jo rrallë kanë folur për procese të mirëfillta koineizimi brenda gegërishtes lidhur me gjuhën e Bogdanit...*”²⁴⁵

Një emër tjetër është edhe Gjon Nikollë Kazazi. Gjon Nikollë Kazazi, duke ndjekur traditën e ndritur të shkrimit shqip të paraardhësve të tij, kishte përkthyer dhe botuar katekizmin Doktrina e krishterë (Romë 1743).

At Donat Kurti edhe pse ishte në burg vazhdoi punën shkencore, nga e cila e ndau vetëm vdekja. Atje ai njihej me të burgosur të krahinave të ndryshme të Shqipërisë, dhe mbledhte fraza gjuhësore që përdornin ndër ato krahina. I shkruante ndër fletore dhe përgatiste “Fjalorin razeologjik të Gjuhës Shqipe”. Ky fjalor kishte 45000 fraza.

Një tjetër figurë e ndritur në kulturën shqiptare, një intelektual dhe klerik i madh, ishte edhe At Gjergj Fishta. Në bashkëpunim me abatin e Mirditës, imzot Prengë Doçi, i jep jetë Shoqërisë Letrare dhe Kulturore “Bashkimi”, boton artikuj të rëndësishëm e të mprehtë, duke përhapur të vërtetën në një numër sa më të madh njerëzish.

Mund ta themi me plot gojën se pa Fishtën historia e kultura shqipe do të ishte e mangët. Ndihmesa e këtyre klerikëve-gjuhëtarë la gjurmë dhe gjithashtu hodhi bazat e mirëfillta të leksikografisë dhe leksikologjisë shqipe.

²⁴¹ B.Demiraj, “*Dictionarium Latino-Epiroticum*”, Shkodër, 2008, f.75.

²⁴² T.Topalli, A.Haxhi, *Shqipja e shkruar në shekullin e XVI-XVII*, “Histori e gjuhës së shkruar shqipe”, Ushtrime, Shkodër, 2007, f.18.

²⁴³ Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Insituti i gjuhësisë dhe i letërsisë, Pjetër Bogdani, *Cuneus prophetarum*, botim kritik përgatitur nga Anila Omari, Tiranë, 2005. (Mësonjëtorja).

²⁴⁴ K.Ashta, “Leksiku historik i gjuhës shqipe”, 1-6, 2000-2012, botim i ISA, Shkodër.

²⁴⁵ Rexhep Ismajli, “Gjuhë standarde dhe histori identitetesh”, Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Tiranë, 2005, f.32.

3.Pjesa mirëfilli filologjike dhe e lidhur me vlerësimin e peshës e rëndësisë që pati punë leksikografike e leksikologjike e autorëve të fjalorëve dialektorë - krahinorë në përgjithësi dhe vendi i tre autorëve (Bardhi, Gazulli, Dema) në veçanti. Konkluzioni a përfundimi ynë kryesor është se të tre këta “të mëdhenj të leksikografisë shqipe” (Bardhi, Gazulli, Dema) na lanë një trashëgimi të pasur gjuhësore, ku secili prej tyre është “i parë” në llojin e vet.

Fjalori i Bardhit përbën Fjalorin e parë të mirëfilltë dygjuhësh shqip – italisht, Gazulli na la Fjalorin e parë krahinor (të gegërishtes veriperëndimore), Dema, gjithashtu, i parë në llojin e vet, ku me punën e tij hulumtuese, na pasqyroj një shtesë fjalësh që nuk ekzistonin në Fjalorin e gjuhës shqipe të '54, ose që kishin një kuptim të ndryshëm nga ky Fjalor.

E përbashkëta e këtyre tre autorëve ishte, se të tre ishin njerëz të fesë katolike (priftërinj), të tre dhanë ndihmesa të vyera në lëmë të leksikografisë, duke na lënë tre fjalorë të pasur e të rëndësishëm dhe, më e rëndësishmja, vërejmë se në këta fjalorë, pasqyrohet e folmja gege, përkatësisht zona e Zadrimës, Shkodrës e Malësisë së Madhe.

Fjalori i Frang Bardhit dhe vlerat e tij si i pari ballafaqim i shqipes me një gjuhë të madhe, siç ishte latinishtja, mund të themi se ai nuk e ndjen veten të plotësuar krejtësisht me këtë vepër, sepse duke qenë në dhe të huaj për shtatë vjet, nuk arrinte të kujtonte shumë prej fjalëve shqipe, dhe se nuk kishte me kë të këshillohej për këtë vepër. Këtë Fjalor Bardhi e punoi me qëllimin që të lëvrohej gjuha shqipe e të pasurohej larg bastardhimeve e prishjes së saj.

Kjo vepër leksikografike ka vlerë të madhe gjuhësore, jo vetëm për paraqitjen e fondit leksikor të gjuhës sonë, por edhe për formimin e disa neologjizmave të krijuara sipas bazave gramatikore të gjuhës shqipe.

Bardhi kishte si qëllim që të bënte një fjalor praktik që t'u shërbente edhe atyre që nuk kishin njohuri gjuhësore.

Puna leksikografike e këtij autori do vlerësohet, se është i pari ballafaqim i shqipes me një gjuhë të lëvruar, siç ishte latinishtja; nga njëra anë për vështirësitë si fjalor dygjuhësh, dhe, nga ana tjetër, autori nuk pati me kë të konsultohet, sepse kishte shtatë vjet që kishte shkuar në Itali.

Sfera e lemave të përfshira është e përdorimit të përgjithshëm ligjërimit, gjithashtu janë sjellë edhe elemente të latinishtes kishtare, një fushë përdorimi praktike për shërbesat fetare.

3.1. Fjalori i Frang Bardhit dhe struktura e tij. Areali gjuhësor i Fjalorit të Bardhit. Vepra e Frang Bardhit meritonte (dhe meriton) analiza dhe studime të thukëta gjuhësore, ashtu si ishte bërë për fjalorin e Kristoforidhit, të Bashkimit etj.,sepse, sikundër shprehet Kolë Ashta, ky Fjalor mund të ketë ndihmuar për një tjetër “Fjaluer latin – shqip” botuar nga etërit jezuitë në Shkodër, më 1925.²⁴⁶

Përsa i takon sasisë së fjalëve shqipe dhe atyre të latinishtes, vërejmë se kemi 2500 fjalë shqipe dhe 5000 ato latine. Kjo dukuri ka ndodhur për faktin se autori shumë fjalëve latine u ka dhënë kuptime të njëjta në gjuhën shqipe.

3.2.Në studimin tonë u përpoqëm të bënim edhe shtresëzimin e lëndës që gjenden Fjalori i Bardhit,duke mbërritur në përfundimet si vijon:

²⁴⁶K.Ashta, “Leksiku historik i gjuhës shqipe” III, Shkodër, 2000.f.63.

Shtresën e parë e përbëjnë frazeologjizmat a proverbat që kanë qenë e janë pronë e mbarë gjuhës, për të cilat as historikisht nuk mund të vërtetohet burimi krahinor, kurse në gjendjen e sotme, nuk kanë asnjë tregues krahinor.

Shtresën e dytë e përbëjnë frazeologjizmat a fjalët e urta me burim dialektor a krahinor, por, që tashmë janë përgjithësuar e që gjuha shqipe i ka bërë pronë të saj.

Shtresën e tretë e përbëjnë ato frazeologjizma a fjalë të urta dialektore a krahinore. Tek këto lloj proverbash, shumica nga ato nuk i ndeshim në gjuhën letrare, por janë dialektore e krahinore, të cilat përdoren vetëm në disa krahina të Shqipërisë, kryesisht gegërishtes perëndimore, nga ishte dhe vetë autori.

3.3. Në bazë të hulumtimeve dhe shqyrtimeve të studimit tonë ishte edhe arsyetimi e nyjetimi sa më i mbështetur i pohimit tashmë edhe të parathënë rreth rolit të Frang Bardhit si i pari leksikolog e leksikograf i gjuhës shqipe, si dhe i disa prurjeve gramatikore në Fjalorin e Bardhit.

Përveç sa u tha më sipër, Bardhi la gjurmë edhe si gramatikan, për të cilin themi se gjejmë edhe gjurmët e para për një gramatikë të shqipes.

Bardhi në këtë rast jep disa elemente të gramatikës së shqipes, kryesisht për pjesët e pandryshueshme të ligjëratës. Bashkohemi me mendimin e shprehur nga akad. Jani Thomai, i cilin nxjerr në pah se Frang Bardhi e ka ndier nevojën që ta vërë shqipen në vend të parë. Kështu vepron me ndajfoljet, të cilat i jep shqip- latinisht, ose ndonjë shqip – italisht, me pasthirrmat që i jep vetëm në shqip, me shembujt për parafjalët, të cilët i jep shqip – latinisht²⁴⁷, dhe kjo, sigurisht, do të thotë se, Frang Bardhi nuk ka pasur si qëllim kryesor motivin fetar e biblik, por më tepër dëshirën për t'i shërbyer gjuhës shqipe.

4. “Fjalori i ri” i Nikollë Gazullit mund të shihet edhe si vepra e parë e madhe që ka përfaqësuar në të të folmet e shqipes veriperëndimore. Në studim jemi përpjekur të dalë në pah gjerësia e tij, vlera njohëse dhe pohuese e pasurisë leksikore të shqipes veriperëndimore në atë fjalor.

Fjalësi i këtij “Fjalorhi” paraqet më së miri një hapësirë të së folmes së gegërishtes veriperëndimore, përkatësisht trevës së Malësisë së Madhe (Bajzë, Bogë, Egçi i Bregut, Gruda e Madhe, Gruda e Vogël, Gruemira, Kastrati, Kelmendi, Hoti, Reçi, Rrjollli, Shkreli (ku ai kaloi shumë vite të jetës së vet dhe, natyrisht prej asaj treve ka sjellë edhe një shumicë fjalësh²⁴⁸), Shkodra, Dukagjini, Lezha, por kemi edhe fjalë nga gegërishtja verilindore, si zonat e Pukës e gegërishtja qendrore, ku përfshihet Mirdita me zonat përkatëse.

Për Gazullin gjuha e folur e popullit, është ajo që duhet t'i japë shkrimtarit fondin themelor të mjeteve të shprehjes dhe se lëvruesi i gjuhës letrare duhet të depërtojë në shtresa të thella të saj, në leksikon dialektor e krahinor përkatës.

4.1. Fjalësi i tij përfshin mjaft aspekte të të jetës shqiptare, historisë, gjeografisë, kulturës (kryesisht zonave të gegërishtes veriperëndimore) duke na dhënë një pasuri leksiko-frazeologjike të shqipes, duke i dhënë lemave përkatëse ngarkesa e ngjyrimë kuptimore të reja e duke zgjeruar valencat e tyre në bashkëvajtje me kategori të tjera morfologjike.

Si njohës i mirë i gjuhëve të huaja dhe me një përgatitje të lartë filologjike klasike e moderne, në shumicën prej fjalëve, ai jep edhe përgjegjëset e tyre në gjuhë të tjera, si

²⁴⁷Jani Thomai, *Frang Bardhi leksikograf*, “400 – vjetori i Frang Bardhit”, Prishtinë, 2007, f.59.

²⁴⁸ B.Beci, *E folmja e Shkrelit*, “Dialektologjia shqiptare”I, Tiranë, 1971.

italisht e latinisht, ose edhe gjermanisht e frëngjisht, kjo ndoshta për të treguar edhe etimologjinë e asaj fjale.

4.2. Tjetër element me vlerë, që nuk duhet lënë pa u përmendur, është se autori i ka kushtuar rëndësi faktit të përdorimit të një gjuhe të mesme, në mënyrë që të kuptohet nga të gjithë shqiptarët e të gjitha trevave. Ai e thotë qartë:

“...sa për gjuhë të mjesme m'arr lëjën me shkruar një oroe qi më duket me vend. Fjalën: gjuhë e mjesme: ka pasë asi Shqiptarësh qi e kanë m'arrë në vështrim të dheshkrojës, shka po diftoj qi asht një hutim (gabim)...”²⁴⁹

P.sh.: kemi fjalën *qeshë*, ku në Pukë jep variantin *keshë*, si trajtë të mesme jep përdorimin e Bardhit *me kjeshun* ose në Malësinë e Madhe jep variantet *kelbë*, *kjelbë*, *qjelbë*, por edhe *qelbë* si përdorim në M.M e Pult të Dukagjinit, në krh. me *qelbë*, standard.

4.3. Larmia frazeologjike del tepër e pasur dhe interesante, e cila pasqyron më së miri mendësinë dhe psikologjinë e zonave malësore të gegërishtes veriperëndimore.

Këto frazeologjizma i kemi klasifikuar sipas strukturës gjuhësore përkatëse, duke i ndarë në frazeologjizma me strukturë togfjalëshi, me strukturë fjalie, me vlerë mbiemërore, foljore, ndajfoljore.

4.4. Në punimin tonë jemi përpjekur të hulumtojmë e të nxjerrim në pah edhe disa elemente etnolinguistike, me vlerë që ndeshim tek Fjalori i Gazullit, të cilat pasqyrojnë, mendësinë, psikologjinë, karakterin dhe kulturën shpirtërore dhe materiale të popullit shqiptar, sidomos atij në zonat më të skajshme veriore. Natyrisht ato japin dorë edhe për trajtime të metejshme, porse ato, ndërkaq, vetëm sa i kemi përmendur, sepse trajtimi i tyre i thelluar do të shkonte larg caqeve të ideuara e të pranueshme për synimet e studimit tonë, kryesisht leksikologjik e dialektologjik.

4.5. Në lëmin formimit të fjalëve, gjithashtu, lënda e Fjalorit të Gazullit ofron mjaft struktura interesante, formime fjalësh me mënyra e tipa fjalëformimi të shumta, të cilat bëjnë që kjo vepër, edhe nga kjo anë, meriton interesimin dhe vëmendjen e studiuesve, qoftë në aspektin leksikologjik, qoftë edhe thjesht gramatikor, kur është fjala për tipologjinë e disa fjalëformimeve emërore, foljore dhe mbiemërore, ndonjëherë edhe të panjohura (d.m.th. të pafiksuar) më parë në vepra leksikografike as në studime gramatikore e dialektologjike.

4.6. Megjithëse është i tipit krahinor, në Fjalorin e Gazullit, fjalët e përfshira kanë valencë leksikore njëlloj si fjalët e fjalorëve normativë të gjuhës shqipe, prandaj edhe na u duk e arsyeshme dhe e frytshme të bëjmë edhe një përjasje me «Fjalorët e gjuhës shqipe» të viteve 1954, 2006.

Bashkëlidhja leksikore e fjalëve përcaktohet nga faktorë të jashtëm gjuhësorë, ku sendi dhe objekti duhet të kenë lidhje logjike mes tyre, p.sh., mund të thuhet ka *sy të shkruar*, por nuk thuhet ka *buzë të shkruara*, ose *flokë të verdhë*, por jo *sy të verdhë* etj. Kjo ka të bëjë me atë që quhet edhe ligji i valencës²⁵⁰. Në Fjalorin e Gazullit kemi vënë re se të gjitha fjalët semantizohen në një kontekst a situatë të caktuar.

Fjalëve përkatëse dialektore, Gazulli u jep valencë leksikore, duke i shoqëruar me fjalë përcaktore të ndryshme. Neve na del se pjesët e ligjëratës që më së tepërmi

²⁴⁹N.Gazulli, *Parathanje*, “Fjalori i Gazullit”, Tiranë, 2005, f.8.

²⁵⁰A.Kostallari, *Kompozitat dëshirore dhe urdhërore të shqipes*, “Studime filologjike” 4, Tiranë, 1968.

formojnë valencë leksikore janë emrat, mbiemrat e foljet, dhe tek-tuk ndonjë ndajfolje.

5. Pjesë me vlerë dhe që i kemi kushtuar trajtime të hapëta është edhe ajo ku Malësia e Madhe dhe Gropa e Shkodrës kundrohen si si vatra kryesore e leksematikës së Gazullit. Kemi sjellë aty kundrime tipologjike, tematike dhe strukturore. Duke marrë parasysh shtrirjen dialektore të fjalësit të Fjalorit, vërejmë se, përveç zonave të Malësisë së Madhe, janë përfshirë fjalë edhe nga Puka, Dukagjini, Mirdita, Ulqini, Malësia e Lezhës, Bregu i Bunës, por ka lëndë edhe nga Tirana etj. Kemi nxjerrë leksikun sipas trevave përkatëse dhe jemi munduar të bëjmë një përjasje me leksikun e trevave veriperëndimore të nxjerrë nga Gj.Shkurtaç, B.Beci, Xhabir Topalli, Jorgji Gjinarri dhe të paraqesim sa është i pranishëm Fjalori i Gazullit me lemat përkatëse, duke shënuar vetëm ato raste që i gjejmë të pasqyruara.

6. Një krye të mirë në studim zënë edhe shqyrtime dhe vlerësimet rreth Fjalorit të Benedikt Demës. Autori, sikundër e ka pohuar edhe vetë, për hartimin e këtij fjalori, u mbështet tek Fjalori i Bashkimit 1908, te Fjalorthi i Gazullit, si dhe mori mjaft prej fjalëve të rralla të Fishtës e Kanunit të Lekë Dukagjinit.

Ky fjalor përmban fjalë e shprehje të papërmendura, ose që kanë ndonjë kuptim të ndryshëm nga “Fjalori i gjuhës shqipe” 1954. Në fund të Fjalorit përfshihet një shtesë fjalësh, të cilën autori e quan “Shtesë e fjalorit të gjuhës shqipe”. Në të përmbledhen fjalë të huazuara nga turqishtja, greqishtja etj, e që sot nuk janë më të nevojshme, ose fjalë të përdorura në krahina të kufizuara të Shqipërisë, të vjetruara, të cilat kanë një përdorim të rrallë.

Benedikt Dema na la një fjalor krahinor dhe një punë studimore të pasur gjuhësisht, ku vend të rëndësishëm zënë edhe neologjizmat, fjalë të krijuara nga vetë autori, të cilat, sipas tij, janë të rëndësishme për terminologjinë shkencore. Përfshihen rreth 284 neologjizma të krijuara nga vetë autori (sipas tij), të cilave u kemi bërë një klasifikim kuptimor e gramatikor. Vihet re se, shumica e neologjizmave të krijuara nga Benedikt Dema janë fjalë të formuara me prejardhje (parashtesore, prapashtesore dhe parashteso-prapashtesore) dhe kompozim, ndërsa përngjitja zë një vend relativisht të vogël. Kjo përbën ndihmesë me vlerë, porse autori, duke iu përmbajtur edhe përvujtënisë së petkut si meshtar e njeri i fesë, po edhe si studiues tregohet krejt modest, duke pohuar:

” *Pranimi ose mospranimi i tyre në Fjalorin e gjuhës sonë mvarret edhe këtu prej gjykimit të përbashkët të shkrimtarve shkencatarë*”.²⁵¹

Duke vijuar më tej me Fjalorin e Benedikt Demës, në sythin pasardhës, del në pah përgatitja e tij erudite, si njohës i mirë i gjuhëve të huaja, sepse fjalëve shqipe u ka dhënë korresponduesen e tyre në gjermanisht, frëngjisht, italisht e turqisht.

6.1. Tjetër element i rëndësishëm, që nuk duhet lënë pa përmendur, është se autori në fund të fjalorit, ka si krye më vete, një “tubë fjalësh”, siç shprehet ai, të cialt përbëjnë një *Shtesë e Fjalorit të gjuhës shqipe*.

Këto fjalë sipas Demës, janë huazime nga turqishtja, greqishtja, të cilat sot nuk janë të nevojshme, ose janë fjalë të përdorura në krahina të kufizuara të Shqipërisë, ose fjalë të vjetruara, që nuk përdoren më. Këto fjalë, autori i ka vendosur më vete, në mënyrë që të mos ngatërrohen me leksikun e përgjithshëm të gjuhës shqipe.

²⁵¹B.Dema, “Fjalor fjalësh të rralla të gjuhës shqipe”, Tiranë, 2005, f.8.

Fjalët janë të nxjerra nga Fjalori i Bashkimit, i Gazullit, si dhe prej fjalorthëve të renduem²⁵² të Folklorit kombëtar. Afërsisht numërohen rreth 2436 fjalë, ku pjesa më e madhe prej tyre janë fjalë të huazuara nga turqishtja, një pjesë fare e vogël janë nga greqishtja, të cilat i ka shënuar me gr., dhe nga mbledhja e Folklorit kombëtar.

7. Një pjesë e gjerë e studimit tonë u është kushtuar veçorive leksikore të Fjalorëve, duke i analizuar një për një të tre fjalorët që janë marrë si mbështetje kryesore e lëndore e studimit tonë.

Fjalësi shqip i Bardhit arrin rreth 2500 lema, prej të cilave 1300 janë autoktone. Fjalori nuk ka karakter shpjegues. Shpeshherë krahas leksemave jepen edhe përdorimi i tyre me togfjalësha ose edhe lokucione foljore me vlerën e një fjale të vetme. Të njëjtën dukuri kemi vënë re edhe tek Gazulli e Dema. Mund të themi se autorët, përmes kësaj dukurie gjuhësore, janë munduar të japin një larmi të madhe leksemash e formime togjesh o togfjalëshash, për të nxjerrë më në pah thellësinë e gjuhës shqipe, pasurinë dhe variantet e ndryshme gjuhësore që na paraqet dialekti i gegërishtes, përkatësisht gegërishtja veriperëndimore.

Gjatë nxjerrjes në pah të këtyre lemave është vënë re se tek Fjalori Latinisht–shqip i Frang Bardhit, bie më tepër në sy dukuria e shpjegimit të fjalëve përmes lokucioneve ose togfjalëshave të ndryshëm, ndërsa Gazulli e Dema janë munduar të tregohen më të rezervuar në këtë pikë dhe kanë shpjegimin e tyre përmes fjalëve përkatëse. Kjo tek Bardhi mund të ketë ndodhur për dy arsye. Në radhë të parë, mund të jetë fakti se Bardhi nuk është përpjekur të gjejë ekuivalentet shqipe, ose është munduar t'i krijojë vetë ato, ndërsa arsyeja tjetër mund të jetë, se në atë kohë kur ku krijua Fjalori, 1635, nuk kishte as një alfabet të njësuar, as drejtshkrim e tejet larg për t'u folur për një gjuhë të konsoliduar, gjë që është e vështirë jo vetëm për Frang Bardhin, por edhe për çdo leksikograf tjetër që do merrej me hartimin e një Fjalori në kushte të atilla. Porse, ndryshe qëndron puna për dy Fjalorët e tjerë, që u hartuan pothuaj tre shekuj më pas, të cilët vijnë pas një sërë përpjekjesh nga gjuhëtarë e studiues të ndryshëm për konsolidimin e gjuhës shqipe. Do veçonim këtu punën e vyer të Kongresit të Manastirit (1908) dhe Komisionit Letrar (1916), të cilat na dhanë edhe vendimin, se cilin alfabet do përdorte gjuha shqipe, gjithashtu hodhën edhe kërkesën për unifikimin e gjuhës letrare.

Për këtë arsye Gazulli e Dema janë treguar më të saktë në shpjegimin e fjalëve dialektore e krahinore. Gjithashtu në fjalësin e Bardhit, Gazullit e Demës zë vend edhe shpjegimi me sinonimi, dukuri e cila e pasuron dhe u jep më tepër vlerë këtyre fjalorëve. Gjuha shqipe ka mundësi të mëdha për të përdorur shumë fjalë me kuptim të përafërt, por me një ngjyrim të fortë emocional, të cilat i gjejmë të pasqyruara në këto fjalorë. Këto lloj sinonimesh që do të pasqyrohen u përkasin sinonimeve stilistikore, të cilat mund t'i quajmë fjalë me ngjyrim emocional, ose sinonime dialektore.

8. Shqyrtimi i **shtresës së huaj të Fjalorëve**, ku vërejmë një numër të madh turqizmesh, sllavizmash, më pak italianizma dhe greqizma. Nga të tre Fjalorët, në Fjalorin e Benedikt Demës, numri i turqizmave është tepër i vogël në krahasim me Fjalorët e Bardhit e të Gazullit. Për këtë mund të ketë ndikuar fakti se Dema na ka pasqyruar një Fjalor, i cili përmban fjalë të rralla të gjuhës shqipe që nuk gjenden në Fjalorin e 54, ose kanë një kuptim të ndryshëm nga ai. Kjo, sigurisht, edhe po të kemi

²⁵²Benedikt Dema, Fjalor fjalësh të rralla të gjuhës shqipe, Tiranë, 2005, f. 245.

parasysh fjalësin e shqipes, është e pamundur të mos përfshihen huazimet turke, të cilat janë rrënjësor në gjuhën shqipe, falë ndikimit dhe pushtimit për mëse pesëshekuj në vendin tonë. Por, nuk duhet lënë pa përmendur se autori, në fund të Fjalorit, ka përfshirë një listë fjalësh, të cilat kanë dalë nga përdorimi duke kaluar në arkaizma. Pikërisht aty, numri i turqizimeve është më i madh, të cilat i kemi analizuar më lart.

9. Në kreun e tretë dhe të fundit përfshihet leksiku i autorëve (Bardhit, Gazullit, Demës), që ka gjetur pasqyrim në fjalorët shpjegues të shqipes.

Këtu kemi bërë një listë të fjalësit të këtyre fjalorëve, duke i përqasur me Fjalorët normativë të shqipes (1954, 1980), për të nxjerrë në pah se sa kanë zënë vend lemat e tyre në Fjalorët e sotëm të shqipes. Nisur nga kjo, kemi bërë një klasifikim të tyre si më poshtë:

1.Fjalë që nuk janë përfshirë në Fjalorët (1954,1980)

2.Fjalë me kuptim të ndryshëm

3.Fjalë me kuptime shites

4.Fjalë që janë përfshirë vetëm në Fjalorin e 1954

5.Fjalë që janë përfshirë vetëm në Fjalorin e 1980

6.Fjalë që janë përfshirë në Fjalorët normativë (1954,1980), të cilët i kemi shoqëruar me grafikët përkatës.

Përfundojmë duke shprehur bindjen se, ky studim doktorature, me gjithë punën disavjeçare dhe kujdesin e përkushtimit tonë, nuk mund të konsiderohet si punë e kryer apo e sosur, aq më pak e përsosur, por do të jetë si fushë hulumtimi dhe tëhollimesh të mëtejshme prej meje (dhe, urojmë, edhe prej studiuesve të tjerë), duke lakmuar e synuar që, pa shkuar shumë mot, të kemi edhe një monografi të plotë e sa më gjithëpërfshirëse të pasurisë leksikore të shqipes veripërëndimore. Le të jetë ky studim i yni një sprovë e parë, natyrisht modeste.

BIBLIOGRAFIA

- Ashta, K.** "Leksiku historik i gjuhës shqipe", 1-6, botim i ISA, Shkodër 2000-2012.
- Baliu, B.** *Frang Bardhi dhe albanologjia*, "Kërkime albanologjike" Prishtinë 2010.
- Bardhi, F.** *Skënderbeu "Apollogji"* (përkthyer nga latinishtja, S. Prifti), Tiranë, 1957.
- Beci, B.** *E folmja e Shkrelit*, "Dialektologjia shqiptare" I, Tiranë 1971.
- Beci, B.** *E folmja e Luznisë së Dibrës*, "Dialektologjia Shqiptare" II, Tiranë 1974.
- Beci, B.** "Të folmet veriperëndimore të shqipes dhe sistemi fonetik i së folmes së qytetit të Shkodrës", Tiranë, 1995.
- Beci, B.** *E folmja e Mirditës*, "Dialektologjia Shqiptare" IV, Tiranë 1982.
- Cimochovski, W.** "Le dialecte de Dushmani", 1951.
- Cipo, K.Çabej, E. Domi, M. Krajni, A. Myderrizi, O.** *Fjalor i gjuhës shqipe*, Tiranë, 1954.
- Çabej, E.** *Për një shtresim kronologjik të huazimeve turke të shqipes*, "Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe", Tiranë, 1989.
- Dema, B.** "Fjalori i fjalvet të rralla shqipe e i fjalvet të hueja të përdoruna në veprën e At Gjergj Fishtës, Lahuta e Malcis", Botimi XV, Botime Françeskane, Shkodër, 2006.
- Dema, B.** "Fjalor fjalësh të rralla të gjuhës shqipe", Tiranë, 2005, f.7, (botuar nën kujdesin e Dom Nikë Ukgjinit dhe redaktimin shkencor të Akademikut Koleç Topalli dhe Prof.dr. Tefë Topalli).
- Demiraj, B.** "Dictionarium latino-epiroticum", Shkodër, 2008.
- Dizdari, T.** "Fjalori i Orientalizmave në gjuhën shqipe", Tiranë, 2005.
- Elezi, M.** "Fjalor i gjuhës shqipe", Tiranë, 2006.
- Gazulli, N.** "Fjalori i Gazullit", Tiranë 2005 (botim postum).
- Gazulli, N.** "Fjalori toponomastik", botuar pjesë – pjesë në revistën "Hylli i dritës" nga viti 1939 – 1943.
- Geci, P.** *Frang Bardhi dhe "Fjalori i tij latinisht – shqip"*, "Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe" II, Tiranë, 1972.
- Gosturani, Xh.** *E folmja e Hasit*, "Dialektologjia Shqiptare" III, Tiranë, 1975.
- Gjinari, J.** *Mbi disa elemente slave në të folmet veriore të Shqipërisë Jugore*, "Studime mbi leksikun dhe formimin e fjalëve në gjuhën shqipe" II, Tiranë, 1972.
- Gjinari, J.** *Vëzhgime mbi të folmen e Bregut të Bunës*, "Dialektologjia shqiptare" I, Tiranë, 1971.
- Haxhi, A.- Topalli, T.** *Maximilian Lambertz*, "Leksikon - gjuhëtarë shqiptarë dhe albanologë", Shkodër, 2012.
- Hidi, A.** *Sinonimet dialektore dhe pasurimi i leksikut të gjuhës letrare shqipe*, "Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe", III, Tiranë, 1989.
- Hoxha, Sh.** *Vëzhgime mbi të folmen e Vilë-e- Kalisit të Lumës*, "Dialektologjia Shqiptare" III, Tiranë, 1975.
- Ismajli, R.** "Gjuhë standarde dhe histori identitetesh", Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Tiranë, 2005.
- Islamaj, Sh.** *Fjalori latinisht –shqip i Frang Bardhit, Fjalor i madh apo i vogël*, "400 – vjetori i Frang Bardhit", Prishtinë, 2007.
- Kastrati, J.** *Mbi disa tipare të së folmes së Thethit*, në "Konferenca I e Studimeve Albanologjike", Tiranë, 1965.
- Kastrati, J.** "Histori e albanologjisë" I, Tiranë, 2000.

- Kostallari, A.** *Pjetër Bogdani dhe gjuha letrare shqipe*, “Pjetër Bogdani dhe vepra e tij”, Tiranë, 1991.
- Kostallari, A.** *Fjalori Latinisht-Shqip i F.Bardhit*, në FESH, vëllimi I, Tiranë, 2008.
- Kostallari, A.** *Kompozitat dëshirore dhe urdhërore të shqipes*, Studime filologjike 4, Tiranë, 1968.
- Kostallari, A.** *Mbi disa drejtime të përsosjes së sistemit e të strukturës së gjuhës sonë letrare*, “Studime filologjike”, Tiranë, 1982, 2.
- Kostallari, A.** *Rreth depërtimit të turqizmeve në gjuhën shqipe gjatë shek. XVII-XVIII*, “Studime mbi leksikon dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhë shqipe”, Tiranë 1989.
- Kruja, M.** “Nji studim analitik Gjuha e Frang Bardhit dhe shqipja moderne”, Tiranë, 2007.
- Lambretz, M.** *Bericht uber meine linguistischen Studien von Mittel Mai, bis Ende August 1916*, në “Anzieger der Akademie Wissenschaft in Wien”,. hist. Klasse XX, 1916.
- Luli, F.** *E folmja e Postripës*, “Studime Filologjike”, 3, Tiranë, 1974.
- Lloshi, Xh.** *Fjalori i Frang Bardhit dhe fjalësi shqip i Theodhor Kavaliotit*, ”400 – vjetori i Frang Bardhit”, Prishtinë, 2007.
- Mulaku, R.** *Elemente të një gramatike në Fjalorin e Bardhit*, ”400 – vjetori i Frang Bardhit”, Prishtinë, 2007.
- Ndreca, M.** “Fjalor shqip-serbokroatisht”, Prishtinë 1980.
- Omari, A.** *Pjetër Bogdani, “Cuneus prophetarum”*, botim kritik Tiranë, 2005.
- Omari, A.** “Marrëdhëniet gjuhësore shqiptaro-serbe”, Tiranë, 2012.
- Omari, A.** *Disa sllavizma të pavënëre në të folmet veriore të shqipes*, “Studime filologjike”, 1-4, Tiranë 1994.
- Osmani, T.** *Shënime për fonetikën e së folmes së Shirokës* në “Buletin Shkencor i Institutit Pedagogjik 2-vjeçar të Shkodrës”, Shkodër, 1965.
- Pepa, S.** *D. Nikollë Gazulli - themelues i leksikografisë krahinore dhe i asaj onomastike*, “Gjurmime kulturore”, Shkodër 2000.
- Pepa, S.** “Martirizimi i kishës katolike shqiptare” 1994-1990.
- Pepa, S.** *Kontributi i klerit katolik në leksikografinë shqiptare*, “Krishtërimi ndër Shqiptarë”- Simpozium Ndërkombëtar-Tiranë, 6-19 Nëntor 1999.
- Roque, M.** *Frang Bardhi dhe Fjalori i tij*, “Dijetarët francezë për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare”, Shkodër, 2005, marrë nga “Buletin Shkencor”, Shkodër, nr.4, 1966, përktheu nga frëngjishtja Willy Kamsi.
- Rrokaj, Sh.** *Fjalësi me prapashtesën –shëm në disa vepra të I.Kadaresë*, “Çështje të gjuhës shqipe”, Tiranë, 2007.
- Shkurtaç, Gj.** *E folmja e Kastratit*. “Studime Filologjike”, 2, 3, Tiranë, 1967.
- Shkurtaç, Gj.** *E folmja e Hotit*, ”Dialektologjia shqiptare” II, Tiranë, 1974.
- Shkurtaç, Gj.** *E folmja e Kelmendit*, “Dialektologjia shqiptare” III, Tiranë 1975.
- Shkurtaç, Gj.** *E folmja e Rranxave të Mbishkodrës*, “Dialektologjia shqiptare” IV, Tiranë 1982.
- Shkurtaç, Gj.** *Tri ndihmesat për gjuhën e Fishtës*, “Pesha e e fjalës shqipe”, Tiranë, 2009.
- Shuteriqi, D.H.S.** “Shkrimet shqipe në vitet 1332 – 1850”, Tiranë, 1976.
- Shamku - Shkreli, L.** *Fjalori i Gazullit dhe gegnishtja e papërmbushur*, ”Shtatë vjet prolog”, Tiranë, 2005.
- Shamku-Shkreli, L.** *Parathënie e botimit anastatik*, ”Fjalori i Gazullit”, Tiranë, 2005.

- Taliavini, K.** *Le parlate albanesi di tipo ghegho orientale* (Dardania e Macedonia nordoccidentale), "Le terre albanesi redenti", I, Roma, 1942.
- Topalli, T. - Haxhi, A.** *Shqipja e shkruar në shekullin e XVI-XVII*, "Histori e gjuhës së shkruar shqipe", Ushtrime, Shkodër, 2007.
- Topalli, T.- Haxhi, A.** *Shqipja e shkruar në shekullin XVI-XVII*, "Histori e gjuhës së shkruar shqipe", Shkodër 2007.
- Topalli, Xh.** *Disa vërejtje për të folmen e krahinës së Pukës*, "Dialektologjia Shqiptare" II, Tiranë, 1974.
- Thomai, J.** *Norma e gjuhës letrare dhe frazeologjia e gjuhës shqipe*, "Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe" III, Tiranë, 1989.
- Thomai, J.** *Frang Bardhi leksikograf*, "400 – vjetori i Frang Bardhit", Prishtinë, 2007.
- Zamputi, I.** "Relacione mbi gjendjen e Shqypnis veriore e të mesme në shekullin XVII", Vëllimi II, Tiranë, 1965.

Përmbledhje

Qysh në ideimin dhe hartimin e platformës së kësaj teme, kemi synuar që, nëpërmjet shqyrtimeve dhe paraqitjes së më të gjerë të leksikut të fiksuar në disa prej fjalorëve më të njohur të gegërishtes veriperëndimore, të mbërrinim edhe në një pamje relativisht të qartë e të plotë të vlerave fiksuese e njohëse të atyre fjalorëve si të tillë, po edhe, mbi të gjitha, të shihnim se sa ka përfituar prej tyre përfshirja në fjalorët e mëdhenj të shqipes dhe sa kanë peshuar të dhënat a prurjet e gegërishtes veriperëndimore në pasurimin potencial dhe real të leksematikës dhe thesarit ligjërimor të shqipes në tërësi. Këtij synimi, qoftë edhe disi largvajtës dhe jo i lehtë për t'u rrokur e zhदारitur plotësisht, i ka shërbyer edhe struktura e kësaj teze.

Si "bazë nisjeje", në punimin tonë synuam të paraqesim veçoritë të së folmeve të gegërishtes veriperëndimore, duke ravijëzuar tiparet fonetike dhe morfosintaksore të tyre, sipas asaj që dihej nga studimet dialektologjike të kryera në rrjedhë të viteve, qysh nga Relacioni i M.Lamercit i vitit 1916, deri në studimet më të reja për të folmet e qytetit të Shkodrës dhe të pjesës më të madhe të krahinave veriperëndimore, si ato të Malësisë së Madhe. Afrimi pranë e pranë dhe kundrimi krahasimtar, përmasës dhe diferencues i veprave leksikografike të këtyre autorëve me karakteristikat kryesore të së folmes së gegërishtes veriperëndimore, është bërë për faktin se, Bardhi, Gazulli e Dema kanë qenë (ndonëse me kulturë filologjike e albanologjike të ndryshme) folës të lindur të idiomës gege të kësaj treve.

Summary

From the design and development of the platform of this topic, we aim, through hearings and submitting the wider vocabulary fixed in some of the most renowned dictionaries gheg northwest, to arrive in a relatively clear picture of the full fixing cognitive value of those dictionaries as such, but also, above all, to see how much has benefited from their involvement in major albanian dictionaries and have a weighted data flows northwest gheg and real potential to enrich the lexic and treasurer of the albanian speech in general. This is the view, even if somewhat not easy to be compiled, has served the structure of this thesis.

As "starting base" in our study we aim to present the features of the gheg northwestern dialects, while outlining the phonetic features and their morphosyntactic according to what was known by dialectologic studies conducted in the course of years, since the ratio of M.Lamercit of 1916, to study the new idioms of Shkodra and most western provinces, such as Malësia e Madhe. The approach side by side and comparing contemplation, and differential lexicographic works of these authors of the main characteristics of gheg dialect northwest, is made of the fact that, Bardhi, Gazulli and Dema have been (though different philological and albanological culture) born speakers of the gheg area idiom.

